

PERMBAJTJA

HYRJA.....	3
KREU 1. “GJUHA DHE FUNKSIONI I SAJ SHPREHËS”	4
1.1 Gjuha dhe filozofia.....	4
1.2 Gjuha dhe format e shfaqjes së saj: natyra subjektive dhe funksioni shprehës.....	7
1.3 Relativiteti gjuhësor: dallime nuancash kuptimore midis ligjëruesit dhe dëgjuesit	10
1.4 Ide të përgjithshme rreth vlerës stilistikore: kumtuesi, mesazhi, marrësi i mesazhit.	12
KREU 2. “GJUHA NË KOHË DHE KOHA E FOLJEVE”	16
2.1 Çështja e parë: gjuha në kohë.....	16
2.2 Çështja e dytë: veprimi i foljes dhe koha e veprimit.....	19
KREU 3. DËFTORJA DHE RAPORTI I SAJ ME REALITETIN.	23
KREU 4: E TASHMJA E DËFTORES.	27
4.1 Fiksimi i një të tashmeje në të shkuarën.	27
4.2 E tashmja rrëfimtare.....	30
4.3 E tashmja me vlera të së ardhmes	41
4.4 Një e tashme aspektore që shtrihet në kohë.	44
4.5 Nuanca aspektore të kohës së tashme.	49
4.6 E tashmja e dëftores apo e tashmja e lidhore ?.....	52
4.7 Përdorimi i kohës së tashme me folje që shprehin dëshirë.....	56
4.8 Disa përdorime të tjera me vlera shprehimore dhe stilistikore të kohës së tashme.	58
4.9 E tashmja e njëkohëshme dhe e tashmja sportive.	63
KREU 5: E PAKRYERA E MËNYRËS DËFTORE	65
5.1 <i>C’era una volta</i>	65
5.2 Aspekti i veprimit zakonor, progresiv dhe i vazhdimësisë.	72
5.3 Njëkohëshmëri në të shkuarën.	78
5.4 E tashme në të shkuarën.....	83
5.5 Nuanca e të ardhmes në të shkuarën.	88
5.6 Vlera modale të kohës së pakryer.	92

5.7	Koha e pakryer në fjali hipotetike.	96
5.8	E pakryera rrëfimtare.	99
5.9	Vlera të tjera te kohës së pakryer.	104
	KREU 6: KOHA E KRYER DHE KOHA E KRYER E THJESHTË	112
6.1	Dallime shprehimore midis kohëve “të kryera” dhe kohës së pakryer.	115
6.2	Koha e kryer e dëftores.	120
6.3	Përdorime deiktike të kohës së kryer.	122
6.4	Nuanca jo-deiktike të kohës së kryer.	127
6.5	E kryera “jashtëkohore”	132
6.6	E kyera me nuancë aktualiteti.	134
6.7	Koha e kryer e thjeshtë.....	136
6.8	E kryera e thjeshtë gnomike.	141
6.9	Krahasime ndërmjet përdorimit të kohës së kryer dhe kohës së kryer të thjeshtë, në gjuhën italiane.....	143
	KREU 7 KOHA MË SE E KRYER DHE KOHA E KRYER E TEJSHKUAR	149
7.1	Mëse e kryera.	149
7.2	Vlera perfektive të më se të kryerës.	157
7.3	Veçanësi aspektore dhe modale të më se të kryerës.....	160
7.4	Koha e kryer e tejshkuar.	164
	KREU 8: E ARDHMJA DHE E ARDHMJA E PËRPARME	171
8.1	Vlera kohore të së ardhmes së thjeshtë.	173
8.2	Vlera aspektore të kohës së ardhme të thjeshtë.....	177
8.3	Vlera aspektore të kohës së ardhme të përparme.	179
	P Ë R F U N D I M E	184
	B I B L I O G R A F I A	190

HYRJA

Punimi me titull : Vlerat stilistikore të kohëve të mënyrës dëftore në gjuhën italiane, në përfaqje me shqipen”, bazohet në analizën e rasteve, në të cilat këto kohë shfaqen me vlera shprehimore dhe stilistikore jo standarte dhe me veçanësi kuptimore, ose aspektore. Punimi është menduar të përfshijë fushën e gjuhësisë, por duke patur parasysh faktin, që shëmbujt kanë të bëjnë edhe më fusha të tjera si komunikimi, letërsia, përkthimi (ballafaqimi i situatave në të dyja gjuhët), është menduar të shfrytëzohen edhe elementë të këtyre fushave, si p.sh marrja e shëmbujve nga tekste letrare, të cilat janë edhe më të ngarkuara me stilema dhe situata shprehimore të veçanta, shfrytëzimi i teorive të komunikimit për interpretimin e teksteve, përkthimi i shëmbujve dhe interpretimi i situatave shprehimore në kalimin nga njëra gjuhë në tjetrën, etj.

Qëllimi i punimit është thellimi i studimeve për kategorinë gramatikore të kohëve, si dhe arsyetimi që kohët foljore, më shumë se kohën, shprehin një orientim në kohë dhe hapësirë, qoftë të veprimit të shprehur nga folja, qoftë përta i përket konceptimit kuptimor nga ana e ligjëruesve. Kjo është edhe hipoteza, të cilën ky punim përpiqet të vërtetojë.

Objekt studimi janë situata të ndryshme shprehimore, të gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, në gjuhën italiane dhe shqipe, në të cilat janë përdorur kohët e mënyrës dëftore.

Metodat që do të përdoren janë ato induktivo – deduktive, si dhe metoda e krahasimit, kryesisht në funksion të përfaqjes së fenomeneve në të dyja gjuhët. Përzgjedhja e këtyre metodave është e lidhur ngushtësisht me analizën dhe interpretimin e rasteve të marra në shqyrtim, si dhe me ballafaqimin e shfaqjes së fenomeneve në dy gjuhë të ndryshme: ndryshimet dhe të përbashkëtat.

Ky punim synon të pasurojë fondin e studimeve rreth vlerave shprehimore dhe stilistikore të kohëve të mënyrës dëftore, të ndihmojë në saktësimin e këtyre vlerave përta i përket informacionit që i jepet nxënësve dhe studentëve, veçanërisht nga mësuesit dhe pedagogët e gjuhëve të huaja, si dhe për një shqyrtim me kënd më të gjërë të “sjelljes” së kohëve foljore, në gjuhën reale, praktike, larg perceptimeve të ngurta thjesht teorike dhe në favor të pasurimit të mëtejshëm të gjuhës dhe formave të saj të përdorimit. Këto synime përbëjnë edhe rezultatet e pritshme të këtij punimi, të cilat nuk mund të përfundojnë vetëm me përfundimin e tij, por do të mbeten gjithsesi objekt shqyrtimi dhe studimi të vazhdueshëm.

KREU I. “GJUHA DHE FUNKSIONI I SAJ SHPREHËS”.

1.1 Gjuha dhe filozofia.

Me mrekullinë e ekzistencës dhe nëpërmjet formave të shfaqjes së saj, gjuha ka mundësuar ngritjen dhe përsosjen e mjaft disiplinave që studiojnë atë vetë.

Duke studiuar vetveten, jo rrallë gjuha krijon iluzionin e një mëvetësie nga disiplinat e tjera njohëse apo studimore, gjë që në realitet nuk ka si të jetë e vërtetë.

Kqyrja e gjuhës në tërësinë e saj, si dhe analizat gjuhësore të çdo lloji, kthehen në objekt të “mendimit” dhe të “menduarit të thelluar”, të këndvështrimit, kulturës dhe rrethanave në të cilat ndodhet kqyrësi, elementë këta që jo rrallë përcaktojnë edhe fatin e përfundimeve studimore mbi gjuhën.

Së këtejmi, vetë gjuha dhe këndvështrimi ynë për të kthehen në objekt të filozofisë. Thënia humboltiane “*Një gjuhë, një këndvështrim*”,¹ na kujton hera herës që zëvendësimi i një shenje gjuhësore me një tjetër, qoftë edhe sinonimike, nuk mund të marrë karakter arbitrar.

Sekreti për të kuptuar deri në fund fenomenet, përfshirë edhe ato gjuhësore, qëndron në njohjen e plotë të konceptit dhe të terminologjisë, me të cilën e “thërrasim” në mendje këtë koncept. Gjuha, e konceptuar si sistem shenjash,² nuk është një fenomen që qëndron jashtë realitetit dhe pavarësisht prej tij. Gjuha qëndron si një urë lidhëse midis Realitetit dhe Njeriut. Arsyeja përse jemi të aftë ta njohim këtë realitet, është pikërisht ekzistenca e këtij “sistemi shenjash”, me anë të të cilit ne jo vetëm shkëmbejmë mesazhe, por përcjellim edhe njohuritë tona mbi botën, si dhe i shtojmë e i përsosim ato.

Me anë të gjuhës, Njeriu ka qënë i aftë të dalë përtej vetvetes, të komunikojë me njerëz të tjerë, të përcjellë, krijojë, apo ndryshojë gjëndje të caktuara shpirtërore; të njohë thelbin e çdo sendi apo fenomeni dhe ta përshkuajë atë duke e kthyer në objekt vëzhgimi,

¹ “*Le diversità delle lingue*”, V.v. Humbolt, Laterza, 2004.

² “*Corso di linguistica generale*”, F. Saussure, Laterza, 1987, f. 17 – 21; 83 – 120.

“*Dizionario di linguistica*”, Zanichelli, 1983, f. 259 - 262.

pra të rrëzojë çdo barrierë që qëndron mes “botës së tij të brëndshme shpirtërore e mendore” dhe gjithshkaje që e rrethon.

Përtej konceptit të gjuhës si *sistem shenjash*, marrëdhënia e njeriut me gjuhën nuk është e njëanshme.³ Nuk ndikon vetëm gjuha mbi njeriun, por edhe ky i fundit mbi gjuhën. Nëpërmjet “përzgjedhjes” së materialit gjuhësor, njeriu përpiket të bëjë të ditura këndvështrimet e veta, bindjet, besimet, filozofitë, ideologjitë, etj. Ai e kthen gjuhën në mjet për mbrojtjen e këtyre pikpamjeve dhe ideve, duke u përpjekur madje të përpunojë e të mbrojë edhe mendime të ndryshme filozofike rreth gjuhës.

Stoikët apo aristotelianët, strukturalistët apo gjenerativistët, materialistët apo idealistët, secila prej rrymave ka lënë pa dyshim gjurmët e veta në zhvillimin e filozofisë së gjuhës.

Potencialisht reale në themelin e një *bote* konceptuale, gjuha në tërësi dhe çdo element gjuhësor në veçanti, nuk mund të mbërthehet brënda një kuptimi të vetëm, apo një numri të kufizuar kuptimesh. Ajo është e aftë të tejkalojë çdo parashikim të individit, duke e ndryshuar pa ndërprerje “sjelljen” e saj në raport me individin. “E gjallë” dhe me një “jetë” tërësisht të sajën⁴, gjuha ndryshon kuptimet dhe perceptimet.

Secili prej elementëve gjuhësorë, nuk mbart një kuptim të vetëm, por siç vërehet rëndom edhe gjatë situatave të ndryshme të jetës së përditshme, duhet pranuar fakti i pranisë të shumë kuptimeve, shpesh edhe të njëkohshëm,⁵ në varësi kjo edhe të ndërlikimit të situatave. Me kuptimet denotative, konotative, kontekstuale, të nënkuptuara, të aluduara, apo të keqkuptuara, gjuha të josh dhe të udhëheq drejt labirintesh të pafundme konceptuale.

Me kuptime të fjalës, të fjalisë, apo të krejt një teksti, me kuptime gramatikore apo semantikore, gjuha na paraqitet jo si potencial dy përmasor (shenjuesi dhe i shenjuari, gramatika dhe leksiku, natyra objektive dhe ajo subjektive, etj.), por në gjenialitetin e ekzistencës së vet, si një realitet shumëpërmasor.

³ “*Corso di linguistica generale*”, F. Saussure, Laterza, 1987, f. 17 – 21; 83 – 120.

“*Fjalët e Ajnshtajnit*”, D. Gouthier, E. Ioli, Dituria, 2008.

“*Dizionario di linguistica*”, Zanichelli, 1983, f. 259 - 262.

“*Il segno del soggetto*”, E. Macola, L. Marcheselli, Editre Edizioni, 1983, f. 7 – 31

“*Semiotica e filosofia del linguaggio*”, U. Eco, Einaudi, 1996.

⁴ “*L'estetica come scienza dell'espressione e linguistica generale*”, B. Croce, Laterza, 1902.

⁵ Nisur nga modeli i “*logos*”, që shpreh njëkohësisht konceptet: *fjalë, fjalim, botë, fjalë hyjnore, arsye*, etj.

“*Dizionario Enciclopedico Sansoni*”, 1986; “*Atlas i Ilustruar i Filozofisë*”, U. Nicola, I.S.P., 2004.

Polisemia dhe fusha semantike, kuptimi dhe aspekti, janë dy mënyra të ndërsjellta të shfaqjes së realitetit gjuhësor, me ndikim të drejtë për drejtë në përcaktimin konceptual të këndvështrimit.

Në marrdhënien gjuhë – filozofi, është e vështirë të vendoset cila ndikon më tepër në zhvillimin e tjetrës, por pa dyshim që ky ndikim është i ndërsjelltë.⁶

Shenja dhe i shenjuari, forma dhe përmbajtja, gramatika dhe semantika, nuk mund të konsiderohen si të pavarura prej njëra tjetrës. Dualiteti mund të shërbejë vetëm si lehtësi për studimet gjuhësore, ndërsa në themel të gjithshkaje qëndron i njëjti realitet: gjuha me shumëllojshmërinë e shfaqjeve të saj.

Kjo është arsyeja, që në këtë punim, i gjithë materiali gjuhësor, i sjellë për t'u analizuar, është konceptuar si shumëkuptimor, në formë dhe në përmbajtje. Gramatika, semantika dhe aspekti, janë konceptuar të lidhura ngushtë dhe në ndryshim të vazhdueshëm raportesh ndaj njëra tjetrës, në varësi të situatave shprehimore.

Duke mos harruar për asnjë çast funksionin metagjuhësor dhe duke shfrytëzuar sa më kënaqshëm filozofinë e gjuhës, bëhet e mundur një analizë shumëplanëshe mbi fenomenet gjuhësore. Gjithsesi, këndvështrimi që përftohet nga një analizë e tillë nuk nënkupton pavarësinë e analizuesit prej gjuhës, por një marrdhënie reciproke, e cila duhet mbajtur kurdoherë parasysh.

⁶ “*Semiotica e filosofia del linguaggio*”, U. Eco, Einaudi, 1996.

“*Segno*”, U. Eco, Istituto Editoriale Internazionale, 1973.

“*La linguistica sincronica*”, M. Durante, Boringhieri, 1975.

1.2 Gjuha dhe format e shfaqjes së saj: natyra subjektive dhe funksioni shprehës.

Ka një kuptim të përgjithshëm të termit “Gjuhë”.

“Gjuha është një mjet komunikimi, një sistem shenjash tingullore, të përbashkëta për të gjithë anëtarët e të njëjtit komunitet folës”.⁷

Me pohimin që “gjuha është një sistem shenjash”, risjellim në vëmendje faktin që materiali gjuhësor është potencialisht i organizuar dhe i gatshëm për t’u përdorur, nëpërmjet rregullash dhe strukturash gramatikore, që e bëjnë të mundur një gjë të tillë.

Por përtej realitetit të ekzistencës objektive të gjuhës si një sistem shenjash, vazhdimisht gjuhëtarët janë përballur me mënyrat subjektive dhe individuale të shfaqjeve të saj.

Një gjuhë, në fakt, nuk shfaqet kurrë me të gjithë potencialin njëkohësisht, por duke shfrytëzuar natyrën e saj subjektive, ose thënë ndryshe, vetëm nëpërmjet “prodhimeve gjuhësore” të sjella prej përdoruesve të saj.

Shumëllojshmëria dhe mënyrat me anë të të cilave ajo shfaqet, varen tërësisht prej përzgjedhjes së materialit gjuhësor të individëve. Secila prej këtyre përzgjedhjeve përbën një mënyrë subjektive jo vetëm të përdorimit të gjuhës, por edhe të qëndrimit që mban individi përkundrejt realitetit, të cilit i referohet.

Përzgjedhja e materialit gjuhësor varet shpesh nga faktorë të “jashtëm”, por me ndikim të drejtëpërdrejtë në mënyrën si individi shprehet. Të tillë faktorë janë kultura, aftësia gjuhësore e secilit prej individëve, moshë, seksi, profesioni, përkatësia e një ambienti të caktuar gjeo-gjuhësor e shoqëror, koha, vëndi, prania ose jo e personave të tjerë, gjykimet apo paragjykimet paraprake rreth çështjes për të cilën individi shprehet, qëllimi që ai ka, posti që zë në shkallën e hierarkisë shoqërore, etj.

Të gjithë këta faktorë sjellin ndryshime të drejtë për drejta në përzgjedhjen e materialit gjuhësor, qoftë në leksikun që përdoret, qoftë në strukturat gramatikore të perceptuara si më të përshtatshme.

Në gjuhën italiane, për shembull, përdoret, apo përzgjidhet për t’u përdorur mënyra dëftore, për t’i dhënë bashkëbisedimit, apo ligjërimin në përgjithësi, një karakter

⁷ “Dizionario di Linguistica”, Zanichelli, 1983, f. 174.

familjar dhe bashkëbisedimor; ndërsa bëhet përzgjedhja e mënyrës lidhore, për t'i dhënë gjuhës një karakter më formal dhe më të përpunuar.⁸

Natyra subjektive e gjuhës është vazhdimisht e pranishme në komunikimet e çdo lloji.⁹ Ajo nxjerr në pah “imazhin” personal të individit, të ndërruar në mënyrë të drejtë për drejtë prej nivelit të tij të njohjes. Ndërkohë që përdor gjuhën për të komunikuar me individët e tjerë, përdoruesi i saj përpiket t'u përcjellë atyre pikërisht këtë nivel dhe këndvështrim njohjeje, e cila jo gjithmonë është e njëjtë me nivelin dhe këndvështrimin e njohurive të individëve të tjerë.

Ky fakt e bën gjuhën jo vetëm të larmishme për nga nuancat kuptimore, por edhe mjaft elastike e të ndryshueshme. Çdo fjalë, shprehje, fjali, apo edhe kategori gjuhësore, “vishet” me nuanca të ndryshme, sipas “imazheve” që përcjellin apo perceptojnë individët me kulturë ndryshme, eksperiencë gjuhësore jo të njëjta, etj.

Përveç kësaj, gjuha ka edhe një funksion shprehës.

Me anë të gjuhës, nuk komunikojmë vetëm informacione apo opinione rreth këtyre informacioneve, por mbi të gjitha përcjellim te bashkëbiseduesit edhe gjëndjen emocionale të çastit të ligjërit. Me anë të gjuhës ne komunikojmë gëzimin dhe hidhërimin, lumturinë dhe trishtimin, emocionin dhe ndjenjën, shpresën dhe frikën, sigurinë dhe pasigurinë, mundësinë dhe pamundësinë, dëshirën, urimin, mallkimin e shumë e shumë përjetime të tjera të botës shpirtërore.

Shpesh herë gramatika është e pamjaftueshme për të shprehur një pasuri të tillë përjetimesh; po kështu edhe polisemia denotative, apo strukturat standarte të të shprehurit. Ndodh pikërisht në një rast të tillë, që nisin e vihen në lëvizje të tjera mekanizma gjuhësore për ta dhënë sa më të plotë mesazhin, si fusha semantike me të gjitha nuancat semantike që ajo përcjell, aspekti semantikor dhe ai gramatikor, vendosja e fjalëve në fjali, apo qoftë edhe “përdorimi i pazakontë” i disa formave gramatikore, të lejuara dhe mjaft të përhapura në disa prej gjuhëve sektoriale¹⁰, si p.sh. në atë të reklamave, në zhargonet e ndryshme, në gjuhën poetike, etj.

⁸ “*Grammatica per italiani maggioreni*”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989, f. 37 – 50.

⁹ “*Italiano antico e nuovo*”, G. L. Beccaria, Garzanti, 1988.

“*Lingua e linguaggi*”, F. Sabatini, Loescher Editore, 1990, f. 3 – 240.

¹⁰ “*Italiano antico e nuovo*”, G. L. Beccaria, Garzanti, 1988, f. 159 – 202.

“*Lingua e linguaggi*”, F. Sabatini, Loescher Editore, 1990, f. 3 – 240.

Në varësi të komunikimit të përjetimeve të tilla, individi ndryshon shpesh, edhe këndvështrimin, edhe “interpretimin” që ai u bën disa kategorive dhe elementëve gramatikorë, duke i “pajisur” këta të fundit me ngjyime e nuanca të ndryshme shprehimore, si dhe jo rrallë me vlera stilistikore.

Kjo nuk do të thotë që në raste të tilla gjuha pëson ndryshime të thella dhe radikale, duke u përpunuar vazhdimisht dhe duke u larguar nga standarti, por që shfrytëzohen dhe zhvillohen mundësitë e brëndëshme të vetë gjuhës, fenomen ky, të cilin gjuhëtarët e kanë quajtur “organizim dytësor i gjuhës”.¹¹

Për shkak se gjuha është mjeti që realizon dhe komunikon, me ane të potencialit të saj shprehës dhe strukturor, realitete vazhdimisht të ndryshme, ose në ndryshim të vazhdueshëm, tërësia e rregullave gramatikorë është qartazi e pamjaftueshme për të riprodhuar objektivitetin e të gjithë larmisë së situatave shprehimore, të pranishme në ligjërimin përditësor. Për këtë arsye, çdo situatë shprehimore mund të rikrijohet, komunikohet apo kuptohet, sepse përtej skemave standarte, të gatshme dhe denotative gjuhësore, ekzistojnë edhe mundësi të komunikimit në mënyrë jo të drejtë për drejtë, për nga ana kuptimore, të këtyre situatave. Mund të përmëndim si shëmbull ironinë, sarkazmën, alegorinë, aludimin, nënkuptimet në përgjithësi e deri edhe përdorimet me kuptime hermetike të gjuhës.

E përfshirë brënda kësaj “jete dhe gjallërie” gjuhësore, gramatika nuk mbetet më një disiplinë e ngurtë, e papërpunueshme dhe e paevolueshme. Në të gjitha shfaqjet morfo-sintaksore të gjuhës, vihet re prania e një larmie mjaft të pasur të nuancave kuptimore, ose edhe e nuancave aspektore. Janë pikërisht këto nuanca dhe aspekte, që i japin elasticitet anës kuptimore të gramatikës, dhe që më pas bëhen objekt shqyrtimi dhe studimi i asaj që quhet “stilistikë gramatikore”, ose “stilistika e gramatikës”.

Edhe në raste të tilla, mundësinë e shfaqjeve të shumëllojta aspektore e favorizon “përzgjedhja e materiali gjuhësor” në përgjithësi dhe e materialit gramatikor në veçanti. Kështu për shëmbull, një përzgjedhje e vetës së dytë njëjës ose shumës në gjuhën shqipe, apo vetës së tretë njëjës në vënd të vetës së dytë në gjuhën italiane, nuk sjell ndryshime vetëm në mënyrën e të shprehurit, por edhe të raportit të individit me bashkëfolësin e tij, në marrdhënien që ata vendosin mes tyre, në kulturën që ata shfaqin , etj..

Vështruar në këtë aspekt, gramatika nuk është vetëm një sistem i ngurtë rregullash, por një këndvështrim përkundrejt realitetit, mundësitë e interpretimit të të cilit varen

¹¹ “*Dizionario di Linguistica*”, Zanichelli, 1983, f. 177 – 180.

tërësisht prej raporteve me realitetin, që ky këndvështrim vendos. Jo rrallë, këto këndvështrime gramatikore paraqesin edhe vlera të mirëfillta stilistikore, të cilat ndihmojnë në pasurimin dhe përsosjen e vazhdueshme të trashëgimisë gjuhësore.

1.3 Relativiteti gjuhësor: dallime nuancash kuptimore midis ligjëruesit dhe dëgjuesit.¹²

Gjuha nuk përfaqëson një realitet të ngrirë, të dhënë një herë e përgjithmonë dhe të pandryshueshëm. Ajo përshtatet në kohë dhe hapsirë dhe gdhëndet në mënyrë të vazhdueshme me karakteristikat ligjërimore, individuale, të përdoruesve të saj.

Në teorinë strukturaliste të shenjës, fjala përcaktohet e përbërë nga dy pjesë : shënjesi dhe i shënjuari¹³. Shënjesi i konceptuar si shenjë konvencionale që shërben për të “thirrur” në vëmëndjen e përdoruesve gjuhësore një realitet, qoftë ky objekt, fenomen, apo ide; i shënjuari përfaqëson konceptin e këtij realiteti të “thirrur” prej shënjesit. Por në komunikimin e ndërsjelltë midis njerëzve, ndërhyt edhe “imazhi” që krijon fjala dhe që ka të bëjë me ngjyrimin, ose nuancën e fjalës.

Çdo individ ka një trashëgimi dhe një eksperiencë të ndryshme jetësore dhe gjuhësore nga individët e tjerë, ndryshim të cilin e pasqyron edhe në imazhin që i krijon atij secila prej fjalëve.

Për shembull, kur përmendim fjalët: *shtëpi* (casa), *plazh* (spiaggia), *qiell* (cielo), *diell* (sole), *det* (mare), etj., çdokush prej individëve, nëpërmjet shenjave konvencionale të gjuhës përkatëse, evokon konceptin kuptimor të këtyre fjalëve. Por jo të gjithë individët ndajnë imazhe të njëjta për këto realitete. Nisur nga disa faktorë, si vëndi ku kanë jetuar (vënde të ftohta apo të ngrohta, të pasura apo të varfëra), psikologjia e moshës, njohuritë, ndjeshmëritë, eksperiencat gjuhësore dhe shumë e shumë faktorë të tjerë, imazhet që

¹² Ideja dhe termi “*relativitet gjuhësor*” janë përdorur pas leximit të librit “*Relativiteti, teoria speciale dhe e përgjithshme*”, A. Ajshtajni, Bargjini, Tiranë 2001. Në mjaft pjesë të saj, teoria bën fjalë për ndryshime kohore, në raport me sistemet e referimit; një teori kjo mjaft e ngjashme me kohën e veprimit, në raport me çastin e ligjërimit, me çastin e leximit, të të shkruarit, si dhe me mjaft pika referimi kohor, të cilat trajtohen në këtë doktoratë.

¹³ “*Corso di linguistica generale*”, F. Saussure, Laterza, 1987.

gjithsecili ka për shtëpinë, plazhin, qiellin, diellin, detin, etj., mbartin ndryshime përmasore dhe cilësore. Ato varen tërësisht prej eksperiencave jetësore dhe gjuhësore.

Por në këtë pikë të arsytimit, nevojitet të hapim një parantezë rreth konceptit të “imazhit” në gjuhësi.

Ky koncept, në dekadat e fundit ka fituar disa përmasa të reja. “Imazhi” në gjuhë nuk perceptohet më vetëm si figurë, por edhe si shije (p.sh imazhi i ndjesisë së shijes që evokon përmëndja e emrit të një ëmbëlsire), si nuhatje (imazhi i ndjesisë së aromës që evokon emri i një luleje), si dëgjimor (tingujt e nje melodie që na vijnë në mëndje), ideor (një ide e shprehur në art nëpërmjet simboleve), etj. Sot po flitet gjithnjë e më tepër për imazhe shqisore, apo imazhe të perceptimit ideor.

Duke mbajtur parasysh sa thamë më sipër dhe duke u kthyer rishtazi te pjesët përbërëse të fjalës, tashmë dallojmë:

a – shenjuesin – të njëjtë për individët e të njëjtit komunitet folës;

b – të shënjuarin – në më të shumtën e rasteve, nuk ndryshon për të gjitha komunitetet gjuhësore apo njerëzore anë e mbanë botës;

c – “imazhin” që fjala mbart – të veçantë për secilin prej individëve.

Gjatë aktit të komunikimit, çdo individ nuk transmeton te bashkëbiseduesi thjesht një mesazh kuptimor, por ai përpiqet të përcjellë edhe imazhin apo tërësinë e imazheve krejtësisht individuale¹⁴, me të cilin ai e ngarkon ligjëratën e tij.

Nëse do të merret shëmbulli i një situatë shprehimore, kur shenjuesi dhe i shenjuari kuptohen tërësisht prej marrësit dhe dhënësit të mesazhit, ndryshimin e sjell imazhi dhe jo vetëm i fjalës, por edhe ai i fjalisë, tekstit, apo realitetit të perceptuar nga të dyja palët.

Thënë kjo, është më e lehtë të kuptohet relativiteti i nuancave, kuptimeve aspektore, ose efekteve shprehëse që gjuha përcjell. E gjallë, elastike, e ndryshueshme për nga forca dhe mënyra shprehëse, në periudha të ndryshme kohore gjuha e riformon në vazhdimësi vetveten dhe realitetin.;

Ajo pëson ndryshime shumë të ngadalta në strukturë, në rregulla gramatikore apo në leksik, por në mënyrën aspektore të të perceptuarit të gjërave, në nuancat shprehimore që sjell, në ngjyrimet me të cilat e vesh e mbështjell ligjëratën, gjuha e pasuron vetveten

¹⁴ “Guida allo studio della letteratura”, R. Cesarani, Laterza, 1999.

pafundësisht, duke iu përshtatur psikologjisë, kulturës, zhvillimit teknologjik e shkencor të përdoruesve të saj.

Janë pikërisht këto ndryshime, të cilat kur bëhen objekt krahasimesh, nxjerrin në pah vlera të bukura, elegante, të pazakonta shprehimore dhe stilistikore.

Këtyre ndryshimeve nuk u shpëtojnë as kategoritë gramatikore në përgjithësi, as kohët foljore në veçanti.

1.4 Ide të përgjithshme rreth vlerës stilistikore: kumtuesi, mesazhi, marrësi i mesazhit.

Në shumëllojshmërinë e shfaqjeve të saj, gjuha paraqitet shpesh me devijime nga standarti përditësor, duke nxjerrë në dukje disa vlera të veçanta shprehimore, të konsideruara edhe si vlera stilistikore. Janë pikërisht këto raste, që e bëjnë gjuhën më të larmishme, më elastike dhe madje më të suksesshme.

Ndodh shpesh që kur i referohemi vlerave stilistikore, të mendojmë se bëhet fjalë thjesht për produktin e një akti krijues. Pjesërisht do të ishte e vërtetë, nëse analiza e çështjes do të përfundonte pa u thelluar edhe më tej në praktikën e derisotme.

Duke u futur me dashje brënda kuadrin të teorive më moderne të komunikimit, vlera stilistikore po lidhet gjithmonë e më shpesh me qëllimin e kumtuesit, me qëndrimin e tij kundrejt bashkëbiseduesve të pranishëm¹⁵ ose potencialë (në rastin e gjuhës së shkruar), si dhe me qëndrimin e tij kundrejt realitetit fenomenal që e rrethon. Në këtë pikë, qëllimi dhe qëndrimi i kumtuesit mund të na shfaqen në dy forma:

a – i vetëdijshëm; në një pjesë të konsiderueshme të rasteve kemi të bëjmë me atë që shumë studiues e quajnë krijimtari të mirëfilltë;

b – i pavetëdijshëm, spontan, që lidhet më tepër me qëndrimin e kumtuesit, por që nuk e zhvleftëson rëndësinë e pranisë së vlerave stilistikore.

¹⁵ “Komunikimi”, X. Mignot, Ch. Baylon., përkthyes Xh. Lloshi, Tekste Universitare, 2005.

Sido që të jetë, ç'ka u tha më sipër ka të bëjë më së tepërmi me ata që i krijojnë këto vlera, ndërsa do të ishte e parakohshme të emërtoheshin *vlera stilistikore*¹⁶, në vend të përdorimit të termit *vlera shprehimore*¹⁷, pa patur parasysh disa kritere të mirëfillta për njohjen e tyre si të tilla.

Arsyeja është e thjeshtë: vlerat stilistikore përcaktohen rreptësisht në kontekst dhe shpesh janë të ndërvarura nga opinioni i publikut, të cilit i drejtohet teksti apo ligjërimi. Le ta analizojmë pak më hollësisht këtë arsyetim.

Në argumentet që mund të sjellim në mbështetje të sa më sipër, duket mjaft i përshtatshëm shëmbulli i “sjelljes” së figurave retorike, në situata të ndryshme shprehimore. Janë të shumtë ata që mendojnë se çdo figurë retorike, paraqitet në vetvete edhe si një vlerë stilistikore, të cilën e shfaq sa herë që përdoret, por pohimi i mësipërm nuk do të mbante parasysh një fakt, me të paktën dy çështje:

E para: konsumimin e vetë figurës retorike nga përdorimi i vazhdueshëm.

E dyta: “gadishmërinë emocionale” të dëgjuesit ose lexuesit, për ta pritur të plotë kuptimin konotativ të figurës retorike.

P.sh. Nëse do të përdornim metaforën me prejardhje nga gjuha e popullit “*këmbë tavoline*”, kjo shprehje do t'i linte emocionalisht të ftohtë bashkëbiseduesit dhe për pasojë nuk do të vlente si stileme nëse:

E para: metafora nuk do të ishte pjesë e një konteksti me ngarkesë konotative (dhe për rrjedhojë të pa konsumuar) – “*Je këmbë e tavolinës*”¹⁸ – me kuptimin “Je i vogël”.

E dyta: nëse nuk do ta vendosim shprehjen “*këmbë tavoline*” brënda një mesazhi me kuptim dhe të shoqëruar nga një kontekst i kuptueshëm lehtësisht prej bashkëbiseduesit, që do ta ngacmonte këtë të fundit edhe emocionalisht, duke krijuar një efekt sa përkëdhelës, aq edhe me një ironi të lehtë, mirëdashëse.

¹⁶ “*Dizionario di Retorica e Stilistica*”, UTET, 2008, f. 454 – 459.

¹⁷ Term i lidhur me funksionin shprehimor të gjuhës, me anë të të cilave shprehen ndjenjat, gjëndjet shpirtërore, etj. “*Dizionario di Linguistica*”, Zanichelli, 1983, f. 110.

Gillo Dorfles e shtrin edhe më tej termin, duke folur për vlerën e mjeteve shprehimore në art (valori dei *mezzi espressivi*), qoftë duke iu referuar mjeteve materiale apo gjuhësore të përdorura dhe impaktit që krijojnë ato te publiku, qoftë duke iu referuar teknikave. (“*Il divenire delle arti*”, G. Dorfles, Bompiani, 1998, f. 51 – 65.

“*Studi di stilistica*”, G. Devoto, LeMonier, 1950, f. 25 – 35.

“*Il linguaggio*”, C. Schick, Einaudi, 1960, f. 246 -268.

¹⁸ Shprehja “*këmbë tavoline*” është me prejardhje dialektore. Përdoret në zonat e Delvinës, Sarandës, Gjirokastrës dhe në disa zona aty rrotull, me kuptimin “*je i vogël në moshë dhe në shtat*”.

Pra dallimi midis termave : *vlera shprehimore* dhe *vlera stilistikore* është qartësisht i dukshëm, po të mbajmë parasysh që rasti i parë e shoqëron vazhdimisht kumtimin dhe lidhet me aksin *kumtues – mesazh*; ndërsa rasti i dytë i referohet kryesisht emocioneve, ndijimeve, shijes, intuitës, dëshirës, reagimeve etj.,¹⁹ që kanë të bëjnë më tepër me kontekstin e mesazhit dhe shfaqen në mënyrë disi më të dukshme brënda aksit *mesazh – marrës i mesazhit*.

Nga ana tjetër, nuk duhet lënë mënjanë edhe një karakteristikë tjetër e elementëve stilistikore. Të shfaqur e të konsideruar të tillë mbi kriterin e efektit që përcjellin, ata e ndryshojnë vazhdimisht masën e këtij efekti, në varësi të aftësive shprehëse të kumtuesit, të aftësive perceptuese të marrësit të mesazhit, si dhe të mjaft faktorëve të tjerë rrethorë. Thënë ndryshe, këto vlera veprojnë brënda këndvështrimeve individuale dhe subjektive të përdoruesve të gjuhës.

Në një farë kuptimi, pra, “vlerat stilistikore” i ngushtojnë ose i zgjerojnë *kufijtë* dhe forcën e tyre shprehëse, në varësi të faktorëve që në pamje të parë e sipërfaqësore mbeten të pavarur dhe indiferentë kundrejt tyre. Kjo natyrë e tyre, mund të vërtetohet fare thjeshtë me anë të analizës stilistikore. Dy studiues të ndryshëm, të cilët do të analizonin të njëjtin tekst, nuk do të ishte aspak çudi që të vërenin edhe elementë të ndryshëm vlerash nga njëri tjetri.

Çështja ndërlikohet edhe më tepër, nëse do t’i referohemi për një çast teorive të interpretimit të teksteve. Në një rast të tillë, kumtuesi nuk do të ishte më “padroni” i mesazhit që ai vetë ka krijuar²⁰, ndërsa në krahun tjetër, marrësi i mesazhit do të vihej nën ndikimin e plotë të mesazhit, i cili në periudhën kohore të ekzistencës së vet, “do të fitonte një pavarësi kuptimore, madje shumëplanëshe nga kumtuesi”.

Nisur nga ky këndvështrim, një studiues i stilistikës, apo i çfarëdo fushe tjetër gjuhësore, do t’i linte mënjanë si kumtuesin, ashtu edhe marrësin, duke “dialoguar” në analizën e tij vetëm me tekstin si produkt përfundimtar dhe duke u kthyer edhe ai vetë në marrës të mesazhit. Ky i fundit, mesazhi, do të shfaqej edhe njëherë fuqplotë përballë “studiuesit hipotetik”, duke e vendosur atë nën pushtetin e tij. Përfundimisht, i vetmi sovran do të mbetej vetë mesazhi, të cilin secili studiues i stilistikës apo i kritikës letrare,

¹⁹ Fenomen i marrë në konsideratë si perceptim dhe këndvështrim : “*Guida allo studio della letteratura*”, R. Cesarani, Laterza, 1999, f. 88 – 135.

“*Il divenire delle arti*”, G. Dorfles, Bompiani, 1998, f. 243 – 272.

²⁰ “*Guida allo studio della letteratura*”, R. Cesarani, Laterza, 1999.

“*Dire, fare, capire*”, G. Bottiroli, D. Corno, T. De Mauro, Paravia, 1990, f. 17 – 41.

“*Le oscillazioni del gusto*”, G. Dorfles, Einaudi, 1990.

“*Apogeo ed eclissi della stilistica*”, C. Segre, Einaudi, 1993, f. 23 – 37.

do ta analizonte sipas formimit kulturor, gjuhësor, eksperiencës, moshës, qëllimit, gjëndjes emocionale të çastit, etj.

Prej këtyre faktorëve, si dhe prej mjaft të tjerëve, varet dhe përcaktimi i vlerave stilistikore, që secili studjues do t'i jepte mesazhit në vetvete. Për ta qartësuar më tepër, mjafton të përmëndim disa shëmbuj, mundësisht ekstremë në natyrën e tyre, me qëllim që ideja të shpaloset sa më mirë (gjithmonë në kontekstin e një debati rreth interpretimeve të ndryshme për të njëjtin mesazh). Të tillë janë qëndrimi i myslymanëve fundamentalistë ndaj biblës dhe i të krishterëve jo tolerantë ndaj kuranit, ose i idhtarëve të realizmit socialist ndaj “librave të verdhë” të viteve '60 – '70, e kështu me rradhë.

Por a ka kritere për të përcaktuar vlerat stilistikore? A mund të flitet për ndryshueshmëri të këtyre vlerave në kohë dhe hapësirë? Mendojmë që ka kritere të tilla dhe në këtë pikë ndoshta na duhet të kthehemi më shumë se një shëkull pas, për t'iu referuar në këtë mënyrë ideve të hedhura nga studiuesi dhe filologu austriak Leo Spitzer. Duke mbështetur këndvështrimin e tij, vlerat stilistikore do të haseshin dhe përcaktoheshin kudo ku intuita dhe analiza e studuesit, do të ndeshnin një largim nga përdorimi standart, ose edhe normal i gjuhës dhe do të ballafaqoheshin me një qëndrim emocional, ose tejet teknikist të përdoruesit²¹.

Me përgjegjësinë që merr mbi vete për të kryer një analizë serioze, vetë studiuesi duhet të qëndrojë emocionalisht i ftohtë dhe i logjikshëm në përfundimet që nxjerr, si dhe të jetë një njohës i mirë i gjuhës, mbi materialin e të cilës ushtron veprimtarinë e tij analitike.

²¹ “Çdo emociion, si dhe çdo largim i yni nga një gjëndje psikologjike normale, i korrespondon në mënyrën e të shprehurit një largimi nga një përdorim normal i gjuhës; dhe e kundërta: çdo largim nga përdorimi i një gjuhe standarte shënon fillimin e një gjëndjeje psikike jo të zakonshme” – “Critica stilistica e semantica storica”, L. Spitzer, Laterza, 1966, f. 46.

Përsa i përket qëndrimeve teknikiste të përdoruesve të gjuhës, fjala është për gjuhët sektoriale dhe për shtrirjen gjithnjë e më të gjerë të disa prej tyre, si p.sh. gjuhës burokratike, asaj tekniko-shkencore, etj. (“*I linguaggi settoriali in Italia*”, G. Luigi Beccaria, Bompiani, 1983.)

KREU 2. “GJUHA NË KOHË DHE KOHA E FOLJEVE”

2.1 Çështja e parë: gjuha në kohë.

Si çdo fenomen tjetër i realitetit që na rrethon, edhe gjuha mund të merret në shqyrtim sipas një paraqitjeje tre dimensionale:

a – Në dimensionin “*kohë*” (rrafshi historik ose diakronik)

b – Në dimensionin e *hapësirës gjeografike* (pra brënda kufijve të një hapësire të caktuar gjeografike, në një çast të përcaktuar të zhvillimit të saj historik – sinkronia)

c – Në dimensionin e shtresëzimeve të shfaqura (niveleve), sipas grupimeve shoqërore brënda të njëjtit komunitet folës (çdo grupim, ose shtresë shoqërore e pasuron gjuhën me cilësi të veçanta, ose dalluese).

Vështruar në rrafshin diakronik, gjuha i përngjan trungut të një peme shumë shekullore, brënda të cilit mund të vërehen fare mirë gjurmët e të gjitha ndryshimeve të jashtme atmosferike që ka pësuar ambjenti, e në të cilin është mbjellë pema. Vetë ajo mbetet një dëshmi e gjallë e këtyre ndryshimeve. Pak a shumë, i njëjti fenomen vërehet edhe në zhvillimin gjuhësor.

Në rrafshin e shënjesit, ndryshimet janë në harmoni dhe në raport të drejtë për drejtë si me evolucionin e gjuhës, ashtu edhe me ndryshimin e kushteve objektivë dhe historikë, të cilët nga ana e tyre nuk lënë pa përfshirë brënda vetes edhe gjuhën.²² Ndryshimet në rrafshin e shënjesve kanë shpënë pa dyshim edhe në ndryshime të fushës semantike, të cilat fillimisht mund të kenë qënë të karakterit konotativ, por që për shkak të përdorimit të vazhdueshëm, mjaft prej tyre, më pas, kanë fituar edhe status denotativ.

Bashkë me historinë e gjuhës, në një “kapitull” të veçantë të saj, gjëndet edhe “*historia*” e foljes, si kategoria më e zhdërvjellët e kodit gjuhësor.

Në një “*kohë të shkuar*”, në gjuhët indoeuropiane, koncepti i aspektit mbizotëronte ndaj koncepteve të kohës dhe mënyrës. Në vënd të kohës dhe mënyrës (siç i konceptojmë

²² “*Lingua, Grammatica, Stile*”, G. Tedeschi, Petrini, 1971.

“*Lezioni di grammatica storica italiana*”, L. Seriani, Bulzoni, 2000.

sot), për të shprehur ndryshime në veprimin e kryer, përdorëshin tema të ndryshme brënda fjalës. Veprimi (folja shpreh edhe veprim) konceptohej sipas tre aspekteve të mëposhtme:²³

a – mund të vështrohej në rrjedhën e zhvillimit, të vazhdimësisë, pra në aspektin e pakryer (*cammino – eci; viaggio – udhëtoj; vivo – jetoj; studio – studioj; continuo – vazhdoj*; etj) . Në këtë kategori përfshiheshin kryesisht folje , të cilat tregonin një veprim të nisur e të papërfunduar).

b – mund të vështrohej në çastin kur ndodhte, pa marrë në konsideratë caqet e zgjatjes së veprimit, por vetëm pikën kohore të realizimit (*nasce – lind; muore – vdes; saltò – kërcëu; uscì – doli*, etj).

d – veprimi mund të vështrohej si i kryer në të shkuarën, por duke u zgjatur dhe duke vendosur një pikë takimi me të tashmen, p.sh.: *mi è caduto il libro – më ka rënë libri* (ndodhet ende në tokë); *è venuta mia sorella – ka ardhur motra ime* (ende nuk ka ikur); *è iniziata la lezione – ka nisur mësimi* (vazhdon të zhvillohet edhe në çastin e këtij pohimi); etj..

Pas ndryshimeve dhe thjeshtëzimeve që solli latinishtja, si p.sh vendosjen e sistemit të mbaresave, krijimin e zgjedhimeve të rregullta, etj., italishtja e thjeshtëzoi edhe më tepër sistemin, duke sjellë të tjera ndryshime, një prej të cilave ishte edhe humbja e nocionit morfologjik të aspektit.²⁴ Pra, për të dalluar veprimin, nuk ndryshonte më tema e foljes, por aspekti i veprimit shprehej me folje semantikisht të ndryshme. P.sh. “*camminare*”, “*passaggiare*”, “*vivere*”, “*continuare*”, shprehin qartësisht veprime, që zgjaten në kohë dhe shtrihen në hapësirë; “*saltare*”, “*nascere*”, “*morire*”, shprehin veprime që ndodhin brënda një çasti të shkurtër; “*sapere*” shpreh një veprim të përmbyshur tashmë, sepse : “*si sa*”, ose “*si è appreso*”.

Aspekti dallohet, ose mund të pësojë ndryshime gjatë përdorimit të frazeologjisë, kur fjala, ose folja vendoset brënda një situatë shprehimore të përcaktuar; p.sh. veta e tretë njëjës e të tashmes së foljes “*fugge*” (ikën), shpreh një veprim të çastit, ende në fillimet e veta. Po kështu ndodh edhe në rastin e foljes “*piangere*” (qaj), kur vendoset brënda situatës ligjërimore “*scoppiare in pianto*” (ia plas të qarit), folja ndryshon aspekt dhe shënon fillimin e një veprimi. E njëjta gjë ndodh pothuajse me të gjitha foljet, si në gjuhë italiane, ashtu edhe në atë shqipe.

²³ “*Lingua, grammatica, stile*”, G Tedeschi, Petrini, 1971.

²⁴ “*Lingua, grammatica, stile*”, G Tedeschi, Petrini, 1971.

Në sistemin foljor të gjuhës shqipe, kategoria gramatikore e aspektit nuk është e zhvilluar, pasi ekziston plotësisht funksionale kategoria gramatikore e kohës. Megjithatë, edhe në gjuhën shqipe, disa forma kohore dallohen për nga larmia e nuancave aspektore që shfaqin, si në rastin e kohëve të mënyrës dëftore, mënyrës lidhore e kështu me rradhë.

Në librin e prof Ali Dhrimos, “Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe”, dallimi midis kategorisë së kohës dhe aspektit shprehet në këtë mënyrë “...kategoria e kohës shpreh marrëdhënien e veprimit foljor ndaj çastit të ligjërimit (ajo mund të tregojë, nëse veprimi është duke u zhvilluar në çastin që po flasim, ka ndodhur para këtij çasti, ose do të zhvillohet pas tij: e tashme – e shkuar – e ardhme), aspekti mbështetet mbi një shumë të njohur tiparësh të veprimit, të cilat nuk kanë kurrfarë lidhjeje me çastin e ligjërimit, por shprehin thjesht rrjedhjen në kohë, të veprimit në përgjithësi...”²⁵

Në gjuhën shqipe, aspekti mund të bëhet i dallueshëm edhe për shkak të formës me të cilën shprehet folja. I tillë është rasti kur e njëjta folje, e vendosur në të njëjtën mënyrë dhe kohë, por duke i shtuar përpara pjesëzën “po”, ndryshon situatën shprehimore. Për shembull foljet “laj”, “marr”, “luaj”, etj, shprehin veprime kryesisht të pacaktuara plotësisht në kohë, ndërsa për t’i kthyer në veprime të mirëcaktuara në kohë, është e nevojshme t’u shtojmë pjesëzën përcaktuese “po”: “po laj”, “po marr”, “po luaj”, etj. E tashmja e shprehur me pjesëzën “po”, e lidh fort veprimin e foljes me çastin e ligjërimit.

Gjithsesi, aspekti si koncept merr një rëndësi të madhe në analizat stilistikore dhe semantikore. Ai shpreh përgjithësisht një qëndrim subjektiv përkundrejt kohës objektive të veprimit, të shprehur nga folja, psh “...zgjatjen, moszgjatjen, shkurtësinë e çastit, përcaktueshmërinë, përsëritjen, intensitetin e lartë ose të dobët, rritjen progresive, fillimin, mbarimin, etj...”²⁶, ose në një tjetër këndvështrim, aspekti mund të shprehë kundërvënien binare kryerje –moskryerje.

Pikpamja se aspekti shpreh, në mënyrë të përmbledhur, karakteristikat e veprimit foljor, mbështetet gjerësisht edhe nga studiuesit shqiptarë.

²⁵ “Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe”, A. Dhrimo, Libri Universitar, 1996, f. 33.

Për M. Dardano-n dhe P. Trifone-n aspekti foljor është: “mënyra se si e konsiderojnë folësit zhvillim e veprimit të shprehur nga folja...” “Grammatica italiana con nozioni di linguistica”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995, f. 315.

²⁶ “Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe”, A. Dhrimo, Libri Universitar, 1996, f. 9.

Gjithsesi, duke iu rikthyer historikut të gjuhës italiane, duhet thënë se krahasuar me latinishten, ajo solli edhe mjaft risi, ndër të cilat mund të përmëdim *kohën e kryer*, (*il passato prossimo*), apo edhe *kohën e kryer të tejshkuar* (*il trapassato remoto*).²⁷

Si përfundim, vështruar në rrafshin historik, konceptet gramatikore “mënyrë” dhe “kohë”, nuk janë thjesht klasifikime gramatikore që kanë ardhur të tilla si të pandryshueshme, por rezultat i një procesi evolutiv të mendimit njerëzor në përgjithësi dhe përpunimit gjuhësor në veçanti.

Në ditët tona, evoluimi i këtyre formave qëndron në raport të drejtë për drejtë me përmbajtjen që ato shprehin dhe me pasurimet semantike që sjell një shoqëri gjithnjë e më e hapur ndaj formave shprehëse.

2.2 Çështja e dytë: veprimi i foljes dhe koha e veprimit.

Në gramatikat tradicionale *folja* shpreh një veprim të kryer prej subjektit (p.sh. “*studenti shkruan*”), një veprim të pësuar nga subjekti (*ky njeri është goditur nga fatkeqësia*), shpreh ekzistencën e subjektit (*Gjallesat e thellësive të mëdha detare ekzistojnë*), shpreh gjendjen (*Gjethet zverdhen*), shpreh gjithashtu edhe marrëdhënien midis përcaktorit dhe kryefjalës (*Idetë janë të pavdekshme*)

Si në gjuhën italiane, ashtu edhe në gjuhën shqipe, folja zgjedhohet duke iu përshtatur situatës shprehimore në *vetë*, në *numër*, në *mënyrë* dhe në *kohë*.

...*Quajmë “kohë”, një kategori gramatikore që përgjithësisht shoqëron foljen dhe që shpreh disa kategori të kohës reale dhe natyrore. Ky kategorizim bëhet duke kundërvënë të tashmen, çasti në të cilin ligjërohet, me “jo të tashmen”, e cila mund të jetë “e shkuar”, çast përpara ligjërimit, (përpara të tashmes), ose e “ardhme”, çast i pas ligjërimit (pas të tashmes).*²⁸

...*Nëpërmjet kategorisë gramatikore të Kohës shprehet lidhja midis kohës kur kryhet veprimi i emërtuar nga folja dhe një çasti të caktuar, që merret si bazë për*

²⁷ “*Lingua, grammatica, stile*”, G Tedeschi, Petrini, 1971.

²⁸ “*Dizionario di Linguistica*”, Zanichelli, 1983, f, 297

*marrdhëniet kohore. Si bazë për marrdhëniet kohore në gjuhën e folur merret çasti i ligjërit, kurse në gjuhën e shkruar merret çasti kur shkruajmë, ose një çast tjetër i përfytyruar.*²⁹

Në vija shumë të përgjithshme, e shkuara dhe e ardhmja e kohës foljore, janë rezultat i dallimit midis kohës së kryerjes së një veprimi dhe kohës së ligjërit kur komunikohet ky veprim, por nëse kryejmë një analizë më të detajuar, ky pohim ka nevojë të plotësohet.

Mbetet për t'u analizuar, për shëmbull, nëse koha e foljes tregon “*veprim në kohë*”, apo “*kohën e një veprimi*”.³⁰

Në varësi të situatës shprehimore, mund të shprehë herë njëren dhe herë tjetren, në ndonjë rast edhe të dyja; por dallimi konceptual i këtyre dy situatave është mjaft i qartë.

“Kuptimi” i *veprimit në kohë* përfshin një sërë aspektesh qoftë gramatikore, qoftë semantike e që përgjithësisht rrjedhin prej mesazhit kuptimor. Në vetvete, *veprimi në kohë* ka të bëjë me kohëzgjatjen, përsëritjen, ritjen në progres të një veprimi, me efektin e tij dhe me shumë nuanca të tjera, të cilat bëhen të komunikueshme edhe thjesht me një përshtatje gramatikore.

Fjali të llojit: “*Studionte për të kapur ritmin e shokëve të tjerë*”; “*Atë ditë, dielli nxehte si asnjëherë tjetër*”; “*Afrohej ngadalë si i zënë në faj*” etj., mund të shërbejnë si shëmbuj tipikë të këtyre nuancave. Tjetër situatë paraqitet, për shëmbull, në fjali ku folja shoqërohet edhe me një ndajfolje kohe: “*Vij pas pak*”; “*Mbërrita tani*”; “*Iku dje*” etj.

Edhe vetë konceptet “*kohë*” dhe “*kohëzgjatje*” nuk shprehin të njëjtën situatë. “*Koha*” bëhet e qartë për shkak të dallimeve midis “*të tashmes*” dhe “*jo të tashmes*”, si dhe për shkak të dallimeve midis çastit të kryerjes së një veprimi dhe çastit të ligjërit. Ndonjëherë, ky ndryshim midis fillimit dhe përfundimit të veprimit as që ekziston, “*kohëzgjatja shfaq qëndresë*” dhe na e fshin nga vëmëndja çastin e fillimit të veprimit. Si shëmbull mund të merret rasti i të tashmes, që përdoret edhe si “*jo e shkuar*”, edhe si “*jo e ardhme*”, fakt ky që na krijon mundësinë të shprehim me anë të gjuhës, të vërteta, të cilat nuk kanë lidhje me kohën: “*Toka rrotullohet përreth Diellit*”.

²⁹ “*Gramatika e gjuhës shqipe I*”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002, f. 273.

³⁰ Duke analizuar nuancat me vlerë aspektore dhe stilistikore të *vazhdimësisë, progresionit, përsëritjes*, etj., u vërejt në jo pak raste se nuk shprehej vetëm koncepti i kohës së një veprimi, por edhe një tjetër koncept: ai i veprimit në kohë. Kjo është arsyeja që të dy këta koncepte trajtohen si nuanca aspektore të ndara.

Në fakt, koha e foljes fikson kohën e një veprimi në raport me rrjedhën reale kohore, ndërsa kohëzgjatja përqëndrohet në shtrirjen e veprimit nga fillimi, deri në përfundim të tij.

Veprimi në kohë sjell në vëmëndje të bashkëbiseduesve dhe pasojën e një veprimi, ku vetë bashkëbiseduesit mbeten jashtë kësaj kohe, kqyrës të asaj që ndodh, ose që ka ndodhur.

“Si u kalit çeliku!”

“U rrit dhe u bë burrë i madh” .

“Me kalimin e kohës, bota ndryshon”.

Është interesante të vërehet, nëse qëllimi i përdorimit të këtyre formave foljore (pësore, vetvetore), si dhe nuancat që ato shprehin, është të komunikohet veprimi, apo koha e veprimit. Natyrisht që koncepti i kohës është i pranishëm, gjë që vërtetohet edhe nga zgjedhimi i foljes, por më shpesh ai shprehet plotësisht nga konteksti i krejt mesazhit, se sa prej veprimit foljor.

Krejt ndryshe paraqitet rasti kur kemi të shprehur *“kohën e veprimit”*. Ky rast, në fakt, është më i thjeshtë për t’u kuptuar, për shkak se kemi të *“fiksuar”* një periudhë kohore të caktuar, në raport me çastin e ligjëritimit, apo në raport me një veprim tjetër.³¹ Gjithsesi, as kur shprehet *“koha e veprimit”* nuk mungojnë nuancat aspektore, veçanërisht për shkak të shprehjes së disa kuptimeve kohore, të cilat janë të pamundura në realitetin objektiv.

Rasti i shprehjes së *“kohës së një veprimi”*, është rasti klasik, të cilit i referohen shpesh kur bëhet fjalë për kohët e foljes si kategori gramatikore. Në pamje të parë, duket sikur ky koncept gjuhësor, na e kufizon vëmëndjen rreth kuptimit se koha foljore është një formë gramatikore, që ndihmon për të shënjuar kohën e shkuar, kohën e tashme dhe kohën e ardhme. Por përtej këtij perceptimi të thjeshtëzuar klasik, *“koha e foljes”* duket, se para të gjithash, shenjon dhe *“fikson”* kohën e kryerjes së një veprimi, apo të një gjëndjeje a situatë të caktuar. Dhe është pikërisht gjuha, e cila me anë të potencialit të saj shprehës, e vërteton ndër të parat disiplina shkencore *“teorinë e relativitetit”* të Ajnshtajnit, duke i

³¹ *“...Si bazë për marrëdhëniet kohore me gjuhën e folur merret çasti i ligjëritimit, kurse me gjuhën e shkruar merret ose çasti kur shkruajmë, ose një tjetër çast i përfytyruar...”* (Gramatika e gjuhës shqipe 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002, f. 273.

“Dizionario di Linguistica”, Zanichelli, 1983, f. 296 – 297.

zhvendosur veprimet (brënda kufijve gjuhësorë) në hapsirë dhe kohë, jo rrallë aspak në përputhje me ligjet universale të rrjedhshmërisë kohore dhe duke sjellë në vënde dhe kohë të ndryshme, efekte shprehëse nga më të pabesueshmet. Ngjan sikur në këto zhvendosje kohore, forma dhe përmbajtja shkrihen e bëhen një e vetme, duke i shpëtuar në këtë mënyrë “caqeve të hekurta” të klasifikimit gramatikor dhe duke e shfaqur gjuhën me të gjitha potencialet e një organizimi dytësor³² (aspektor, nënkuptimor, emocional , etj.), ku spektakli, emocioni, ndjenja dhe shumë elementë të tjerë të përmbajtjes e “lënë disi në hije formën”. Koha e foljes, bëhet në ligjërim “kohë e veprimit”.

Në përfundim të një analize të fundit, askush nuk e pengon ligjëruesin, bashkëbiseduesin, dëgjuesin, lexuesin, apo cilindo përdorues të gjuhës, të jetë “i pranishëm” dhe të ndjekë në rolin e dëshimtarit, “me sytë e imagjinatës”, cfilitjen shpirtërore dhe fizike të Prometeut, fitoret e mundimshme të Pirros së Epirit, udhëtimet ekzotike të Marko Polos, apo të jetë “i pranishëm” në qytetërimet e shekujve të ardhshëm.

Dantja i lexuar në të “tashmen” e tij, nuk bëhet për ne një “i shkuar” dhe e “ardhmja” e Makiavelit mbetet edhe për ne një e ardhme.

Duke shfrytëzuar mundësitë e afuara nga gjuha dhe kategoria gramatikore e kohës, shkrimtari dhe lexuesi, pedagogu dhe studenti, intelektualit dhe gjithkush tjetër, mund të zhvendoset në të shkuarën, të kthehet në të tashmen dhe të niset drejt të ardhmes, për të udhëtuar përsëri, në se dëshiron, drejt të shkuarës. Gjuha na ka çliruar prej vargonjve të rrjedhës kohore, ndërsa vetë koha si kategori gramatikore, i ka dhënë universit të mendimit njerëzor përmasën e katërt: vetveten.

³² “*Dizionario di Linguistica*”, Zanichelli, 1983, f. 177 – 180.

KREU 3. DËFTORJA DHE RAPORTI I SAJ ME REALITETIN.

Në një vështrim të përgjithshëm, sistemi foljor i gjuhës italiane përmbledh shtatë mënyra të zgjedhimit foljor, ndërsa sistemi foljor i gjuhës shqipe nëntë mënyra.

Shkurtimisht:

Dëftorja - i paraqet ngjarjet si reale.

Lidhorja - i paraqet ngjarjet si të mundshme.

Kushtorja - i paraqet ngjarjet si të ndërvarura nga kushte të caktuar.

Urdhërorja - shpreh vullnetin e folësit, në raport me bashkëbiseduesin.

Paskajorja - i shpreh ngjarjet në vetvete.

Përcjellorja - shpreh një ngjarje, duke e vendosur në marrëdhënie kohe, shkak, mënyre, etj., me një ngjarje tjetër.

Pjesorja - kryen përgjithësisht funksionin e mbiemrit ose të emrit.

Në sistemin foljor të gjuhës shqipe gjejmë edhe mënyrën habitore, si dhe atë dëshirore, me anë të të cilave shprehen habia, ose dëshira e atij që flet apo shkruan.

Duke iu rikthyer mënyrës dëftore, vërejmë se është mënyra me numrin më të madh dhe më të plotë të kohëve, gjithsej tetë, të cilat në boshtin e rrjedhës kohore, renditen nga e shkuara më e largët, deri në të ardhmen më të përtejme.



E shkuara

E tashmja

E ardhmja

Është kjo arsyeja, që shpesh ia komplikon dëftores marrëdhëniet e saj me realitetin, madje në një vështrim pak më analitik, dëftorja jo gjithmonë i paraqet ngjarjet si reale, apo më mirë në dimensionin e tyre, real, të ekzistencës.

Duket sikur hera herës, realiteti qëndron mbi kohën e foljes, e dominon atë, e nxjerr në plan të dytë, duke e ridimensionuar si në kuptim, ashtu edhe në vlera shprehimore. P.sh:

Dante Aligheri è un grande poeta italiano (D.Aligheri **është** një poet i madh italian)

Dante Aligheri è **nato** nel 1265. (D. Aligheri **ka lindur** më 1265 –ën).

Dante Aligheri **mori** a Ravenna. (D. Aligheri **vdiqu** në Ravenë).

Dante Aligheri **avrà** sempre la stima dei lettori. (D. Aligheri **do të ketë** gjithmonë vlerësimin e lexuesve.

Në tekstin e mësipërm, është e vështirë të vendosësh një kufi midis realitetit objektiv dhe një tjetër realiteti paralel, të krijuar nga ligjëruesi. Kalimet nga e tashmja (e vlerave), në të shkuarën (e kujtesës) dhe në të ardhmen (e dëshirës), janë kaq të natyrshme, saqë nga këndvështrimi i mesazhit, roli i përdorimit gramatikor të kohëve të foljes zbehet në mënyrë të ndjeshme. Renditja kohore thuhetse humbet, kufijtë e saj zhduken dhe ekzistenca fiton brënda ngjarjes vlera universale.

Në jetën e përditshme, brënda realitetit objektiv që na rrethon, është e pamundur të priset rendi kronologjik i ngjarjeve. Në këtë dimension respektohen vitet, muajt, ditët, orët dhe asnjë sekuencë kohore nuk mund t’i mbivendoset tjetrës.

Nuk ndodh e njëjta gjë me gjuhën e përdorur në tekste. Duket sikur njeriu ka plotësuar me anë të saj një ëndërr të vjetër të tij: të udhëtojë në kohë, madje pa gabuar kronologjikisht as ditë e as orë gjatë zhvendosjes. Por ky udhëtim në kohë nuk merr aspak trajtat e një udhëtimit fantastiko – shkencor; ai respekton ligjet e llogjikës dhe e rindërton realitetin me një pasqyrim plot besnikëri ndaj të vërtetës.

Madje më shumë se kaq. Mekanizmat gjuhësorë të kohës na e shfaqin realitetin në një plan “tre-dimensional”, jo më pak të natyrshëm se realitetin virtual kompjuterik. Më pas, ky realitet i rikrijuar nuk mbetet thjesht një “realitet në miniaturë”, por kthehet në një dritare për të njohur më mirë realitetin që na rrethon, brënda të cilit, secili prej nesh mbetet i përfshirë. Eksperienca e gjithsecilit, i shërben komunitetit, për të zgjeruar kufijtë e këtyre njohurive.

Le t’i analizojmë më poshtë tre dimensionet e realitetit, të krijuar nga mekanizmat gjuhësorë të kohëve të dëftores.

pikë referimi, në mos për ligjëruesit, së paku për dëgjuesin apo lexuesin. E tashmja na shërben si urë lidhëse me të shkuarën dhe si vizion për të ardhmen.

Dimensioni i tretë i realitetit kohor është e ardhmja, të cilën mund ta konsiderojmë kohën e një realiteti që ende s'ka mbërritur, por që në përputhje me vizionet apo dëshirat tona, bëhet e pranishme. Dimensioni i të ardhmes është një dimension i projektuar. Si i tillë, ai nuk mund të jetë një dimension i përmasave njerëzore, i përcaktuar detyrimisht nga kriteret e ekzistencës, por sa më në të ardhme të shtyhem, aq më tepër ajo merr trajtat e një "realiteti" të projektuar, që i zgjeron kufijtë e saj. Është ky projektim, që e bën, për shëmbull, autorin e një romani fantastiko – shkencor të marrë mbi vete rolin e një "perëndie të botës, që ai vetë krijon", duke "dëshmuar" ngjarje të një të ardhmeje, shpesh prej qindra e qindra vjetësh të largët.

Me anë të projektimit në të ardhmen, poeti e bën realitet shpresën, dëshirën dhe ëndrrën për një botë më të mirë; po nëpërmjet këtij projektimi, ligjëruesi (nëpërmjet gjuhës, i ngjashëm me krijuesin e universit) njeh dhe profetizon rreth fatit të tij, duke e hedhur vështrimin dhe fantazinë mbi "tokën ende të pashkelur".

Gjithsesi, duke u rikthyer mbi boshtin kronologjik të kohës, kahu i lëvizjes së ligjëruesit, natyrisht edhe në përputhje me normat gjuhësore dhe logjike, do të ndryshonte vazhdimisht, pikërisht sipas interesave logjike, të asaj që ai rrëfen.

Dhe pikërisht në këtë "ec e jake" kohore, kohët e dëftores marrin vlera stilistikore. Një zhvendosje sado e vogël e sekuencës kohore në rrjedhën reale të ngjarjeve, e bën këtë "sekuencë" të dalë nga norma dhe për pasojë të fitojë një vlerë, të cilën në realitetin objektiv nuk e ka. Që këtë nis edhe analiza e mëtejshme rreth vlerave stilistikore. Një zhvendosje sado e vogël e akrepave të kohës prej rrjedhave normale, madje deri edhe një ndryshim i kahut të kësaj rrjedhe, mbart vlerën e një çasti të dokumentuar me anë të një "fotografie gjuhësore", të cilës vetë koha i jep vlera artistike.

KREU 4: E TASHMJA E DËFTORES.

4.1 Fiksimi i një të tashmeje në të shkuarën.³³

Në tekstet e shkruar, më tepër se kohën realisht të tashme, e tashmja e dëftores **fikson** një të tashme.

Është e natyrshme që midis të *tashmes* së tekstit të shkruar dhe të *tashmes* së leximit, të vendoset një distancë e tillë kohore, që ta vendosë vazhdimisht tekstin e shkruar në të shkuarën, por kjo nuk përbën një arsye të mjaftueshme për të ndërruar edhe natyrën e të tashmes të përdorur në tekst dhe që vazhdon të mbetet e tillë. Shtrirja e kësaj distance kohore, nga pikpamja dokumentare, ka vetëm një rëndësi: dëshminë e gjallë dhe “të fotografuar” të një çasti të dikurshëm; por nga këndvështrimi stilistikor paraqitet mjaft e rëndësishme ajo çfarë ndodh me procesin mendor (imagjinar) të lexuesit. Midis **ngjarjes** që evokohet dhe **lexuesit**, raportet kohore ndryshojnë; ky i fundit zhvendoset në hapësirë dhe kohë drejt të shkuarës, për t’u bërë i pranishëm në rrëfimin e ngjarjes. Fenomeni mund të vërehet pa vështirësi në mjaft tekste, siç është edhe kjo dëshmi e Tertulianit, rreth praktikave dhe riteve të krishterëve të parë, dhënë në veprën e tij “*Apologeticum*”:

“...*Ci raduniamo* in gruppo e associazione per ricorrere, falange compatta, a dio con le nostre preghiere. Questa è la forza che *piace* a dio. *Preghiamo* anche per gli imperatori, per la loro corte e le loro alte magistrature, per lo stato del secolo, per la pace del mondo. *Ci raduniamo* per l’interpretazione delle Sacre Scritture. Coi sacri canti *nutriamo* la fede...” (Apologeticum, “*Est modus*”, A. Piva, G. Sega, 2002)

Në tekstin e mësipërm, është përdorur koha e tashme e stilit të kronikës, e njëkohshme me çastin e ligjëritimit, ku autori përfshin brënda kohës së tashme që përdor, krej periudhën për të cilën ai shkruan; por që prej atij çasti e deri në ditët tona kanë rrjedhur shumë shekuj. Kur lexuesi i shekullit të XXI merr në dorë dhe lexon mesazhin e mësipërm, ndodh një zhvendosje e “korpusit” mendor të tij, drejt shekujve të parë pas Krishtit, periudhë për të cilën dëshmojnë shkrimet e Tertulianit, njëllor siç ndodh një

³³ Për shkak të hulumtimit për të gjetur shëmbuj në tekstet e shkruar, u vërejt që e tashmja e shëmbujve të gjetur mbetet vazhdimisht në të shkuarën e leximit të tyre. Për këtë arsye u mendua si më i saktë përdorimi i konceptit “*fiksimi i një të tashmeje*”, duke iu referuar sidomos gjuhës së shkruar, ose po aq interesante do të ishte shprehja “*fotografimi i një të tashmeje*”.

zhvendosje e po këtij “korpusi” mendor drejt epokës *faustiniane* të Gëtes, kur personazhi i tij i famshëm deklaroi, duke iu referuar rrënimin të pritshëm si të ishte një qen i zi, që sa vjen dhe afrohet gjithnjë e më shumë :

“...*Mi sembra, che egli tenda attorno ai nostri piedi dei sottili lacci magici...Il circolo si restringe, egli è già vicino...*”(Faust, J. V. Goethe, përkthyer G. Scalvini, 1960, f.23)

Dhe mendja e lexuesit vështrohet, si në një film, nga brënda ngjarjes (ky është imazhi që krijohet), një qen të zi, që vjen rrotull tutje – tëhu. Koha e tashme rrjedh në këtë pasazh prej të shkuarës, përfshin të tashmen, duke shfaqur në kontekst edhe vlerat e një veprimi me aspekt progresiv.

I njëjti fenomen mund të vërehet edhe në tekstet e shkruara në shqip. I lexuar në kohën e tashme, fjalimi i Skënderbeut i mbajtur përpara princërve shqiptarë në Lezhë, bën që lexuesi të ndjehet pjesmarrës në këtë kuvënd dhe t’i krijohet përshtypja se është vetë ai që dëgjon çfarë u thotë princërve heroi i kombit. Koha e tashme i jep nuancë mjaft aktuale pjesës së mëposhtme të fjalimit:

...”Por jo, o etër të kuvendit, edhe ju, siç *kujtoj* unë, kini për t’i dalë zot mbrojtjes. ..Dhe unë *po i shoh* tani zemrat e të gjithëve të ndezura dhe brënda në këto zëmra të ndezura urrejtjen për armikun. *Po vërej* me admirim fytyrat krenare dhe më duket se po *ju shoh* që tani të armatosur. Do t’i dilni zot, *ju them*, mbrojtjes edhe pa dashur, kur të dëgjoni se atdheu, i shtypur prej Muratit, *po kërkon* ndihmën tuaj, kur të shikoni se armiku, i pafre dhe tërë kapardi për fitoren, *po çduk* lirinë edhe sundimin tuaj dhe i tërbuar, me gojën e vet të gjakosur e me duart e ndyra me sakrilegje, *po turret* për ta pirë gjer në pikën e fundit gjakun tuaj...

Ndonjëri ka frikë dhe *kolovitet* nga dyshimi se Murati nuk do të dërgojë kundër nesh një ushtëri të vetme e të dobët...Këto të gjitha *unë i pranoj*, sigurisht, dhe i *pranoj* me kënaqësi, por nga ana tjetër, mua ma *parandjen* zemra se çdo gjë do të jetë e lavdishme...” (Historia e Skënderbeut, Marin Barleti, 1967, faq 102 – 103).


Po me të njëjtën procedurë gjuhësore, kemi një zhvendosje të mendjes dhe imagjnatës së lexuesit drejt të shkuarës edhe në shkrimin e Ismail Kadaresë: “*Uzina që ka lidhje me bukën – bërthamë për një libër*” .

“Siç shihet uzina është fare e re, kurse toka e lashtë, e stërlashtë. Dhe toka jonë hyn në atë sipërfaqe të planetit, që u punua nga dora njerëzore, qysh në kohët më të vjetra. Është tokë e jetës, siç thonë pleqtë...”

Në çastin e leximit të këtij teksti, duke ndjekur “autostradën” e kujtes-imagjinatës, ne zhvendosemi edhe njëherë në të “tashmen” e zanafillës së Uzinës Traktori, një uzinë kjo që sot pothuajse nuk ekziston, por që mbetet e dokumentuar në kujtesën e pandryshuar të tekstit të mësipërm letrar. Kjo e tashme është quajtur edhe e *tashme dokumentare*.

E SHKUAR

E TASHME



Skema paraqet një shkëputje nga realiteti ekzistues të lexuesit dhe zhvendosje drejt një realiteti të rrëfyer e të përfunduar vite apo shekuj më parë, si një mundësi për të eksploruar të shkuarën.

Si përfundim, është e domosdoshme të nënvizojmë se koha e tashme e mënyrës dëftore, vështruar në këtë përmasë të saj, nuk ka vetëm vlera informuese dhe dëshmuese, por e lidhur me momentin e ligjërit ajo shërben më tepër si një stacion kohor, prej të cilit ne nisim “udhëtimin aventuresk” të leximit të teksteve. Duhet thënë, se këtë vlerë stacionare (të fotografimit të një të tashmeje), duket sikur e ka vetëm e tashmja e dëftores.

4.2 E tashmja rrëfimtare.³⁴

Megjithatë, gjatë lëvizjes në hapësirë dhe kohë, sidomos brënda teksteve letrare, nuk gjejmë pjesë të mekanizmit gjuhësor, mendor, apo psikologjik që mbeten të ngurta e të palëvizura. Gjithshka lëviz pa kufizime kohe dhe hapësire, ndërsa boshtet sinkronike dhe diakronike shërbejnë vetëm si gurë kilometrikë të këtij universi shumëpërmasor. Imazhet që afrojnë kohët foljore janë aq të shumta e të larmishme, saqë ato ndryshojnë sipas situatave shprehimore në të cilat janë përdorur.

Nisur nga kjo logjikë, është e natyrshme të mos kemi vetëm zhvendosje të “korpunit” mendor drejt ngjarjes, por shpesh edhe të një rrjedhe të ngjarjes drejt “korpunit” mendor, ose thënë ndryshe, një tërheqje të ngjarjeve drejt të tashmes objektive, të njehsuar me çastin e ligjërit.³⁵ Në parantezë, mund të risjellim në kujtesë teorinë e interpretimit, të cilën e morrëm në shqyrtim kur analizuam konceptin e *vlerës stilistikore*, rreth pavarësisë që fiton mesazhi, pra edhe teksti i shkruar, sidomos në distancë kohore dhe hapsinore.

Fjala është për atë që quhet e *Tashme Rrëfimtare*, apo edhe e *Tashme Historike*,³⁶ një mënyrë përdorimi kjo e kohës së tashme, për të cilën të gjithë studiuesit kanë qënë të mendimit që ka vlera të pamohueshme stilistikore. Ndryshimi i këtij përdorimi të kohës së tashme, me ato të shëmbujve të mësipërm, qëndron në raportin që krijon ajo me të shkuarën (çfarëdo lloj të shkuare). E tashmja rrëfimtare, apo historike, duket sikur e humbet vlerën e stacionimit në kohë, për të përfutur veti të reja, thuajse manjetike. Ajo shërben për të tërhequr, për të sjellë në kohën reale, ide, ngjarje, personazhe historikë ose imagjinare, që i përkasin në të vërtetë një kohe të shkuar, të afërt apo të largët dhe për t'i rreshtuar ata (ose ato) përpara *shqisave* të “korpunit” mendor të lexuesit, sa herë që ky i fundit shfleton faqet e një libri dhe përfshihet brënda ngjarjeve të tij.

³⁴ “*Grammatica per italiani maggiorenni*”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

“*Guida allo studio della letteratura*”, R. Cesarani, Laterza, 1999.

“*Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*”, A. Dharmo, Libri Universitar, 1996, f. 73 – 75.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010

“*Grammatica italiana con nozioni di linguistica*”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995.


³⁵ “*Guida allo studio della letteratura*”, R. Cesarani, Laterza, 1999.

“*Grammatica avanzata della lingua italiana*”, S. Nocchi, R. Tartaglione, Alma Edizioni, 2006.

³⁶ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986, f. 334.

E SHKUAR

E TASHME



Tërheqja e ngjarjeve dhe personazheve, nga e shkuara në të tashmen e lexuesit, nuk është meritë vetëm e kohës së tashme të dëftores, por varet në një përqindje të madhe nga konteksti i krejt asaj që rrëfëhet, si dhe kuptimet semantike të foljeve. Do të ishte tejet e gabuar të merrnim në konsideratë vetëm aspektin gramatikor të gjuhës, duke i lënë në harresë aspektet e tjera.

Po ashtu, kur analizojmë të tashmen rrëfimtare në situata të ndryshme shprehimore, nuk ka si të mos vërejmë brënda këtij kuadri një tipologji të vërtetë nuancash, pozicionimesh e deri edhe distancash në raportet midis *lexuesit*, *kohës së tashme të foljes* dhe *kohës të shkuar të ngjarjeve*.³⁷ Këto raporte, vërtetojnë faktin që e tashmja rrëfimtare nuk shfaq vazhdimisht të njëjtat imazhe dhe vlera aspektore, por në varësi të ndryshimit të tyre, ndryshojnë edhe vlerat.

Një nga rastet më tipike, është kur në marrëdhënien midis lexuesit dhe ngjarjes, ndërhyr rrëfimtari, i cili “autorizon” dhe “justifikon” si dëshmitar i gjithshkaje që ndodh, përdorimin e të tashmes së dëftores, por me vlera rrëfimtare.


Një situatë e tillë, përsëritet herë pas here në romanin e Umberto Eko-s “*Il nome della rosa*”:

“...Gli uomini di una volta erano belli e grandi (ora *sono* dei bambini e nani), ma questo fatto è solo uno dei tanti che testimoni la sventura di un mondo che *incanutisce*. La gioventù non *vuole* apprendere più nulla, la scienza è in decadenza, il mondo intero *cammina* sulla testa, dei ciechi *conducono* altri ciechi e li *fanno* precipitare negli abissi, gli uccelli *si lanciano* prima di aver preso il volo, l’asino *suona* la lira, i buoi danzano... Siano rese grazie a Dio, che io a quei tempi acquisii dal mio maestro la voglia di apprendere e il senso della vita...” (“*Il nome della rosa*”, Umberto Eco, pag 67)

³⁷ “*Grammatica italiana con nozioni di linguistica*”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995.

Ai që në mënyrë indirekte i drejtohet dhe bashkëbisedon me lexuesin, në këtë tekst të shkurtër, është rrëfimtari i ngjarjeve, i mishëruar në personazhin me emrin Adso, i cili në pleqëri të shtyrë, i rikthehet kujtimeve të viteve djaloshare. Sipas kronologjisë së librit, rrëfimi i Adsos merr jetë aty nga shek. XIV – të.

Në varësi të raporteve që krijohen, në tekstin e mësipërm, kemi tre kohë që ndërveprojnë njëkohësisht: kohën e lexuesit (dhe të autorit të librit – jo të njehsuar plotësisht), kohën e rrëfimitarit, kohën e ngjarjeve të rrëfyera. Shtjellimi në librin e U. Ekos i këtyre tre kohëve paraqitet tërësisht logjik, madje edhe dallimi mes tyre realizohet sipas *kritereve* të logjikës. Ajo që mbetet e pandryshuar, që i përshkon të tre kohët logjike dhe shërben si fill lidhës, është e tashmja e dëftores, që merr mbi vete natyrshmërinë rrëfimtare të udhëtimit në kohë. Duke vepruar nëpërmjet foljes, e tashmja e përdorur në tekstin e mësipërm e afron kohën e *rrëfimitarit* me atë të *lexuesit*, duke ia sjellë pranë, këtij të fundit, nëpërmjet një zhvendosjeje në hapësirë dhe kohë, imazhin e personazhit Adso, i cili i paraqitet lexuesit duke shkruar kujtimet mbi tavolinën e tij të punës.



Përsa thamë më sipër, nëse e analizojmë bashkë me mesazhin që përçon konteksti, e tashmja e përdorur nga U. Eko duket se i jep kontekstit një ngjyrim të fortë aktualiteti.

Në po të njëjtin libër, “*Il nome della rosa*”, përdorim mjaft specifik të së tashmes, autori ka bërë sidomos në nëntitullin hyrës të çdo kapitulli: p.sh.

Primo giorno

PRIMA

Dove si arriva ai piedi dell'abazia e Guglielmo dà prova di grande acume.

Primo giorno

SESTA

Dove Adso ammira il portale della chiesa e Guglielmo ritrova Ubertino da Casale.

Secondo giorno

MATTUTINO

Dove poche ore di mistica felicità interrompono un sanguinosissimo evento.

Përdorimi i të tashmes rrëfimtare, shoqëruar me ndajfoljen lidhore: “ku” (dove)³⁸, sjell si rezultat afrimin dhe vendosjen në një pozicion fiks dhe të përcaktuar në kohë dhe në hapësirë njëkohësisht, të krejt ngjarjes që shtjellohet më pas. Me interes është të vërehet, që jo vetëm ngjarjet afrohen dhe vendosen përpara imagjinatës së lexuesit, por ato, më tepër se imazhe që rrjedhin, kthehen në imazhe të një tabloje të palëvizshme. Duke iu referuar vëndit, veprimi foljor shpreh më tepër përfundimin e një situatë, në një vënd të caktuar.

Po nga Umberto Eko mund të risjellim si shëmbull një pasazh të shkurtër nga një tjetër libër i tij, “*Il pendolo di Foucault*”, ku njëri prej personazheve të këtij libri, sjell në kujtesë kohën kur ai ndodhej për herë të parë në Paris:

“...Della città ho un'immagine più chiara. E' Parigi, io sono sulla riva sinistra... trovo una via che piega curvando verso destra, in una serie di vicoli, e sono certamente nel Bario Gotico di Barcellona...”


Rrëfimtari i drejtohet lexuesit në vetën e parë. Ai përdor kohën e tashme, qoftë kur i referohet çastit në të cilin ligjëron (*...ho un immagine*), ashtu edhe kur rrëfen për vëndet e qytetit, që i kanë lënë më shumë mbresa (*...io sono sulla riva...; ...trovo una via...; ...sono nel...*). E veçantë është që me mënyrën e të rrëfyerit, në fillim rrëfimtari njehson kohën e tij me atë të lexuesit, thua se kur i drejtohet atij, ky i fundit ndodhet bashkë me të; më pas, ai afron krejt skenën e të kaluarës në të tashmen dhe lëviz nëpër të, duke vazhduar t'i drejtohet lexuesit, sikur të bëhej fjalë, për vënde mjaft të njohura për të dyja palët. Pasazhi merr nuancat e një monologu, ku protagonistin tregon me gjysëm zëri, i zhytur në

³⁸ “*Grammatica italiana*”, G. Pittano, Bruno Mondadori, 1986, f. 368.

“*Gramatika e gjuhës shqipe I*”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002, f. 365.

kujtime. (“...Prej qytetit kam një imazh mjaft të qartë. Është Parisi, unë jam në bregun e majtë... gjej një rrugë që kthehet në të djathtë e të nxjerr në disa rrugica dhe ndodhem pa asnjë dyshim në Bario Gotico di Barcellona...”)

Hera herës të krijohet përshtypja, se rrëfimtari ndodhet i pranishëm njëkohësisht qoftë në Paris (në të shkuarën), ashtu edhe në të tashmen e ligjërit, apo edhe në të tashmen e lexuesit. Duke kaluar natyrshëm nga fjalia e parë, në ato që vijnë më pas, gjithshka shkrihet dhe bëhet një e vetme.



Koha e Tashme

Një tjetër mënyrë e përdorimit të së tashmes rrëfimtare, është kur autori nuk ndërhyr në raportet midis lexuesit dhe ngjarjes, pra mbetet i fshehur dhe gjithshka jepet nëpërmjet “Zërit rrëfimtari”³⁹. Ngjarjet përsëri zhvendosen në hapësirë dhe kohë, duke u zhvilluar pikërisht përpara “korpunit” mendor të lexuesit, i cili bëhet dëshmitar direkt dhe i brëndshëm i tyre. Fenomeni mund të vërehet si në gjuhën italiane, ashtu edhe në gjuhën shqipe, madje duke ruajtur të njëjtat vlera. Me këtë mënyrë të rrëfyerit, askush nuk interferon midis lexuesit dhe ngjarjeve, ndërsa figura e *personazhit që rrëfen* mungon totalisht. Gjithsesi, në rastin e mëposhtëm, ligjëruesi është zhvendosur në periudhën kohore kur janë zhvilluar ngjarjet dhe “zëri” i tij i vjen lexuesit nga brënda kesaj periudhe kohore.

Kruj’ o qytet i bekuar

Prite, prite Skënderbenë!

Po vjen si pëllumb i shkruar

³⁹ “Guida allo studio della letteratura”, R. Cesarani, Laterza, 1999, f. 197 – 266.

“Discorsi e progetti 2”, M. Della Casa, M. Mambrini, LaScuola, 1980.

Të shpëtojë mëmëdhenë,... (*Historia e Skënderbeut*, N. Frashëri)

Forma e kryer e foljes “ *po vjen*”, në kohën e tashme, bashkëngjitur kuptimit semantik të saj, krijon përshtypjen jo vetëm të një ngjarjeje që pritet të përfundojë nga çasti në çast, por edhe të një imazhi të gjallë, në lëvizje, në zhvendosje drejt vëndmbërritjes aq shumë të dëshiruar dhe me aspektin e një lëvizjeje progresive, që i jep skenës së ndërtuar prej autorit pamjen e një sekuence filmike, që përsëritet pambarimisht.

Lexuesi mbetet i befasuar nga kjo “skenografi”; edhe pse ai nuk ndihet i pranishëm në atë ngjarje, pozicionimi i tij i ngjan shume spektatorit të një filmi në një sallë kinemaje, ku e “tashmja” e ngjarjeve filmike, edhe është, edhe s’është e tashmja e kohës së spektatorit. Forma foljore “*po vjen*”, tregon një veprim në progresion, një të tashme që zgjatet në kohë dhe në hapësirë, pa fillim dhe mbarim. Për ta bërë skenën e ardhjes së heroit sa më reale, autori ka përdorur të tashmen rrëfimtare, duke risjellë edhe njëherë përpara lexuesit mbërritjen lavdiplotë të heroit tonë kombëtar, në Krujë.

E ndërkohë që toni enfatik i vargjeve të mësipërme i krijon lexuesit ndjesinë që rrëfimtari është bashkohës i ngjarjeve, në të tjera shëmbuj, “*zëri rrëfimtari*” mbetet i papërfshirë brënda sekuencave të ngjarjeve, por vetëm një referues i tyre. Në tekstin e mëposhtëm, të përzgjedhur prej legjendave të moçme shqiptare, e tashmja rrëfimtare e gjallëron tej mase udhëtimin e Ymer Agos. Ky udhëtim zhvillohet mjaft i shpejtë (dhënë me pak fjali të shkurtra), megjithëse shumë i shtrirë në kohë për nga aspekti shprehës.

“...*Shalon* ai shpejt kalë dorinë, i *hyp* e merr vrapin drejt për në Ulqin. Kali *ikën* si shigjetë, lë pas një vazhdë pluhuri, që *ngrihet* lart. *Mbeten* prapa male e fusha, *dalin* përpara male të tjera, fusha të tjera. “Vrap dori, që të arrijmë të bukurën, përpara se të martohet!...”

Përdorimi i kohës së tashme dhe një farë fragmetarizimi i skenave, i japin ngjarjes karakteristikat e sekuencave, të cilat lëvizin me shpejtësi filmike përpara lexuesit. Ngjarjet pasojnë mjaft shpejt njëra tjetrën. Koha e tashme bën që secila prej tyre të kryhet brënda një çasti të shkurtër, ndryshe nga çdo të ndodhte nëse autori do të përdorte të shkuarën, e cila duke i vendosur ngjarjet në largësi nga çasti i ligjërit, do t’i paraqiste ato më të shtrira, më pranë kohëzgjatjes së tyre reale. E vërteta është që shpesh, e tashmja e përdorur me vlerën e të shkuarës, e shkurton qartazi kohëzgjatjen e veprimit, faktet paraqiten rrjedhshëm dhe ligjërimi fiton zhdërvjelltësi.

I njëjti fenomen mund të vërehet edhe në gjuhën italiane, ku gjithashtu gjuha fiton rrjedhshmëri sekuencash dhe zhdërvjelltësi mendimi⁴⁰.

Në poezinë epike të Giovanni Pascoli-t, gjejmë thujtë të njëjtat karakteristika të shfaqjes të së tashmes, që hasëm edhe në legjendën e Ymer Agos.

Ma uno squillo *suona* al ciel di guerra

Come uno strillo d'aquila sul monte.

I cavalieri *levano* la spada

ed i gonfalonieri, il gonfalone.

Levano il duro pungolo i biolchi

e i trombettieri *imboccano* le trombe.

(*Il re Enzo*, G. Pascoli)

Skena të shpejta, imazhe me ngjyra të gjalla, foljet e vendosura rresht në të tashmen e dëftores, i trasmetonë lëvizje gjithshkaje që përshkruhet nga autori. Madhështia dhe dramaciteti i tingullit që ngjitet lart në qiellin e luftës, do të humbisnin pjesërisht po të mos ishte për kohën e tashme të foljes “*suonare*”, që e risjell çastin të gjallë dhe të vërtetë përpara lexuesit. Edhe kalorësit do të ishin të largët dhe si figurina pa jetë, nëse folja “*levare*” nuk do të ishte vendosur me vetëdije në kohën e tashme. Në këtë mënyrë, kemi mundësi ta përjetojmë, nëpërmjet leximit, çastin solemn, kur kalorësit ngrajnë shpatat e tyre lart, në vigjilje të një tjetër çasti historik.

E *scoppia* acuto il suono delle trombe,

e grave *romba* il suon delle campane,

e vi *si mesce* il grido dei fanciulli

e le femmine voci di preghiera;

e i cavalieri *spronano*, e i cavalli


partono sfavilando sulle selci.

(*Il re Enzo*, G. Pascoli)

⁴⁰ “*Dizionario di Retorica e Stilistica*”, UTET, 2008, f. 470.

Papritur skenat bëhen masive. Bori që lëshojnë tinguj luftarakë, këmbana që gjëmojnë me goditjet e tyre, klithma fëmijësh dhe britma grash, që na vijnë nga historia, reale dhe me ngjyra të gjalla, nëpërmjet një kohe të tashme, të përdorur në mënyrën më të përsosur që e kërkon një situatë e tillë rrëfimtare. Dhe në mes të këtij gjëmimi dhe zhurmërie trumpetash e armësh, kalorës që nxisin kuajt e tyre me mamuze dhe nisen fluturimthi në sulm.

E tashmja e dy vargjeve të fundit na ndihmon ta shquajmë qartë lëvizjen plot epizëm të personazheve, duke na i sjellë ata shumë pranë, madje pa e humbur perceptimin e një fushëbeteje të përgjithshme.



Shpesh ndodh, që ndërsa ngjarjet zhvillohen në kohën e shkuar, rrëfimtari e zbulon me vetëdije praninë e tij si dëshmitar i ngjarjeve në këtë të shkuar dhe i drejtohet lexuesit me një të tashme, që meqënëse vjen nga e shkuara, fiton trajtat e një të tashmeje rrëfimtare. Nga këndvështrimi i nuancave që shpreh, nuk është i njëjti rast me atë të “zërit rrëfimtari”. Figura e rrëfimitarit është e mirë vendosur brënda ngjarjeve të së shkuarës.


Kështu ndodh p.sh. me rrëfimin e Manxonit në romanin e tij të njohur “*I Promessi Sposi*”, ku ai i “betohet” lexuesit për besnikëri ndaj së vërtetës gjatë rrëfimit të tij, si dhe për pa anshmëri në gjykimet që jep përkundrejt personazheve.

“Qui è necessario tutto l’amore, che *portiamo* alla verità, per farci proseguire fedelmente un racconto di così poco onore a un personaggio tanto principale. Per questa stessa ragione d’imparzialità, *dobbiamo* però anche avvertire ch’era la prima volta, che a Renzo avvenisse un caso simile...” (“*Promessi sposi*”, A.Manzoni, pag 276)

Në këtë pjesë të rrëfimit të tij, autori e ndërpret rrjedhën e ngjarjeve dhe duke kaluar në përdorimin e të tashmes së dëftores, i drejtohet si në një bashkëbisedim të drejtë për drejtë lexuesit. Madje shkon edhe më tej: duke përdorur vetën e parë shumës, ai e bën lexuesin bashkëpunor në gjykimin e tij, duke shprehur edhe mendimin e lexuesit. Stili i përdorur është tipik i të ashtuquajturës “Ligjëratë e zhdrejtë e lirë”, e përdorur më gjerësisht sidomos prej autorëve antitradicionalistë të gjysmës së dytë të shek. XX,⁴¹ të cilët u munduan me këtë teknikë të vendosnin një komunikim të drejtë për drejtë me lexuesin, duke mos dalë vetë ata në vetën e parë.

Lexuesit e të gjitha kohërave, ndërsa do të lexojnë këto rreshta, do të ndjehen edhe ata bashkëpunorë të Manxonit, njësoj si lexuesit e periudhës në të cilën ai jetoi dhe punoi.

Pozicionimi i rrëfimitarit përkundrejt ngjarjeve dhe lexuesit



Gjithsesi, në poezi, përdorimi i të tashmes rrëfimtare paraqitet më i këndshëm edhe për shkak të pranisë së elementëve të tjerë poetikë. Për shëmbull në vargjet e mëposhtme, autori i tyre, Giosue Carducci, ka përcjellë në poezi, nëpërmjet përdorimit të kohës së tashme, nota epike të cilat zakonisht është e aftë t’i përcjellë vetëm e kryera e thjeshtë.

...*Sta* Federico imperatore in Como

Ed ecco un messaggero *entra* in Milano

da Porta Nova a briglie abbandonate.

“Popolo di Milano”, ei *passa e chiede*,

fatemi scorta al console Gherardi...

(*Il parlamento*, G. Carducci)

⁴¹ “*Guida allo studio della letteratura*”, R. Ceserani, Laterza, 1999.

“*Analisi stilistica*” A. B. Terracini, Feltrinelli, 1966, f. 361 – 378.

“*Lingua, grammatica, stile*”, G. Tedeschi, Petrini, 1971, f. 160.

Folja – *Stare-* (qëndron), në kohën e tashme të dëftores dhe e vendosur në fillim të vargut, i jep solemnitet figurës së perandorit Frederik në Komo, duke e paraqitur atë me imazhin e një burri të madh shteti. Po kështu, format foljore *entra, passa, chiede,* (*hyn, kalon, pyet*) mbartin bashkë me kontekstin ku janë vendosur, solemnitet, epizëm, si dhe e ridimensionojnë krejtësisht ngjarjen, duke ia rritur së tepërmi rëndësinë.

Përdorimi i kohës së tashme në këto vargje, duket sikur jo vetëm na i afron ngjarjet, por edhe fikson në kohë çaste historike, madhështie dhe epizmi, duke i skalitur ato në gjuhë.

Një tjetër rast i përdorimit të së tashmes rrëfimtare, është kur kjo e fundit përdoret brënda një dialogu. Atëhere përcjellja e ngjarjeve bëhet nëpërmjet personazheve që dialogojnë, të cilët kthehen edhe në “*dëshimtarë virtualë*” të ngjarjes, që në të vërtetë ka ndodhur shumë kohë përpara.

Il nonno – Ascoltami figlio: è proprio in questo momento che Cesare *ordina* un controattacco e *piomba* sul nemico.

Il figlio – E li *uccide* tutti ?

Il nonno – Colto di sorpresa, il nemico *fugge*, lasciando tutto il campo nelle mani dei soldati di Cesare.

E tashmja rrëfimtare që përdoret për të rikujtuar historinë është e vendosur në raport të drejtë me personazhet, të cilët nëpërmjet kohës foljore zhvendosen në të shkuarën dhe bëhen “të pranishëm” në ngjarje, ndërsa lexuesi mbetet disi asnjans dhe në periferi të ngjarjeve.

Modeli i kohës së tashme për të cilën folëm deri tani, përveçse rrëfimtare, fiton të drejtën të quhet edhe historike, kur përdoret në tekste historikë ose të historisë, në biografite e njëjzve të shquar të epokave të ndryshme, në monografite moderne dhe në të tjera situata të tilla specifike⁴². Një situatë e këtij lloji përfaqëson edhe shëmbulli i mëposhtëm, në të cilin vlerat dokumentare, qoftë të tekstit në tërësi, qoftë të kohës foljore në veçanti, janë të pamohueshme.

“...Nel 1274 *avviene* un incontro importantissimo per la vita di Dante, quello con la giovane Beatrice, figlia di Falco Portinari. Dante *se ne innamora*, ma di un amore tutto ideale: Beatrice *rappresenta* per lui la bellezza e anche la verità spirituale. Purtroppo

⁴² “*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004, f. 12.

Beatrice *muore* nel 1290 e Dante ne *resta* sconvolto. *Decide* così di approfondire i suoi studi, per poter realizzare un'opera poetica degna della donna da lui amata...

...Versi il 1315 Dante è ospite di Cangrande della Scala a Verona, dove *rimane* per cinque anni. Nello stesso periodo *inizia* la terza cantica del suo capolavoro (*Il Paradiso*)..."

Rast i veçantë është ai i zhvendosjes së ligjëruesit në të shkuarën, ndihmuar kjo edhe nga konteksti i mesazhit. Në njërin prej librave të tij, Giusto Conti shprehet:

“Nel bel passato *io sento* il mal presente e me medesimo oblio”.

Ajo që ndodh me dimensionin e kohës në këtë frazë është një “thyerje” totale e ligjeve të fizikës, por që gjuha, si i pari element “prej të cilit u krijua bota”, i ka tejkaluar prej kohësh, duke ia nënshtruar edhe ato ligjeve gjuhësore. Me anë të kuptimit kontekstual, autori zhvendoset në *të shkuarën* dhe prej andej ndjen me të gjithë intuitën e shpirtit të tij *të ardhmen* (të tashmen e ligjërimit), që nuk është tjetër veçse e tashmja e autorit. Një udhëtim në kohë? Aspak. Duket sikur koha nuk ka lëvizur, ajo është mbledhur e përqëndruar në një pikë të vetme dhe autori e përjeton nëpërmjet të tashmes së foljes “*io sento*”. Në këtë kontekst, e tashmja është vendosur brënda të shkuarës. Dimensioni hapsinor është sa real, aq edhe shpirtëror, madje tepër, tepër i shkrirë me to. Ekziston vetëm një përmasë e dallueshme, *Koha*, por edhe ajo me vlera universale.

Duke u larguar prej të tashmes rrëfimtare dhe historike, duhet thënë se në pjesën më të madhe të rasteve e tashmja nuk gjendet e vetme brënda një teksti, por e kombinuar edhe me kohë të tjera, si për shëmbull me të pakryerën, të kryerën e thjeshtë dhe të kryerën, të cilat edhe ato janë kohë karakteristike të rrëfimeve. Kur kemi të bëjmë me raste të tilla në tekstet letrarë, të tashmen e dëftores mund ta gjejmë edhe si pjesë të dialogjeve, ndërtuar në ligjëratë të drejtë.

4.3 E tashmja me vlera të së ardhmes

Gjithsesi e tashmja nuk përdoret vetëm me vlera të së shkuarës. E tashmja e mënyrës dëftore merr vlera stilistikore edhe ku përdoret për të zëvendësuar të ardhmen. Është si të udhëtojmë drejt një kohe që ende s'ka ardhur, ta arrijmë atë, të bëhemi dëshmitarë të asaj që do të ndodhë dhe këto ngjarje më pas t'i vendosim në të tashmen.⁴³E ardhmja në vetvete përmban të panjohurën, misterin, pamundësinë për t'u kuptuar, të papriturën, dimensionin hyjnor të profetit dhe profecisë. Por ja ku na vjen në ndihmë gjuha dhe ligjet e saj; mjafton të përdorim kohën e duhur dhe si me magji e ardhmja shpaloset përpara syve tanë dhe secili prej përdoruesve të gjuhës mund të udhëtojë me fantazinë e tij në “dimensionin hyjnor të kohës”.

Domani parto per Italia (Nesër nisem për në Itali)

Folja “*partire*” (nisem) është përdorur duke iu referuar një veprimi që do të kryhet në të ardhmen e afërt. Me përzgjedhjen e kohës së tashme në vënd të asaj të ardhme, bashkëbiseduesi ka dashur të shprehë vendosmërinë e tij, pa mëdyshje, për t'u nisur të nesërmen e çastit të ligjërit dhe për ta siguruar bashkëbiseduesin e tij që kjo gjë ka për të ndodhur. E ardhmja e shprehur në fjalinë e mësipërme i referohet një kohe relativisht të afërt (vetëm një ditë më pas).

Forse domani *vado* in campagna (Ndoshta nesër *shkoj* në fshat).

Përdorimi i “*forse*”, në shëmbullin e dytë, nuk e lejon bashkëbiseduesin të shprehë vendosmërinë e tij, përkundrazi kthehet në tregues të mëdyshjes së tij për ta realizuar atë që thotë, por nga ana tjetër për shkak të natyrës së dyfishtë që paraqet, është një element që na vërteton dëshirën që ka ai për t'u nisur dhe për të shkuar në fshat. Edhe në kontekstin e shëmbullit të dytë, bëhet fjalë për një të ardhme shumë të afërt, vetëm një ditë më pas. Përdorimi i kohës së tashme dëshmon faktin, që folësi ka një dëshirë mjaft të madhe për ta realizuar veprimin, i cili nëse varet tërësisht prej vullnetit të tij, mund të konsiderohet si i realizuar tashmë. Folësi ka filluar ta përjetojë që në çastin e ligjërit udhëtimin e tij.

⁴³ “*Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*”, A. Dhimo, Libri Universitar, 1996.

“*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.

“*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“*Grammatica italiana*”, A. Panzini, Sallerio Editore, 1982.

“*Grammatica italiana con nozioni di linguistica*”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995.

Më i kuptueshëm bëhet përdorimi i kohës së tashme për të zëvendësuar një të ardhme që do të ndodhë një çast më pas (dhe ku siguria që veprimi do të ndodhë shprehet në nivelet më të larta), apo edhe pas disa orësh. Është rasti, kur mjaft shpesh, e tashmja dhe e ardhmja përfshihen brënda njëra tjetrës, duke e humbur deri diku “*pavarësinë e territorit*” të tyre. Shëmbuj të shumtë hasen sidomos në gjuhën e folur (është përgjithësisht karakteristikë e gjuhës së folur, ndërsa në gjuhën e shkruar mund t’i ndeshim, për shëmbull, në dialogje letrare), pra në një komunikim të drejtë për drejtë midis dy bashkëbiseduesve⁴⁴:

- *Vai alla partita ?*
- *Esci con tua sorella ?*

Nuanca e të ardhmes e shprehur në dy shëmbujt e mësipërm, është kaq delikate, saqë kur i përkthejmë në gjuhën shqipe diçka humbet. Dy kontekstet e mësipërme gjuha shqipe i zgjidh ose me të tashmen e caktuar perfekteve, ose më të ardhmen, në varësi të situatës shprehimore

- *Po shkon në ndeshje ?* (Pra veprimi i referohet në mënyrë progresive çastit të ligjëritimit, ndërsa e ardhmja, të cilës i referohet konteksti në gjuhën italiane, nuk është e shprehur qartë, nëse bëhet fjalë për çastin e ligjëritimit, apo për një çast tjetër pas disa orësh. Nevojitet një kontekst më i plotë.)

- *Do të shkosh në ndeshje ?* (Në varësi të kontekstit, mund të jetë edhe e ardhmja që përdoret me një nuancë të së tashmes, kur bëhet fjalë për çastin menjëherë pas ligjëritimit) Në fakt, rol të rëndësishëm luan edhe i tërë konteksti i situatës, brënda të cilës zhvillohet dialogu.

- *Po del me motrën ?* - *Do të dalësh me motrën ?* (Arsytimi ndjek të njëjtin zhvillim si në shëmbullin e mësipërm).

Por largësia kohore e kryerjes së veprimit, që shprehet me të tashmen e mënyrës dëftore dhe që projektohet në të ardhmen, jo gjithmonë është e rëndësishme për të përcaktuar përdorimin e njëjës kohë apo tjetrës. Kështu, për shëmbull, në fjalinë e mëposhtme:

- *Tra due giorni parto per Roma* (Pas dy ditësh *nisem* për Romë), - Mund të përdoret koha e tashme për të zëvendësuar të ardhmen edhe kur largësia kohore, që e ndan

⁴⁴ “*Grammatica italiana; lingua commune e lingua letteraria*”, L. Serianni, UTET, 1989.

“*La lingua italiana per stranieri: corso superiore*”, K. Katerinov, Guerra, 1976.

veprimin nga çasti i ligjërimit, rritet me disa ditë. Edhe në këtë rast, ligjëruesi, me përdorimin e kohës së tashme përpiqet t'i komunikojë bashkëfolësit vendosmërinë e tij për ta kryer udhëtimin si dhe sigurinë që veprimi do të kryhet. Koha e tashme i jep veprimit që do të kryhet në të ardhmen e çastit të ligjërimit një nuancë të veçantë, thua se ky veprim është kryer tashmë. Ndërsa në shëmbullin tjetër:

- Tra cinque anni *smetto* di lavorare (Pas pesë vjetësh *dal* në pension), - as që bëhet fjalë për një të ardhme të afërt. Distanca kohore e reflektuar në kontekst është tepër e madhe, por vendosmëria me të cilën shprehet folësi, si dhe nuanca e sigurisë e shprehur nga koha foljore që është përdorur, nuk lënë vend për dyshime, që ka për të ndodhur pikërisht ashtu siç mendon folësi.

Shëmbujt e mësipërm vlejné si për vetën e parë të numrit njëjës, ashtu edhe për vetat e tjera të numrit njëjës dhe shumës. Mund të vërehet si në gjuhën e folur, ashtu edhe në gjuhën e shkruar: në dialogje, rrëfime në vetën e parë, rrëfime në ligjëratë të zhdrejtë etj.

Stili letrar dhe veçanërisht ai poetik, mund të sjellë shëmbuj të papërsëritshëm të përdorimit të kohës së tashme me vlerë të së ardhmes⁴⁵, shëmbuj që vështirë të gjënden në të folurën e përditshme, siç është edhe rasti i pjesës poetike në vijim:

Shën Valentinin nesër *kremtoj*

Dhe *ngrihem* në mëngjes

Dhe, vajzës, nga dritarja *po i shkonj*

Se nukë mund të pres... (*Albumi*, nga “*Hamleti*”, F. Noli, f. 51)

Duket sikur autori ka nisur ta festojë që në atë moment Shën Valentinin, i cili kremtohet të nesërmen e çastit të ligjërimit. Shoqëruar me ndajfoljen e kohës “*nesër*”, në pamje të parë duket sikur janë thyer të gjitha normat e logjikës kohore, por në fakt mënyra që ka zgjedhur ligjëruesi për të dhënë gëzimin e festës që pritet të vijë, është sa e veçantë, aq edhe artistike.

⁴⁵ “*Grammatica per italiani maggioreni*”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

4.4 Një e tashme aspektore që shtrihet në kohë.

Në fakt, me anë të gjuhës, e tashmja mund “të zhvendoset” në boshtin e kohës sa nga e shkuara me e largët, në të ardhmen më të përtejme. Mjafton që autori i një teksti të dëshirojë t’i trajtojë nga afër ngjarjet e shekullit XII – të, apo të XXII dhe koha e tashme do t’ia mundësojë një gjë të tillë. Për lexuesin do të ishte njëlloj sikur ai të jetonte vetë në atë shekull.

Gjithsesi koha e tashme ka aftësi jo vetëm të zhvendosë ngjarjet dhe fantazinë e lexuesve në kohë dhe hapësirë, por edhe të tregojë një realitet të përditshëm, që përsëritet, madje për periudha të gjata kohore. Ngjarjet e këtij realiteti përditësor mund të shtrihen: nga e shkuara, në të tashmen dhe të zgjaten drejt të ardhmes, pikërisht për shkak të “zakonit” të përsëritjes, deri në shndërrimin në një ritual, pra në një veprim, kryerja e të cilit kthehet në zakon⁴⁶. Ndërkohë pra, që e tashmja tregon përgjithësisht çastin në të cilin ndodh ligjërimi, rasti që po trajtojmë merr formë, kur koha e tashme e dëftores dëshmon njëkohësi me ligjëruesin dhe çastin e ligjërimit. Kjo e tashme që përsëritet, në gjuhën italiane emërtohet “*il presente di consuetudine*”⁴⁷ dhe përdoret në fjali të tipit:

Ogni giorno, Laura *mangia* qualcosa di dolce (Çdo ditë, Laura *ha* diçka të ëmbël).

Come di solito, prima di andare a lavorare, Giovanni *compra* “Il corriere della sera” (Si zakonisht, përpara se të shkojë në punë, Xhovani *blen* ...).

Kuptimi kontekstual i krejt fjalisë, ndikon drejt për së drejti në ngjyrimin e të tashmes me këtë nuancë të veçantë.

Koha e tashme e mënyrës dëftore, mund të tregojë edhe një veprim të pakufizuar në kohë, që ka vlera të përhershme e të pandryshueshme, pra gjithmonë aktuale. Në të gjitha situatat shprehimore që përdoret, duket sikur ky “lloj” i të tashmes qëndron jashtë dimensionit kohë, apo vetë koha nuk ka asnjë ndikim mbi të. Gramaticienët e gjuhës italiane e kanë quajtur këtë të tashme “*il presente atemporale*”⁴⁸ (e tashmja jashtëkohore)

⁴⁶ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

⁴⁷ “*Dire, fare, capire*”, G. Bottiroli, D. Corno, T. De Mauro, Paravia, 1990, f. 257

“*Grammatica avanzata della lingua italiana*”, S. Nocchi, R. Tartaglione, Alma Edizioni, 2006.

⁴⁸ “*Dire, fare, capire*”, G. Bottiroli, D. Corno, T. De Mauro, Paravia, 1990, f. 258.

“*Dizionario di linguistica*”, Zanichelli, 1983, f. 297

“*Grammatica italiana con nozioni di linguistica*”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995, f. 353

P. M. Bertinetto, në veprën e tij : “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*” përdor terminin e “*tashme gjithëkohore*” (*presente onnitemporale*). “*Mbarëkohore*” e konsideron edhe prof. Ali Dharmo në veprën e tij: “*Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*”, faqe 65, duke iu referuar më së shumti fjalëve të

dhe përdoret në tekste, ku mesazhit të shprehur nuk i humbet vlera me kalimi e kohës, si për shëmbull në përkufizimet shkencore, në formulat matematikore, në të vërteta proverbiale, apo edhe në tekste të karakterit të mirëfilltë shkencor.

L'acqua bolle a 100 gradi (Uji *vlon* në 100 gradë).

Tre più due fanno cinque (Tre plus dy *bëjnë* pesë).

Chi va col lupo, impara a ululare (Kush *shkon* me ujqit *mëson* të ulurasë).

E njëjta situatë, si më sipër, mund të haset edhe kur ligjëruesi i referohet vëndeve gjeografikë, apo kur përshkruan një vënd gjeografik. Për shëmbull:

“Roma si trova in Italia”

“Dalle colline circostanti si vedono le luci della città di Roma”

“Tirana ndodhet në pjesën perëndimore të Shqipërisë”

Përdorimi i kohës së tashme në këto situata shprehimore, i jep ligjërimit aktualitet dhe vërtetësi.

E “*tashmja jashtëkohore*” përdoret gjithashtu në citimet që u bëhen personaliteteve të çdo fushe, qofshin këta edhe të lashtësisë. Veçanërisht me foljet “*thotë*”, “*shkruan*”, “*pohon*”, etj., përdorimi i kohës së tashme të mënyrës dëftore, i jep gjithmonë thënieve të tyre, nuancë aktualiteti.

“Aristotele *afferma* che tra la verità e la falsità *esiste* “una terra di nessuno”, in cui ognuno di noi *compie* le sue ricerche...”

“Për retorikën, Platoni *thotë* që ajo nuk shërben për asgjë!

Në këto raste, jo vetëm që kemi të bëjmë me një të tashme që i qëndron rrjedhës së kohës, por edhe vetë personazhi historik që citohet, vishet me një tis aktualiteti.

Jemi mësuar që kur flasim për kohën e pakryer të mënyrës dëftore, të pohojmë se ajo tregon veprime që zgjaten për një periudhë kohe të pacaktuar. Por edhe e tashmja e

urta ose aforizmave. Na është dukur më i përshtatshëm termi i parë, për shkak se e tashmja, në përdorime të tilla, tregon një veprim që qëndron më tepër jashtë nocionit kohor, se sa një veprim gjithë-kohor-përfshirës.

mënyrës dëftore mund të fitojë vlera të tilla dhe të tregojë veprime që shtrihen në kohë⁴⁹, madje pa ndonjë adresë të saktë kohore:

Come fa a saperlo ? Sta bene con i suoi nonni ! Rimane un vuoto dentro lui !

Të njëjtin fenomen e hasim edhe në gjuhën shqipe, siç është shëmbulli i mëposhtëm, marrë nga libri “Emblema e dikurshme”, i Ismail Kadaresë:

“...Si *ia bën* ajo e vetme midis tyre? – tha njëra nga vajzat

Koha e tashme e përdorur në fjalinë e mësipërme paraqitet mjaft e shtrirë në kohë. Ajo përfshin të shkuarën, të tashmen, madje nënkupton, duke e paragjykuar, edhe të ardhmen, pasi në kontekst, situata nuk ka gjasa të ndryshojë edhe në të ardhmen.

Përtej aftësisë së saj *gjithë-kohë-përfshirëse*, duke mos ia kufizuar aspak vlerat që e tashmja ka për t’u shtrirë sa më gjatë në kohë, teorikisht duhet thënë se ajo mund të tregojë edhe një pafundësi, brënda universalitetit të realitetit objektiv. I tillë është përdorimi i kohës së tashme në terciën e mëposhtme të Dantes, shkëputur nga pjesa e parë e veprës së tij dhe që “aludon” për “ekzistencën” e një teksti të shkruar, që ndodhet i vendosur mbi portën që të shpie drejt ferrit:

Per me *si va* nella città dolente,
per me *si va* nell’eterno dolore,
per me *si va* tra la perduta gente.

Dante, “L’Inferno”.

Fjala e përzgjedhur në vargun e dytë – *eterno* – (i përjetshëm), duket sikur i jep përjetësi krejt mesazhit të strofës. Anafora e vendosur në fillim të secilit varg, mbështetur edhe nga një e tashme e foljes “*andare*”, që i jep ekzistencës së këtij mbishkrimi *vërtetësi letrare*, i veshin imazhit të ndërtuar prej autorit ngjyra universale, thua se ato vargje janë shkruar realisht mbi atë portë dhe do të mbeten aty në përjetësi.

Koha e tashme e përdorur në shëmbullin e mësipërm shfaq aspekt të dyfishtë: progresion dhe determinizëm.

⁴⁹ “Aspekti dhe mënyrat e veprimt foljor në gjuhën shqipe”, A. Dharmo, Libri Universitar, 1996, f. 70

“Grammatica italiana con nozioni di linguistica”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995.

“Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

Në konceptin psikologjik dhe letrar, kohëzgjatja, - sado që ajo të zgjasë – shpesh nuk është e lidhur ngushtë me kohën reale, por me përjetimin e individit. Çasti që tregon ankth për jetën e një njeriu të dashur, një puthje midis dy të dashuruarve, një ndarje për të mos u takuar më, apo një mëngjes i bukur me aromë lulesh e cicërima zogjsh, mund ta ngarkojnë mëndjen njerëzore me aq shumë intensitet jetësor, saqë për shkak të përjetimeve të pashlyeshme emocionale, t'i japë çastit disa vlera pafundësie. Fenomeni mund të vërehet më qartë kur përdoren disa folje, që nga ana e aspektit semantikor, shprehin veprim që fillon dhe mbaron brënda një çasti të vetëm, si p.sh.: *lind, vdes, fillon, mbaron*, etj.

Kështu në shprehjen “*Dielli po lind*” (në italisht: *il sole sta nascendo*), edhe për shkak të përdorimit të formës së caktuar perfekte dhe pjesëzës “*po*”⁵⁰, që e fikson të tashmen në proces e sipër, agimi i kuqerremtë që i paraprin lindjes së diellit ngjan sikur nuk do të përfundojë ndonjëherë, ndërsa vetë *lindja e diellit* fotografohet e ngrirë në fillimet e saj. I njëjti fenomen ndodh edhe në shëmbullin italisht. Forma foljore e përdorur dhe prania e foljes gjysmë ndihmëse “*stare*”, e vesh veprimin që pritet të përfundojë plotësisht me aspekt pritshmërie. Duket sikur koha e fiksuar në të dy variantet gjuhësore është ajo e paralindjes, që i prin lindjes dhe jo vetë *lindja e diellit*, që mbetet i nënkuptuar nga mesazhi, por i pashprehur nga ana leksikore. Pra *i fiksuar* në këtë formë brënda situatës shprehimore për të cilët bëhet fjalë, a ka gjasa që konteksti apo mesazhi të ndryshojnë? Jo. Koha brënda fjalisë e ka ndërprerë rrjedhën e saj. Brënda kontekstit të dhënë, koha nuk evoluon më dhe dielli nuk do të lindë, - për lindjen e tij nevojitet të shprehemi me anë të një tjetër fjalie. Kjo është arsyeja, për të cilën na lind e drejta të themi se e tashmja nuk do të ndryshojë më aty brënda, por ajo do të mbetet e pandryshuar në përjetësi (fotografimi i çastit nëpërmjet të tashmes).

E njëjti fenomen vërehet edhe me folje të tjera, të së njëjtës natyrë:

“Miqësitë e vjetra *po vdesin*.” (*Le vecchie amicizie stanno morendo*).

“*Po nis* nje epokë e re.” (*Sta iniziando una nuova era*) etj.

Nga ana tjetër, nuk kemi si të mos vëmë re që koha foljore e përdorur në këta shëmbuj shfaq edhe një nuancë progresiviteti të lëvizjes, nuancë kjo që përforcohet me foljet që tregojnë lëvizje, si “*andare*” (*shkoj*), “*venire*” (*vij*), “*camminare*” (*eci*), etj. Në

⁵⁰ “*Gramatika e gjuhës shqipe I*”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002, f. 274: ...kur është fjala për një veprim të caktuar, në zhvillim e sipër, atëherë përpara formave sintetike vendoset pjesëza përcaktuese “*po*”, psh.: *Po laja, po zbres, etj...*”

Prof. Shaban Demiraj është i mendimit që pjesëza “*po*” shpreh edhe një nuancë vazhdimësie: “*Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*”, Sh. Demiraj, Prishtinë, 1971, f. 167 – 198.

gjuhën shqipe përforcohet edhe më tepër në rastin e të “tashmes perfekte”, ndërtuar me pjesëzën “po”.

Kush *po shkon* ashtu me bujë?

Kush *po vjen* ashtu për ujë?

Po *shkon* trimi si dragua,

Po *vjen* vasha për në krua

(*Vepra letrare*, L. Poradeci, f. 203)

Interesant është përdorimi i të “*tashmes gnomike*”⁵¹, pra i atyre rasteve, kur koha e tashme është përdorur brënda një sentence, në të cilën përfshihen e shkuara, e tashmja dhe një farë pritshmërie për të ardhmen, për shëmbull kur themi:

“Dio *vede tutto!*” (Zoti *shikon* gjithshka!)

“La *verità è un bene supremo, ma non sempre!*”

“Në këtë botë *lahen* të gjitha!”

“Bota *rrotullohet!*”

Në këtë lloj strukture është shpesh i pranishëm edhe një lloj paralajmërimi

Për shkak të faktit, që i drejtohet të rinjve në mënyrë të drejtë për drejtë, nocioni i kohës humbet edhe në kontekstin e mëposhtëm, shkëputur nga fjalimi i njërit prej personaliteteve themelues të Italisë si shtet i bashkuar, Maxinit:

...*Pensate o giovani alle date promesse, al sangue dei nostri martiri...all'Italia dell'avvenire che aspetta da voi la sua iniziazione...*”

Për meritë të kohës foljore të përdorur, duket sikur autori flet për të tashmen e çastit të ligjërit, duke përfshirë paksa edhe kohët që do të vijnë, por për shkak edhe të një farë anonimatit të marrësit të mesazhit (autori i drejtohet krejt rinisë italiane), thënia është e vlefshme për të gjitha kohërat.

⁵¹ “*Dizionario Enciclopedico Sansoni*”, 1986, f. 864 : gnomike quhet dituria e shprehur nëpërmjet aforizmave apo përfundimeve të nxjerra nga eksperiencia jetësore.

“*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinotto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

Po për shkak të urtësisë, ose moralit të shprehur në mesazh, apo edhe për shkak se vlera e kësaj urtësie nuk humbet as me kalimin e kohës dhe as me ardhjen e kohëve të reja, e tashmja fiton vlera gjithëkohore edhe në disa thënie të urta popullore, si p.sh.:

Quanto più *hai*, tanto più *desideri*. (Sa më shumë të kesh, aq më shumë dëshiron – në gjuhën shqipe, ky kumtim zgjidhet pjesërisht me përdorimin e mënyrës lidhore).

Thënia mbetet e vlefshme për të gjitha brezat dhe epokat. Por edhe në gjuhën shqipe hasim të njëjtën vlerë, në disa fjalë të urta popullore të llojit:

I zoti e *nxjerr* gomarin nga balta. (L'occhio del padrone *ingrassa* il cavallo)

Gjuha kocka *s'ka*, por kocka *thyen*.(La lingua non *ha* osso, ma *fa* rompere il dosso).

Në veprat letrare përdoret për të evokuar një realitet të hershëm, për të cilin autori mendon se duhet të jetë në dijeni edhe lexuesi:

“Tutti *sanno* che a Pocapaglia

“L'asino *fischia* e il suo padrone *raglia*” (Fiabe italiane, I.Calvino, p. 43)

4.5 Nuanca aspektore të kohës së tashme.

Për të përcaktuar nëse kemi nuanca aspektore ose jo, apo edhe në përcaktimin e llojit të një aspekti përkundrejt një aspekti tjetër, është e nevojshme:

Së pari : analiza dhe interpretimi i saktë i kontekstit të fjalisë apo mesazhit;

Së dyti: njohja dhe përcaktimi me saktësi i ngjyrymeve semantike të foljes në një kontekst të caktuar.

⁵²Aspekti ndikohet pra si nga raporti që fjala apo kategoria gramatikore vendos me gjymtyrët e tjera të fjalisë, ashtu edhe nga sjellja e fjalës apo kategorisë së gramatikore në

⁵² “Dizionario Enciclopedico Sansoni”, 1986, f. 2327, (verbo).

“Time in language” Wolfgang Klein, Routledge, London, 1994.

veçanti. Gjithsesi, nuanca aspektore e fjalës apo kategorisë gramatikore interpretohet gjithmonë brënda kontekstit të ligjëritimit.

Kur i referohemi kohës së tashme të mënyrës dëftore, në varësi të kontekstit, ajo mund të përftojë disa lloje nuancash aspektore.

Aty ku shpreh një veprim të përsëritur e të kthyer në zakon, e tashmja e dëftores përfton pikërisht nuancën aspektore të një veprimi që përsëritet vazhdimisht e kthehet në zakonor. Për shëmbull:

“Da un mese *piove* ogni giorno!” (Prej një muaji *bie shi* çdo ditë)

“L’orso *dorme* durante l’inverno.” (Ariu fle gjatë dimrit)

“Në pranverë *vijnë* dallëndyshet.”

Siç shihet edhe nga shëmbujt e mësipërm, disa fenomene që përsëriten në mënyrë ciklike, nëse shprehen me kohën e tashme, bëjnë që folja dhe e tashmja e përdorur të përftojnë pikërisht nuanca të përsëritjes ciklike, për veprime të cilat konsiderohen tashmë si të zakonshme.

Në raste të tjera, aspekti i veprimit që konsiderohet si i zakonshëm, lidhet me kontekste që i referohen sjelljeve zakonore të njerëzve⁵³ dhe që mund të kenë lidhje qoftë me veprime të tyre të përditëshme, qoftë me periudha më të gjata ciklike, si për shëmbull kur themi:

“Marco si alza ogni mattina alle 5.00” (Marko ngrihet çdo mëngjes në orën 5.00)

“Ogni giorno, Luigi *prende* il tram per andare all’ufficio” (Çdo ditë, Luixhi *merr* tramvajin për të shkuar në zyrë)

“Luiza *del* mbrëmjeve në dritare dhe *ujit* lulet”

Shpesh, për shkak të rregullsisë së përsëritjes së fenomenit, veprimi zakonor mund të përftojë edhe një ngjyrim vazhdimësie, veçanërisht kur përsëritja e kësaj rregullsie bëhet tej mase e shpeshtë, sa që veprimi fillon e shfaqet si i pandërprerë:

“Antonio *sopporta* ogni cosa pazientemente” (Antonio duron gjithshka me qetësi)

“Nuk *harron* të ndihmojë fqinjët”

⁵³ “Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe”, A. Dhrimo, Libri Universitar, 1996, f. 60 – 91.

Duke qënë se kemi të bëjmë me veprime të kryera, shpesh këto përfaqësohen nga folje që shprehin vese në kohën e tashme, përgjithësisht si karakteristikë e gjuhës së folur:

“Gabriele *fuma.*” (Gabrieli pi cigare)

“Arditi *pi...*” etj.

Një veprim zakonor mund të jepet edhe me një folje që evokon një veprim, që ka të bëjë me një profesion, për shëmbull kur themi:

“Lei *canta.*” (ajo këndon)

“Lui *scrive.*” (ai shkruan)

“Arbeni *pitkuron*”, etj.

Përtej aspektit të veprimit të kthyer në zakon, koha e tashme, në një kontekst të përshtatshëm, mund të përftojë edhe aspekt vazhdimësie, pra të shprehë një veprim që vazhdon pa u përfunduar.

“E’ dall’inizio della conferenza che l’ambasciatore *chiede* alla ragazza seduta vicino a lui di tradurgli ciò che *dice* l’oratore” (ka që nga fillimi i konferencës që ambasadori i *kërkon* vajzës të ulur afër tij, që t’i përkthejë atë që *thotë* oratori).

Edhe pse është e kuptueshme që bëhet fjalë, në fakt, për një “kërkesë të përsëritur”, koha e tashme bën që folja ta shtrijë veprimin që shpreh përgjatë krejt periudhës kohore (që nga fillimi i konferencës), duke përfutur një nuancë vazhdimësie. Veprimi mbetet i papërfunduar, ose të paktën nuk merr zgjidhje.

⁵⁴Shpesh herë, nuanca e vazhdimësisë pa përfundim të veprimit mund të jepet edhe me përsëritjen e foljes (dyfishimin e foljes):

“La piccola *piange e piange*, e non intende smettere” (Vogëlushja qan e qan dhe nuk ka ndër mend të pushojë)

“Ka kohë që *kërkon e kërkon* dhe nuk na flet me gojë”

⁵⁴ Prof. A. Dhrimo, ndërsa trajton kohën e pakryer, e shikon përsëritjen më tepër si shprehje të intensitetit të veprimit (“*Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*”, A. Dhrimo, Libri Universitar, 1996, f.97). Jemi të mendimit, që në varësi edhe të kontekstit, përsëritja në kohën e tashme paraqet vazhdimësi, progresion, ose një ndërthurje të të dy nuancave, duke e vënë theksin më tepër te vazhdimësia, meqënëse nuk kemi një përfundim të veprimit. Në përrallat shqiptare, për shëmbull, shprehja “...*ec dhe ec...*” tregon një veprim që zgjat deri në çastin kur rrëfimtari nuk vendos ta përfundojë këtë veprim “...*deri sa arritën në një shtëpizë të vogël buzë një liqeni...*”.

Nuanca vazhdimësie vihen re edhe në ato raste të gjuhës së folur, kur ligjëruesi i referohet një situatë të caktuar, e cila ka kohë që vazhdon e tillë, p.sh.:

- Tu non *sai chi sono io!* (ti nuk e di cili jam unë)

- Ti nuk studion fare ! etj.

⁵⁵Koha e tashme e mënyrës dëftore mund të shfaqë edhe nuancën e një veprimi progresiv, kryesisht me folje që përshtaten nga pikpamja e kuptimit, si psh. zhvilloj, evoluoj, përpunoj, përmirësoj, përkeqësoj etj:

“Giacomo migliora ogni giorno di più, come studente e come persona.”

“Europa zhvillohet pa u ndalur në rrugën e demokracisë!”

4.6 E tashmja e dëftores apo e tashmja e lidhores ?

Në gjuhën italiane, qëllon shpesh që mënyra dëftore të zërë vëndin e lidhores, në fjali të varura me folje që shprehin opinion, apo me folje të llojit: *sapere, dire*, në formën mohuese. Natyrisht ngjyrimet kuptimore të kontekstit ndryshojnë, ndryshojnë edhe vlerat e të tashmes, kur është ajo koha e përzgjedhur prej ligjëruesit.

Non so se Carlo sta (stia) bene. (Nuk e di nëse Karlo ndjehet mirë).

Credo che Carlo non sta (stia) bene. (Besoj se Karlo nuk ndjehet mirë).

⁵⁶Në rastet kur informacioni i dhënë përmban pasiguri ose dyshim rreth vërtetësisë së tij, gramatika italiane këshillon përdorimin e mënyrës lidhore, madje në shumicën e rasteve ky përdorim është i detyrueshëm. Në shëmbujt e mësipërm, zëvendësimi i të

⁵⁵ “Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe”, A. Dhrimo, Libri Universitar, 1996, f.60 – 91.

“Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

⁵⁶ “I verbi italiani”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.

“Grammatica per italiani maggiori”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

“La lingua italiana per stranieri”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010

“Grammatica italiana con nozioni di linguistica”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995.

“Dizionario di Linguistica”, Zanichelli, 1983.

“Lingua e linguaggi”, F. Sabatini, Loescher Editore, 1990.

tashmes së lidhore, me kohën e tashme të dëftores, bën që raporti midis kumtuesit të mesazhit dhe subjektit për të cilën bëhet fjalë në mesazh, Karlos, të jetë akoma më i ngushtë, ndërsa konteksti të mbartë një dozë më të madhe shqetësimi, se në rastin po të ishte përdorur lidhorja. Karakteristikë e kësaj mënyre të shprehuri është sidomos përdorimi mjaft i gjerë i saj në gjuhën e folur.

Interesant paraqitet përdorimi i po këtij rasti në poezi, pra përdorimi i të tashmes së dëftores në vënd të së tashmes së lidhore. Kështu, në “*Komedinë Hyjnore*”, ndërsa Konti Ugolini takohet me Danten, i drejtohet atij me këto fjalë:

“Non *so* chi tu sii

Né per che modo *sei* quaggiù...”

Përdorimi i të tashmes së dëftores, megjithëse i parregullt nga pikpamja e gramatikës së gjuhës italiane, justifikohet me faktin që Konti Ugolini arrinte ta shikonte Danten, ndërsa ky i fundit qëndronte përpara tij, por ende nuk e dinte cili ishte. Pra “*pasiguria e lidhore*” zëvendësohet me praninë në kontekst të personazhit, të cilit nuk i njihet identiteti.

Në të tjera raste, gjuha italiane lejon luksin e përzgjedhjes së njëres apo tjetres formë foljore, në varësi të nuancës kuptimore që dëshiron të përçojë kumtuesi:

“*Dicono* che il maltempo *stia* (lidhore) per cominciare.”

“*Dicono* che il maltempo *sta* (dëftore) per cominciare.”

Në dy shëmbujt e mësipërm, të dyja format foljore janë përdorur në mënyrë korrekte nga ana gramatikore, por nëse në rastin e parë, ligjëruesi e vesh informacionin që kumton me një vel dyshimi, pra informacioni nuk është tërësisht i sigurtë, në rastin e dytë, koha e tashme e dëftores e paraqet lajmin pa dyshime dhe të sigurtë. Përzgjedhja e njëres apo tjetres formë foljore, mbetet në funksion të sigurisë që ka kumtuesi, për informacionin që kumton.

Mbetet në dorë të kumtuesit të përzgjedhë edhe në shëmbujt e mëposhtëm:

“Ti ho raccontato queste cose perché *tu sia* mio amico.”

“Ti ho raccontato queste cose perché *tu sei* mio amico.”

Në shëmbullin e parë, përdorimi i kohës së tashme lidhore realizon shfaqjen e dëshirës nga ana e kumtuesit, që bashkëbiseduesi i tij të bëhet edhe miku i tij. Në shëmbullin e dytë, koha e tashme e mënyrës dëftore realizon thjesht një kuptim shkakor, pra “*po të tregoj këto gjëra, pasi ti je miku im*”.

Përgjithësisht, shëmbuj të tillë janë më të shumtë në gjuhën e folur.

⁵⁷Gjithsesi, në gjuhën italiane, arsytet e zëvendësimit të lidhores me dëftoren mund të jenë edhe të karakterit etiko-stilistikor. Nëse kumtuesi dëshiron të shprehet me një formë më elegante, më të përpunuar dhe më të rafinuar, duke ruajtur edhe një raport respekti përkundrejt bashkëbiseduesit, ai zgjedh të përdorë mënyrën lidhore; ndërsa, në ato raste, kur vendos të jetë më i thjeshtë, më i drejtë për drejtë, më pranë nuancave të një bashkëbisedimi midis miqsh, kumtuesi mund të zgjedhë për të përdorur mënyrën dëftore.

Shëmbulli i mëposhtëm paraqet një formë të përpunuar dhe me një farë standarti:

“*Cara Valentina,*

*penso che sulle passioni non **si possa** discutere, perché rappresentano un valore in più nella vita: quello che ne aumenta la qualità. E purtroppo io ho l'impressione che i tuoi genitori **siano** egoisti e, per questo, incapaci di essere dalla tua parte. Sei in una situazione difficile, ma credo che **tocchi** a te decidere il tuo futuro.*”

Shëmbulli i mëposhtëm, paraqet një formë të papërpunuar, kumtuesi nuk kujdeset për mënyrën si i drejtohet marrëses së mesazhit, e tashmja e dëftores që ka zëvendësuar lidhoren është tregues i faktit, se të dy personat që komunikojnë, kanë shumë konfidencë me njëri tjetrin.

“*Cara Valentina,*

*penso che sulle passioni non **si può** discutere, perché rappresentano un valore in più nella vita: quello che ne aumenta la qualità. E purtroppo io ho l'impressione che i tuoi genitori **sono** egoisti e, per questo, incapaci di essere dalla tua parte. Sei in una situazione difficile, ma credo che **tocca** a te decidere il tuo futuro.*”

Shpesh, edhe vendosja e foljes në fjali mund të japë nuanca të ndryshme shprehimore dhe stilistikore. Kjo ndodh qoftë për shkak të ndryshimit të raporteve midis

⁵⁷ “*Grammatica per italiani maggieoreni*”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

“*Lingua, grammatica, stile*”, G Tedeschi, Petrini, 1971

“*La lingua come strumento di libertà*”, L. Nadin, Padova, 1990.

“*Grammatica essenziale della lingua italiana*” M. Mezzadri, Guerra Edizioni, 2000.

gjymtyrëve të fjalisë, qoftë edhe për shkak se fjala-folje përfton nuanca të reja kur vendoset me të tjera fjalë pranë.

Jo rrallë, përdorimi i njëjës apo tjetrës kohë foljore varet edhe nga kuptimi semantikor i foljes, por në situata shprehimore të caktuara dhe në varësi të asaj që kumtuesi kërkon të shprehë, mund të thyhen edhe disa të ashtuquajtura “skema”.

Zakonisht, vendosja e foljes *credere* (besoj) në fillim të fjalisë, e kërkon foljen e fjalisë së varur në mënyrën lidhore, por nuk ndodh gjithmonë kështu. P.sh.

Io credo che c'è un Dio solo. (Unë besoj që ka vetëm një Zot).

Forma foljore “*Io credo*” (Unë besoj) nuk e ngarkon me asnjë hije pasigurie kontekstin e mesazhit të mësipërm dhe kjo është arsyeja që folja *essere* (jam) vendoset në të tashmen e mënyrës dëftore. Nëse të njëjtën folje do ta vendosnim në formën mohore, situata do të ndryshonte rrënjësisht dhe përdorimi i lidhore do të bëhej i detyrueshëm:

Non credo che esista un solo Dio. (Nuk besoj të ekzistojë vetëm një Zot).

Pra pavarësisht prej ekzistencës së strukturave gramatikore, jo gjithmonë këto struktura janë të pandryshueshme. Shpesh herë në përzgjedhjen e njëjës apo tjetrës mënyrë, rol të rëndësishëm luan kuptimi i vetë mesazhit, siguria e vërtetësisë së informacionit që përcillet, fakti nëse mesazhi i një fraze është i vërtetë apo i pavërtetë.

Për shëmbull, në tekstin e mëposhtëm, pavarësisht nëse personazhi për të cilin bëhet fjalë nuk është në dijeni që i biri i saj është vrarë, ky fakt është gjithsesi aq i vërtetë, saqë përdorimi i mënyrës lidhore, vetëm e vetëm për të qëndruar brënda një strukture gramatikore, do të ishte një arsye e pamjaftueshme, për shkak edhe të nuancave krejt të ndryshme që do të shprehte:

“*Questa signora non deve sapere che l'ucciso è suo figlio.*” (Pra i biri i është vrarë, por zonja nuk ka ende dijeni).

4.7 Përdorimi i kohës së tashme me folje që shprehin dëshirë⁵⁸.

Mjaft nuanca kontekstuale paraqet përdorimi i të tashmes së dëftores me foljet e tipit *volere, desiderare, amare, sperare*, për shkak edhe të kuptimit që mbartin këto folje. P.sh.

“Qua voglio vederti” (Qui vorrò vederti – formë që do të ishte e gabuar)

“Këtu dua të të shoh.”

E tashmja e foljes “*volere*” (dua), për shkak se shpreh një dëshirë, deri diku ka vlera aspekte që shtrihen drejt të ardhmes, ose që projektohen në të ardhmen. Ajo shpreh edhe një dëshirë të çastit, brënda të cilit ligjëruesi trasmeton atë çfarë ai dëshiron, pavarësisht nëse kjo gjë realizohet në të tashmen apo në të ardhmen. Pra midis të tashmes dhe të ardhmes, folja *volere* i përfshin të dyja, duke u pozicionuar në pritje të zhvillimit të mëtejshëm të ngjarjeve (nga e tashmja – në të ardhme).

- Come vuoi ! - Come volete ! (Në gjuhën shqipe shprehet me mënyrën lidhore)

Dy shprehjet e mësipërme janë kthyer tashmë në “formula” për gjuhën italiane, në një situatë shprehimore kur gjithshka investohet, duke iu nënshtruar vullnetit dhe vendimit të të tjerëve. Edhe në këtë rast, nuancat e kohës shkojnë duke u shtrirë nga e tashmja drejt të ardhmes, me një farë pritshmërie përkundrajt vullnetit të ngjarjeve të mëpastajme.

- Non voglio sbagliarmi (Nuk dua [dëshiroj] të gabohem).

E vendosur në kohën e tashme (por edhe të pakryer), folja *volere* shërben si një mënyrë mirësjelljeje, ose mirëdashjeje, në raport me bashkëfolësit e tjerë. Në shëmbullin e mësipërm, përdorimi i saj shërben për të treguar edhe një farë maturie, njëfarë qëllimi mirëdashës të lidhur me çastin e ligjërimit, por edhe për të treguar që : “*nuk po gabohem aspak*”, ose mbart idenë se “...*të paktën, unë jam i sigurtë që nuk gabohem...*”, e “veshur” kjo me një formë mirësjelljeje (në varësi edhe të kontekstit).

Të trija rastet e mësipërme me foljen *volere*, janë karakteristika përgjithësisht të gjuhës së folur, por mund të bëhen pjesë e dialogjeve në gjuhën e shkruar, sidomos në tekstet letrare, për t’i dhënë ngjyra sa më reale të folurit të personazheve.

⁵⁸ Duke vërejtur rastin e foljes “*amare*”, “*io amo*” (unë dashuroj), u vu re rëndësia e përdorimit të kohës së tashme me foljet që shprehin dëshirë dhe për këtë arsye u mendua të trajtohen si një rast i veçantë, kur këto folje përdoren në kohën e tashme të mënyrës dëftore.

Me dy foljet e tjera, *desiderare* (dëshiroj) dhe *amare* (dashuroj), koha e tashme fiton një *status* krejtësisht të veçantë. E vetmja mundësi që ligjëruesi të shprehë dashurinë ndaj partnerit, mbetet përdorimi i kësaj kohe.

- Io ti desidero ! - Io ti amo ! (Unë të dashuroj !)

Asnjë variant tjetër i kohëve foljore, me përjashtim të së tashmes të dëftores, nuk ekziston për të përcjellë një mesazh dashurie. Krahasojmë:

- Io ti ho amato! (Unë të kam dashur!). – Kuptimi i kontekstit është “*nuk të dua më*”

- Io ti amavo! (Unë të dashuroja!). – Pra për një arsye, ose një tjetër, nuk të dua më, madje forma me të pakryerën mbart edhe nuanca zhgënjimi.

- Io ti amerò! (Unë do të të dashuroj!) – Konteksti bën fjalë për një premtim, se në të ardhmen do të bëj gjithshka që të dashurohem me ty, por tani për tani, nuk të dua!

Nisur nga krahasimet e mësipërme, mund të nxjerrim si përfundim që koha e tashme është e vetmja kohë e përshtatshme për të shprehur dashurinë dhe e vetmja kohë që ka rëndësi për dashurinë (koha e tashme –e vetmja kohë e qënësishme e realitetit njerëzor).

Edhe folja “*sperare*” (shpresoj) fiton disa vlera të veçanta kur përdoret në kohën e tashme, që nuk i shfaq kur përdoret me kohët e tjera. Kështu për shëmbull, në shprehjen me mjaft përdorim në gjuhën italiane “*Spero bene*”, të vendosur brënda një situatë shprehimore me rolin e një përgjigjeje të dhënë nga bashkëbiseduesi, komunikohet, në fakt besimi, që ajo për të cilën bëhet fjalë në mesazh, do të zhvillohet sipas dëshirave të vetë personit që shprehet në këtë mënyrë, përfshirë këtu edhe një farë paralajmërimi të fshehur në kontekst.

- Tornerò domani. (Do të kthehem nesër).

- *Spero bene!* (Ashtu shpresoj!)

Folja “shpresoj” nuk do të kishte këtë kuptim me asnjë prej kohëve të tjera foljore. Në shëmbuj të tjerë:

- *Spero che venga presto!* (*Shpresoj që të vijë shpejt!*)

- Mi ha detto che “*spera*” in una nuova nomina! (Më ka thënë, që *shpreson* në një emërim të ri).

Që të tregojë një gjëndje shpirtërore shprese të ligjëruesit, folja “*sperare*” (*shpresoj*) vendoset vazhdimisht në kohën e tashme; me kohët e tjera kjo nuancë shprehimore humbet, duke mos treguar më një gjëndje shprese.

⁵⁹E njëjta situatë përsëritet edhe me mjaft folje që shprehin një gjëndje shpirtërore. Të vendosura në një kohë tjetër, përveç të tashmes, këto folje tregojnë një situatë të brëndshme të ligjëruesit, që ka ekzistuar, por që nuk ekziston më. E vetmja mundësi për ta shprehur gjëndjen shpirtërore, është përdorimi i kohës së tashme; në të gjitha rastet e tjera kjo gjëndje shpirtërore, ose ka ndryshuar, ose nuk ka ndodhur ende. Folje të kësaj natyre mund të përmëndim:

Odiare (urrej), *piacere* (pëlqej), *piangere* (qaj), *disprezzare* (përçmoj), *sentire* (ndjej), etj.

4.8 Disa përdorime të tjera me vlera shprehimore dhe stilistikore të kohës së tashme.

⁶⁰Koha e tashme e mënyrës dëftore i humbet ngjyrimet emocionale dhe bëhet tejet informuese, kur përdoret në formën pavetore (veta e tretë). Kjo formë është karakteristike sidomos e gjuhës së shkruar, kur përdoret stili administrativ, por edhe kur ligjëruesi ka për qëllim të japë thjesht një informacion, duke qëndruar indiferent përkundrejt këtij informacioni.

- *Vengono* ad aggiustare il tetto.

Folja komunikon thjesht një informacion, rreth asaj që po ndodh. Gjithsesi, edhe në këtë rol, ajo mbart vlerat shprehimore të informimit.

⁵⁹ Duke e shtyrë analizën edhe më tej, u vu re që edhe mjaft prej foljeve që shprehin një gjëndje shpirtërore, të vendosura në kohën e tashme, fitojnë vlera të papërsëritshme në kohët e tjera.

⁶⁰ “*Linguaggi settoriali in Italia*”, G. L. Beccaria, Bompiani, 1973.

“*Grammatica italiana*”, A. Panzini, Sellerio Editore, 1982.

“*Grammatica italiana con nozioni di linguistica*”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1983.

“...La Repubblica *riconosce e garantisce* i diritti inviolabili dell’uomo, sia come singolo sia nelle formazioni sociali ove *si svolge* la sua personalità, e *richiede* l’adempimento dei doveri inderogabili di solidarietà politica, economica e sociale...” (*Costituzione della Repubblica Italiana*, articolo 2.)

“...Republika e Shqipërisë *mbron* të drejtat kombëtare të popullit shqiptar, që *jeton* jashtë kufijve të saj.

Republika e Shqipërisë *mbron* të drejtat e shtetasve shqipëtarë, me banim të përkohshëm, ose të përhershëm jashtë kufijve të vet.

Republika e Shqipërisë u *siguron* ndihmë shtetasve shqipëtarë, që *jetojnë e punojnë* jashtë shtetit, për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare...” (*Kushtetuta e republikës së Shqipërisë*, neni 8.)

Përtej stilit të ftohtë burokratik, e përdorur në dokumenta të rëndësishëm zyrtarë, koha e tashme shpreh edhe solemnitetin e aktit, apo veprimit, që mbart folja.

⁶¹Koha e tashme e mënyrës dëftore mund të zëvendësojë edhe kohën e pakryer, ose të kryer, kur veprimi që folja shpreh, konsiderohet sikur është ende në proces dhe nuk ka përfunduar.

“*Sono due giorni che né mangio, né dormo.*” (Kam dy ditë që as *ha*, as *fle*).

Foljet tregojnë një gjëndje ende në proces të ligjëruesit, fundi i të cilës nuk sinjalizohet në kontekstin e fjalisë.

Nuk do të shprehim të njëjtën nuancë nëse do të thoshim:

“*In questi due giorni, non ho mangiato e non ho dormito.*” (Në këto dy ditë, as kam ngrënë, as kam fjetur).

Gjithsesi, koha e tashme ka ndryshime të karakterit aspektor me kohën e kryer edhe për faktin se koha e tashme është një kohë imperfektive, e jep veprimin në zhvillim, ndërsa koha e kryer është perfektive dhe jep veprimin të plotë, bashkë me përfundimin e tij. Ndërsa koha e pakryer, megjithëse imperfektive edhe ajo, i përket gjithsesi të shkuarës.

Shumë stilistikore dhe poetike tingëllon e tashmja e përdorur në prodozoi:

⁶¹ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinotto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.
“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010
“*Lingua, grammatica, stile*”, G Tedeschi, Petrini, 1971.

- Il dir vostro, se pur *pecca, pecca* per bontà.

Duket sikur forma e zgjedhur për foljen *peccare* (mëkatoj) ka si qëllim ta përkëdhelë dhe ta zbusë disi kuptimin e fjalës. Natyrisht, kjo edhe për shkak të kontekstit dhe strukturës së krejt fjalisë, që paraqitet mjaft artistike.

Koha e tashme e mënyrës dëftore mund të fitojë nuanca dhe vlera sugjestive, në fjali të tipit sugjestionues:

- Dimmi con chi *pratichi*, e ti dirò chi sei!

- Më thuaj me kë vete, të të them cili je!

Nisja e fjalisë me mënyrën urdhërore e bën të tashmen e dëftores, të përdorur menjëherë më pas, që të shprehë siguri dhe të mos lërë hije dyshimi për sa thuhet në vazhdim. Përdorimi i të tashmes në shëmbujt e mësipërm, ndihmon “*për t’i dhënë të drejtë*” folësit për atë çfarë ai thotë, apo deklaron.

Jo të rralla janë rastet, në gjuhën italiane, kur koha e tashme e mënyrës dëftore zëvendëson urdhëroren:

- Tu non *entri* qui senza il mio permesso, altrimenti chiamo la polizia! (Ti nuk hyn këtu pa lejen time, përndryshe thërras policinë!)

⁶²Një gamë e pafund modelesh me vlerë stilistikore përmblihet në të tashmen e foljes “*essere*” (jam), lidhur kjo edhe me kontekstet e ndryshme, brënda të cilave folja gjëndet. Kështu, konotacion të rëndësishëm merr veta e parë e numrit njëjës, “*io sono*”, me anë të së cilës shpesh nuk shprehet folja, por një botë e tërë e brëndshme e ligjëruesit. Në gjuhën fetare, një rast i tillë gjëndet, për shëmbull, në përgjigjen që Jezusi u kthen rabinëve, kur këta të fundit e pyesin:

- *Sei tu il Figlio di Dio?* (*Ti je Biri i Perëndisë?*)

- *Voi stessi lo dite: io lo sono!* (Ju vetë po e thoni: unë jam!) – në gjuhës shqipe humbet paksa forca shprehimore, për shkak të mungesës së kundrinorit . Gjithsesi mund të ndreqet deri diku, duke përdorur përemrin vetor: “Unë jam *Ai*”.

⁶² Duke vërejtur fenomenin e përkthimit të vargjeve Shekspiriane “*Essere o non essere*” nga anglishtja, si dhe përkthimin e Nolit për të njëjtat vargje, u vu re që për shkak të kuptimit semantik, koha e tashme e foljes “*jam*”, në kontekste të caktuara, fiton vlera të veçanta shprehimore dhe stilistikore. Më tej fenomeni u hulumtua në kontekste të ndryshme të gjuhës së shkruar dhe të folur, për ta vështruar fenomenin më në detaje.

Forma foljore “*io lo sono*” nuk shpreh vetëm identitetin e folësit, por madhërisht shpreh edhe *ekzistencë, krenari, botë të brëndshme, individualitet, personalitet*, të theksuara këto edhe më tepër për shkak të pranisë së kundrinorit. Deklarimi në vetën e parë, shoqëruar edhe nga përemri vector, mbushet me solemnitet dhe nota emfatike, ndërsa përdorimi i kohës së tashme tregon bindjen e thellë të ligjëruesit, për atë ç’ka ai deklaron.

Ndërsa në dialogun e mëposhtëm, veta e parë e formës foljore “*io sono*”, shpreh identitet dhe paraqitet pa ndonjë ngjyrim konotativ.

- Chi sei ?

- Sono il bambino del mare. (Konotacioni gjëndet te përdorimi i metaforës)

Por ndryshojnë vlerat në një tjetër situatë shprehimore, në të cilën ligjëruesi, nëpërmjet vetës së parë të foljes “*jam*”, vendoset me “adresë” të përcaktuar brënda një dimensionit kohor.

- Sei in ritardo ? (Je me vonesë ?)

- Sì, sono in ritardo! (Po, jam me vonesë – jam vonë)

Në situatën shprehimore të mësipërme, folja “*jam*” mbart vetëm kuptim kohor, megjithatë për shkak të konsumimit nga përdorimi, edhe këtu nuk kemi vlera konotative. Shëmbulli shërben për të treguar shumëllojshmërinë koptimore të formës foljore.

Që folja “*jam*” të fitojë vlera stilistike, nevojitet në fakt, që ligjëruesi t’u referohet situatave të veçanta shprehimore, pra kur vetë konteksti i asaj që thuhet fiton vlera konotative dhe artistike.

Vlera të tilla konotative gjejmë, për shëmbull, në vargjet e Naim Frashërit, ku veta e parë e foljes “*jam*”, ndryshon përsëri natyrë dhe kuptim, duke na paraqitur këtë herë gjëndje shpirtërore:

“Në mes tuaj kam qëndruar

Dhe jam duke u përvëlur...”

Gjithsesi, në këto vargje, poeti i referohet edhe një situatë krejt të veçantë shprehimore, një gjëndjeje, duke e identifikuar vetveten me qiririn; pra i gjithë konteksti, bashkë me të edhe forma foljore, fiton vlera konotative e stilistike.

E njëjta gjë ndodh edhe në gjuhën italiane:

- *Sono di ghiaccio!* (Jam prej akulli!)

- *Sono il re degli orchi!* (Jam mbreti i gogolëve!)

Ndërsa në kontekste të tjera, folja “*jam*” mund të shprehë një vendodhje në hapësirë, me konotacion të fortë të “mos ekzistencës”, konotacion ky që buron pikërisht prej kontekstit. Një shëmbull i shkëlqyer i këtij rasti janë vargjet e fundit të poezisë “*Pianto antico*”, të Xhozue Karduçit:

Sei ne la terra fredda

Sei ne la terra negra

Né il sol più ti rallegra

Né ti risveglia amor.

Siç e kemi theksuar edhe në kapitujt e parë, vlerat stilistikore të një elementi leksikor, apo gramatikor, janë të lidhura ngushtë edhe me kontekstin. Madje vetë konteksti, shpesh na paraqitet me kuptim të shumëfishtë. Kështu, për shëmbull, forma foljore “*io scrivo*” (unë shkruaj), në varësi të kontekstit, të cilit i referohet ligjëruesi, mund të shprehë jo thjesht veprimin që kryen ligjëruesi në çastin e ligjërimit, por mund të shprehë një paralamërim përkundrejt “atyre të tjerëve”, të cilëve u drejtohet ligjëruesi, në kuptimin: - *duhet të tregohesh i kujdesshëm me atë çfarë po thua, pasi unë po i shkruaj (po i mbaj shënim) besnikërisht fjalët e tua.*

Por në gjuhën e folur, me të njëjtën formë foljore (veta e parë) “*io scrivo*”, mundet që ligjëruesi të mos shprehë një veprim që ai kryen në çastin e ligjërimit, por thjesht t’i referohet me indiferencë profesionit që ai ushtron. Në këtë rast, ligjëruesi e përdor shprehjen e mësipërme për të treguar atë që ai bën në jetë (faktin që ai shkruan), por pa e specifikuar profesionin, pra nëse bëhet fjalë për një shkrimtar, për një kompozitor, për një gazetar, apo për ndonjë profesion tjetër.

Po kështu ndodh edhe kur themi :

Io compro e vendo, (unë blej dhe shes), *io suono*, (unë i bie një vegle), *io assisto la gente*, (unë ndihmoj njerëzit), etj.

Në fakt, në fjalitë e thjeshta, të përbëra vetëm nga kryefjala dhe kallzuesi, veta e parë e shumë foljeve lejon mjaft hapësirë për interpretime kuptimore apo nuancore, sigurisht kur shoqërohet edhe nga një situatë kontekstuale e njohur që më parë prej të gjithë pjesmarrësve në bashkëbisedim (qofshin këta edhe shkrimtarë e lexues), apo nga mjete te tjera gjuhësore që plotësojnë kuadrin kuptimor.

4.9 E tashmja e njëkohëshme dhe e tashmja sportive⁶³.

Paraqet interes koha e tashme e përdorur gjatë trasmetimeve të ndeshjeve sportive. Personi që komenton ndeshjen, përpiqet vazhdimisht të sjellë sa më të gjalla tek ata që nuk kanë mundësinë ta shikojnë, emocionet e saj. Në një rast të tillë është normale që e tashmja e përdorur nga komentatori, të sjellë nuanca dhe vlera shprehimore, apo emocionale nga më të ndryshmet, sipas emocioneve që ai vetë përjeton. Ky është rasti, kur e tashmja e komentatorit, “i jep ngjyra” fantazisë së dëgjuesve të ndeshjes:

“...I giocatori *entrano* nel campo e il pubblico *si alza* in piedi...”

“...Il centrocampista *lascia* rimbalzare la palla, poi *dribbla* l'avversario e *si avvia* verso l'area di rigore ...”

“...Topin e *marrin* nën kontroll futbollistët e skuadrës tonë kombëtare, e *hapin* lojën në të majtë, *ecin* përpara dhe janë tre sulmues me katër mbrojtës, *futen* në zonën e gjashtëmbëdhjetëshes....”

Në raste të tjera, të tashmen “reale”, apo të njëkohëshme, mund ta hasim edhe në kronika televizive direkte, në komunikime në radio, etj. Për shëmbull:

⁶³ Disa grammatica, siç është rasti i K. Katerinov-it : “*La lingua italiana per stranieri*”, Guerra Edizioni, 2010, por edhe të tjera, e trajtojnë këtë fenomen si një të vetëm. Ka autorë të tjerë, siç është rasti i S. Bailini-t dhe S. Consonno-s: “*I verbi italiani*”, Alma Edizioni, 2004, apo edhe i P. M. Bertinetto në librin e tij: “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, Edizioni Accademia Crusca, 1986, të cilët i trajtojnë këto fenomene si të veçanta. Kemi zgjedhur edhe ne t’i trajtojmë si të veçanta, për dy arsye: së pari për shkak të vlerave të ndryshme shprehimore dhe stilistikore që shprehin gjatë përdorimit dhe së dyti për shkak se njëkohësia mund të paraqitet edhe në gjuhën e shkruar, ndërsa e tashmja e përdorur gjatë trasmetimeve të aktiviteteve sportive i përket posaçërisht gjuhës së folur, duke sjellë kështu edhe dallime jo të vogla.

“...In questo preciso istante *vedo* una persona con la faccia mascherata che *sbatte* un oggetto contro la vetrina di fronte; ...adesso *si riempie* la borsa di cose varie;...ora *fugge* verso una moto che lo *aspetta* davanti al negozio...”

Në gjuhën e shkruar, e tashmja e njëkohëshme përdoret gjerësisht në stilin e librave të udhëtimit, në stilin e kronikave, në stilin e ditarit, në stilin gazetaresk të një lajmi të marrë nga vëndi i ngjarjes, në dialogjet midis personazheve të një veprë letrare, etj.

E tashmja ndihmohet për të fituar ngjyra reale dhe të njëkohëshme edhe nga shprehje apo ndajfolje kohe të llojit: “in questo preciso istante” (pikërisht në këtë çast), “adesso”(tani), “ora (tani)”, “in questo momento (në këtë moment)”, etj.

E tillë është koha e tashme e mënyrës dëftore: më tepër se kohën e veprimit, ajo fotografon një të tashme dhe na orienton nëpër dimensionet e Realitetit: kohë dhe hapësirë. Me praninë e saj, ajo na dëshmon se asgjë nuk është e pamundur në realitetin gjuhësor, madje edhe e shkuara dhe e ardhmja, mund të kthehen në një “të tashme” për ligjëruesit, lexuesit, dëgjuesit e kështu me rradhë, të cilët në këtë mënyrë, i japin jetë dhe larmi gjuhës dhe fantazisë së tyre.

KREU 5: E PAKRYERA E MËNYRËS DËFTORE

Ndër kohët e mënyrës dëftore, e pakryera është koha, ndoshta, me përdorimin më të gjerë dhe më të larmishëm si nga ana aspektore, ashtu edhe nga ana stilistikore në përgjithësi. Fakti që e pakryera tregon një periudhë kohore mjaft të shtrirë, por shpesh edhe të papërcaktuar, i jep mundësinë kësaj kohe imperfektive të jetë mjaft e pasur me nuanca shprehimore. Veprimi i dhënë me të pakryerën shfaqet në zhvillim e sipër, por përfundimi i këtij veprimi mbetet i pashfaqur. Krahasojmë:

E pakryera: Luigi *andava* a scuola (...*shkonte* në shkollë)

Në shëmbullin e mësipërm informacioni përfshin vetëm faktin që “...shkonte në shkollë”, por jo përfundimin, pra nëse ka mbërritur në shkollë apo jo.

E kryera e thjeshtë: Luigi *andò* a scuola. (...*shkoi* në shkollë)

E kryer: Luigi *è andato* a scuola (...*ka shkuar* në shkollë)

Në dy shëmbujt e tjerë, vërehet mjaft qartë që informacioni përfshin edhe mbërritjen e Luixhit në shkollë.

Përgjithësisht e pakryera “vështron brënda” veprimit që paraqitet në zhvillim, pa u “interesuar” për faktin nëse do të përfundojë ose jo⁶⁴.

5.1 ⁶⁵*C’era una volta...*

...l’imperfetto (*Na ishte njëherë...*e pakryera)

Përdorimi i të pakryerës në strukturën e mësipërme rrëfimtare është sa interesant, aq edhe unik dhe i papërsëritshëm, si në gjuhën italiane, ashtu edhe në gjuhën shqipe.


E pakryera, si një kohë e papërfunduar dhe e tejzgjatur në veprimin dhe në efektin që shpreh, duket se humb diçka prej natyrës së saj, kur përdoret brënda formulës me të

⁶⁴ Në gjuhën shqipe fenomeni bëhet edhe më i dukshëm në rastin e përdorimit të së pakryerës së përcaktuar perfektive me pjesëzën *po*. Prof. A. Dharmo vëren edhe një përdorim të gjuhës së folur me lidhëzën kohore *tek*: *tek po flinte, tek po shkonte, tek po kuvendonte*, etj., apo edhe në dialektin gegërisht me *kah*. (“*Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*”, A. Dharmo, Libri Universitar, 1996, f. 104.)

⁶⁵ Duke qënë se në rastin e kohës së pakryer, të mënyrës dëftore, kemi të bëjmë me një formë foljore të natyrës rrëfimtare, struktura “*c’era una volta*”, e pranishme sidomos në rrëfimet për fëmijë, duket që e përfaqëson në një mënyrë unike përdorimin e kësaj forme në letërsi.

cilën nisin përgjithësisht përrallat. Në gjuhën italiane, ndajfolja e vendit “*ci*” që e shoqëron vazhdimisht foljen, e vendos ngjarjen që rrëfëhet më pas, diku në hapësirë, duke shprehur në këtë mënyrë dimensionin e hapësirës. E pakryera e foljes “*essere*”, që i qëndron mjaft pranë ndajfoljes së vendit, i jep ngjarjes që rrëfëhet më pas ekzistencë, vërtetësi, prani, pavarësisht se mbetet e pazbuluar përgjigja e pyetjes: “*Kur ka ndodhur saktësisht?*”.

Folja “*essere*” e vendosur në kohën e pakryer, e mbush ngjarjen e fantazuar për fëmijë, me jetë; *ekzistenca* e shprehur brënda një harku të pambyllur kohor, e mbështjell ngjarjen me universalitet, i jep vlera të gjithkohshme, duke e lënë të rrjedhë, kapur pas vetë rrjedhës së kohës. Nëse ngjarjen e rrëfyer e shënojmë me gërmën “*A*”, hapësirën me rrethin “*B*” dhe kohën me rrethin “*C*”, skematikisht anën teorike do ta paraqisnim në këtë mënyrë:




E vetmja gjë për të cilën jemi të “*sigurtë*”, është se pika *A* gjëndet si brënda rrethit *B* ashtu edhe brënda rrethit *C*. (*C’era una volta...* kontekstualisht ekziston si në një pikë çfarëdo të hapësirës, ashtu edhe në një pikë çfarëdo të kohës)

Fakti që i jep universalitet *gjithëkohor* dhe të *kudondodhur* formulës me të cilën nis shpesh një përrallë në traditën e gjuhës italiane, është se pika *A* mund të vendoset në secilën prej pikave të mundshme brënda rrathëve *B* dhe *C*, për shkak të një mospërcaktimi të saktë në kontekst të vëndit dhe kohës, por edhe për shkak të natyrës imperfektive të kohës së pakryer, shfaqur brënda “formulës” që po analizojmë, si një rrjedhje e pambyllur kohore nëpër hapësirë.

Ndoshta pak më ndryshe paraqitet kjo çështje me të pakryerën e gjuhës shqipe, në traditën shqiptare të nisjes së rrëfimit të një përralle. Përdorimi i trajtës së shkurtër të përemrit vector, e bën të pakryerën e gjuhës shqipe të jetë me po atë natyrë papërcaktueshmërie, por më pranë figurës së rrëfimitarit dhe dëgjuesit, apo lexuesit të përrallës. Edhe në variantin shqip, folja “*jam*”, në kohën e pakryer të mënyrës dëftore,

tregon *ekzistencë*, *vërtetësi* dhe *universalitet* vlerash, por pika e referimit e vendosur në hapësirë mungon, nuanca e *ekzistencës* shprehet vetëm nëpërmjet foljes dhe pikë referimi bëhen vetë pjesëmarrësit në komunikim, pra “*Ai*” që rrëfen dhe “*Ai*”, ose “*Ata*” që dëgjojnë. E pakryera e çmbështjell ngjarjen rreth tyre, e dëshmon ekzistencën, por nuk e përcakton vazhdimësinë e kësaj ekzistence dhe çuditërisht e afron veprimin shumë afër të tashmes. Ndihet “prania” e ngjarjes në atmosferën përreth bashkëfolësve, ata kthehen në “dëshmitarë” të kësaj ngjarjeje dhe e pakryera u krijon përshtypjen, sikur veprimi rrjedh përpara syve të tyre.

Në rastin e variantit shqip të nisjes së një përralle, skema e dhënë më lart do të ndryshonte, duke futur atje një element të munguar në ngjarje: *bashkëfolësit*. Nëse këtë element të ri, që shtohet për shkak të raporteve të reja, të vendosura nga prania e trajtës së shkurtër të përemrit vetor (*Na ishte...*) do ta shënojmë me gërmën “*D*”, skema e re do të paraqitej në këtë mënyrë:



Pra edhe në këtë rast veprimi nuk dihet kur fillon dhe kur përfundon, vendodhja e saktë në hapësirë e ngjarjes mbetet përsëri enigmatike, por brënda kësaj hapësire dhe kohe të papërcaktuar saktësisht ndihet tashmë prania e bashkëfolësve (rrëfimtari dhe publikut), të lidhur, nëpërmjet trajtës së shkurtër, me ndodhinë që përfaqësohet nga forma foljore “*ishte*”, në të pakryerën e vetës së tretë.

I sintetizuar, ndryshimi qëndron në atë që: ndërsa në variantin italisht bashkëfolësit mbeten në pozicionin neutral, në variantin shqip ata bëhen pjesëmarrës, nëpërmjet “pranisë” së tyre në ngjarje (trajta e shkurtër e përemrit vetor).

Në fakt, universaliteti i kohës së pakryer qëndron pikërisht në një farë vlere gjithëkohore që fiton veprimi i shprehur nga folja. Pas përpunimit që i bëhet veprimit duke përdorur një “të pakryer”, veprimi rrjedh i tejzgjatur, i papërfunduar ndoshta, në hapësirat e kujtesës letrare apo dokumentare.

Në ndryshim nga rasti i të kryerës së thjeshtë (*passato remoto*), që na paraqet dy faza të veprimit (1 – veprimin e përfunduar⁶⁶ dhe 2 – lejon të imagjinohet apo të kuptohet realiteti i ri i “pas-veprimit”⁶⁷), koha e pakryer shtjellon vetëm një fazë: veprimin në proces. E pakryera nuk i lejon imagjinatës të kapërcejë kufijtë e këtij veprimi, madje ajo as nuk vendoset në pozicionin për t’i dalluar këta kufij kohorë dhe personazhi (qoftë letrar apo real) që vepron nëpërmjet foljes, mbetet i ngërthyer brënda atij çasti universalisht në lëvizje, pa patur mundësi ta përfundojë atë.


P.sh. “Luigi *guidava* la macchina”

“Babai *lexonte* gazetën”, etj.

Të dy personazhet e shëmbujve të mësipërm, kanë ngecur të ngërthyer brënda veprimit që po kryejnë, duke përfutur në të njëjtën kohë edhe statusin e figurave në lëvizje, brënda imazheve të së shkuarës.

E analizuar në kuadrin e të “Shkuarës”, të cilën ne e kemi konsideruar edhe si *kohë të kujtesës*, e pakryera e mënyrës dëftore rrit ndikimin e njeriut mbi ngjarjet, kur ky i fundit i rikthehet kësaj të shkuare kujtesore.

Nën dritën e një analize më të thelluar, edhe kontekstuale, më tepër se më një kohë që tejzgjatet, duket sikur në një pjesë të mirë të rasteve kemi të bëjmë me një lëvizje të vazhduar në kohë. Në shëmbullin: “Luigi *guidava* la macchina” (Luigji *ngiste* makinën), elementi që bëhet shkak i shtrirjes kohore është, në fakt, lëvizja e automjetit, ndërsa koha kthehet në pasojë të kësaj lëvizjeje. Po kështu nëse do të analizojmë shëmbujt : “*Il sole nasceva* sopra le alte montagne”, apo “*Il cervo correva* veloce tra i boschi”.



⁶⁶ “*Gramatika e gjuhës shqipe I*”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002, f. 274.

“*Dizionario di Linguistica*”, Zanichelli, 1983, f. 296 – 297.

“*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“*Grammatica italiana*”, A. Panzini, Sellerio Editore, 1982. Etj.

⁶⁷ “*Grammatica per italiani maggioreni*”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989, f. 215 – 218.

Është në interes të analizës që po zhvillojmë, që t'i rikthehemi në këtë pikë *Kohës* si koncept universal në Natyrë (*Koha fizike*) dhe *Kohës* si koncept gjuhësor⁶⁸.

Koha si koncept universal i Natyrës, ose siç quhet ndryshe *Koha fizike*, është një lëvizje që kryhet në mënyrë ciklike, por pa drejtim të përcaktuar (aq më tepër nga njeriu) dhe pa mundësi për t'u kthyer prapa, pasi e tillë është edhe logjika e Natyrës.

Koha gjuhësore e analizuar në aktet ligjërimore, është një lëvizje me drejtim të orientuar (për shkak të pranisë së një qëllimi në mesazh), që ka mundësi t'i thyejë rregullat e rrjedhës së *Kohës Universale*, sepse e tillë është edhe logjika njerëzore.

Megjithatë çdo rregull ka edhe përjashtimet e veta. Në rastin e “formulës” me të cilën nisin shpesh rrëfimet popullore dhe përrallat, *Koha Universale* përputhet me *Kohën Njerëzore*.

“*C’era una volta...*” (*Na ishte njëherë...*). Brënda mesazhit të fjalisë, lëvizja me drejtim të orientuar mungon, ndoshta edhe për shkak të mospërcaktimit saktë të vëndit në hapësirë nga ana e bashkëfolësve, të cilët gjithashtu nuk kanë dijeni për rrethanat kohore. **Pra një vendosje e pacaktuar në hapësirë e ngjarjes, e humbet konceptin e lëvizjes me orientim**, duke ruajtur vetëm atë të ekzistencës në kohë dhe të “*vërtetësisë*” (dikur ka ndodhur..., dikur ekzistonte...) dhe duke e veshur mesazhin, apo krejt ligjërimin, me konceptin universal të ekzistencës në Natyrë. Nga ky këndvështrim, ndërtimi i formulës gjuhësore “*C’era una volta...*” është vërtet i veçantë dhe meriton të analizohet.

Ndodh shpesh, që gjuha e përdorur nga fëmijët, duke u përpunuar me një natyrshmëri, pafajësi dhe thjeshtësi karakteristike për moshën, të nxjerrë në dritë gjetje gjuhësore që do t'i kishte zili edhe gjuha e përdorur nga shumë të rritur. Dhe nuk është fjala vetëm për shprehjen: “*C’era una volta...*”

Në fjalinë: “*Mia sorella, quando era piccola, andava nel letto se c’era il temporale...*” (Kur ishte e vogël, motra ime *shkonte* në shtrat, nëse *niste* stuhia), *koha* e pakryer na shfaqet me dy pamje. Në shprehjen “...quando *era piccola...*” (Kur *ishte* e vogël...), shtrirja kohore përfshin gjithë fëmijërinë, periudhë kjo që përcaktohet në mënyrë

⁶⁸ “*Dizionario Enciclopedico Sansoni*”, 1986, f. 2194 - 2195.

“*Grammatica per italiani maggiori*”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

“*Time in language*” Wolfgang Klein, Routledge, London, 1994.

“*Guida allo studio della letteratura*”, R. Cesariani, Laterza, 1999.

“*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“*Il linguaggio*”, C. Schick, Einaudi, 1960.

të natyrshme prej kuptimit të mesazhit. Në dy përdorimet e mëpasme, e pakryera shfaq karakteristikat e një veprimi që kthehet në zakon dhe që asnjë kohë tjetër e të shkuarës së Dëftores nuk do t'i shfaqte kaq mirë. Pra nëse në rastin e parë e pakryera përfshin krejt periudhën e vegjëlisë, në dy shprehjet e tjera jep idenë e një veprimi që rishfaqet në mënyrë ciklike.

Shpesh edhe në varësi të kuptimit që përcillet prej fjalisë, e pakryera mund të përcjellë edhe mesazhe ironie të hollë, në formën e thirrjes në kujtesë të një situatë, që vështruar në distancë kohore, ka rezultuar absurde.

P.sh. “*C’era una volta un gruppo di fiammiferi di zolfo, che andavano troppo fieri della loro nobile origine...*”

“*Na ishte një herë një tufë shkrepseve squfuri, që e mbanin veten me të madh për origjinën e tyre fisnike...*”

Nëse në vënd të së pakryerës do të përdornim ndonjë kohë apo mënyrë tjetër foljore, mesazhi do ta humbiste shijen e një ironie të hollë, thuajse të padukshme, madje mund të fitonte edhe vlera vërtetësie e realiste, në rast për shëmbull të përdorimit të kohës së tashme dëftore.

“*Esiste da qualche parte, un gruppo di fiammiferi di zolfo, che vanno troppo fieri della loro nobile origine...*” E tashmja e dëftores, jo vetëm që e humbet nuancën ironike, por bën që origjina fisnike e shkrepseve as të mos vihet në dyshim. Madje ndryshimi i kohës, bën që të ndryshojë edhe këndvështrimi i përkthyesit në përzgjedhjen e materialit gjuhësor, që do të shërbejë për të përcjellë të njëjtin mesazh, në varësi edhe prej nuancave të reja që merr fjalia në variantin italisht.

“*Ndodhet diku një tufë shkrepseve squfuri, që e mbajnë veten tepër krenare (ose:...ndjehen tepër krenare – variant ky edhe më radikal konceptimi), për origjinën e tyre fisnike.*”

Ndryshimet, pra, në mënyrën e të përkthyerit janë të pashmangshme.

Ideja e përsëritjes së fenomenit nëpërmjet të pakryerës, jepet edhe në tekstin e mëposhtëm, nxjerrë nga teza e diplomimit të një liceisti në Itali, me emrin Lorenzo Picinali (Liceu i shkencave V.Veneto, Milano). Ndër të tjera ai shkruan:

“...*C’era* una volta, una scuola in cui *ci si ammalava*. Lì dentro, i ragazzi *passavano* le ore più noiose della loro vita, seduti ad ascoltare una persona che *cercava* di insegnare qualcosa di utile...”.

Edhe në tekstin e mësipërm mund të vërehen dy paraqitje të së pakryerës. Në fjalinë e parë: “...in cui *ci si ammalava*...” (...në të silën *sëmureshe*...), forma pavetore e të pakryerës në gjuhën italiane krijon perceptimin e një atmosfere të pandryshueshme. Vetë konteksti i formës foljore: “*ci si ammalava*” shërben si ambjent i brendshëm i shkollës në fjalë, si një atmosferë përreth nxënësve dhe që nëpërmjet të pakryerës, të bën gati-gati të besosh se ky është qëllimi i kësaj shkolle.

Në gjuhën shqipe, veprimi foljor “*ci si ammalava*” mund të përcillet nëpërmjet një forme joveprore, por “duke humbur” prej vlerave shprehimore të variantit italisht, ndjesinë e atmosferës për të cilën folëm më sipër dhe në bashkëpunim me elementët e tjerë leksikorë të togfjalëshit (...në të cilën *sëmureshe*...) krijon ndjesinë e pasojës dhe të fatalitetit.

Në dy përdorimet e mëpastajme, e përcaktuar edhe prej kontekstit, e pakryera jep idenë e një fenomeni që përsëritet, pa patur mundësi për t’i shpëtuar asaj situatë.

Megjithatë, në përdorimet e veta, e pakryera e dëftores shfaqet në situata shprehimore të panumërta, duke i patur gjithashtu të panumërta si vlerat shprehimore, ashtu edhe ato stilistikore. Duke kaluar nga gjuha e shkruar në atë të folur dhe anasjelltas, përfundimet që do të përfshihen në një sistem teorik vlerash, do ta gjenin mbështetjen në analizën stilistikore dhe semantike të fjalisë, duke u ndalur kryesisht në ngjyrimet e përfutuara prej kumtimit.

5.2 Aspekti i veprimit zakonor, progresiv dhe i vazhdimësisë⁶⁹.

Koha e pakryer e mënyrës dëftore është një kohë përgjithësisht imperfektive, me përjashtim të disa rasteve mjaft të rralla në gjuhën italiane, si dhe të rasteve kur shoqërohet me pjesëzën “po” në gjuhën shqipe.

Për shkak të natyrës imperfektive që shfaq, e pakryera e tregon veprimin në proces, pra në kryerje e sipër⁷⁰, duke shmangur në më të shumtën e rasteve mungesën e të dhënave për fillimin apo përfundimin e një veprimi (me përjashtim kur vihen në dukje nga elementë të tjerë kontekstualë)

Brënda kësaj natyre imperfektive, koha e pakryer shfaq një gamë mjaft të pasur nuancash shprehimore dhe stilistikore, në varësi edhe të kontekstit. Ndër më të rëndësishmet janë aspekti i “veprimit të kthyer në zakon”, i “vazhdimësisë” dhe i “vijimësisë progresive” .

Io cantavo per lei ogni sera, la guardavo negli occhi, le sussurravo parole dolci e mi chiedevo ansioso del nostro futuro

Në shëmbullin e mësipërm, veprimet përsëriten me një ritual thuajse zakonor. Përdorimi i të pakryerës në kontekstin në fjalë, megjithëse, në numrin njëjës, krijon ndjesinë që kemi të bëjmë më një shumësi veprimesh të ngjashme. Pra veprimi jo vetëm shtrihet në kohë, por përftohet aspekti i përsëritjes të kthyer në zakon. E njëjta situatë shprehimore paraqitet edhe në shëmbullin e mëposhtëm:

Talvolta, egli *appoggiava* più forte il capo, *socchiudeva* le palpebre....

Pra edhe pse bëhet fjalë për një fenomen të vërejtur hera herës, mënyra e të vepruarit është vazhdimisht e njëjta.

Sekuena kohore të zgjata e të dhëna nëpërmjet kohës së pakryer, që ndjekin njëra tjetrën në një vijimësi gjithashtu të përzgatur, gjenden në tekstin e mëposhtëm.

⁶⁹ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“*Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*”, A. Dhrimo, Libri Universitar, 1996.

“*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004

⁷⁰ “*Dizionario di Linguistica*”, Zanichelli, 1983.

“*Lingua e linguaggio*”, F. Sabatini, Loescher Editore, 1990.

“*Gramatika e gjuhës shqipe I*”, Akademia e Shqipërisë, 2002

“...*Riuscivo* fortunatamente a raggiungere la frontiera austriaca a Linz, di lì *mi portavo* a Vienna dove *mi ricongiungevo* con la persona attesa, e insieme *risalivamo* il corso di Danubio...” (“*Lingua e linguaggio*”, Francesco Sabatini, p.442)

Lëvizjet e dhëna nëpërmjet foljeve, duket sikur nuk ndjekin vetëm një hartë gjeografike, por nëpërmjet shtrirjes kohore, ngjajnë sikur përvijojnë zhvendosje drejtvizore, që pasojnë njëra tjetrën. Me mjaft interes është të përmëndim edhe faktin, se duke përdorur vetëm të pakryerën, kumtuesi u ka dhënë këtyre zhvendosjeve të njëjtën shtrirje; pra të gjitha sekuencat kohore, brënda të cilave ndodhin lëvizjet, paraqiten si të barabarta.

Të njëjtën vlerë aspektore dhe stilistikore e hasim edhe në gjuhën shqipe, në të cilën koha e pakryer e shfaq herë pas here aspektin e një veprimi të përsëritur si zakon.

“...Ajo *nuk i shikonte* burrat në sy dhe s’kishte qejf të kalonte përpara tyre...”(Emblema e dikurshme, I.kadare)

“...Tani, kur i *takonte* në rrugë vajzat e ekipit, *Leza ndalonte* dhe *bënte* ndonjë shaka me to...” (*Emblema e dikurshme*, I. Kadare, faq 332.)

Në shëmbujt e mësipërm, koha e pakryer tregon një mënyrë të vepruari, të kthyer në një ritual.

Aspekti tjetër, të cilin e ndeshim gjerësisht me përdorimin e kohës së pakryer, si në gjuhën italiane ashtu edhe në gjuhën shqipe, është ai i një veprimi progresiv.

“...*Scendeva* dalla soglia e *veniva* verso il convoglio... “ (I promessi Sposi, A. Manzoni, p. 367).

(...*Zbriste* prej pragut dhe *vinte* në drejtim të karvanit...)

Imazhet e dhëna nëpërmjet foljeve “*scendere*”, “*venire*”, (zbres, vij) mbartin nuancën aspektore të një veprimi në zhvillim të plotë, vazhdimisht në progresion, të ngjashëm me lëvizjet brënda një bobine filmike, ku lëvizja as ndalet e as përfundon.

“La signora, sua madre, ci *lasciava* un litro di late sulla porta.”

(Zonja, e jëma e tij, *na linte* një litër qumësht përpara portës.)

Në shëmbullin e mësipërm, ajo çfarë dëshiron të komunikojë ligjëruesi, nuk është një veprim i caktuar në një moment të caktuar, por pikërisht imazhi i veprimit të zonjës, një

imazh që mbetet i ngjizur përgjithmonë në zhvillim e sipër dhe për pasojë në një veprim progresiv.

“...Gjatë gjithë kohës që *ecnin*, kishte folur vetëm ai...”(*Emblema e dikurshme*, I.Kadare., f. 339)

“...Turma pas tij *ulërinte* dhe *shfrynte* e *mallkonte*, gjithnjë e më fort.” (*Etje*. P.Zheji f. 131)

“...Gjëma *vraponte* rrafshnaltave, *ikte* grykave,

Ato dot *nuk e mbanin*, ia *kthenin* maleve gulçonjës...” (Mundja e ballkanasve nga turqit në fushën e Kosovës – poezi të zgjedhura, I.Kadare, f. 251)

“...Dielli *sa vinte e bëhej* më i nxehtë...”

Edhe në shëmbujt e mësipërm, të cilët i përkasin gjuhës shqipe, aspekti i një veprimi në progresion është i pranishëm. Forma foljore “*ecnin*”, në shëmbullin e parë , krijon një imazh të disa personazheve vazhdimisht në zhvendosje, në ecje, drejt një vëndmbërritje, pra në progresion.

Format foljore “*ulërinte*”, “*shfrynte*”, “*mallkonte*” , të shoqëruara me shprehjen “*gjithnjë e më fort*” japin disa situata në evoluim e sipër, në një përshkallëzim progresiv, ndërsa shprehja që mbyll fjalinë, lë të hapur krejt situatën në fjalë dhe kryerjen e veprimeve, pa i përfunduar ato.

Edhe në shëmbullin e tretë dhe të katërt, vërejmë praninë e një situatë me lëvizje, me efekte përshkallëzuese, të cilat krijojnë idenë e një situatë në progresion.

Ndonjëherë, progresion shfaq edhe një përshkrim i detajuar letrar, i cili krijon përshtypjen sikur autori i përshkrimit po rrëfen gjithshka, ndërsa vetë është në lëvizje. Në një rast të tillë lëvizjet dhe peisazhet kalojnë me shpejtësi duke ndjekur njëra tjetrën dhe duke dhënë idenë e një lëvizjeje filmike, që vazhdon pa u ndalur.

Në tekstin e mëposhtëm, peisazhet rrëfohen si të vështruara nga dritarja e një makine, e cila i përshkon ato duke lëvizur përpara, me shpejtësi.

“...E l’acqua *scorreva, discendeva* per la china verso la spiaggia ghiaiosa; *passava* sotto un piccolo ponte. All’ombra dell’arco, alcune donne *levavano* le tele; e i loro gesti *si vedevano* riflessi nell’acqua come in uno specchio mobile. ...Lungo il binario *camminava* un uomo scalzo, portando le sue scarpe in mano penzoloni. Una donna *usciva* dalla casa

del guardiano e *gettava* con un atto rapido qualche avanzo da un canetro. Due fanciulle, cariche di tele, *correvano* ridendo a gara. Una vecchia *sospendeva* a una canna, una matassa tinta di turchino...” (*Trionfo della morte*, G. D’Annunzio).

Aspekti i tretë, i cili merr një rëndësi edhe më të madhe për shkak se i përket , me pak përjashtime, vetëm kohës së pakryer, është aspekti i vazhdimësisë. Siç e kemi përmendur edhe më sipër, është një karakteristikë e kohës së pakryer, që ta tregojë veprimin në lëvizje, të shtrirë në kohë dhe pa e përfunduar atë⁷¹.

“...Dopo un’ora *si ripartiva* e da lontane strade maestre *giungeva* l’inerte canto brontolante dei carrettieri.” (*Il garofano rosso*, E. Vittorini, p.54)

“...Le grosse dita *componevano* le pieghe, *spianavano* gli sbuffi, *appuntavano* sulla seta...” (*Il gattopardo*, G.Tomasi di Lampedusa, p.73)

“...Veziri *shikonte* qytetin nga dritarja...” (*Ali Pashë Tepelena*, S. Godo, f. 117)

“...Ali Pashai *vrojtonte* nga bedenat kampin armik, që *mbulonte* fushën me dhjetëra mijë njerëz, kuaj, bagëti e qerre...” (*Ali Pashë Tepelena*, S. Godo, f.281).

Në të gjithë shëmbujt e dhënë më sipër, veprimi i shprehur nga folja shtrihet në mënyrë të vazhduar. Është interesant fakti, që kjo shtrirje nuk ndihet aq shumë në kohë se sa në hapësirë (*si ripartiva, giungeva, componevano, appuntavano*; - *vrojtonte, mbulonte*), gjithsesi nuanca e kohës mbetet e mirëkuptuar. Në mjaft raste, ky fenomen ka lidhje edhe me kuptimin e shprehur nga folja , si edhe me llojin e veprimit të shprehur prej saj (verbi continuativi – pra folje që transmetojnë edhe nuancën aspektore të vazhdimësisë), si për shëmbull: *dormire-dormivo* (flija); *camminare-camminavo* (ecja); *andare-andavo* (shkoja); *studiare-studiavo* (studioja); *giungere-giungevo* (mbërrija) etj.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i kohës së pakryer është ai i përsëritjes së një veprimi⁷², pra kur folja e vendosur në kohën e pakryer shpreh përsëritje. Si rast aspektor, shpesh mund të konsiderohet në mënyrë të gabuar, duke u klasifikuar aspekt progresiv, ose aspekt i vazhduar, por nuk janë të paktë rastet, kur aspekti i përsëritjes jepet mjaft qartë dhe pastër, pa u ngatërruar me dy aspektet e tjera në fjalë, sidomos kur shoqërohet me ndajfolje apo shprehje ndajfoljore që tregojnë kohë.

⁷¹ Kjo nuancë aspektore ka të bëjë më së shumti edhe me perceptimin e rolit të kohës së pakryer, të mënyrës dëftore, të dhënë nga shumë gramatika të gjuhës italiane, si psh.: “*Grammatica italiana*”, G. Pittano, Bruno Mondadori, 1986; “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010; dhe shumë gramatika të tjera.

⁷² “*Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*”, A. Dhrimo, Libri Universitar, 1996.

“La ragazza *andava* tutti i giorni dal suo fidanzato” (Çdo ditë, vajza *shkonte* te i fejuari i saj)

“Tutte le volte che *andava* dallo zio, *era felice*.”(sa herë që *shkonte* nga xhaxhai, *ishte* i lumtur)

Si teknikë letrare dhe stilistikore, ndodh që për të shprehur deri në fund imazhet e ideve të tyre dhe për t’i përcjellë me sa më tepër jetë te lexuesit, autorëve nuk u mjafton ajo shtrirje kohore e veprimit që afron e pakryera, por e përforcojnë edhe më tej këtë shtrirje nëpërmjet përsëritjes⁷³. Pikërisht diçka të tillë ka bërë edhe shkrimtari italian Carlo Emilio Gadda me personazhin e tij, në shëmbullin e mëposhtëm:

“Zoraide, in quel momento, dormiva, certo!...*respirava!*...*respirava!* Come se fosse fatta d’amore.”

Përsëritja e foljes në të pakryerën, jo vetëm që e zgjat në kohë veprimin, por edhe e shtron, e ngadalëson, i jep lëvizje ritmike, thua se autori po e shijon këtë pamje me çdo qelizë të trupit të tij. Vetë ky ngadalësim dhe ritëm në lëvizje e “mbulojnë” personazhin e C.E.Gadda me një qetësi dhe joshje, përmasat e të cilës do të ishin të pamundura të shpreheshin pa përsëritjen e foljes në kohën e pakryer. Por duket që rrëfimitarit i pëlqen ta nxjerrë në dukje joshjen që shpërndan përreth vetes seksi femëror, duke ndërthurur efektin e të pakryerës, me kontekstin e vetë rrëfimit. Në përshkrimin e të njëjtit personazh, në tregimin me të njëjtin titull, ai shkruan:

“...Serrati i talloni, alle caviglie tendinee *sucedeva* la simetria delle gambe dentro la calza attillata, cui sapienti muscoli *rendevano* vive per ogni spasimo e amoroso soccorso...”

E pakryera e përdorur mbi formën foljore “*succedere*”, fiton në kontekstin e mësipërm thuajse të njëjtin status me atë të përsëritjes së foljes “*respirare*”, në shëmbullin e mëparshëm.

Në vënd të përforcimit së idesë nëpërmjet një përsëritjeje të fjalës, autori ka përdorur një folje, që në shqip përkthehet *ndiqte, pasonte*, ku ideja e diçkaje që vijon në mënyrë të vazhdueshme (funksioni i të pakryerës), evokon në mënyrë paksa të maskuar pikërisht imazhin e përsëritjes të kësaj “diçkaje”. Në kontekstin e përgjithshëm, veprimi i shprehur nëpërmjet foljes “*succedere*”, duket sikur pulson nëpër të gjithë shtrirjen e muskujve të pulpës së personazhit, përforcuar kjo shtrirje gjatësore edhe nëpërmjet imazhit

⁷³ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinotto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

të fijeve të çorapeve të holla që mban veshur personazhi. Pra veprimi nuk shtrihet (apo pulson si një përsëritje me frekuenca mikroskopike) vetëm në kuptimin e foljes dhe në funksionin e të pakryerës, por përforcohet edhe në hapësirë, duke ndjekur gjatësinë e linjave të këmbës, apo të fijeve të çorapeve. Vetë kuptimi i foljes “*succedere*” (*succedeva la simetria delle gambe* – ndiqte simetrinë e këmbëve), duket sikur shtrihet e zgjatet nëpër këto linja.

E njëjta vlerë aspektore gjendet edhe në kohën e pakryer të gjuhës shqipe. Ashtu si edhe në gjuhën italiane, ajo shërben jo vetëm për të dhënë imazhin e një veprimi që përsëritet, por edhe për të dhënë idenë e shtrirjes në kohë të këtij veprimi, nëpërmjet përsëritjes së tij.

“...Ishte e shtunë mbasdite. Leza doli nga vatra e kulturës ku *shkonte* herë pas here, të çfletonte revistat..” (*Emblema e dikurshme*, I. Kadare, f. 336)

“...Qëndronte përpara pasqyrës dhe *pikturonte e ripikturonte*, prapë e prapë autoportretin e tij...”(Etja, P.Zheji, f. 587) .

“...Suzana e kuptoi që e kishin gënjyer. Në oborr dikush *shtinte*...(Emblema e dikurshme, I.kadare, f. 339).

5.3 Njëkohëshmëri në të shkuarën⁷⁴.

E ndihmuar edhe nga konteksti i ligjëratës, koha e pakryer jo rrallë mbart nuancën aspektore dhe stilistikore të njëkohësisë në të shkuarën. Kjo nuancë bëhet e dallueshme vetëm pas krahasimit të dy veprimeve, të cilat supozohet që kanë ndodhur pothuajse në të njëjtën kohë.

“La settimana scorsa, mentre tu *passavi* tutto il tempo sui libri, io *guardavo* un film dopo l’altro.” (javën e kaluar, ndërsa ti e kaloje gjithë kohën mbi libra, unë shikoja filma njëri pas tjetrit”

Në shëmbullin e mësipërm është konteskti ai që e lejon kohën e pakryer të shfaqë njëkohësi të të dy veprimeve. Nëse e lexojmë shëmbullin me kujdes, vërejmë që bëhet fjalë për dy persona dhe veprimet që kanë kryer ata në të njëjtën periudhë kohore, shprehur me dy folje të ndryshme (meqënëse edhe veprimet që kanë kryer, kanë qënë po ashtu të ndryshme), të vendosura në kohën e pakryer.

“...Giovanni *passeggiava* avanti e indietro, mentre la sua amica *sosteneva* l’esame.” (Xhovani *shëtiste* sa para, prapa, ndërsa shoqja e tij *jepte* provimin).

Nëse do të merrnim në analizë vetëm pjesën e parë të periudhës, “*Giovanni passeggiava avanti e indietro...*” folja e zgjedhurar në kohën e pakryer na jep nuancën aspektore të progresionit, por kur vendoset në periudhë dhe nëpërmjet “mentre” lidhet dhe shikohet si veprim përkundrejt një veprimi të dytë, atëhere ndihmuar si zakonisht nga konteksti, nuanca që komunikon është njëkohësia e dy veprimeve, apo e dy situatave për të cilat bëhet fjalë në ligjërim.

Ndërmjet kohëve të së shkuarës, vetëm e pakryera është në gjëndje të komunikojë nuanca njëkohësie. Le të krahasojmë:

A – “Fuori *pioveva*. Laura *indossava* un abito grigio. La stanza *era* in disordine.”

⁷⁴ Duke vërejtur skemat e bashkërendimit të kohëve foljore nga K. Katerinov, në librin e tij: “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010, u vërejt prania e njëkohëshmërisë në të shkuarën, në rastet e përdorimit të kohës së pakryer si në fjalinë kryesore ashtu edhe në atë të varur. Është një fenomen i vërejtur edhe nga prof A. Dhrimo në librin e tij: “*Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*”, A. Dhrimo, Libri Universitar, 1996.

B – “Fuori piove. Laura indossò un abito grigio. La stanza fu in disordine.”

Në shëmbullin e parë, nëpërmjet disa veprimeve të paraqitura njëra pas tjetrës në seri, koha e pakryer bën të mundur paraqitjen si të njëkohshëm të këtyre veprimeve. Pra, në të njëjtën kohë, *binte shi, Laura vishte dhe dhoma ishte*.

Ndërsa në shëmbullin e dytë, ai që ligjëron vëren që *po bie shi* (veprimi jepet me formë perfektive), Laura *veshi* (por pa u përcaktuar nëse para, pas, apo në të njëjtën kohë) një fustan gri dhe së fundi gjatë gjithë kohës, por edhe përpara se te niste shiu, dhoma *qe* rrëmujë.

Po kështu nëse krahasojmë fjalitë:

A – “Laura vestiva suo figlio e gli cantava una canzone.” (Laura vishte të birin dhe i këndonte një këngë).

B – “ Laura vestì suo figlio e gli cantò una canzone.” (Laura veshi të birin dhe i këndoi një këngë)

Në fjalinë e parë, koha e pakryer, e ndihmuar edhe nga lidhëza bashkërenditëse si dhe nga konteksti, tregojnë veprime të njëkohshme, ndërsa në shëmbullin e dytë, e kryera e thjeshtë nuk e krijon këtë nuancë dhe veprimet rrjedhin të një pas njëshme.

Po kështu:

“Dormivo tranquillamente, quando hanno suonato alla porta.” (Po flija qetësisht, kur i ranë portës).

Me renditje të përmbysur, e njëjta fjali mund të shprehet:

“Hanno suonato alla porta, proprio quando dormivo tranquillamente.” (Po flija qetësisht, pikërisht kur i ranë portës.

Pra që të dyja palët, si personi që po flinte, si ata që i ranë portës, kanë vepruar njëkohësisht.

Në gjuhën shqipe, përkthimi i strukturës dhe i nuancës kuptimore, qoftë të foljes, qoftë të kontekstit, realizohet me anë të formës perfektive të së pakryerës.

Është për t’u përmëndur që edhe aspekti i veprimit që kthehet në zakon, mund të komunikojë përveç “forcës së zakonit” edhe veprim të njëkohshëm. P.sh kur themi:

“Luigi si alzava alle 7.00., si rasava, raccoglieva le cose e andava a lavoro.”

Është mjaft interesant përdorimi që mund të gjejë në rrëfimet letrare e pakryera që tregojnë njëkohësi. Madje në disa raste, nuk ka nevojë të krijohet një paralele midis dy veprimeve të kryera në të njëjtin segment kohor, por njëkohësia mund të jepet edhe me anë të një konteksti të veçantë, siç është edhe rasti i mëposhtëm, shkëputur nga një libër i Umberto Eco-s.

“...Io volevo diventare completamente medievale e vivere nel Medio Evo, come se fosse il mio tempo...” (*Il nome della rosa*, U.Eco, p. 512).


Në këtë fjali nuk kemi të bëjmë me dy veprime të ndodhura njëkohësisht, si në rastin e shëmbullit të mësipërm: “*Dormivo tranquillamente, quando hanno suonato alla porta*”. Nuk kemi të bëjmë as me dy persona që krahasohen në veprimet e tyre, por me një individ të vetëm. Megjithatë, për shkak se folja e parë shpreh gjëndje-dëshirë , “*volevo*” (*Dëshiroja*) dhe në pjesën e dytë të periudhës autori shpreh atë që ai ka dëshirë, ky veprim i dëshiruar dhe vetë dëshira përputhen në kontekst, duke na dhënë edhe një herë tjetër njëkohësi kontekstuale.

Në rastin e fjalisë :“*Che lettore modello volevo mentre scrivevo?*”(*Il nome della rosa*, U.Eco, p.522) – “Çfarë lloj lexuesi *dëshiroja*, ndërsa *shkruaja?*”, autori bën një kapërcim të “vijës ndarëse” dhe nis një dialog me lexuesin, duke ngritur ai vetë një pyetje retorike dhe duke zëvendësuar kështu kureshtjen e një lexuesi potencial, me kureshtjen e tij si shkrimtar. Sidoqoftë dialogu mbetet i maskuar pas një monologu me vetveten, që e rikthen, ndoshta emocionalisht, autorin në periudhën kur ai shkruante librin e tij, por një monolog ky që i drejtohet në mënyrë dialogjike lexuesit, nëpërmjet pyetjes së cituar më sipër. Në të vërtetë, brenda kontekstit të mesazhit, fakti real shprehet me fjalët “...*mentre scrivevo...*” (e pakryera shfaq nuancën, megjithëse iluzore në këtë rast, që këtë e ka menduar gjatë gjithë periudhës në të cilën shkruante).

Pjesa tjetër mbetet thjesht një pyetje, e vendosur strukturalisht në një fjali pyetëse, të nisur me një mbiemër pyetësor (“Che” – në gramatikën italiane çmohet si mbiemër pyetës – *Che modello...*), që shpreh një kohë gramatikore (kohë gjuhësore), por që mungon dhe nuk ka ngjarë me të vërtetë në “*kohën reale*” (në kohën fizike), pasi është vetëm një reflektim që “*shkon drejt të shkuarës.*” Pyetja, në këtë rast, nuk do të kishte vlerën e një fakti të ndodhur, gjithmonë në lidhje me një kontekst më të përgjithshëm. Pavarësisht prej dy foljeve në kohën e pakryer, të përdorura njëra pas tjetrës, që në mënyrë iluzore krijojnë përshtypjen e të njëjtës periudhë kohore, mesazhi lë të kuptohet se njëri prej fakteve nuk ka ndodhur, por gjatë një dialogu me lexuesin, të maskuar teknikisht nga

ana letrare, forma “*volevo*” shpreh një kureshtje të shkrimtarit në lidhje me periudhën kur shkruante, pra si kohë, i përket një kohe të mëpasme.

Skematikisht, një krahasim midis dy fjalive, të vendosura më sipër përballë njëra tjetrës, do të paraqitej i tillë.




Tek e fundit, është tepër e vështirë të ndeshesh vazhdimisht me forma foljore që shprehin “njëkohësi të plotë”, me tërë kuptimin e fjalës. Edhe pse në pamje të parë ndodhin njëkohësisht, shpesh veprimet e të njëjtit personazh, apo dy personave të ndryshëm, vijojnë njëri pas tjetrit.

Në fjalinë e mëposhtme edhe pse koha e pakryer, e përdorur në të dyja foljet tregon relativisht njëkohësi, ajo nuk shpreh një përputhje të plotë të segmentëve kohorë.

- Quando *arrivava* lei, disfava tutto il lavoro degli altri.⁷⁵
- Kur *mbërrinte* ajo, çbënte krejt punën e të tjerëve.

Veprimet vijojnë menjëherë njëri pas tjetri, por edhe për shkak të strukturës së frazës me varësi kohore, bëhet fjalë për renditje të këtyre veprimeve, pra për një çast të parë, të shprehur nga folja “*arrivare*” dhe për një çast të dytë që ndodh pas të parit, të shprehur nga folja “*disfare*”

⁷⁵ “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010, megjithëse nuk e shpreh, i trajton këto raste si të unifikuara dhe që tregojnë njëkohësi. Gjithsesi, nisur nga kuptimi semantik i secilës prej foljeve, konteksti i fjalisë jo gjithmonë është në favor të një njëkohësie të tillë, siç është edhe rasti i shëmbujve që po trajtojmë.




E njëjta renditje faktesh pra, ruhet sa herë që “ajo mbërrinte”. E pakryera tregon edhe njëherë përsëritje të kthyer deri në zakon, me pasoja aspak të mira. Nuk ndodh i njëjti fenomen, për shëmbull, në fjalitë e mëposhtme, ku veprimin e kryen përsëri një person i vetëm:

- *Ascoltavo musica, mentre scrivevo.*
- *Dëgjoja muzikë, ndërsa shkruaja.*
- *Passeggiavo per la strada e ricordavo l’infanzia*
- *Shëtisja nëpër rrugë dhe kujtoja fëmijërinë.*
- *Guardavo i bambini e pensavo della mia infanzia.*
- *Shikoja fëmijët dhe mendoja për fëmijërinë time.*

Në secilën prej fjalive të mësipërme, foljet e vendosura në kohën e pakryer tregojnë të njëjtin segment kohor të veprimit.

5.4 E tashme në të shkuarën.⁷⁶



E PAKRYERA

Koha e pakryer mund të përdoret edhe me vlerat shprehimore të një të tashmeje në të shkuarën dhe kjo mund të vërehet si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë italiane. Mund të ndodhë një fenomen i tillë, për shëmbull, kur fjalitë të cilat mbartin përshkrimin e peisazhit të një vëndi, vendosen në pozicionin e një fjalisë të varur nga një fjali tjetër, në të cilën folja është vendosur në një nga kohët e shkuara. P.sh.

...Kronikani *shkruante* se këto *ishin* male të larta, ku as *sorrat* nuk *fluturonin* dot...”
(Kështjella, I. Kadare)

Folja “*jam*”, pavarësisht se në të pakryerën, është vendosur për të treguar një të tashme në raport me çastin kur kronikani po i shkruante këto rreshta. Në të vërtetë, kuptimi i njëkohësisë këtu humbet dhe ajo që mbetet është një përkim rastësor çastesh: “ ekzistenca e përhershme e maleve të lartë në atë vend dhe faktit që kronikani nisi të shkruante për to”.

Të njëjtin përdorim si tek Ismail Kadareja, e gjejmë edhe diku andej nga faqet e fundit të romanit të Umberto Ekos “*Emri i trëndafilin*”, në të cilat ai shkruan pikërisht rreth romanit të tij dhe impaktit që ky roman pati në rrethin e lexuesve. Duke bërë një analogji me A. Manzoni, Umberto Eko shkruan:

“...Manzoni non *scriveva* per piacere al pubblico, così come *era*, ma per creare un pubblico a cui il suo romanzo non potesse non piacere...”

Përdorimi i kohës të pakryer si e tashme në të shkuarën, nuk është diçka jo logjike. Midis të pakryerës dhe të tashmes, edhe pse mund të duket e pamundur, ekzistojnë analogji në lidhje me sjelljet aspektore.

⁷⁶ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinotto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

Një prej analogjive të shumta, për shëmbull, është përdorimi i këtyre dy kohëve foljore për të treguar ngjarje të pandryshueshme me kalimin e kohës, ose të paktën për aq kohë sa zgjasin kushtet që qëndrojnë në themel të këtyre veprimtarive⁷⁷.

“Sapevo bene che lui *si chiamava* Luigi”

“Fin dai tempi di Copernico e Galilei ci si accorse che la terra *girava* intorno al sole.”

Në shëmbullin e parë, personi për të cilin flitet do të vazhdojë të quhet i tillë deri sa të mos ketë ndërruar jetë, ndërsa në shëmbullin e dytë situata që toka të rrotullohet përreth diellit është e pandryshueshme.

Gjithsesi nuk bëhet fjalë vetëm për situata shprehimore të pandryshueshme me kalimin e kohës, por edhe për raste kur e pakryera i ruan të gjitha vlerat shprehimore të së “tashmes”, veçanërisht në strukturat gramatikore të ligjëratës së zhdrejtë⁷⁸.

“Lucia mi ha detto che *veniva* subito.”

“Lucia mi ha detto che *usciva* proprio allora dall’ospedale.”

Përtej ligjëratës së drejtë, veçanërisht në përdorimet letrare, e pakryera me vlerat e një të tashmeje në të shkuarën shfaqet jo rrallë edhe në të ashtuquajturën “ligjëratë e zhdrejtë e lirë”.

“...Ella esitò: *aveva* da dirgli la verità? Ma fu salvata da quella mano, che come per caso ora le palpava la nuca...” (Gli indifferenti, Moravia, p.74)

Në fakt, rreth këtij përdorimi jo të zakonshëm, por me shumë vlera shprehimore dhe stilistikore, gjuhëtarët janë të mendimit se e pakryera sugjeron idenë e “aktualitetit në të shkuarën”⁷⁹.

Në fjalinë “...Il Manzoni dice di Napoleone, che serviva pensando al regno...”, (Manxoni thotë që Napoleoni, shërbente duke menduar për mbretërinë), kumtuesi i

⁷⁷ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

⁷⁸ Shëmbuj të tillë gjënden me shumicë në ushtrimet që japin shumë gramatika të gjuhës italiane, për të praktikuar përdorimin e kohës së pakryer të mënyrës dëftore.

“*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.

“*Grammatica avanzata della lingua italiana*”, S. Nocchi, R. Tartaglione, Alma Edizioni, 2006.

“*Grammatica italiana*”, G. Pittano, Bruno Mondadori, 1986. Etj.

⁷⁹ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“*Tense and aspect in the languages*”. Ö. Dahl, Mouton de Gruyter, 1989.

mesazhit na e paraqet Manxonin, nëpërmjet përdorimit të një kohe të tashme, ndërsa Napoleonin e lë në të shkuarën. Kështu Manxoni bëhet bashkëkohës jo vetëm i folësit, por edhe i lexuesit të çdo kohe, ndërsa e pakryera e foljes “*servire* shtrihet në kohë dhe në hapësirë, duke përfshirë të gjithë periudhën e shërbimit të Napoleonit: Në fakt, duke afruar Manxonin, duket sikur Napoleoni na largohet gjithnjë e më tepër, ndërsa e pakryera përfton një nuancë thujtë si në legjendë.

Ky është rasti i një kombinimi të së tashmes dhe të pakryerës, gjithmonë në funksion të asaj që do të komunikojë ligjëruesi.

Një tjetër shëmbull, deri diku i ngjashëm me atë më sipër, na vjen nga gjuha e përdorur prej fëmijëve në lojrat e tyre.

- *Io facevo il ladro e tu la guardia.*

Në një krahasim midis dy shëmbujve, vërejmë se në vënd të emrit të Aleksandër Manxonit, janë vendosur përemrat e vetës së parë dhe të dytë, të cilat dëshmojnë praninë e një të tashmeje në dialogun midis bashkëfolësve, ndërsa koha e pakryer shërben për të evokuar fëmijërinë e tyre.

Nga ana tjetër, kjo e pakryer përfton edhe ngjyrimet e një gjuhe karakteristike për moshat fëminore, si dhe përcjell çaste emocionale, që i përkasin një të shkuare, me reflektime nostalgjike në të tashmen. Gjithashtu, e pakryera e vendos pjesëzën e jetës të evokuar prej mesazhit, në një kontekst të tillë, që të evokojë në mënyrë kuptimplote krejt fëmijërinë, ndoshta si pjesa më e mirë e saj, që ia vlen të mbahet mend – pasi me siguri nuk ka qenë e vetmja lojë që kanë luajtur bashkëbiseduesit.

Përkthyer në gjuhën shqipe, e pakryera i ruan nuancat e kontekstit të gjuhës italiane, natyrisht, me disa pak dallime që kanë të bëjnë më tepër me materialin gjuhësor të përzgjedhur prej përkthyesit.

- *Unë bëhesha hajduti dhe ti rojtari.*

Edhe në gjuhën shqipe, koha e pakryer e mënyrës dëftore e ruan nuancën e një “të tashmeje në të shkuarën”, shoqëruar me ngjyrimet respektive, në raport edhe me kontekstet e ndryshme në të cilat vërehet.

“...Në të vërtetë asnjëri *nuk e dinte* se nga erdhi në qytetin e Gjirokastrës Basri Hankoni. Një mbiemër i tillë s’që dëgjuar kurrë më parë. Disa *thoshin* se ai zbriti nga

Lunxhëria, të tjerë *thoshin* nga malet e Tepelenës....” (*Emblema e dikurshme*, I.Kadare. f. 278)

Duke i vendosur ngjarjet në të tashmen e një të shkuare (evokon ngjarje të shekujve të shkuar, duke i ambjentuar edhe personazhet në atë perudhë) dhe duke i “detyruar” personazhet e tij që të vrisnin mendjen se “*kur kishte ardhur Basri Hankoni në qytetin e tyre*”, autori ka krijuar brënda të shkuarës dy periudha: atë të së “tashmes në të shkuarën” dhe një tjetër të “shkuar” në raport me të “tashmen e të shkuarës”.

“...Shumica *thoshin* se zjarri kishte rënë rastësisht, por *kishte* që *dyshonin* për Cacin, shitësin e vjetër të vajgurit, që hankonatët pothuajse e kishin rrënuar ekonomikisht...” (*Emblema e dikurshme*, I.Kadare, f. 291).

Edhe në shëmbullin e dytë, ngjarjet i përkasin shekujve të kaluar. Vërehen përsëri dy periudha kohore: ajo kur ka rënë zjarri, e cila evokon një të shkuar jo të largët, në raport me një “të tashme”, në të cilën njerëzit hamendësojnë se kush e ka vënë zjarrin.

E njëjta situatë, pra, prania në të shkuarën e një “të tashmeje” dhe “të shkuare” në raport me atë të tashme, vërehet edhe në shëmbujt e mëposhtëm:

“...Tani kur *i takonte* në rrugë vajzat e ekipit, *Leza ndalonte* dhe *bënte* ndonjë shaka me to...” (*Emblema e dikurshme*, I.Kadare, f. 335)

“...Ajo *e dinte*. *Tani e njihte* të kaluarën e tij që nga fëmijëria, pa zbukurime e hollësi të trilluara. Dhe *shihte të sotmen*...” (*Ali Pashë Tepelena*, S. Godo, f. 242)

Prania e ndajfoljeve të kohës, që tregojnë aktualitet, në dy shëmbujt e mësipërm, e bëjnë edhe më të qartë praninë e një të tashmeje në të shkuarën, me përdorimin e kohës së pakryer të mënyrës dëftore.

Gjithsesi e pakryera nuk krijon vetëm nuancat e një të tashmeje në të shkuarën, por në gjuhën italiane, jo rrallë, mund të zëvendsojë edhe të tashmen në kuptimin më të plotë të kësaj fjale. Është karakteristikë kryesisht e gjuhës së folur dhe mund të haset kur bashkëbiseduesit përdorin format e mirësjelljes⁸⁰. Zëvendësimi i të tashmes me të pakryerën mund të përdoret prej të dy bashkëbiseduesve, pra si në pyetje, ashtu edhe në përgjigje:

⁸⁰ “*Grammatica per italiani maggiori*”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

“*Grammatica italiana*”, G. Pittano, Bruno Mondadori, 1986.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

- *Desiderava* ? (Pyetje)

- *Volevo vedere Luigi* (Përgjigje)

Krahasuar me të tashmen, koha e pakryer e rrit “largësinë e mirësjelljes” dhe shfaq më tepër finesë dhe përpunim gjuhësor. Përsa i përket ngjyrimit që merr krejt komunikimi, ai është në varësi të intonacionit të përdorur prej bashkëbiseduesve dhe mund të përfshijë një gamë nuancash që shkojnë nga një mirësjellje e stërholluar, deri në nuancat e një bezdie.

Ajo çfarë mbetet e sigurtë në përfundim të një analize, është se në të gjitha rastet, bashkëbiseduesit qëndrojnë në një “distancë” edhe më të madhe përkundrejt njëri tjetrit, krahasuar me rastin nëse do të përdornin, për të komunikuar, kohën e tashme dëftore.

Për ta transplantuar këtë formë në gjuhën shqipe, përsëri kemi nevojë të mësojmë nuancat kontekstuale, me të cilat po zhvillohet biseda midis dy personave. Duke patur parasysh gamën e pasur që mund të përftojë modeli i përdorur në gjuhën italiane, kalimi në gjuhën shqipe mund të bëhet me të paktën dy mënyra, duke i supozuar ngjyrimet shprehimore edhe në varësi të informacionit apo kontekstit.

- *Dëshironit* ? (Një formë që nuk përdoret në gjuhën shqipe, por me të cilën mund të kalohet me mirësjellje edhe një nuancë bezdie, pra kur njëri prej bashkëbiseduesve përpiqet të trasmetojë edhe bezdi.

- *Doja* të takoja Luixhin!

Elementi i parë që bie në sy, është përdorimi i dy foljeve në kohën e pakryer, të përdorura njëra pas tjetrës, në përgjigjen që jep bashkëbiseduesi i dytë. Përsa i përket nuancës shprehimore, nga mënyra si drejtohet evokon ndërprerjen e një situatë të caktuar, ndoshta një mendim, një bisedë, zhvillimin normal të një procesi pune, për shkak të mbërritjes së personit tjetër, si dhe faktin që bashkëbiseduesi i dytë ndodhet prej pak kohësh i pranishëm në atë vënd, pa patur mundësi të pyesë për atë që dëshiron. Vërehet gjithashtu edhe fare pakëz ngutje nga ana e atij që pyet, për ta mbyllur sa më shpejt çështjen. Përgjigjja, gjithashtu me një folje të vendosur në të pakryerën, vjen si reagim i pyetjes, duke treguar edhe një dozë të vogël padurimi.


Mënyra e dytë e përkthimit: -*Ç’ dëshironit?*

-*Doja* të takoja Luixhin.

Është një mënyrë të shprehuri që përdoret më shpesh në gjuhën shqipe. Është karakteristikë kryesisht e gjuhës së folur.

Vërejmë që është shtuar përemri pyetës. Ritmi brenda situatës përshpejtohet paksa, toni bëhet më i vendosur, më i prerë, megjithëse ruhet forma e mirësjelljes. Duke analizuar situatën shprehimore, në varësi edhe të intonacionit, pyetja mund të përmbajë edhe bezdi.

5.5 Nuanca e të ardhmes në të shkuarën.⁸¹



Megjithëse është kohë që i përket të ardhmes, e pakryera mund të shfaqë edhe nuanca kapërcimesh kohore, madje duke shprehur edhe konceptin e një të ardhmeje.

- *Non sapeva che i cieli gli destinavano una morte mille volte più miserabile.*
- *Nuk e dinte që qiejt i ruanin një vdekje një mijë herë më mjerane.*

Në spostimet që mund të pësojë e pakryera përgjatë aksit të kohës, ajo jo vetëm mund të projektojë një të ardhme në të shkuarën, si për shëmbull në rastin e shëmbullit të mësipërm, por mund të marrë mbi vete edhe një nuancë të plotë të së ardhmes, ndërkohë që faktet apo veprimet vazhdojnë t'i referohen kohëve të shkuara.

⁸¹ “Grammatica per italiani maggiori”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

“Grammatica italiana”, G. Pittano, Bruno Mondadori, 1986.

“La lingua italiana per stranieri”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“Lingua, Grammatica, Stile”, G. Tedeschi, Petrini, 1971.

“Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe”, A. Dhrimo, Libri Universitar, 1996

“Grammatica essenziale della lingua italiana” M. Mezzadri, Guerra Edizioni, 2000.


“Grammatica italiana”, A. Panzini, Sellerio Editore, 1982. Etj.

-Mi ha detto che *veniva!*

Vlerën e të ardhmes në të shkuarën, e pakryera e përfton për shkak të shtrirjes së saj në kohë, duke përfshirë në këtë shtrirje kohore edhe atë që mund të konsiderohet si “*e ardhmja*” përkundrejt një veprimi në fjalinë kryesore.⁸²

Dallimi i nuacës midis shëmbujve: “*Non sapeva che i cieli gli destinavano una morte più misera*” dhe “*Mi ha detto che veniva!*”, bëhet për shkak të mesazhit që përçojnë secila prej tyre dhe të ndryshimit të madh në kohë që mund të vërehet nga një analizë më e zgjeruar e kuptimeve kontekstuale.

Në shëmbullin e parë, e pakryera e foljes në fjalinë e varur nuk tregon një të ardhme reale, por një projektim drejt kësaj të ardhmeje, një projektim ky që ka nisur të përvijohet në një kohë “më të shkuar”, se e shkuara e shprehur nga e pakryera në fjalinë kryesore, e cila përfshin duke e mospërshkuar periudhën e përfaqësuar nga forma mohore e foljes “së pakryer” të fjalisë kryesore dhe projektohet për më tej, e orientuar drejt një të ardhmeje – “*për shkak se qiejt ia ruanin këtë vdekje, ndoshta që kur kishte lindur*”. Me anë të një skeme, analizën e mësipërme, në mënyrë të përmbledhur, mund ta paraqesim në këtë formë:



⁸² Nisur edhe nga shëmbujt e shumtë me të cilët jemi ndeshur, mendojmë se për shkak të shtrirjes së veprimit në kohë, vendoset njëfarë distance kohore midis fillimit të veprimit dhe çastit që mund të hamëndësohet si përfundim i të njëjtit veprim apo ngjarje. Është pikërisht kjo distancë kohore, brenda një konteksti të përshtatshëm për këtë rast, që shpesh krijon nuancën sa shprehimore aq edhe stilistike të së ardhmes në të shkuarën.

Pra siç vërehet, veprimi i fjalisë së varur ka nisur përpara veprimit të shprehur nga folja e fjalisë kryesore.

Në gjuhën shqipe, fjalia “Mi ha detto che *veniva!*”, “transplantohet” në formën “Më tha që *po vinte!*”. Pra kemi një kalim nga aspekti imperfektiv i shfaqur në variantin italisht, në aspektin perfektiv, shoqëruar me pjesëzën “po”, në variantin shqip. Pjesëza “po” e afron së tepërmi veprimin, dhe i jep edhe një nuancë njëkohësie me çastin të cilit i referohet ligjëruesi. (Është i pamundur një përkthim pa praninë e kësaj pjesëze, pasi nuk mund të shprehemi “Më tha që *vinte!*”) Aq e madhe është kjo nuancë njëkohësie, sa që mund të thuhet se të dyja faktet po ndodhin relativisht brënda të njëjti hark kohor, edhe pse i dyti shpreh një të ardhme, për shkak të një shtrirjeje më të madhe kohore të së pakryerës, që përfshin edhe periudhën që vjen pas çastit kur: “*Më tha...*”.⁸³

Në mjaft raste, aspekti i të ardhmes bëhet i dallueshëm nga aspekti i njëkohësisë, vetëm nga prania e ndonjë ndajfolje kohe apo elementi tjetër leksikor. P.sh.

“Cinque minuti dopo, il drapello *guardava* silenziosamente il fiumicello, che *era* scarsissimo d’acqua e *si radunava* sulla riva opposta...” (La giungla nera, E.Salgari, p. 245)

E pakryera e foljes “*guardare*” shpreh një të ardhme brënda harkut kohor të së shkuarës, në raport me njësinë kohore paraprake të nënkuptuar në kontekst, por këtë herë e saktësuar pas sa kohe ndodh ngjarja – *pas pesë minutash*. Megjithatë, kjo saktësi kohore vlen vetëm për veprimin e shprehur nga folja “*guardare*”, pasi e pakryera e veprimit të shprehur nga folja “*radunare*”, paraqet një të ardhme edhe më të largët, madje këtë herë të papërcaktuar.

Interesante shfaqet në tekst e pakryera e foljes “*essere – era*”, e cila në kontekstin e fjalisë më sipër, më tepër se një kohë të mirëfilltë, shpreh një gjëndje – gjëndjen e sasisë së ujit të lumit, në çastin kur “*skuadra po e shikonte në heshtje*”. Nëse do të thoshim që përmban edhe nocionin e kohës, kjo kohë përfshin si periudhën “*pas pesë minutash*” të veprimit të shprehur nga folja “*guardare*”, ashtu edhe të ardhmen e papërcaktuar të

⁸³ Prof. A. Dhrimo e shikon këtë fenomen si të ardhme në të shkuarën : “*Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*”, A. Dhrimo, Libri Universitar, 1996, f. 106 (*Prespa po dilte..., Mimoza po shkonte..., duke pritur çka po ndodhte..., etj.*). Jemi të mendimit, që kur folja në kohën e pakryer shoqërohet më pjesëzën “po”, në shumicën e rasteve shikohet tërësisht nga brënda dhe për këtë arsye, nuanca e njëkohësisë, në shumicën e konteksteve, është më e fortë se ajo e të ardhmes në të shkuarën. Përkundrazi, në gjuhën italiane, nuanca e të ardhmes në të shkuarën është mjaft e qartë dhe nuk lë vend për dyshime.

shprehur nga folja “*radunare*” . Në gjuhën shqipe, gjëndja sasiore e lumit mund të shprehet edhe pa përdorimin e foljes “*jam*” .

Projektimi i të ardhmes në një të shkuar, ose thënë më ndryshe, perspektiva e një veprimi, nuk është një nuancë që shprehet rrallë me përdorimin e të pakryerës. Kjo nuancë i jep gjuhës së përdorur elegancë, fleksibilitet dhe stil në të shprehur.

Rasti i shoqërimit të foljes me një ndajfolje kohe, që tregon koncept të së ardhmes, e bën më të dallueshme nuancën e të ardhmes në një të shkuar.

“A quel che mi è stato detto, Lucia *veniva* domani.”

“Marco non *voleva* andare, ma in seguito *era* proprio lui ad insistere per esserci mandato.”

“L’indomani, il suo amico *partiva*. Così almeno *sembrava*.”

“L’estate scorsa hai promesso che *ritornavi* prima o poi!”

Mund të vërejmë të njëjtin fenomen edhe në gjuhën shqipe:

“Të nesërmen vinte i vëllai dhe e merrte.”

“Më pas shkonte dhe i kërkonte falje.”

Shoqëruar me pjesëzën “po”, koha e pakryer shpreh në shqip një të ardhme thujse të lidhur me “të tashmen” e çastit, për të cilin bëhet fjalë në të shkuarën, madje shpesh duket sikur ngjarja fillon në fund të kësaj “*kohe të tashme*”, për të përfunduar në të “*ardhmen*”.

“Po *vinte* pranvera !”

“*Po* i *humbte* shpresat që gjithshka të përfundonte mirë.”

Në kuptimin e konceptit të përfshirjes kohore, përdorimi i kohës së pakryer me pjesëzën “po” në gjuhën shqipe, duket sikur ka një shtrirje kohore më të madhe se rastet që mund të hasen në gjuhën italiane.

Një rast të veçantë, duket që përbën në gjuhën italiane përdorimi i foljes “*dovere*” (duhet), shoqëruar me një folje tjetër në paskajore.

“Le misure prese *dovevano rivelarsi*, alla resa dei conti, del tutto insufficienti.

Në një rast të tillë, në kuptimin kontekstual të mesazhit, shfaqet nuanca konotative e një fakti, ngjarjeje a diçkaje që ndodh më pas, pra nuanca “*e të mëvonshmes*”

5.6 Vlera modale të kohës së pakryer.⁸⁴

Një nga vlerat e shumta që përfton gjatë përdorimit e pakryera e dëftores, është edhe shprehja e një forme të veçantë të mirësjelljes, veçanërisht kur midis bashkëbiseduesve ka tërësisht mungesë konfidence. Mund të sjellim këtu një shëmbull të përdorur edhe diku më sipër, por që natyrisht, me intonacionin e duhur shpreh mirësjellje:

- *Cosa desiderava signora ?*

- *Volevo dirti che domani me ne vado !*

Kjo formë është karakteristikë, kryesisht, e gjuhës së folur. Për shkak se komunikimi, edhe pse ndodh në kohë reale midis bashkëbiseduesve, zhvendoset në të shkuarën për shkak të përdorimit të kohës së pakryer, e gjithë biseda fiton disa nuanca “jo reale”, larg prej vëndit ku ndodhen personat dhe në një tjetër kohë, që nuk ka lidhje me të tashmen e çastit të ligjërit.

Në fakt, kur flasim për vlerat modale të një foljeje, mbajmë parasysh rastin kur ato shprehin veprime, të cilat pësojnë një zhvendosje nga bota reale, në një botë më pak reale, apo tërësisht pjellë e imagjinatës dhe fantazisë së ligjëruetit. Të ambjentuara në një kontekst të tillë, këto folje shpesh mbartin vlera të veçanta shprehimore dhe stilistikore.

Ndodh kështu, për shëmbull, kur një autor nis e përshkruan një ngjarje të përjetuar në gjumë prej personazheve të tij.

“...E in quella nebbia dell’anima, ebbi una visione o sogno che fosse. Adamo *gorgogliava* riverso e il vino gli *usciva* dalla costola, Noè *malediceva* nel sonno Cam,

⁸⁴ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010

“*Grammatica avanzata della lingua italiana*”, S. Nocchi, R. Tartaglione, Alma Edizioni, 2006.

“*Dire, fare, capire*”, G. Bottiroli, D. Corno, T. De Mauro, Paravia, 1990, f. 258.

“*Dizionario di linguistica*”, Zanichelli, 1983, f.188.

Oloferne *russava* senza sospetto, Giona *dormiva* sodo, Pietro *vigilava* sino al canto del gallo e Gesù *si risvegliava* di colpo udendo Bernardo Gui ... chi *beveva* bene, chi *moriva* ridendo e chi *rideva* morendo, chi *portava* ampolle e chi *beveva* nel bicchiere degli altri...” (*Il nome della rosa*, U.Eco, p. 433).

Edhe pse bëhet fjalë për një rrëfim, ambientimi në një botë aspak të natyrshme (në ëndërr) i jep vlera disi të veçanta kohës së pakryer, e cila shërben pikërisht për të bërë dallimin midis botës reale dhe asaj të ëndërrave, madje përdoret pikërisht për të evokuar një kohë dhe botë tjetër, të ndarë si nga një pëlhurë kohore me të tashmen e rrëfimit. Krejt rrëfimi del “jashtë kohe” dhe filtrohet nëpërmjet të pakryerës, për të mbërritur te lexuesi dhe për t’u pajisur gjithësesi me një dimension kohor.

“... E vidi nel sogno un isola deserta. La Perla di Labur *era* con me. *Cantava* una dolce canzone e *sorrideva*...” (*I pirati della Maleisia*, E.Salgari, p. 273)

E gjithë ngjarje është përjetuar si e vërtetë në ëndërrën e personazhit kryesor të librit. Koha e pakryer shërben për të ndarë realitetin dhe çastin e ligjërit, me një tjetër realitet, të përjetuar në gjumë, por aspak të jetuar.

Ndodh që në ëndërr të jetë ligjëruesi që e kryen veprimin:

- *Io correvo* su una pianura lunare.

- *Io volavo* sopra i tetti di una città straniera.

Prania e përemrit vector dëshmon një të tashme rrëfimtare dhe e pakryera e foljes një të shkuar, edhe pse në ëndërr. Por më tepër se kohë, me tejzgjatjen e saj karakteristike, e pakryera duket sikur pikturon pamjen e një zhvendosjeje të vazhdueshme në hapësirë. “*Io correvo*” – dhe imazhi që krijohet është një vrapim i njëtratsëm, i zgjatur dhe i pambaruar. Po ashtu edhe me formën foljore “*Io volavo*”. Fakti fiksohet në lëvizje të vazhdueshme, duke u tretur tej, pa u ndalur.

- *Unë vrapoja* mbi një fushë hënore.

- *Unë fluturoja* mbi çatitë e një qyteti të huaj.

Edhe në variantin e përkthyer në shqip, e pakryera i ruan të gjitha ngjyrimet e italishtes. Ndryshojnë këto ngjyime, nëse kalimi do ta zgjidhte përkthimin e të pakryerës së italishtes, duke përdorur pjesëzën “po”. Në këtë rast, megjithëse e pakryera do të vazhdojë të tregojë një zhvendosje në hapësirë, këtë lëvizje do ta shprehë duke nënkuptuar një çast kohe.

- Unë *po vrapoja* mbi një fushë hënore.

-Unë *po fluturoja* mbi çatitë e një qyteti të huaj.⁸⁵

Pra të njëjtat vlera modale ruhen edhe në gjuhën shqipe, ku e pakryera i ngjan një tisi të hollë pëlhure, që ndan ëndrrën nga realiteti, por edhe duke i përzjerë paksa të dyja bashkë..

“...Dhe ja, i përgjumur siç *isha*, u mbështeta te Jani. Edhe ai më duket se *po flinte* ...Mua *më bëhej* sikur *isha* i zhytur në kumin e zi dhe *s’dilja* dot. ...bëja të ngrihesha e të *vrapoja*, po nuk *mundja*. *Bëja* të nxirrja thikën e mprehtë, por duart më *ishin* mpirë.”(Shpella e piratëve, P. Marko, f. 110)

I njëjti përdorim haset edhe në rrëfimet letrare, në të cilat autori nuk e ka fshehur fantazinë, madje e pakryera mund të konsiderohet edhe si një kohë tipike rrëfimtare në gjuhën fëminore. Në përralla, p.sh, e pakryera fiton vlera të mirëfillta stilistikore, duke shprehur situata të një “jo realiteti” dhe fantazie të pastër. Me përdorimin e kohës së pakryer, natyra e saj imperfektive i zhvendos dhe i largon ngjarjet nga dimensionimi real. Vlerat shprehimore dhe konotative të një realiteti aspak aktual që zotëron kjo kohë, janë mjaft efikase që fëmijët ta kuptojnë thjesht dhe pa vështirësi rrëfimin. Mjafton të përmëndim “formulën” me të cilën hapen kryesisht përrallat “*Na ishte seç na ishte*”, për të kuptuar mekanizmin me anë të të cilit e zhvendosim vëmendjen e fëmijëve në një botë fantastike, imagjinare.

“...Una donna *aspettava* un bambino e *aveva* voglia di prezzemolo. Vicino a lei *stava* una strega famosa, e *aveva* un orto tutto di prezzemolo. La porta dell’orto era sempre aperta, perché di prezzemolo c’è n’era tanto, che chi *voleva*, *poteva* anche prenderselo...” (*Fiabe italiane*, “*Il dimezzato*”, I. Calvino, p. 147)

“*C’era una volta* un re senza corona.

Era la seconda nota della scala musicale, *abitava* proprio sotto il rigo, e per combinazione *vedeva* al piano di sopra un “mi” che *aveva* una corona grossa così. ...” (*Storie fantastiche, favole, filastrocche*; G.Rodari, p. 395)

“*Na ishte seç na ishte*, na *ishte* njëherë një djalë i vogël, por kaq i vogël, saqë shokët e *thërrisnin* Gishto...” (*Përralla e Gishtos*).

⁸⁵ Prof. A. Dhrimo e shikon si një veprim të shprehur në zhvillim e sipër, pikërisht në çastin e marrë si pikë referimi : “*Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*”, A. Dhrimo, Libri Universitar, 1996, f. 102.

Përtej evokimit të një realiteti fantastik ose imagjinar, koha e pakryer mund të krijojë stilistikisht edhe disa realitete që i mungojnë ligjëruesit. Një rast i tillë, vërehet në disa forma të përdorimit të së pakryerës në letërkëmbim, për ta modifikuar realitetin e dërguesit dhe marrësit.⁸⁶

“Cara mamma! Ti scrivo perchè volevo dirti...”

“E dashur nënë! Po të shkruaj, pasi *doja* të të thosha...”

Me anë të përdorimit të kohës së pakryer, letërshtuesi shtiret sikur ndodhet pranë nënës dhe po bashkëbisedon me të. Përdorimi i të pakryerës e ndihmon që të krijojë këtë lloj imazhi.

Një përdorim i ngjashëm për nga natyra, por i ndryshëm për nga efekti gjëndet në tekstin e mëposhtëm:

“...Sapreste voi esser moglie d’un uomo povero, che desiderava, cercava potervi offrire un pane sicuro e non può...” (*Fede e bellezza*, Tommaseo)

Me anë të përdorimit të së pakryerës, përftohet një zhvendosje e veprimit në të shkuarën e afërt, ndërkohë që konteksti na lë të kuptojmë që është ende në vazhdim. Përkthyer në gjuhën shqipe, që të ruhej sado pak prej ngjyrimit të italishtes, por duke e zhvendosur veprimin në një kohë të pacaktuar, situata do të zgjidhej me përdorimin e kushtores (*...do të dëshironte, do të kërkonte...*). Po kështu në fjalitë:

- *Venivo a dirti che me ne vado ! (Po vija të të thosha që po largohem!)*

- *Dove andavi così in fretta ? (Ku shkoje me kaq nxitim?)*

Mekanizmi i përfutur prej kohës së foljes, i jep kontekstit të fjalive një ngjyrim supozimi. Vetë procesi përfaqësohet nga një “Kohë”, që në mënyrë konotative tregon çastin pak përpara ligjërimit: “*po vija...*”, “*ku shkoje...*”; Vetëm konteksti në të cilën zhvillohet situata mund të na lejojë të kuptojmë, që është fjala pikërisht për çastin e ligjërimit (dhe njëkohësisht edhe për çastin e takimit.)

Ndërsa në shëmbujt e mëposhtëm, e pakryera shërben për të treguar një veprim që nuk është kryer:⁸⁷

“Luigi doveva essere qui!” (Luixhi *duhej* të ishte këtu!)

⁸⁶ “*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.

⁸⁷ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“*Bastava fare un piccolo sforzo; ormai è troppo tardi.*” (*Mjaftonte* të bëhej një përpjekje e vogël; tashmë është tepër vonë)

Meqënëse tregon një veprim që është kryer në të shkuarën, por që shtrihet deri pranë çastit të ligjërit, koha e pakryer e mënyrës dëftore përdoret shpesh për të shprehur një veprim, gjëndje etj., që duhej të ndodhte në të tashmen, por për të cilën, papritur, ligjëruetit kujtohen që është vonë. Për shëmbull kur themi:

“*Il compleanno di Marco era oggi!*” (Ditëlindja e Markos *ishte* sot).

“*Il puntamento era per stasera!*” (Takimi *ishte* për sot në mbrëmje!”

Edhe në këto raste, si në shumë konotacione të tjera, e pakryera përdoret për vetë papërcaktueshmërinë kohore të veprimit që shpreh, për shkak të natyrës së saj imperfektive.

5.7 Koha e pakryer në fjali hipotetike.⁸⁸

Në gjuhën e përditshme të folur, koha e pakryer mund të gjejë edhe mjaft përdorime të tjera, që shfaqin nuanca konotative me interes stilistikor. Disa nga këto raste kanë të bëjnë më përdorimin e kohës së pakryer në periudha hipotetike, ku shpesh vërehet një mënyrë me stil e të shprehurit.

E përdorur në struktura hipotetike, koha e pakryer e mënyrës dëftore mund të zëvendësojë një prej kohëve të mënyrës lidhore, ose të mënyrës kushtore. Kështu për shëmbull, në vënd të shprehemi: “ – Se fossi venuto, ti saresti divertito... (Po të kishe ardhur, do të ishe argëtuar...), në kushtet e një bashkëbisedimi të lirë midis dy personave, që kanë konfidencë me njëri tjetrin, apo janë të afërt, mund të përdoret shprehja:

- Se *venivi*, ti *divertivi*. (në gjuhën shqipe është e pamundur të ruajmë të pakryerën e dëftores “Po të vije, do të argëtoheshe.)

⁸⁸ “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“*Grammatica per italiani maggiori*”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

“*Grammatica italiana*”, A. Panzini, Sellerio Editore, 1982.

“*Grammatica avanzata della lingua italiana*”, S. Nocchi, R. Tartaglione, Alma Edizioni, 2006.

“*Grammatica italiana*”, G. Pittano, Bruno Mondadori, 1986.

Po të mos ishte për shkak të natyrës me më tepër liri shprehjeje të gjuhës së folur, një gjuhëtar i gramatikës italiane do ta përjashtonte përdorimin e kësaj fjalie si të parregullt gramatikisht. Por ja që disa elemente gramatikore ndryshojnë, ose bëhen të papërdorshëm në kushtet e një të foluri të lirë. Konteksti i mesazhit lë të kuptohet që toni me të cilin kumtohet është ai i përdorur në lojërat e fjalëve: ledhatar, e “lodruet”; duket hapur qëllimi i bashkëfolësit “për të luajtur”, duke përdorur një formë jo fort klasike paranomazie, madje fjalia është e ndërtuar si lojë edhe strukturalisht. Dy foljet në të pakryerën, njëra pas tjetrës, krijojnë tingëllim të këndshëm dhe rimë.

Është fakt, që koha e pakryer mund të përdoret gjerësisht në lojërat e fjalëve. Në periudhat hipotetike, për shëmbull, mund ta theksojë edhe më tepër ndjesinë e një situatë hipotetike, por edhe jo reale.

- Se *venivi* prima, *trovavi* ancora posto.

- Nëse *vije* më parë, *gjeje* akoma vënd.

Struktura e mësipërme është karakteristikë e gjuhës së folur edhe në gjuhën shqipe. Sidomos mjaft e përhapur është në dialektin tosk. Përdorimi i foljeve “*venire*” dhe “*trovare*” në kohën e pakryer, e nënvizon edhe më tepër një të shkuar, që nuk u kthye dot në diçka reale, thua se edhe vetë folësi, që shprehet në këtë mënyrë, e ka të vështirë ta pranojë rastin e humbur. E pakryera e afron veprimin shumë afër të tashmes, duke e bërë edhe më të prekshëm realitetin e krijuar.

Me mjaft elementë të ngjashëm paraqitet situata edhe në disa lloje të tjera të fjalive të varura kushtore. P.sh.:

-Se tu *avevi* altra ira, non ci *dovevi* perciò straziare.

Edhe në këtë rast, përdorimi i të pakryerës në të dyja foljet, është karakteristikë e gjuhës së folur dhe e një ambienti të përcaktuar kulturor. Prania e kësaj kohe në fjalitë me varësi kushtore, na sjell ndër mënd mungesën e përdorimit të lidhores dhe kushtores, çka do të thotë që folësi nuk ka praktikë me gjuhën letrare, apo me gjuhën e përpunuar në përgjithësi. Evokimi i ambientit kulturor dhe familjar, është një tjetër karakteristikë e këtyre përdorimeve, me mjaft vlerë stilistikore në tekstet letrare, ku personazhi duhet t’i përshtatet ambientit të tij shoqëror edhe nëpërmjet gjuhës së folur.

Nga ana tjetër, përdorimi i kohës së pakryer në foljen gjysme ndihmëse “*dovere*”, i jep kuptimit të kësaj foljeje edhe nuancën e diçkaje të pakthyeshme, e një situatë që nuk mund të rikthehet më për t’u korrigjuar, por me tone më të zbutura se në rastin e përdorimit

të një tjetër kohe të së shkuarës, me intonacion më tepër këshillues dhe qortues, se imponues, apo urdhërues.

Megjithëse karakteristikë kryesisht e gjuhës së folur, përdorimin në struktura hipotetike të së pakryerës e hasim edhe në tekste letrare, si pjesë të dialogjeve:

“...Se mi *s'accostava* un passo di più, soggiunse, *l'infilavo* addirittura prima che avesse tempo di accomodarmi me...” (I promessi sposi, A.Manzoni, p.167)

Mjaft shpesh, përdorimi i të pakryerës në periudha hipotetike krijon nuancat e të shkuarës përkundrejt çastit të ligjërit, të njëkohësisë, ose të së ardhmes. Kjo mund të ndodhë edhe me një përdorim fare normal të periudhës hipotetike:

- Se ieri *prendevo* la macchina, *venivo* anch'io. (e shkuar përkundrejt çastit të ligjërit)

- Se *prendevo* la macchina in questo momento, *venivo* anch'io. (e tashme përkundrejt çastit të ligjërit)

- Se *venivi* domani, *ci divertivamo*. (e ardhme përkundrejt çastit të ligjërit)

Në gjuhën shqipe, përdorim kombinimin e lidhore me kushtoren për të shprehur të njëjtat konotacione të shëmbujve të mësipërm.

Ndonjëherë, përdorimi i nuancës të së ardhmes ndesh në kundërshti me faktin që konteksti tregon se veprimi ka ndodhur:

Se lo *mangiavi* domani, *era* meglio.

- Nëse e *haje* nesër, *ishte* më mirë!

Konteksti i fjalisë, lejon të kuptohet, që tashmë veprimi është kryer.

5.8 E pakryera rrëfimore.⁸⁹

Duke hulumtuar për vlerat stilistikore të kohës së pakryer të mënyrës dëftore në tekste të shkruar, pa dyshim, që çdokush do t'i referohej para së gjithash stilit letrar, duke gjetur atje përdorime nga më të pabesueshmet. Në fakt, askush më mirë se një shkrimtar apo poet, nuk mund ta pajisë fjalën me vlera origjinale shprehimore.

Në stilin letrar, veçanërisht e përdorur në Itali prej shkrimtarëve modernë të pasluftës dhe shpesh duke marrë mbi vete (në gjuhën italiane) edhe rol zëvendësues për të kryerën e thjeshtë apo të kryerën, koha e pakryer mund t'i paraqesë faktet apo ngjarjet e përfunduara, si të ishin mu në mes të procesit të tyre të zhvillimit. Për shëmbull:

- Dopo alcune ore, *moriva* tra le braccia dei suoi familiari.
- Pas disa orësh *vdiste* në krahët e familjarëve të tij.
- In quell'anno *nasceva* Leonardo, il geniale.
- Atë vit *lindte* Leonardoja, gjeniu.

Përveç stilit letrar, kjo formë foljore, që prej gjuhëtarëve italianë është quajtur edhe "E pakryera stilistikore" (*L'imperfetto stilistico*)⁹⁰, haset edhe në gjuhën gazetareske, në studimet historike, në fjalimet përkujtimore dhe në shumë raste të tjera. Është shumë e vështirë ta hasësh në gjuhën e folur të përditëshme.

Në gjuhën shqipe, të njëjtën formë mund ta gjejmë në shprehje të tipit:

- Sa herë që e *kujtonte*, ia *plaste* të qeshurit.
- Sa herë që e *shikonte*, "*vdiste*" nga frika.
- I dukej se po *rilindte* për së dyti etj.

⁸⁹ "Dizionario di Retorica e Stilistica", UTET, 2008, f. 273 – 277.

"La lingua italiana per stranieri", K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

"Grammatica per italiani maggiori", M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

"Grammatica italiana", A. Panzini, Sellerio Editore, 1982.

"Lingua, grammatica, stile", G. Tedeschi, Petrini, 1971.

"Guida allo studio della letteratura", R. Ceserani, Laterza, 1999.

"Analisi stilistica" A. B. Terracini, Feltrinelli, 1966.

"Dire, fare, capire", G. Bottiroli, D. Corno, T. De Mauro, Paravia, 1990. Etj.

⁹⁰ "Grammatica per italiani maggiori", M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

"Lingua, grammatica, stile", G. Tedeschi, Petrini, 1971.

"Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano", P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

Por në gjuhën shqipe do të ishte normale të zëvendësohej edhe me kushtoren, e cila në një rast të tillë merr gati-gati nuancat e një të ardhmeje në të shkuarën.

- Atë vit do të lindte Leonardoja, gjeniu.

Edhe më qartë vërehet në këto vargje të Ismail kadaresë:

Ata që *do të binin*, ndjenë vëndet e plagëve

Kush në brinjë,

Kush në ballë... (*Shqiponjat fluturojnë lart*, I. Kadare).

Qëllon ndonjëherë, që e pakryera të përftojë aspektin e një kohe përfektive.

“...L’illustre ospite *si recava* ieri in visita ufficiale presso il capo dello stato. Più tardi *s’intratteneva* in lungo e amichevole colloquio con il presidente del consiglio, e a sera *partecipava* a una seduta del parlamento..” (Il *Corriere della Sera*)

Teksti i mësipërm është shkëputur nga një gazetë italiane, “Il corriere della sera”. Për shkak të stilit informues të gjuhës së përdorur në shtyp, folja e vendosur në kohën e pakryer evokon veprime që ngjajnë si të përfunduara. E njejtat gjë, në situata të caktuara shprehimore mund të ndodhë edhe në tekste letrarë:

“...poco dopo *si apriva* una finestra sopra il suo capo e *vi compariva*, al chiaro di luna, il vecchio visetto del signor...” (*Piccolo mondo antico*, A. Fogazzaro, p. 13)

Konteksti i fjalisë ndihmon që folja të marrë nuancë përfektive.


Në gjuhën shqipe, e pakryera merr nuanca përfektive kur shoqërohet me pjesëzën “po”. P.sh.

Ujkun *po* e *qethnin* që t’i vinin mëndtë, ndërsa ai thoshte: “Shpejt se më ikën dhëntë”! (Fjalë e urtë, krahina Vlorë)

“...Fshatarët dalëngadalë zunë e *po* e *donin*, zunë e *po* e *fitonin* besën tek ai...” (Etja, P. Zheji, f 191)

“...*Po* i *kalonte* të shtatëdhjetat dhe nuk e kishte ndier përparimin e heshtur të viteve...Kundërshtimet *po kalonin* në zëmërim e në grindje...” (Ali Pashë Tepelena, S. Godo, f. 235)

Në rastin e formës perfektive me pjesëzën “po”, ligjëruesi vendoset brënda rrjedhës së veprimit dhe zhvendoset në kohë, sëbashku me ngjyrimin kohor të shprehur nga folja, apo së bashku me të gjitha nuancat aspektore, që mund të shprehen prej foljes.



V E P R I M I

E pakryera stilistikore “lind” shpesh nga një kundërshti kuptimesh, që krijohet midis kuptimit kontekstual të fjalisë, ose mesazhit dhe kuptimit aspektor të foljes në kohën e pakryer. Kështu për shëmbull:

“L’indomani, a mezzogiorno in punto, egli *usciva* dalla città” (Të nesërmen, fiks në mesditë, ai dilte nga qyteti)

Nga njëra anë, çasti i daljes nga qyteti, i personit për të cilin bëhet fjalë, është dhënë me saktësi të madhe, nga ana tjetër, koha e pakryer e përdorur te folja “*uscire*” e zgjat në kohë procesin e veprimit, nuk e përfundon atë dhe prej “kontrastit” të krijuar midis kuptimit të fjalisë dhe aspektit të foljes, “lind” ajo vlerë, që e bën të pakryerën të quhet stilistikore.

“Dopo essersi fermato un poco a Torino, egli *arrivava* a Milano proprio nel momento in cui si inaugurava la fiera”

Midis aspektit të formës foljore “*arrivava*” e cila shtrihet në kohë dhe nuk e përfundon veprimin dhe faktit që kuptimi kontekstual i fjalisë lë të kuptohet se ky veprim përfundon në çastin e inaugurimit të panairit, bën që vlerat e veçanta shprehimore me të cilat e pajis forma foljore krejt kontekstin, ta klasifikojnë këtë formë foljore, si të “pakryer stilistikore”.

Po kështu ndodh nëse themi:

“Due ore più tardi, Gianni *partiva* con il treno del pomeriggio”

“Tre ore più tardi, Gianni *scriveva* la lettera”, etj.

Midis çastit të saktësuar në kontekst dhe veprimit foljor të shtrirë në kohë dhe pa përfundim të së pakryerës të foljes, vihet re një “kontrast” aspektor, që i jep jetë të pakryerës stilistikore, apo siç mund të konsiderohet në një këndvështrim më të gjerë, të pakryerës rrëfimtare.

Brënda kuadrit të së pakryerës rrëfimtare, duhet klasifikuar edhe e “pakryera përshkruese”⁹¹, si një nuancë më e specifikuar e atyre rasteve, kur e pakryera përdoret nga shkrimtarët apo poetët, për të përgatitur me anë të një përshkrimi skenën, në të cilën do të ndodhin më pas ngjarjet. Gjithsesi, e “pakryera përshkruese” mund të përdoret çdo ditë edhe në gjuhën e folur, për të rrëfyer diçka që i ka ndodhur ligjëruesit. Fenomeni mund të vërehet si në gjuhën italiane, ashtu edhe në gjuhën shqipe, me të njëjtat vlera shprehimore.

“...Non *tirava* un alito di vento, il mare *giaceva* liscio e piano...*s’udiva* soltanto il fiotto lento delle onde infrangersi sulle ghiaie del lido ...” (La corona di Nana Sahib”, Luigi Motta, p. 223).

“All’uscita dello stadio c’era un ingorgo di macchine, terribile, non *si riusciva* a passare”

“Mëma e erës *kishte* ngritur një stan në Tepelenë. *Frynte* nga gryka e Këlcyrës, nga lugina e Dropullit, nga lumi i Bënçës, nga pllajat e maleve të zhveshura. Në atë qytet të vogël, me nëntëdhjetë shtëpi, erërat *flisnin* një gjuhë të përzier dhe *sillnin* lajme nga Stambolli, Korfuzi e Berati. (*Ali Pashë Tepelena*, S.Godo, f. 5)

“Ne e *dinim* që Niko Dabua *ishte* peshkatari më i mirë i fshatit; e *dinim* që Niko Dabua *ishte* më i fuqishmi i fshatit. E kishim parë disa herë të ecte me shpinën drejt, ndonëse *ishte* plak. Nuk *shikonte* mirë. Thuhej se i *kishte* sytë si të peshkut dhe vetëm në ujë *shikonte* edhe vrimën e gjilpërës...” (Shpella e piratëve, P. Marko, f. 5).

Pa dyshim, vlera të mirëfillta shprehimore ose stilistikore përfiton e pakryera në tekstet poetike. Në varësi edhe të çdo situatë shprehimore brënda të cilës përdoret, ajo shfaqet jo vetëm si kohë rrëfimtare, por edhe poetike. Kështu ndodh edhe me kohën e pakryer të përdorur nga poeti G. D’Anunzio, në poezinë e tij “La nonna” (“Gjyshja”).⁹²

⁹¹ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“*Lingua, grammatica, stile*”, G Tedeschi, Petrini, 1971.

⁹² U mendua të bëhej një ballafaqim midis të pakryerës prozaike, pra asaj të përdorur në gjuhën e folur dhe të shkruar, dhe të pakryerës së përdorur në gjuhën poetike, që na shfaqet edhe më e përpunuar. Veçanërisht kur

D'inverno *ti mettevi* una cuffietta,
Coi nastri bianchi come il tuo visitino.
E *facevi* ogni sera la calzetta,
Seduta al lume, accanto al tavolino.

Io imparavo la storia sacra in fretta
E poi m'*accoccolavo* a te vicino
Per sentirti narrar la favoletta
Del Drago Azzurro e di Guerin Meschino

E quando il sonno proprio *mi vinceva*
M'accompagnavi fino alla mia stanza
E *m'addormivi* al suono dei tuoi baci.

Nëpërmjet të pakryerës së dëftores, autori evokon një periudhë të jetës së tij, për të cilën ai ndien mall. Notat e përmallshme që shoqërojnë më pas krejt tekstin e poezisë, ndihet që krijojnë një atmosferë të ëmbël kujtimesh, për një periudhë kohore që nuk do të kthehet më. Megjithatë, për nga efektet që jep dhe nuancat që mbart, e pakryera e strofës së parë nuk sillet njëlloj si e pakryera e përdorur në strofën e dytë.

Në strofën e parë, është përdorur veta e dytë e të pakryerës dhe në sferën e kujtimeve të evokuara, koha e pakryer vendos raporte midis gjyshes –personazhit që nuk është më-, veprimi që kryhet dhe autorit të tekstit, që është edhe rrëfimtari. Në këto vargje, autori i drejtohet gjyshes së tij, sikur ajo të ishte ende e gjallë dhe e ulur diku pranë tij (veta e dytë, duke qënë një vetë kryesisht bashkëbisedimore, bën që të krijohet efekti, sikur personazhi të cilit i drejtohet autori të jetë diku aty pranë tij), ndaj edhe orientimi i lëvizjes së dhënë prej foljes, shkon -prej autorit, drejt gjyshes-, si figurë e mbetur e pranishme në kujtesë. Veprimi i përcjellë prej foljeve, shërben për ta ruajtur këtë figurë, të gjallë dhe në

vargjet janë të rimuara dhe pikërisht për shkak të shtrirjes së rimës në më shumë se një varg, të krijohet përshtypja se e pakryera tregon veprime dhe ngjarje edhe më të shtrira në kohë.

lëvizje, duke u kujdesur po për ato punë që janë të rrënjësura në kujtesën e rrëfimitarit dhe që i japin imazhit të gjyshes një prani të përhershme brënda në familje.

E pakryera e përdorur në foljet e strofës së dytë, nuk ka më natyrë dialogjike, por përfton ngjyrimet e një monologu, gjatë të cilit autori, nëpërmjet një sekuence të jetës së tij, përgjithëson dhe sjell ndër mënd i përmalluar, kënaqësitë e çasteve kur qëndronte pranë gjyshes. Veprimi i shprehur prej foljeve përmbushet prej vetë autorit dhe shtrirja e efektit të këtij veprimi përfshin krejt periudhën kohore, për të cilën folëm.

Statusi i nuancave që përcjellin format foljore, ndryshon përsëri në strofën e tretë. Edhe këtu e pakryera tregon shtrirje në kohë, por lëvizja drejtohet këtë herë me kah - prej gjyshes, drejt autorit-, duke krijuar edhe imazhin e një veprimi të përbashkët nëpërmjet formave foljore “*m’accompagnavi*” dhe “*m’addormivi*” (të dy, rrëfimtari dhe gjyshja e tij, të përjetësuar prej së pakryerës dhe imazheve të shprehura prej formave foljore).

5.9 Vlera të tjera të kohës së pakryer.

Koha e pakryer e mënyrës dëftore mund të shërbejë edhe për të tërhequr apo rikthyer vëmendjen e dëgjuesve, në ato çështje që ligjëruesi kumton. Në një rast të tillë, e pakryera merr vlera stilistikore tipike për gjuhën e folur, për dialogjet midis personazheve në një vepër letrare, apo për diskutimet rreth një tavoline të rrumbullakët, në rastin e një konference.

Mund të sjellim si shëmbull shprehje të tipit:

- *Volevo dire...* (*Doja të thoja*)

- *Avevo l’intenzione di...* (*Kisha për qëllim të...*)

-*Parlavo di...*(*Po flisja për...*) etj.

Me përdorimin e këtyre skemave të gatshme, duket sikur kumtuesi dëshiron t’i rikthehet edhe njëherë çështjes, apo të nënvizojë përfundimet, në të cilat do të dalë menjëherë më pas.

- *Dicevi ?...* (*Po thoje?...*)

Ndërsa në rastin e kësaj strukture tjetër dhe të ngjashmeve si kjo, ligjëruesi i drejtohet në mënyrë të drejtë për drejtë personave të tjerë, duke u përpjekur t'u tërheqë vëmëndjen.

Herë pas here, e pakryera vendoset pas një tjetër kohe të shkuar, për të treguar për shëmbull një maksimum të përgjithshme, ose një përfundim logjik të nxjerrë nga përvoja jetësore e ligjëruesit, që për shkak të natyrës universale që kanë, do të kishin dashur të tashmen e dëftores. Shëmbulli i mëposhtëm, i shkëputur prej “Princit” të Makiavelit, e vërteton më së miri këtë rast.

“...Disse di non essere sua intenzione trarre la libertà a quella città, ma rendergliene; perchè solo le città disunite *erano* (sono) serve, e le unite...libere.”

Koha e pakryer e foljes “*essere*”, në pjesën ku flitet për shtetet e përçara, tregon një realitet të kohës së shkuar, por meqënëse maksimumat nuk duhet ta humbasin vlerën e tyre me kalimin e kohës, përdorimi më i saktë do të ishte duke e vendosur foljen në kohën e tashme. Megjithatë, për shkak të mësimt që përçon, koha e pakryer duket sikur e tejkalon kohën që normalisht duhet të shprehë (të shkuarën) dhe përfshin në atë çfarë shprehet, nëpërmjet një jehone madhështie, deklarative, që buron prej strukturës së kontekstit, edhe “*të ardhmen*” kontekstuale, pra për pasojë edhe “*aktualen*”. Besnikëria e përcjelljes në gjuhën shqipe të kësaj kohe gramatikore, do të ishte tepër e vështirë, në mos e pamundur, për shkak se maksima do ta humbiste ngjyrimin e saj me vlera gjithëkohore. Në gjuhën shqipe fjalia do të tingëllonte pak a shumë kështu:

“...sepse vetëm qytetet e përçara *janë* shërbëtore.”

Mbajtja edhe në variantin shqip e të përkryerës së dëftores, do të bënte që fjalia ta humbiste vlerën e maksimumës, duke treguar thjesht një realitet të së shkuarës.

“...sepse vetëm qytetet e përçara *ishin* shërbëtore.”

Në gjuhën italiane, megjithëse zbehet, kjo vlerë nuk humbet.

Vlera shprehimore dhe stilistikore e kohës së pakryer, varet edhe nga pozicioni që zë folja në fjali. Ndodh që kur fjalia fillon me një folje të vendosur në kohën e pakryer, e gjithë fjalia të fitojë vlera shprehimore të veçanta:⁹³

⁹³ Në rastin e vlerave stilistikore të përfutuara nga vendosja e fjalëve në fjali, është sintaksa që i përcakton raportet midis kategorive gramatikore.

“*Temeva di essere rimproverato dalla mamma.*” (*Frikësohej mos e qortonte mamaja*)

“*Temeva il peggio*” (*I frikësohej më të keqes.*)

Në shëmbujt e mësipërm, më tepër se një zgjatje horizontale në kohë, e pakryera ndërron drejtimin duke shkuar në thellësi, shton intensitetin, pra bën një lëvizje të natyrës vertikale. Arsyeja kryesore e këtij drejtimi të ri që përfton lëvizja e veprimit, është vetë kuptimi i foljes “*Temere*”, ndërsa një arsye tjetër, është se ajo çka shpreh kjo folje, ka të bëjë me gjëndjen shpirtërore, pra me botën e brëndshme të individit, duke përfutur një lëvizje për në thellësi, vertikale. Sa më tepër ta shtrijë lëvizjen në kohë e pakryera e foljes “*temere*”, aq më në thellësi shkon.

Thellësia e shprehur nëpërmjet kohës së pakryer në italisht, në gjuhën shqipe jepet me një tjetër element; me përdorimin e vetvetores, e cila duke dhënë një gjëndje të brëndshme shpirtërore, ndjek të njëjtin kah si në variantin italisht, pra me lëvizje vertikale.

Gjithsesi ka një këndvështrim tjetër për të pakryerën në fjalinë e mëposhtme:

“*Camminava il ragazzo con piccoli passi di gloria.*”

“*Ecte djaloshi me hapa të vegjël lavdie*”

Në shëmbullin e mësipërm, gjuha poetike kumbon e plotë, e rrjedhshme, solemne. Përsëri koha e pakryer e dëftores i prin krejt fjalisë, por këtë herë roli i saj është muzikaliteti, lëvizja harmonike me ritmin e imazhit (në rastin tonë imazhi është djaloshi i vogël që zhvendoset duke ecur me hapa të vegjël) dhe përjetësimi i këtij çasti lavdie. Shpesh, e vendosur në krye të një vargu poetik, apo të një proze poetike, e pakryera e dëftores i jep tekstit një ritëm solemn. Zhvendosja e djaloshit duket sikur nuk ndalet, vijon përpara, gjithmonë përpara.

Të njëjtat vlera ruan ky përdorim edhe në gjuhën shqipe.

“*Vidi una fanciulla, che era bellissima*”

“*Pashë një vajzë, që ishte shumë e bukur*”

Fjalja e mësipërme nis me një të kryer të thjeshtë, që e vendosur mbi boshtin e kohës tregon një çast të vetëm, të përfunduar. Por e pakryera e foljes “*jam*”, tregon një segment kohor të shtrirë si përpara çastit të ligjërit, ashtu edhe mbrapa (*e bukur ishte, e*

bukur është). Madje e trajtuar me shrirjen që pëson veprimi drejt të ardhmes, folja në kohën e pakryer lë shijen se ajo vajzë do të jetë ende e bukur për shumë kohë.

Ndryshojnë marrëdhëniet kuptimore dhe interpretimi, nëse e rindërtojmë të njëjtën fjali, por tashmë jo me vartësi nënrenditëse, por me lidhje bashkërenditëse.

“Vidi una fanciulla ed *era* bellissima”

“Pashë një vajzë dhe *ishte* shumë e bukur”

Për shkak të raporteve të reja, të tipit bashkërenditës, që krijohen midis fjalive, e pakryera shpreh relativisht pothuajse të njëjtën periudhë kohore të së kryerës së thjeshtë. Shtrirja në kohë, për të cilën kemi folur, e të pakryerës, reflekton më tepër efektin e bukurisë, se sa kohën. Krijohet gjithashtu ideja se vajza “*ishte shumë e bukur*”, në çastin që e pa ligjëruesi, por ky i fundit nuk ka asnjë shpresë për ta vështruar edhe një herë.

Por le t’i rikthehemi për një çast stilit letrar. Megjithëse e pakryera e dëftores normalisht nuk tregon një të shkuar tepër të largët dhe këtë detyrë e marrin përsipër disa prej kohëve të tjera, në stilin letrar mund edhe ta ndryshojë këtë natyrë të saj dhe ta paraqesë një kohë si tepër të largët, madje duke i dhënë rrëfimit ngjyrat e një periudhe kohore që humbet e tretet nëpër vëndet më të largëta të kujtesës, apo duke i dhënë nuancat e gati një miti.

Ja si e nis Xhani Rodari njërin prej rrëfimeve të tij me titull “Pigmalione”.

“*Viveva* a Cipro, ai tempi delle favole antiche, un giovane scultore di nome Pigmalione. Egli *amava* la sua arte sopra ogni altra cosa al mondo.” (*I cinque libri*, G. Rodari, p. 465).

“Quando i cavatori gli *portavano* un nuovo blocco di marmo, *si metteva* a studiarlo, gli *girava* intorno accarezzandolo, *si domandava...*” (*I cinque libri*, G. Rodari, p. 465).

Atmosfera thuhet mitiko – solemne që i jepet rrëfimit të mësipërm, është rrjedhojë e përdorimit në mënyrë tërësore të kohës së pakryer, e cila e vendosur në vetën e tretë të numrit njëjës, e mbulon rrëfimin me një ritëm dhe një përumbje kohore, që vetëm në mitet epike mund ta gjesh. Ngjarjet vijnë si një jehonë e largët nëpërmjet kohës së pakryer.

E njëjta nuancë mund të vërehet edhe në gjuhën shqipe, natyrisht kur ndihmohet nga konteksti, si në shëmbujt e mëposhtëm:

“...Na *ishin* njëherë dy vasha, sa të bukura, aq të mira. *Duheshin* si motra; s’*ndaheshin* kurrë: bashkë në valle, bashkë për ujë, bashkë për thana, kudo. Njëra *kishte* një vëlla të hijshëm si veten, por më të gjatë, trim. Ky kishte shkuar të luftonte në ushtrinë e Skënderbeut...” (Tregime të moçme shqiptare, M. Kuteli, f. 214).

“...Në ato vite *dukej* sikur Aliu ishte reshtur. Mbase syrin nuk e *kishte* aq të fortë sa më parë, apo shpirti i tij i munduar *kërkonte* pajtim e prehje...” (Ali Pashë Tepelena, S. Godo, f. 242).

E pakryera nuk ka vetëm aftësinë të shfaqet me tiparet e një të shkuare shumë të largët, por edhe ta shtrijë një sekuencë kohore, përtej çdo kufiri që sekuenca do të përfshinte realisht.⁹⁴

Në tekstin e mëposhtëm, për shëmbull, krejt veprimet i referohen një situatë të vetme, por për shkak të përdorimit të disa foljeve në të pakryerën, të vendosura me intensitet njëra pas tjetrës, situata e evokuar në mesazh shtrihet përtej disa caqeve, që do të ishin kufijtë e saj normalë:

“...*Cercava* disperatamente di svignarsela, ora *allungava* il passo, ogni tanto *si fermava*, *diceva* una cosa qualunque agli altri; e intanto *sudava* freddo fin giù nei calcagni...” (*La corona di Nana Sahib*, L. Motta, 223)

Vendosja në seri e foljeve në shëmbullin e mësipërm dhe shtrirja kohore që shfaq koha e pakryer, krijojnë përshtypjen që autori ka dashur t’i bëjë më të gjata orët e vuajtjes.

Koha e pakryer e mënyrës dëftore shpesh merr vlera të veçanta kur përdoret në foljen “*essere*” (*jam*).⁹⁵

“La luna *era* là e *sapeva* la sua strada.”

“Hëna *ishte* (*ndodhej*) atje dhe e *dinte* vetë udhën.”

Folja “*essere*” në shëmbullin e mësipërm, është përdorur për të treguar ekzistencë, vëndëndodhje, prani. Folja në të pakryerën krijon idenë e pranisë së hënës në atë vënd, prej një periudhe relativisht të gjatë kohe, thua se ajo kishte kohë që priste atje. Gjithashtu edhe kuptimi i foljes “*sapere*”, i përpunuar me kohën e pakryer dhe brënda kontekstit të krejt fjalisë, krijon ngjyrimin e diçkaje që dihet prej kohësh (në rastin tonë të : *rrugës*)

⁹⁴ “*Dizionario di linguistica*”, Zanichelli, 1983, f. 145.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

⁹⁵ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinotto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

Pra koha e pakryer paraqet në mënyrë të përsëritur sekuenca kohore, kohëzgjatje, evokim ngjarjesh të largëta, ekzistencë, apo prani të diçkaje për një kohë të gjatë, etj. Të gjitha këto nuanca, të analizuara brënda kontekstit, e bëjnë ngjarjen, apo faktin e rrëfyer, të shtrihet në kohë dhe hapësirë në mënyrën sa me “reale” të mundshme. Por a ekziston skaji i kundërt?⁹⁶ A ekziston mundësia e të shprehurit me anë të gjuhës, që koha e pakryer të mos tregojë shtrirje kohore, por mbyllje, tkurrje, veprim që nuk ndodh? Në një rast të tillë e pakryera do të duhej ta paraqiste veprimin, ngjarjen, si të mohuar dhe interpretimi i kontekstit midis të ndodhurës dhe të pandodhurës do ta shpinte interpretuesin drejt abstragimeve gati të pamundura, për të përshkruar nuancat, që do të kumtonte folja e vendosur në kohën e pakryer. Një sfidë e tillë, në fakt, do të joshte çdo studiues.

Ndoshta mundësinë na e jep fjalja e mëposhtme, e shkëputur nga libri “*Il giro di vite*”. I shkrimtarit Henri Xhejms:

“...*Non erano mai opportuni, eppure non si mostravano mai sbadati...*”

“...*Nuk ishin kurrë të përshtatshëm, e pra nuk tregoheshin kurrë të shkujdesur...*”

Pjesëza mohore e përforcuar nga ndajfolja e kohës, që me kuptimin e saj semantiko-kontekstual përjashton praninë e çdo pjesëze sado të vogël kohe, brënda të cilës mund të kishte ndodhur fakti, bën që krejt kuptimi i mesazhit të vendoset në formën mohore. Çfarë vlere merr në një rast të tillë koha e pakryer e mënyrës dëftore? Folja tregon ekzistencë apo mosekzistencë?

Së bashku me elementët e pranishëm të formës mohore, folja tregon një gjëndje ose fakt që nuk ndodh. Përdorimi i kohës së pakryer, përforcon idenë se kjo gjëndje po zgjat dhe faktet janë të tilla prej shumë kohësh; pra faktet të cilat përmenden në kontekst nuk kanë ndodhur kurrë, të paktën për një kohë aq të gjatë, sa ç’mbahet mend.

Po ky autor, diku më poshtë shkruan:

“...*Mi muovevo in un mondo di loro invenzione...né loro avevano occasione di entrare nel mio...*”

“...*Po lëvizja në një botë të shpikur prej tyre...as ata kishin rast të hynin në timen...*”.

⁹⁶ Pyetja lind nga nevoja për të verifikuar nëse ekziston edhe një rast i kundërt, qoftë edhe si përjashtim. Për këtë është i nevojshëm të analizohet kuptimi kontekstual i krejt tekstit ose mesazhit dhe koha e pakryer të vërehet domosdoshmërisht brënda këtij konteksti.

Forma mohore e përdorur në fjalinë e dytë, tregon që fakti ka mbetur i tillë prej shumë kohësh, nuancë kjo, të cilën e mbart si vlerë shprehimore, në tekst, koha e pakryer.

Pra duke abstraguar deri në tejskaj, edhe kur ekzistenca apo gjëndja e një fakti mohohet, është pikërisht ky mohim që kthehet në fakt, ndërsa koha e pakryer qëndron atje për të dëshmuar që ngjarjet kanë rrjedhur në këtë mënyrë prej shumë kohe.

Duke mbetur në rolin e strukturës gjuhësore, për vlerat shprehimore ose stilistikore që mesazhi përcjell, është me interes të trajtohet edhe një strukturë stilistikore e veçantë.

Në veprat letrare, hasen shpesh ato që quhen monologje të brëndëshme, nëpërmjet të cilave, autori dëshiron t'i bëjë të ditur lexuesit, mendimet, meditimet, apo reflektimet e protagonistëve të zgjedhur prej tij. Nëpërmjet monologut të brëndshëm, autori mund të depërtojë në mëndjen dhe shpirtin e personazhit, t'ia shpalosë ato lexuesit, i cili e merr "informacionin" nëpërmjet vetë "gojës" së personazheve. Por këtij rasti të veçantë, për ta bërë sa më të besueshëm dhe për ta sjellë sa më pranë lexuesve, duhet t'i përgjigjet një strukturë gjuhësore po kaq e veçantë.

Në gjuhën italiane, edhe më përpara, por sidomos pas viteve '50 të shekullit të kaluar, po përdoret gjithmonë e më tepër ajo që gjuhëtarët e kanë quajtur "*Discorso indiretto libero*" (Ligjëratë e zhdrejtë, e lirë).⁹⁷ Karakteristikë e kësaj ligjërate, është përdorimi mjaft i madh i të pakryerës, të kryerës së plotë, si dhe një monolog i brëndshëm, ku ligjërimi përmban në vetvete, si karakteristika që i përkasin ligjëratës së drejtë, ashtu edhe karakteristika që i përkasin ligjëratës së zhdrejtë.

Shëmbulli i mëposhtëm është nxjerrë nga libri i F. De Robertos, "*L'illusione*":

"...*Se non l' amava ?! Se pensava ancora alla sua fidanzata morta?! Se aveva giurato di restar fedele alla memoria di lei?!...*"

"...*Nëse nuk e dashuronte?! Nëse mendonte ende për të fejuarën e tij të vdekur ?!...*"

Shëmbulli i sjellë në fjalinë e mësipërme, është një shëmbull tipik i ligjëratës së zhdrejtë, të lirë. Në kontekstin e sapo përmëndur, e pakryera mund të mos tregojë me patjetër një kohë të shkuar, ajo mund të tregojë edhe një të tashme, të ardhur prej brënda

⁹⁷ "*Dizionario di linguistica*", Zanichelli, 1983, f. 93 – 95.

"*Studi di stilistica*", G. Devoto, LeMonier, 1950.

"*Lo stile indiretto libero in italiano*", G. Herczeg, G. C. Sansoni, 1963.

ngjarjeve nga “zëri rrëfyes”, por që paraqitet me cilësitë e një “situate aktuale”, që po zgjat prej shumë kohe.

Po ky autor, më poshtë, vazhdon me të njëtin stil:

“...*Se egli soffriva ancora per la perdita amara, se ricordava sempre la sua povera morta, ella agognava di essergli amica, consolatrice, sorella del cuore. Un affetto puro, un sentimento incontaminato, nascosto gelosamente a tutti, non era ciò che più conveniva ad entrambi ?!... Lo amava d’amore!*”

Ligjërata e zhdrejtë , e lirë, në fragmentin e mësipërm, përmban gjykimin e protagonistes së librit, mendim ky që bazohet në faktet konkrete të rrëfyera prej autorit. Edhe me ndihmën e nuancave që përcjell e pakryera, krijohet njëfarë kalimi i gjykimit, nga shkrimtari te personazhi dhe anasjelltas: atë çfarë ndodh e tregon autori, pasojat e fakteve reflektohen në ndërgjegjen dhe botën e brendëshme të personazhit.

Përdorimi i kohës së pakryer tregon përsëri një tejzgjatje të situatës, si dhe faktin që protagonistin i bluan prej kohësh këto përjetime. Në fjalinë e fundit: “*Lo amava d’amore*”, e pakryera i jep faktit të shprehur një rëndësi kohore universale, njësoj sikur protagonistin të pohonte: “*E desha, e dua dhe do ta dua me gjithë dashurinë time.*” E pakryera e përfshin, në këtë mënyrë, krejt boshtin e kohës: të shkuarën, të tashmen, të ardhmen.

KREU 6: KOHA E KRYER DHE KOHA E KRYER E THJESHTË

Koha e kryer e thjeshtë dhe koha e kryer, përvçse janë kohë rrëfimtare, kanë edhe një përdorim mjaft të gjerë në gjuhën e shkruar dhe të folur, njëllon si koha e tashme dhe ajo e pakryer.

Që të dyja janë kohë të së shkuarës, por në ndryshim nga e pakryera (e cila, me ndonjë përjashtim, është kohë imperfektive), ato vendosin në qëndër të vëmëdjës përfundimin e veprimit, pa “e vështruar procesin e veprimit nga brënda” si në rastin e kohës së pakryer.⁹⁸Të dyja janë kohë me natyrë perfektive.

Me një analizë nxitimthi sipërfaqësore, dikush mund të mendojë që koha e kryer e thjeshtë përdoret për të treguar veprime apo fenomene të ndodhura shumë kohë më parë në raport me çastin e ligjërimin, ndërsa koha e kryer shërben për të treguar veprime të ndodhura vetëm pak kohë më parë⁹⁹, por nuk është plotësisht kështu.

Ndryshimi qëndron në mënyrën se si ne e perceptojmë kohën e kryerjes së një veprimi, në raport me kohën tonë të tashme. Kështu për shëmbull, nëse ne do të perceptojmë që një veprim i kryer në të shkuarën ka ende ndikim në të tashmen, do ta vendosim në kohën e kryer foljen që shpreh veprimin, si kohë më e përshtatshme për ta shprehur këtë perceptim.¹⁰⁰

Nëse ne e perceptojmë veprimin si plotësisht të përfunduar në të shkuarën dhe pa asnjë pasojë mbi rendin e gjërave në të tashmen, do të zgjedhim për ta vendosur foljen në të kryerën e thjeshtë.

Përsa i përket distancës kohore të kryerjes së veprimit nga çasti i ligjërimin, ky fakt nuk do parë në një kënd të ngushtë, bardh e zi. Për shëmbull:

⁹⁸ “*Grammatica italiana: italiano comune e lingua letteraria*”, L. Serianni, UTET, 1988.

“*Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*”, G. L. Beccaria, Einaudi, 1994.

“*Grande grammatica italiana di consultazione*”, A. Salvi, G. Cardinaletti, Il Mulino, 1995.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“*Grammatica italiana*”, A. Panzini, Sellerio Editore, 1982.

“*Grammatica per italiani maggiori*”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

“*Grammatica italiana*”, A. Panzini, Sellerio Editore, 1982.

⁹⁹ “*Grammatica italiana*”, G. Pittano, Bruno Mondadori, 1986.

¹⁰⁰ “*Grammatica avanzata della lingua italiana*”, S. Nocchi, R. Tartaglione, Alma Edizioni, 2006.

“Una settimana fa, all'improvviso gli *comparvero* sulla pelle delle strane macchie; ma dopo due giorni, come gli erano venute, così se ne *andarono*”.

“Një javë më parë, papritur ju shfaqën mbi lëkurë disa njolla të çuditëshme; por dy ditë më pas, siç i ishin shfaqur, ashtu ju zhdukën”

“L'uomo è *comparso* sulla terra più di centomila anni fa”.

“Njeriu është shfaqur mbi tokë më tepër se njëqind mijë vjetë më parë”

Po të analizojmë me kujdes dy shëmbujt e mësipërm, do të vërejmë që për ngjarje të ndodhura një javë më parë nga çasti i ligjërimit, është përdorur koha e kryer e thjeshtë, ndërsa për fakte të ndodhura qindra mijë vjetë më parë, është përdorur koha e kryer. Arsyeja qëndron në faktin se në rastin e parë bëhet fjalë për fenomene, të cilat pas dy ditësh nuk janë vërejtur më dhe nuk kanë patur asnjë pasojë për të tashmen.¹⁰¹ Ndërsa në shëmbullin e dytë, bëhet fjalë për qënien njerëzore, e cila u shfaq mbi tokë në kohëra prehistorike, që nuk mbahen mend, por që vazhdon ekzistencën e saj edhe sot e kësaj dite. Në fund të fundit, flitet për origjinën e të njëjtës krijesë, për origjinën tonë si njerëz.

Pra zgjedhja e të kryerës së thjeshtë apo të pakryerës nuk varet nga largësia kohore e kryerjes së veprimit me çastin e ligjërimit, por me efektin e tyre mbi të tashmen, nëse këto veprime kanë lënë gjurmë edhe në të tashmen ose jo.

Nëse do të dëshironim të zëvendësonim kohën e kryer, me kohën e kryer të thjeshtë, në shëmbullin e dytë, atëhere kontekstit të mesazhit do të duhej t'i ndryshonim disa elementë, ose një pjesë të informacionit, me qëllim për të krijuar një shkëputje nga e tashmja, të fakteve që janë vërejtur në atë periudhë.

“Quando l'uomo *apparve* sulla terra, era appena incominciata l'epoca del quaternario”

“Kur njeriu u *shfaq* mbi tokë, sapo kishte nisur epoka e kuartenarit”

Vërejmë që me ndryshimet e bëra, kemi një shkëputje të fakteve nga e tashmja, pasi bëhet fjalë për një epokë gjeologjike tashmë të përfunduar dhe pa efekte mbi të tashmen.

Në gjuhën italiane, ka raste kur përzgjedhja e njëres apo tjetres kohë është në varësi të qëllimit kumtues të ligjëruesit, ndërsa në raste të tjera është i detyrueshëm përdorimi i

¹⁰¹ “*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.

vetëm një rës prej kohëve, si në shembujt e mëposhtëm, ku përdorimi i kohës së kryer është i pazëvendësueshëm:

“Oggi Martina è *andata* bene a scuola”

“Finalmente *ho finito* il dottorato”

“Finora *hai fatto* quello che hai voluto”

(Në gjuhën shqipe, dy situatat e para mund të zgjidhen edhe me përdorimin e kohëve të tjera, ndërsa situata e tretë e ruan përdorimin e të kryerës, nëse duam të ruajmë nuancat shprehëse të mesazhit)

Arsyeja e përdorimit të kohës së kryer dhe jo e një kohe tjetër në gjuhën italiane, qëndron në praninë e ndajfoljeve të kohës: “*oggi*” (sot), “*finalmente*” (më së fundi), “*finora*” (deri tani), të cilat e lidhin qartazi veprimin me çastin e ligjërit.

Në raste të tjera, është i pranueshëm vetëm përdorimi i të kryerës së thjeshtë:

“Renzo, quando *vide* la capanna, *si fermò*, *si voltò* indietro e *disse* con voce tremante: “è qui”. (Kur pa kasollen, Renco u ndal, ktheu kokën pas dhe tha me zë të dredhur: “është këtu”

“Dopo la battaglia di..., Napoleone non *si rassegnò* all’idea che la sconfitta fosse definitiva” (Pas betejës të..., Napoleoni nuk u pajtua me idenë që humbja ishte përfundimtare)

Është i nevojshëm përdorimi i të kryerës së thjeshtë për të shprehur distancën kohore me të tashmen, si dhe për të ruajtur natyrën rrëfimore të pjesës dhe për ta shkëputur kontekstin nga çasti i ligjërit.

Megjithatë, janë të shumta rastet, që bëjnë të mundur përdorimin e të dyja kohëve:


“L’anno scorso *siamo andati* in vacanza, in Grecia.”

“L’anno scorso *andammo* in vacanza, in Grecia.”

6.1 Dallime shprehimore midis kohëve “të kryera” dhe kohës së pakryer.

Dallimet konceptuale “*kohë e pakryer, imperfektive*” dhe “*kohë të kryera, perfektive*” i kemi shprehur edhe më sipër, (Kreu 6, paragrafi 2); gjithsesi mbetet për t’u bërë edhe një analizë e fundit përsa i përket dallimeve, në raport me veprimin, të nuancave shprehimore që shpreh natyra e dy kohëve.

Në mënyrë skematike, kohën imperfektive të pakryer mund ta shprehim me një drejtëz, e cila do të simbolizonte zhvillimin e veprimit, pa skajet: fillimin dhe mbarimin; ndërsa veprimi i vendosur në një rën prej kohëve perfekte, e kryer e thjeshtë – e kryer, do të paraqitej me një segment, ku skajet e segmentit përfaqësojnë fillimin dhe përfundimin e veprimit.



Për nga përshtatshmëria që paraqesin, e pakryera shpreh një veprim të papërfunduar, apo që fillimi dhe përfundimi i të cilit është i pashprehur qartë dhe i papërcëktuar. Duke mbetur tek e pakryera, ajo “...*përshkruan vënde dhe personazhe, përcakton situatën e gjërave...*”¹⁰²

Kohët e kryera e japin veprimin jo vetëm të përfunduar, por për shkak se e japin të plotë, e shfaqin të gjithin njëherësh dhe disi të distancuar prej ligjëruesve.

Megjithatë, është i përhapur mendimi, se konceptet “*perfektiv*” dhe “*imperfektiv*” kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e veprimit. Në fakt nuk është plotësisht kështu: ajo që përcakton një kohë, nëse është perfektive apo imperfektive është faktori “*aspekt*”: “...*nëse*

¹⁰² *La nuova grammatica della lingua italiana*, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1997, f.345

*veprimi prezantohet në një çast të zhvillimit (imperfektiv), apo në kompletësinë e tij (perfektiv)...”.*¹⁰³

“Maria tornò a casa.” (Maria u kthye në shtëpi). Veprimi është tërësisht i përfunduar.

“Maria tornava a casa” (Maria {po} kthehej në shtëpi). Veprimi trajtohet si proces, në çastin e zhvillimit.

“Maria è tornata a casa” (Maria është kthyer në shtëpi) Vërehet që efekti i veprimit shtrihet edhe në të tashmen (kreu 6, f. 86).

Vlerat aspektore dalin edhe më mirë në pah, kur gjatë zhvillimit të një veprimi (ngjarjeje), ndërhyt një tjetër ngjarje, duke ndikuar në mënyrën si do të vazhdojë të zhvillohet veprimi:

“Maria tornava a casa, quando ha incontrato Marco” (Në gjuhën shqipe, situata kërkon që për foljen e dytë, të përdoret koha e kryer e thjeshtë)

“... Nëse analizohet procesi i një veprimi, nga mënyra si realizohet dhe jo nga vendosja në kohë e tij, atëherë në plan të parë nuk dalin vlerat kohore të foljes, por specifikat aspektore të përfutuara...”¹⁰⁴

“ Ieri, verso le 7.00, Marco *andava* a Campo dei Fiori.”

“Ieri, verso le 7.00, Marco *è andato* a Campo dei Fiori.”

... “Të dyja ngjarjet ndodhin në të njëjtin hark kohor, - pohon Bertinetto, - ndryshon vetëm “aspekti”, i cili dallohet qartazi prej referencës kohore...”¹⁰⁵ (Edhe kuptimi kontekstual në të dyja fjalitë është i njëjtë, ndryshon vetëm koha e foljes)

Përdorimi i kohës së kryer, ose asaj të pakryer, varet edhe nga faktorë të tjerë, gjithmonë në lidhje me vlerat shprehimore që ka për qëllim të kumtojë ligjëruesi, me vlerat stilistikore, ose vështruar në një kënd më të ngushtë, me vlerat aspektore, të cilat gjithashtu përkthehen në vlera shprehimore dhe stilistikore.


Kështu, nëse qëllimi i ligjëruesit është të kumtojë veprime të kryera njëra pas tjetrës dhe të përfunduara, atëherë është i detyruar të përdorë kohën e kryer:

¹⁰³ “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010, f. 65.

¹⁰⁴ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986, f. 77.

¹⁰⁵ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986, f. 77.

“ Ieri *ho mangiato* e poi *ho guardato* la TV”



Por nëse qëllimi i ligjëruesit është të kumtojë veprime të ndodhura paralelisht dhe me kohëzgjatje të papërcaktuar, atëherë do të përdorë të pakryerën :

“Mentre *mangiavo*, *guardavo* la TV.”



Përkundrazi, ndryshon sërishmi skema, nëse ligjëruesi dëshiron të ndërfitë një veprim brenda një tjetri.

“Mentre *mangiavo*, *è arrivato* Marco”

“*Mentre mangiavo*” është situata e qëndrueshme, në vazhdim, e pa përfunduar, “*è arrivato Marco*” është fakti që ndërhyt në situatën e mëparshme. Veprimi i dytë ka përfundim dhe kombinimi që del nga kjo ndërthurje situatash është përdorimi i dy kohëve në mesazh: e pakryera për të shprehur veprimin e parë dhe koha e kryer për të shprehur veprimin e dytë.



E pakryera përdoret mjaft shpesh e shoqëruar nga ndajfolja e kohës “*ndërsa*” (*mentre*), për të treguar që gjatë një veprimi në zhvillim e sipër, ndërhyt një tjetër fakt. Fakti që ndërhyt mund të jetë i kufizuar në kohë dhe me përfundim: në një rast të tillë përdoret koha e kryer (si më sipër). Por nëse ndodhia e dytë, që ndërhyt në situatën e parë, nuk është një veprim me përfundim, atëherë po për shkak të këtij mos përfundimi, nga ai çast e mbrapa do të kemi të bëjmë me dy veprime paralele dhe të dyja foljet do të përdoren në kohën e pakryer (imperfektive).

Mentre *mangiavo*, _____ situata paraprake
 Marco *bussava* alla porta _____ fakti që ndërhyt në
 situatë.

Veprime paralele


“*Ndërsa po haja, Marko trokiste në portë.*” (Në shqip situata nuk ndryshon)

Dhe së fundmi, nëse veprimet do të vinin njëri pas tjetrit, i dyti si pasojë e të parit dhe të dy me përfundim, atëherë do të përdorej koha e kryer në të dyja foljet që shprehin veprime.

“*Da quando è arrivato il nuovo professore, non abbiamo avuto pace.*”

“*Që kur ka ardhur profesori i ri, nuk kemi patur qetësi*”

Da quando è arrivato



Skema e mësipërme tregon që aty ku përfundon veprimi i parë, nis veprimi i dyti.

Në fakt mund të ketë disa ngjyrimë e nuanca, të dallueshme mes tyre, për të dhënë përfundimin e një veprimi.

“Siamo andati al cinema insieme” (kemi shkuar në kinema së bashku)



Veprimi i vajtjes në kinema ka përfunduar.

“Allora ho deciso di andare al cinema con lei” (veprimi në gjuhën shqipe jepet



Veprimi i vajtjes në kinema nuk ka përfunduar. me kohën e kryer të thjeshtë)

Siç e përmëndëm edhe më lart, koha e pakryer mund të paraqesë një veprim, që për shkak të përsëritjes ciklike, kthehet në zakon (kreu 5, 5.2). Sipas mënyrës aspektore të të konceptuarit, shpesh veprimi mund të paraqesë një veprim të kthyer në zakon, ose që përsëritet dhe për pasojë të përdoret koha e pakryer, ose koha e kryer.

“Da giovane, *andavo* spesso a ballare.” (I ri, *shkoja* shpesh të kërcëja)

“Da giovane, *sono andato* spesso a ballare.” (I ri, *kam shkuar* shpesh të kërcëj)

Nëse veprimi është përsëritur disa herë dhe më pas ndërpritet, atëhere me foljen përdoret vetëm koha e kryer.

“Da giovane, *sono andato* a ballare tre volte.”

Me kohën e kryer, veprimi foljor përfshin vetëm periudhën e kohës që na intereson, ndërsa me kohën e pakryer, veprimi foljor shtrihet në kohë dhe hapësirë.

“Nel 1990 *frequentavo* l’università” (Veprimi shtrihet përgjatë gjithë vitit, por nuk është e qartë nëse ishte kështu edhe një vit më parë, apo vazhdonte edhe një vit më pas)

“Nel 1990 *ho frequentato l’università*” (Veprimi mbase nuk shtrihet përgjatë gjithë vitit, por gjithsesi mbetet i kufizuar brënda atij viti.)

Me elementët ndajfoljorë që vendosin kufij kohorë “*nga*” , “*deri në*”, etj. përdorimi i kohës së kryer është i detyrueshëm (nuk mund të përdoret koha e pakryer) , sipas gramatikës italiane.¹⁰⁶

“*Ho fumato dai quindici, fino ai venti anni*”

Me kohën e kryer të thjeshtë, dallimet janë edhe më të qarta, për shkak se paraqet një kohë më të largët dhe mbi të gjitha pa asnjë efekt mbi të tashmen.¹⁰⁷ Mund të përdoret në të njëjtin mesazh më të pakryerën, për të treguar një veprim që vjen menjëherë më pas, duke e ndërprerë veprimin e parë brutalisht, ose në mënyrë të menjëhershme dhe të prerë.

“*Da giovane, andava spesso a ballare, ma smise dopo il matrimonio.*”

“*Nel 1990 frequentava l’università, ma finì gli studi nello stesso anno*”

6.2 Koha e kryer e dëftores.

Koha e kryer e mënyrës dëftore bën pjesë në serinë e kohëve që evokojnë një çast të së shkuarës. Të gjitha gramatikat e gjuhës italiane, japin përkufizime, të cilat mund të përmbliidhen në atë që: “koha e kryer shpreh, sipas rastit, një veprim, ose gjëndje të përmbushur në të shkuarën, por që ka ruajtur një marrëdhënie me kohën e tashme, ose me çastin e ligjërit.¹⁰⁸

Kjo marrëdhënie me të tashmen ka të bëjë:

¹⁰⁶ “*Grammatica avanzata della lingua italiana*”, S. Nocchi, R. Tartaglione, Alma Edizioni, 2006.

¹⁰⁷ “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“*La nuova grammatica della lingua italiana*”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1997.

¹⁰⁸ “*Grammatica italiana: italiano comune e lingua letteraria*”, L. Serianni, UTET, 1988.

“*Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*”, G. L. Beccaria, Einaudi, 1994.

“*Grande grammatica italiana di consultazione*”, A. Salvi, G. Cardinaletti, Il Mulino, 1995.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“*Grammatica italiana*”, A. Panzini, Sellerio Editore, 1982.

“*Grammatica per italiani maggiori*”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

“*Grammatica italiana*”, G. Pittano, Bruno Mondadori, 1986.

A – me kohën e shkurtër që ka kaluar nga çasti kur ka ndodhur veprimi deri në çastin e ligjërit;

B – me shtrirjen e efekteve të veprimit edhe në çastin e ligjërit;

C – me shtrirjen dhe vazhdimin e veprimit edhe në çastin e ligjërit.

a - “*Ho visto* i servi stamane quando facevano le loro ricerche, *hanno aperto* la porta della costruzione dei balnea e *hanno dato* un’occhiata intorno, senza frugare oltre...” (*Il nome della rosa*, U. Eco, p. 258)

b – *E’ andato* a caccia in una podagra e *ha preso* la malaria.” (*Guida alla pratica della creatività*, A. Rossetto, p. 80)

c – “*Ho scoperto* che un’idea del genere l’aveva avuta da qualche parte Chesterton...” (*Il nome della rosa*, U. Eco. p. 533)

a – Natës qershorit, hëna sa *ka dalë*,

Ne krah-për-krah shtektojmë prej qyteti

Rrugën e madhe marrim së rëpjeti

Te kodra jonë ngjitemi ngadalë.(*Sonete*, E. Çabej, f. 20)

b – Homo sapiens–i bën përjashtim: ai *ka arritur* të shkojë shumë më larg numrit të disa qindra individëve. Për të mbajtur të bashkuar grupin e vet shoqëror, për të mbushur hendekun e hapur nga zhvillimi që *ka depërtuar* dramën e mërrëdhënieve shoqërore, ai *ka shpikur* ligjërimin...” (*Fjalët e Ajnshtajnit*, D.Gouthier, E. Ioli, f. 45)

c – Në mes tuaj *kam qëndruar*

dhe jam duke u përvëluar... (*Fjalët e qiririt*, N. Frashëri)

Siç shihet, në rastin e kohës së kryer, ndërhyr vazhdimisht perceptimi i kohës së tashme, si çast ligjërimi, megjithëse nuk ndodh vazhdimisht kështu. Le të analizojmë dy shëmbujt e mëposhtëm:

“Il bambino *ha mangiato* il gelato da dieci minuti”

“Il bambino *ha mangiato* il gelato dieci minuti prima.”

Në rastin e parë, me shprehjen ndajfoljore (*da dieci minuti* – prej dhjetë minutash), ligjëruesi ka për qëllim të masë periudhën kohore nga përfundimi i veprimit deri në çastin e ligjërimit. Ndërsa në shëmbullin e dytë, perceptohet intervali kohor nga përfundimi i veprimit, deri në një tjetër çast, të pa përcaktuar qartë.

“Il bambino *ha mangiato* il gelato dieci minuti prima che io arrivassi. Io *sono arrivato* alle 10.00. Dunque, il bambino *ha mangiato* il gelato dieci minuti prima delle 10.00.”(Djali i vogël e *ka ngrënë* akulloren 10 minuta para se të vija unë. Unë *kam ardhur* në orën 10.00. Pra djali i vogël e *ka ngrënë* akulloren dhjetë minuta para orës 10.00)

6.3 Përdorime deiktike të kohës së kryer.

Me shumë ngjashmëri në gjuhët italiane dhe shqipe, koha e kryer gjen përdorim si në format deiktike, ashtu edhe në ato jo deiktike. Kur flasim për përdorimet deiktike të kohës së kryer, elementi më i rëndësishëm në këtë kuadër mbetet vlera konotative, e “*qëndryshmërisë në kohë të rezultatit të një veprimi.*”¹⁰⁹

“*Ho comprato questa casa alcuni anni fa.*” (Veprimi i kryer paraqet si rezultat pronësinë e ligjëruesit mbi shtëpinë. Ligjëruesi mbetet pronar i shtëpisë edhe në çastin e ligjërimit, disa vjetë pas kryerjes së veprimit.)

“*E kam blerë këtë shtëpi, disa vite më parë.*” (Edhe në variantin shqip kemi situatë të njëjtë)

“*Dove hai trovato questa macchina? Sembra un pezzo rarissimo.*” (Ligjëruesi tregon objektin për të cilin bëhet fjalë, ndërsa fakti për të cilin flitet, nuk ka gjasa të ndryshojë më)

“*Ku e ke gjetur këtë makinë? Duket një objekt shumë i rrallë.*” (E njëjta situatë vërehet edhe në gjuhën shqipe)

“*Sono nato il 30 settembre 1967*” (Fakti për të cilin flet ligjëruesi nuk mund të ndryshohet më, periudha kohore është e përcaktuar prej kontekstit)

¹⁰⁹ “*Analisi grammaticale dei due tempi passati nell’italiano contemporaneo: passato remoto e passato prossimo*”, B. Esskali, Scholarly Paper, 2002, f. 8 -9.

“*Kam lindur më 30 shtator 1967*” (Përsëri në gjuhën shqipe, nuanca konotative mbetet e pandryshueshme).

Në të gjithë shëmbujt e mësipërm nuk ka përmbysje raportesh kohore ndërmjet faktit të ndodhur dhe çastit të ligjërimit. Ajo çfarë në të vërtetë bie në sy, është rëndësia që ka ky fakt, për ligjëruesin. Elementi deiktik, “*questa*”(këtë) i pranishëm në dy shëmbujt e parë, dëshmon për praninë e objektit, diku afër ligjëruesit.

Ndërkaq, në shëmbullin e tretë, vërejmë rëndësinë që ka për ligjëruesin, fakti të cilit ai i referohet, megjithëse realizimi material nuk vazhdon më: “*Kam lindur më...*” (një herë ka lindur, por rëndësia e asaj ngjarjeje mbetet po e njëjtë për ligjëruesin). Rëndësia që i jepet, ka të bëjë më tepër me vazhdimësinë psikologjike, apo me pasojën psikologjike të faktit, të cilit i referohemi, se sa me vazhdimësinë në kohë dhe hapësirë të të njëjtit fakt.

Në një analizë më të thelluar, bëhet krejtësisht e qartë domosdoshmëria e përdorimit të kohës së kryer, kur fakti apo ngjarja e ndodhur kanë rëndësi për ligjëruesin apo çastin e ligjërimit, pavarësisht nëse veprimi ka ndodhur në një të shkuar të largët, në raport me këtë çast, apo në një të shkuar të afërt. Por nëse konsiderojmë të rëndësishëm një fakt të ndodhur në të shkuarën e largët, është edhe më e kuptueshme të quajmë të rëndësishëm një fakt të ndodhur në të shkuarën e afërt. Për shëmbull:

“Un po’ tardi per incontrarlo: il professore è *partito* cinque minuti fa”

“Pakëz vonë për ta takuar: profesori është *nisur* pesë minuta më parë”

“*Ho parlato* con lui, prima di incontrare te”

“*Kam folur* me atë, para se të të takoja ty”

Në fakt, është pothuajse i detyrueshëm përdorimi i kohës së kryer, për të kumtuar një lajm që sapo ka ndodhur, ose të sapo njoftuar nga organet e shqypit.

“Che cos’è *successo*?” “*E’ caduto* il governo!”

“Çfarë ka ndodhur?” “*Ka rënë* qeveria!”

Kjo formë gjen përdorim të gjerë sidomos në lajmet radiotelevizive, në titujt e gazetave, në stilin telegrafik, në komunikimet zyrtare, etj. Në gjuhën italiane mund të përdoret edhe si formë eklitike stili për mbajtjen e një ditari, duke përdorur vetëm pjesoren dhe jo foljen ndihmëse “kam”, ose “jam”. Për shëmbull:

“...Entrato in un bar.....preso un caffè e ascoltato musica...visto molta gente...deciso di tornare di nuovo domani...”

Një tjetër përdorim karakteristik për kohën e kryer të mënyrës dëftore, është ai që në italisht njihet me termin “esperienziale” (që buron prej eksperiencave),¹¹⁰ dhe që ka të bëjë me rrëfimin e eksperiencave personale, apo të eksperiencave të tjerëve, të ndodhura të paktën njëherë në të shkuarën.

“*Ho conosciuto altri italiani*” (Kam njohur italianë të tjerë)

“*Marco ha camminato 20 km in una giornata*” (Marko ka ecur 20 km në ditë)

“*Da giovane ho lavorato fino a mezzanotte*” (Kur isha i ri, kam punuar deri në mesnatë)

Shëmbulli i mësipërm mund të zgjidhet edhe duke përdorur kohën e pakryer, nëse qëllimi i folësit do të ishte të kumtonte periudhën e gjatë kohore, në të cilën ai ka punuar deri në mesnatë dhe jo faktin që: “*ka punuar deri në mesnatë*” kur ishte i ri. Gjithsesi, një nuancë e lehtë e pranisë të “shtrirjes në kohë” nuk i shpëton as konteksteve, në të cilat është përdorur e kryera.

Megjithatë nuk mund të merren si të ndërtuara me nuanca rrëfimtare, të nxjerra prej eksperiencave, rastet kur shprehemi:

“*Non ho ancora dormito, lasciami in pace*”

“*Tra le 8.00 e le 9.00 non ho lavorato, perciò dimmi cosa posso fare*”

Dallimi qëndron në strukturat e ndryshme të sasisë kohore të marra në shqyrtim. Në shëmbullin e parë, shtrirja kohore është e matshme, me një shifër që shkon afër zeros, për shkak se koha për të cilën flitet: *në rradhë të parë është krejtësisht individuale* dhe në rradhë të dytë, *ka një shtrirje kohore të papërfillshme*. Ndërsa në shëmbullin e dytë kemi një interval kohor jo vetëm të matshëm, por edhe të përcaktuar në kontekst

Gjithsesi, kufijtë e përdorimit të kohës së kryer me ngjyrimet *eksperienciale* nuk janë të përcaktuar qartazi edhe për shkak të ndërhyrjes, herë pa here, të një tjetër nuance, asaj të “*përsëritjes së një veprimi të kthyer në zakon*”. Psh.

¹¹⁰ Termi është huazuar prej disiplinave didaktike. Në përdorimin e kohës së kryer, ka të bëjë me qëndrimin e folësit përkundrejt eksperiencave të veta apo të tjerëve: duke përdorur kohën e kryer (prania e foljeve ndihmëse) vendoset një raport më i ngushtë midis ngjarjes apo veprimit dhe personit që e ka kryer, me referime më të drejtë për drejta (*kam, jam, etj.*)

“Ogni volta che ho chiesto informazioni, mi è stato risposto evasivamente”

“Sa herë që kam kërkuar informacion, më janë përgjigjur në mënyrë jo të qartë”

Nëse analizojmë shëmbujt e mësipërm, do të vërejmë që konteksti i fjalisë shpreh qoftë një eksperiencë të ligjëruetit, ashtu edhe një veprim të kthyer në zakon. Dominante është nuanca e dytë edhe pse e gjitha kjo kumtuesit i shërben si eksperiencë.

Në disa raste, e kryera që tregon eksperiencë mund të zëvendësohet edhe nga e kryera e thjeshtë, por me ndryshime nuancore:

“Arben *fu* quattro volte in Italia” (Arbeni qe katër herë në Itali)

Në shëmbullin e mësipërm, numri i intervaleve kohore mund të konsiderohet i mbyllur. Edhe kuptimi kontekstual, për shkak të nuancës përmbyllëse që mban, nuk lejon të mendohet për udhëtime të tjera drejt Italisë, madje komunikimi që realizohet nënkupton faktin që nuk do të ketë udhëtime të tjera.

Krejt ndryshe qëndron çështja, nëse në vënd të kryerës së thjeshtë, të përdorim kohën e kryer. Kuptimet kontekstuale ndryshojnë:

“Arben è stato quattro volte in Italia” (Arbeni ka qënë katër herë në Itali)

Konteksti i fjalisë e trajton çështjen e udhëtimeve të Arbenit si eksperiencë të tijën dhe lë të hapur mundësinë që ai mund të shkojë edhe herë të tjera në Itali.

Ka raste, kur në rrethana të veçanta, koha e kryer mund të përftojë vlerat e një kohe imperfektive. Ndodh diçka e tillë, veçanërisht kur veprimi përfundon në çastin e ligjërimin. Meqënëse në përdorimet diektike, çasti i kryerjes së një veprimi, shpesh koinçidon me çastin e ligjërimin, qëllon që çasti i kryerjes së veprimit edhe ta tejkalojë çastin e ligjërimin. Bëhet fjalë për nuancën e “*përfshirjes*”, të vërejtur shpesh në kohët e përbëra, një nuancë kjo e konsideruar si përjashtim. Nuanca e “*përfshirjes*”, nënkupton kuptimin kontekstual, sipas të cilit jo vetëm rezultati apo efektet e veprimit (shiko: 6.2, B.), por edhe vetë veprimi përfshin çastin e ligjërimin.



Në raste të tilla, përdorimi i të kryerës së thjeshtë, përjashtohet:

“Negli ultimi mesi, Marco *ha vissuto* vicino a noi”

“Në muajt e fundit, Marko *ka jetuar* pranë nesh”

“Le donne italiane, *hanno portato* sempre con sé i costumi del loro paese”

“Gratë italiane, i *kanë mbajtur* gjithmonë zakonet e vendit të tyre.”

Mjaft shpesh, e kryera përfshirëse shoqërohet nga ndajfolje ose shprehje ndajfoljore që tregojnë kohë dhe që kanë të bëjnë qartazi me çastin e ligjërit. ¹¹¹ Ky përdorim e ndan në mënyrë të qartë nuancën përfshirëse nga nuanca të tjera që shfaq koha e kryer dhe në veçanti nga nuanca e “eksperiencës”. Për shëmbull:

Përfshirëse : “*Finora ho abitato* a Parigi” (Deri tani kam banuar në Paris).

Eksperiencë : “*Ho abitato* a Parigi” (Kam banuar në Paris)

Shprehja ndajfoljore “*deri tani*” përfshin edhe çastin e ligjërit, ndërsa në shëmbullin e dytë, informacioni kumtohet si eksperiencë. Gjithshka varet, në fakt, nga këndvështrimi i kumtuesit për atë çfarë kumton.

Gjithsesi, ekzistojnë rrethana, në të cilat shprehja ndajfoljore mund të rezultojë jo e qartë, siç është edhe rasti i mëposhtëm:

“*Ho già passato* tre anni all'estero.”

Prej interpretimit që ligjëruesi i bën ndajfoljes “*gia*”, varet edhe fakti nëse informacioni i dhënë do të interpretohet si përmbyllës apo eksperiencë.

Eksperiencë : “Kam kaluar tashmë tre vjetë jashtë shtetit”

Përfshirëse : “Tashmë i kam kaluar tre vjetë jashtë shtetit”

¹¹¹ “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010

“*Grammatica italiana con nozioni di linguistica*”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995.

6.4 Nuanca jo-deiktike të kohës së kryer.

Kur përdorim kohën e kryer, jo gjithmonë koha e kryerjes së një veprimi është e lidhur me çastin e ligjërimit. Kjo ndodh kur koha e kryer, ka për qëllim të tregojë një kohë më të hershme, në raport me të tjera ngjarje, për të cilat bëhet fjalë në një kontekst.

Rastet më të qarta janë ato, kur veprimi në kohën e kryer varet nga një tjetër veprim në kohën e ardhme të thjeshtë, ose nga një veprim i vendosur në kohën e tashme, me nuanca të së ardhmes.¹¹²

“Quando vedrai Marco, digli che *sei venuto*” (Kur të shikosh Markon thuaji që *ke ardhur*).

“Soltanto fra un mese sarà possibile capire chi *ha avuto* ragione” (Vetëm pas një muaji do të jetë e mundur për t’u kuptuar kush *ka patur* të drejtë).


Në shëmbullin e parë, çasti i ligjërimit varet nga rrethana të natyrës pragmatike. Veprimi që pritët të ndodhë në të ardhmen dhe që në gjuhën shqipe shprehet me të tashmen e lidhore, mund të realizohet edhe pas një intervali kohor shumë të shkurtër, menjëherë pas ligjërimit. Gjithshka ka të bëjë në fakt, me largësinë në hapësirë dhe vëndin në të cilin ndodhet Marko, në raport me bashkëbiseduesin e ligjëruesit. Nëse Marko ndodhet në një tjetër vënd, larg bashkëbiseduesit, veprimi i dytë do të ndodhë në të ardhmen, pa u përcaktuar saktësisht çasti; nëse ndodhet diku afër, çasti i përmbushjes së veprimit të dytë mund të jetë shumë afër çastit të ligjërimit.

Gjithsesi është me vënd të bëhet një dallim i qartë midis përmbushjes së një veprimi dhe kohës së shkuar të kryerjes së veprimit.¹¹³ Të dyja nuancat mund të qëndrojnë së bashku, pa kundërshtuar njëra tjetrën. Në shëmbullin e parë, veprimi i dytë (*sei venuto*), kryhet përpara veprimit (*vedrai*), pra përmbushja e veprimit, në gjuhën italiane, shprehet me kohën e kryer, edhe pse referimi (bërja e ditur)i këtij veprimi do të ndodhë në të ardhmen e çastit të kryerjes.

¹¹² “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986, f. 420.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

¹¹³ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986, f. 421.



Në gjuhën shqipe, situata zgjidhet me përdorimin e kohës së tashme të mënyrës dëftore, duke e shprehur, ndoshta më mirë se varianti italisht, pasigurinë e çastit kur do të bëhet i ditur veprimi (kur do të shikojë Markon), por edhe faktin që ky veprim (takimi me Markon) mund të ndodhë pak çaste më pas, thuajse në të tashmen.

Në shëmbullin e dytë, koha e verifikimit dhe e impaktit të efekteve të veprimit të parë, është saktësisht e përcaktuar me shprehjen ndajfoljore (*fra un mese*). Në variantin shqip të të njëjtit shëmbull, vërejmë që kohët e përdorura janë po ato, pasi këtë herë kemi saktësi (dhe për pasojë edhe siguri më të madhe që veprimi i parashikuar do të ndodhë) kohore.


Nëse krahasojmë nuancat kontekstuale të dy shëmbujve të mësipërm, me nuancat kontekstuale të fjalisë së mëposhtme:

“In seguito, Marco *ha fatto* tesoro di quell’esperienza”

“Më pas, Markos i *ka vlejtur* ajo eksperiencë”,

do të vërejmë që edhe këtu është e pranishme nuanca e të ardhmes, por si e “*ardhme në të shkuarën*”¹¹⁴

Ngjarja 1 *ha fatto tesoro*



Elementët leksikorë, gramatikorë dhe semantikorë, që e përcaktojnë këtë nuancë, janë mjaft të qartë. Efektet e veprimit nuk mund të realizohen në të ardhmen reale, por janë

¹¹⁴ “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“*Grammatica per italiani maggiori*”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989”.

realizuar në një të ardhme të së shkuarës (përkundrejt një tjetër veprimi të ndodhur më parë) dhe veprimi është përmbushur bashkë me efektet e tij.

Nuancë krejt tjetër kumton shëmbulli i mëposhtëm:

“Quando Marco incontrerà la ragazza che è appena *uscita* dalla facoltà, se ne innamorerà.”

“Kur Marko të takojë vajzën që sapo *ka dalë* nga fakulteti, do të bjerë në dashuri.”


Megjithëse kemi të bëjmë me një veprim që pritet të verifikohet në të ardhmen, nuanca kontekstuale është ajo e vazhdimësisë dhe jo ajo e të ardhmes. Në gjuhën shqipe, njëra nga foljet e variantit italisht (*incontrerà*) e vendosur në të ardhmen e thjeshtë, përkthehet përsëri me të tashmen e mënyrës lidhore, edhe këtë herë për shkak të mos saktësisht të intervalit kohor nga ligjëruesi.

Në të tjera raste, nuanca e të ardhmes shprehet edhe me kombinimin e kohës së ardhme të thjeshtë me kohën e kryer, si dhe me përdorimin e një ndajfoljeje kohe, që i vendos veprimet qartësisht njëra pas tjetrës.

“Ti *raggiungerò* dopo che tu *sei uscito*” (mënyra e përdorimit të këtyre formave foljore është karakteristikë e gjuhës së folur).

“Do të të mbërrij, pasi të kesh dalë” (në shqip përdoret detyrimisht mënyra lidhore).

Të dyja veprimet do të ndodhin pas çastit të ligjërimit. Veprimi i parë është i shprehur në fjalinë e varur me një folje të vendosur në kohën e kryer, ndërsa veprimi që do të ndodhë më pas është i shprehur në fjalinë kryesore me një folje në të ardhmen. Të dyja veprimet, në fakt, ndodhin në të ardhmen e çastit të ligjërimit.




Edhe ne këtë rast, gjuha shqipe vazhdon ta zgjidhë situatën me përdorimin e të tashmes të lidhore, për shkak të mos përcaktimit të saktë kohor.

Raporti kohor i një veprimi më të hershëm dhe i një tjetri më të vonë përkundrejt të parit, mund të shprehet me disa mënyra, duke na paraqitur variacione nuancash:

1 – Nuanca e një veprimi më të hershëm shprehet me kombinimin e kohës së kryer, me kohën më se të kryer, të dëftores.¹¹⁵


“Ti avevo detto che *ha studiato*” (Të kisha thënë që ka studiuar)



2 – Nuanca e një veprimi më të hershëm shprehet me përdorimin e dy kohëve të kryera:¹¹⁶

“Marco *ha parlato* dopo che tu *sei allontanato*”

Përcjellja e formës foljore “*sei allontanato*” në gjuhën shqipe, zgjidhet me përdorimin e kohës të kryer të thjeshtë : “*u largove*”



Në këtë rast, vetëm veprimi i shprehur me kohën e kryer “*ha parlato*” ka të bëjë me çastin e ligjëritimit dhe shërben si ndërmjetës për të shprehur krejt vendosjen në kohë të mesazhit.

3 – Nuanca e një veprimi më të hershëm mund të shprehet edhe me kombinimin: e tashme historike dhe e kryer.¹¹⁷

“Quella mattina, Marco non *si sente* bene; la sera precedente *ha ecceduto* nel bere”


¹¹⁵ “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

¹¹⁶ “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

¹¹⁷ “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“Atë mëngjes, Marko nuk ndjehet mirë; një mbrëmje më parë e ka *tepruar* me të pirë”

Shprehja ndajfoljore “*Quella mattina*”, e dërgon në të shkuarën të gjithë mesazhin që vjen pas. Për këtë arsye, forma foljore “*si sente*” përfton natyrën e një të tashmeje historike, ndërsa folja e dytë është vendosur në kohën e kryer. Ka një farë përcaktimi kohor në rrjedhën e ngjarjeve dhe për këtë arsye vërehet përdorimi i të njëjtave kohë foljore në variantin shqip të mesazhit. Skema e renditjes së veprimeve është si më poshtë:



Siç edhe vërehet, i gjithë konteksti i mesazhit i përket të shkuarës dhe vendosja e një veprimi në të ardhmen, përkundrajt një tjetër ngjarjeje, ambientohet tërësisht në kohën e shkuar, ndërsa koha e tashme është e njëjtë me çastin e ligjërit.

Në disa përdorime të gjuhës së folur italiane, për të shprehur një të ardhme shumë të afërt, folësi mund të përdorë kohën e kryer, për t'i dhënë mesazhit nuancat e një fakti që do të ndodhë me pa tjetër (vërtetësia e të cilit është jashtë çdo dyshimi).¹¹⁸ Për shëmbull në dialogje të llojit:

- Quando sarete qua ?
- Prima di sera *siamo arrivati!*

Konteksti i dialogut lejon të përdoret kjo formë stilistikore në gjuhën e folur, për të komunikuar nuancën : “*quaje punë të mbaruar*: - zëre që kemi arritur (do të mbërrijmë) përpara mbrëmjes”

Në gjuhën shqipe mund të përdoret në gjuhën e folur, për shëmbull kur bëhet fjalë për vëndmbërritjen, pas një udhëtimi, të cilin folësi kërkon ta kumtojë si diçka të sigurtë, të kryer e të mbaruar.

- Në mëngjes kemi mbërritur në Sarandë, quaje punë të mbaruar!

¹¹⁸ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986, f. 425.

-Në të perënduar kemi kaluar atë qafën e malit atje tutje dhe pastaj vetëm një e përpjetë na mbetet!

6.5 E kryera “jashtëkohore”

Koha e kryer e mënyrës dëftore mund të shfaqet edhe me nuanca “jashtëkohore”, njësoj si koha e tashme e mënyrës dëftore (kreu 4, 4.4). Me këtë nuancë mund të shfaqet në tekstet e shkruara me natyrë shkencore, filozofike, në esé, në disa prej llojeve të teksteve burokratike, etj.¹¹⁹

“... La colonna vertebrale è *costituita* da una serie di 33 – 34 vertebre...”

“... Il metodo mitico è *costruito* secondo una tecnica particolare...”

“... Historia e qënies njerëzore *ka ndjekur* një rrugë të ndryshme nga ajo e shumë qenieve të tjera...”

Në formula gjuhësore, të llojit:

“...Come *si è sempre detto* ...” ; “...*Abbiamo già notato* che...”, “*Abbiamo osservato*...”, etj.,¹²⁰

mënyra e ndërtimit të së “kryerës jashtëkohore”, nuk ndryshon prej mënyrës së ndërtimit të së “tashmes jashtëkohore”, madje mund të themi, që shprehje të tilla e përfshijnë deri në njëfarë mase çastin e ligjërit.

Pra njësoj si e tashmja, e kryera, me anë të këtyre përdorimeve, përpiqet të fiksojë një çast të ligjërit.

Përtej këtyre skemave, e kryera jashtëkohore haset edhe në kontekste të tipit:

¹¹⁹ M. Dardano dhe P. Trifone i trajtojnë këto raste të kohës së kryer, me nuanca që zgjasin në kohë, ose si gjithëkohore: “*Grammatica italiana con nozioni di linguistica*”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995, f 352 – 360. Gjithsesi, mendojmë që duke mos pasur një referencë të përcaktuar kohore, veprimi duket sikur del jashtë kohe (nisur edhe nga modeli i të vërtetave shkencore, “të vërtetave” me natyrë filozofike, etj.

¹²⁰ Kemi arritur në këto përfundime teorike, pasi është vërejtur përdorimi i këtyre shëmbujve rëndom në gjuhën italiane të folur e të shkruar.

“Una persona che *ha studiato*, non deve comportarsi così”

“ Një njeri që *ka studiuar*, nuk duhet të sillet në këtë mënyrë”

Në fjalinë e mësipërme, koha e kryer është përdorur në një kontekst, që shfaqet në formën e një këshillimi. Ligjëruesi është përpjekur t’i japë këshillës së tij vlera stilistikore gjithëkohore, universale dhe me anë të kohës së kryer, duket që ia ka arritur qëllimit.

“Immagina ciò che si prova, quando *si è perduta* l’unica copia del documento...”

Forma foljore “*si è perduta*” shpreh një fakt të ndodhur në një çast të rrjedhës kohore, por pa e përcaktuar se në cilin pikërisht. Ndoshta edhe për shkak të mungesës së një informacioni të saktë rreth çastit të humbjes së kopjes së vetme të dokumentit, si dhe të kuptimit të foljes “*perdere*”, krejt fjalia përfton nuancat e një çasti që qëndron jashtë kohës. Në rrjedhën kohore, humbja e dokumentit i përket të shkuarës, të tashmes dhe do të mbetet e tillë edhe në të ardhmen”

Forma jashtëkohore haset edhe në mesazhe, me përmbajtje filozofike, fetare , etj.¹²¹

“Il tempo *ha reso* giustizia”

“Il figlio di Dio *è venuto* tra di noi per portarci alla salvezza”

Fjalia e parë është një përfundim filozofik, ndërsa përmbajtja dhe morali i mesazhit të dytë i drejtohet të gjitha brezave, atyre që kanë jetuar në të shkuarën, që jetojnë në të tashmen, por edhe atyre që do të vijnë.

Përdorimet jashtëkohore, ose gjithëkohore, janë karakteristikë edhe e skenarëve të filmave, ose pjesëve teatrale. Për të përshkruar ngjarjet e ndryshme që trajton në vepër, autori e përdor nuancën gjithëkohore si një tregues të fakteve që do të mbeten të tillë e të pandryshuar në rrjedhën e kohës.¹²² Për shëmbull:

“...La scena rappresenta la camera di una casa. Marco *ha puntato* la pistola alla tempia di sua moglie e la fissa ostinatamente. Dall’estero suona con insistenza la campanella...”

¹²¹ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“*Analisi grammaticale dei due tempi passati nell’italiano contemporaneo: passato remoto e passato prossimo*”, B. Esskali, Scholarly Paper, 2002.

¹²² “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“*Analisi grammaticale dei due tempi passati nell’italiano contemporaneo: passato remoto e passato prossimo*”, B. Esskali, Scholarly Paper, 2002.

“...Skena tregon dhomën e një shtëpie. Marko i *ka vendosur* pistoletën në kokë gruas së tij, pa ia shqitur sytë. Nga jashtë bie me insistim zilja e portës...”

Koha do të rrjedhë dhe brezat do t’ia lënë vëndin njëri tjetrit, por cilido regjizor që do ta vinte në skenë një pjesë të tillë teatrale, do të lexonte të njëjtin përshkrim të autorit, që do të mbesë i pandryshuar, me nota aktualiteti edhe për vitet që vijnë.

Me të njëjtat karakteristika paraqitet edhe situata e mëposhtme, që përpos të tjerash shpreh edhe një veprim zakonor:

“Tutte le volte che lo incontro, lui mi parla dell’ultimo film che *ha visto*.”

E njëjta situatë përsëritet edhe në pjesën e mëposhtme, nxjerrë nga vepra e Gadës, “La cognizione del dolore”:

“...Perché è *stato scemo*, superbamente scemo...e, non *ha capito* nulla di nulla...e tutt’a un tratto *ha chiesto* di andare a fare...e lei lo *ha atteso* che ritornasse, pazientemente...e allora *hanno ripreso* a tentar di leggere....Non *ha capito* nulla, *si è grattato* i ginocchi, *si è rovistato* il naso, *si è messo* la penna dietro gli orecchi....E, invece della frusta che gli va data, ecco le caramelle, i fichi, i biscotti, le lodi...”

6.6 E kyera me nuancë aktualiteti.

Jo rrallë qëllon që koha e kryer të përftojë në kontekste të caktuara nota aktualiteti, apo nuanca të ngjashme me kohën e tashme. Në raste të tilla edhe vetë veprimi i shprehur duket sikur ndodh pikërisht në të tashmen.¹²³

Me interes stilistikor, paraqitet në këtë kuadër nuanca e një veprimi, të dhënë në mënyrë iluzore si i përfunduar, apo sikur pritet të përfundojë nga çasti në çast. Kështu, për shëmbull, kur themi:

¹²³ “*Gramatika e gjuhës shqipe I*”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002, f. 274.

“*Il linguaggio*”, C. Schick, Einaudi, 1960.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“*Grammatica italiana*”, A. Panzini, Sellerio Editore, 1982.

“*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.

“*Ho finito, ho finito, abbi un po’ di pazienza!*” (në gjuhën shqipe përdoret me kohën e kryer të thjeshtë – Mbarova, mbarova, kij pak durim!)¹²⁴

Me përdorimin e kohës së kryer, mesazhi fiton ngjyra të së tashmes dhe pavarësisht se folësi nuk e ka përfunduar veprimin për të cilin flet, ai e paraqet atë si në përfundim e sipër, megjithëse përfundimi i vërtetë mund të vijë në një të ardhme sado të afërt me çastin e ligjëritimit.

Koha e kryer e mënyrës dëftore shpreh nuanca të së tashmes edhe kur kemi të bëjmë me veprime të përfunduara pikërisht në çastin e ligjëritimit. Për shëmbull kur themi:

“Finalmente *abbiamo vinto!*” (Më së fundi *kemi fituar!*)

“*Abbiamo cantato un pezzo di Ganni Morandi*” (Kënduam një pjesë të Xhani Morandit – në gjuhën shqipe mund ta ruajmë nuancën, duke përdorur të kryerën e thjeshtë)

“*Siamo usciti per fumare una sigaretta*” (*Kemi dalë për të pirë një cigare*), etj.

Aktualitet paraqesin edhe disa përshkrime faktesh historike, të cilat me përdorimin e kohës së kryer, mbeten vazhdimisht aktuale, edhe pse me një nuancë të lehtë të shkuare. I tillë është përshkrimi i mëposhtëm i një gazetari, për një figurë të shquar të politikës botërore:

“Ora, la camera, che egli *ha adornato* per tanti anni, *ha aggiornato* i suoi lavori, e lui *si è alzato* dal suo scranno, *ha camminato* lentamente verso l’ingresso, *si è inchinato* ed *ha lasciato* il palcoscenico della sua gloria...”

Përdorimi stilistikor i mësipërm i ka dhënë kohës së kryer nuanca mjaft të ngjashme madje edhe me të tashmen historike: sekuencat vijoje njëra tjetrën si në një film me lëvizje të ngadalësuar, solemniteti i çastit dhe heroikja përçohen tek lexuesi pikërisht nëpërmjet këtyre lëvizjeve të ngadalësuar dhe i gjithë akti fiksohet si i filmuar në përjetësi.

Nuanca të së tashmes mund të përftohen edhe kur konteksti është i veshur me nuancat e një ndodhie që ndodh rëndom (veprim zakonor)

“E’ sempre la stessa storia: vado a casa ed *ho perso* un altro giorno!”¹²⁵

¹²⁴ Shëmbuj të përdorimit të së kryerës me nuancë aktualiteti mund të hasen me shumicë në gjuhën e folur, të përditshme.

Në kontekstin e mësipërm, mund të vërehet njëfarë konsekuence, gjithmonë aktuale.

6.7 Koha e kryer e thjeshtë.

“...ndryshe nga e pakryera, kjo kohë (koha e kryer e thjeshtë) shërben për të treguar vetëm veprime, të cilat folësi a shkruesi i paraqit si të kryera, të përfunduara përpara çastit të ligjërit dhe çastit të marrë si pikë referimi në të shkuarën dhe që ai i ka jetuar, i ka parë vetë me sy, ka qënë pjesëmarrës a dëshmitar në zhvillimin e tyre, ose kur i tregon, i përjeton si të tilla...¹²⁵ .

Koha e kryer e thjeshtë përdoret mjaft shpesh në përralla, rrëfime historike dhe letrare, kujtime etj.

“... Il re *mandò* a chiamare il panettiere, che aveva tre figlie, e gli *chiese* se sua figlia maggiore era disposta a sposare il suo figlio porco. La figlia, tra il piacere di sposare il figlio del re e il dispiacere di sposare un porco, *si decise* per il sì.

La sera delle nozze, Re Crin tutto soddisfatto *andò* a spasso per le vie della città e *si sporcò* tutto. *Tornò* nella sala dove la sposa l’attendeva e con aria di farle delle carezze le *si strofinò* contro la sottana. La sposa, disgustata, invece di accarezzarlo *gli diede* un calcio...

Re Crin *s’allontanò* grugnendo...” (*Fiabe italiane*, I.Calvino, pag. 85)

“...Mblodha gjithë forcat e mia dhe me mundime mbinjerëzore *arrita* shkëmbin, ja mu aty. *Lidha* fort litarin dhe erdha dhe *u shtriva* mu këtu si i vdekur. Kur *erdha* në vete, ishte pasdreke. Gjaku me ishte mpiksur në gjoks. *Ndjeva* dhimbje therëse. *U ngrita*. *Pashë* se peshkaqeni ishte aty, i mbërthyer dhe i ngordhur. Kjo më *gjallëroi*. Ashtu është. Kur del fitimtar njeriu, edhe i vdekur ngjallet. Fitorja të ringjall e të jep forca të reja.

U ngrita në këmbë. Ç’të bëja? Si do ta nxirrja armikun e mposhtur? *Lidha* teshat e mia në kokë dhe *u hodha* në det. Plaga më digjte shumë...” (*Shpella e piratëve*, P.Marko, f. 26)

¹²⁵ “E’ sempre la stessa storia” është një shprehje mjaft skematike dhe mjaft e përdorur në gjuhën e folur italiane.

¹²⁶ “Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe”, A. Dhrimo, Libri Universitar, 1996, f. 114.

“Kur tufani e *çthuri* fenë,
Kur tirani e *krrusi* atdhenë,
Mbi një breg të Dragobisë
Priret Flamur’ i lirisë.

Atje *nisi*, atje mbaroj,

Atje *krisi*, atje pushoj,

Rrufe-shkab e Malësisë

Në një shkëmb të Dragobisë. (*Albumi*, F. Noli, f. 30)

“...Il 2 giugno 1946 gli italiani *votarono* per la Repubblica e il re Umberto di Savoia *andò* in esilio...”

“...Giuseppe Garibaldi *nacque* a Nizza nel 1807 e *morì* a Caprera nel 1882...”

“...*Entrò* il cameriere e accese la luce. Maggiorelli *ordinò* una birra. Il cameriere *portò* la birra, e la coppia, forse disturbata dalla luce, se ne *andò*; ma la conversazione non *rinacque*. Ormai erano anni e anni che facevano sempre gli stessi discorsi...” (*Esiliati* in *La casa di Via Valadier*, Carlo Cassola, p. 12)

Koha e kryer e thjeshtë (il passato remoto), shpesh konsiderohet vetëm si një hark kohor i largët në lidhje me çastin e ligjëritimit.¹²⁷ Por në gjuhën italiane, jo gjithmonë ndodh kështu; për shëmbull:

“Venendo qui, *vidi* Marco che andava alla stazione; sarà stato cinque minuti fa...”

“Duke ardhur këtu, pashë Markon që po shkonte në stacion; bëhet fjalë për pesë minuta më parë.”

¹²⁷ “*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.

“*Grammatica italiana*”, S. Battaglia, Loescher, 1951.

“*Grande grammatica italiana di consultazione*”, A. Salvi, G. Cardinaletti, Il Mulino, 1995.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“*Grammatica italiana*”, A. Panzini, Sellerio Editore, 1982.

“*Grammatica per italiani maggiori*”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

“*Grammatica italiana*”, G. Pittano, Bruno Mondadori, 1986. Etj.

Që koha e kryer e thjeshtë, të tregojë në gjuhën italiane, veprime të ndodhura vetëm pak minuta para çastit të ligjërimit, është e nevojshme që ndodhia për të cilën bëhet fjalë të konsiderohet si e përfunduar dhe e pakthyeshme.

Në fakt, siç shihet edhe nga shëmbujt e shumtë të sjellë më sipër, koha e kryer e thjeshtë ka natyrë të theksuar rrëfimtare. Kjo edhe për shkak se e kryera e thjeshtë tregon një proces plotësisht të përfunduar dhe prej të cilit fokusohet çasti përfundimtar, ndërsa pasojat që rrjedhin prej një procesi të tillë, nuk konsiderohen aktuale prej folësve.

Në krahasim me të kryerën, koha e kryer e thjeshtë duket se jep informacione më të sakta kohore, megjithatë nuk përjashtohen edhe disa përdorime me papërcaktueshmëri kohore, njësoj si në rastin e të kryerës.¹²⁸

Ndërsa në shëmbujt e mëposhtëm, koha e kryer e thjeshtë çon në disa interpretime më të përcaktuara se në rastin e përdorimit të kohës së kryer.

1 –Per consolarmi cercai di pensare ad una madre che *ha perso* il proprio figlio.

1/a –Per consolarmi cercai di pensare ad una madre che *perse* il proprio figlio.

2.-Mi verranno certamente incontro con l’aria di quelle persone che *hanno ottenuto* una promozione.

2/1 - Mi verranno certamente incontro con l’aria di quelle persone che *otterrò* una promozione.

Në shëmbujt e mësipërm, përdorimi i kohës së kryer reflekton kuptimin kontekstual që fjala është për një grua apo disa persona hipotetike, të vendosur diku në dimensionin kohë, por pa u përcaktuar saktësisht se “KUR?”. Përkundrazi, në fjalitë, në të cilat është përdorur koha e kryer e thjeshtë, gruaja dhe personat e tjerë bëhen qartazi të identifikueshëm.

“*Vissi a lungo in questo posto*”

“*Jetova gjatë në këtë vënd*”

Në shëmbullin e mësipërm, koha e kryer e thjeshtë ndihmon, bashkë me vetë kuptimin e foljes “*vivere*”, që konteksti të përftojë ngjyrimet gjithë përfshirëse. Shprehja

¹²⁸ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

ndajfoljore “*a lungo*” përfshin një hark të madh kohor në zhvillimin e faktit për të cilin bëhet fjalë, ndërsa “*in questo posto*” i jep kuptimit kontekstual përfshirjen e hapësirës.

Nga ana tjetër, shëmbulli paraqet edhe një rast të veçantë. Megjithëse në pamje të parë nuk vërehet, por çasti i “ndodhisë” nuk përputhet me çastin e ligjërimit. Megjithë shtrirjen e saj kohore edhe në hapësirë, çasti i ndodhisë, i dhënë me të kryerën e thjeshtë, duket sikur vjen pas çastit të ligjërimit, pra sikur gjithshka ndodhi, vjen më pas.



“ Saraçenia e bukur jetoi në shpellë me Gjonipin” (Shpella e piratëve, P.Marko,f.82)

Koha e kryer e thjeshtë mund të përdoret për të shprehur veprime që ndodhin përpara një veprimi tjetër. Në raste të tilla, në gjuhën italiane qëllon që e kryera e thjeshtë të marrë pjesërisht mbi vete funksionet e mëse të kryerës, megjithëse nuk përputhen plotësisht nga ana semantike.¹²⁹ Për shëmbull:

“Ritornando dal viaggio che *feci* (e kryer e thjeshtë), trovai una montagna di posta”

“Me t’u kthyer nga udhëtimi që *bëra*, gjeta një mal me letra në kutinë e postës”

“Ritornando dal viaggio che *avevo fatto* (më se e kryer), trovai una montagna di posta”

“Me t’u kthyer nga udhëtimi që *kisha bërë*, gjeta një mal me letra në kutinë e postës”

“Marco mi riferì che lui e Maria *andarono* insieme prima che ci incontrassimo”

“Marco mi riferì che lui e Maria *erano andati* prima che ci incontrassimo”

¹²⁹ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

Koha e kryer e thjeshtë dhe koha më se e kryer tregojnë të njëjtin kuptim kontekstual, por veprimi i shprehur shfaq ritëm dhe shtrirje kohore të ndryshme. Në përdorimin e më se të kryerës, veprimi është i vendosur në të shkuarën dhe vetëm më pas vjen çasti i ligjërit. Gjithsesi, përfundimet e analizës janë të natyrës pragmatike, pasi në fjali të përbëra dhe me raporte varësie mes tyre, rradha e veprimeve të kryera mund të ndryshojë në varësi të situatave shprehimore.

Në italishten e vjetër, zëvendësimi i më se të kryerës me të kryerën e thjeshtë ishte një praktikë më e shpeshtë, siç edhe vërtetohet në këto vargje të shkëputura nga “Komedia Hyjnore” e Dante Aligerit:

“...*Mi ritrovai in una selva oscura...*” (Canto I, 2)

“...*Ricominciò colei che pria m'inchiese...*” (Purgatorio, XXVI, 74)

Koha e kryer e thjeshtë mund të zëvendëjë edhe kohën e pakryer, duke rishfaqur nuancat e një gjuhe të vjetër italiane, me pak solemnitete dhe ngjyrim poetik brënda saj:¹³⁰

“*Marco odiò violentemente il suo destino*” (Marko e urreu fuqishëm fatin e tij).

“*Marco odiava violentemente il suo destino*” (Marko e urrente fuqishëm fatin e tij).

Në shëmbullin e parë, krejt konteksti është zhvendosur mjaft qartë në një periudhë të largët, në të shkuarën e Markos. Kjo periudhë ka një shkëputje të qartë nga koha e ligjërit dhe çasti i ligjërit, ndërsa veprimi i shprehur me anë të foljes në të kryerën e thjeshtë tregon pa mëdyshje që ka përfunduar.

Në fjalinë e shëmbullit të dytë, koha e pakryer që ka zëvendësuar të kryerën e thjeshtë , e zhvendos qëndrën e mesazhit: merr më tepër rëndësi fakti që Marko “*urrente*”; mjegullohet dhe bëhet e paqartë rëndësia e largësisë kohore që ndan veprimin nga ligjërit dhe theksohet veprimi kryesisht si cilësi e Markos.

¹³⁰ “*Fra grammatica e vocabolario: studio sull’aspetto del verbo italiano*”, V. Lucchesi, Accademia Crusca: Studi di grammatica italiana 1, Sansoni, 1971, f. 238 – 257.

6.8 E kryera e thjeshtë gnomike.¹³¹

Me interes dhe tejet e pasur paraqitet përdorimi gnomik i të kryerës së thjeshtë. Me këtë nuancë shprehimore, kjo kohë haset në fjalët e urta, në esé, në poezi e kështu me rradhë. Për shëmbull:

“Poche parole e caldo di panno, non *fecero* mai danno” .

“Credere ciecamente alla donna, non *fu* mai cosa buona”.

“Un bel tacer, non *fu* mai scritto”.

“Chi va dietro a pesce e penne, in questo mal ci *venne*” .

“Spesso i figli *scontarono* le colpe dei padri”.

“Chi *fece* del seren troppo gran festa, avrà doglia maggior nella tempesta”.

“I *dhe* gishtin, të *mori* krahun”.

“Budallai *hodhi* një gur në lumë, njëqind të mënçur nuk e *nxorrën* dot”.

Nuanca kohore e shprehur nëpërmjet këtyre fjalëve të urta e kapërcen konceptin e të shkuarës dhe shtrihet përtej saj, drejt të tashmes, madje në formën e eksperiencës, shkon edhe drejt së ardhmes. Në këtë pikë, duhet thënë që në këto lloj përdorimesh, koha e kryer e thjeshtë i ngjan të tashmes jashtëkohore, vlerat e të cilës kthehen në universale dhe i përkasin më pas të gjitha periudhave kohore.

Janë të shumta rastet, kur koha e kryer e thjeshtë shoqërohet me ndajfolje ose shprehje ndajfoljore që tregojnë kohë. Në të tilla raste, është e natyrshme që shtrirja kohore të përcaktohet kryesisht nga kuptimi i ndajfoljes.

“...A vent’anni, nessun mortale *conobbe* la pazienza, la quale non *fece* mai nido negli animi dei bambini, degli avventurieri e degli innamorati...” (“*Le lande di fuoco*”, R. A. Salvatore, p. 119)

“Sot u *pamë* e sot u *ndamë*

Dhe nuk *thamë* dot një fjalë;

¹³¹ “*Lingua, grammatica, stile*”, G Tedeschi, Petrini, 1971.

“*Lingua e linguaggi*”, F. Sabatini, Loescher Editore, 1990.

Kur u ndamë, vamë e qamë,

Qamë me ca lot të valë.

Edhe shpejt kur me të dalë,

Vamë u pamë e shumë thamë,

Thamë fjalë, fjalë, fjalë,

Pastaj *heshtë* e më s'u ndamë" (*Vepra letrare*, L. Poradeci, f. 255)

Koha e kryer e thjeshtë përdoret edhe në folje që tregojnë veprime "zakonore", apo në folje që tregojnë eksperiencë të ndodhura jo në realitet, por në ëndrra, apo në ëndërrime.¹³² Në të tilla kontekste, e kryera e thjeshtë shfaq vlera aspektore, ose modale, që në pamje të parë nuk përputhen me kuptimet semantike e kontekstuale bazë të mesazhit:

Në kontekste ëndërrimesh:

"A lungo rimase immobile ... *rivide* i libri di casa sua e forse i libri *videro* lui."

"*Andò* dal padrone del Verde,

andò dal padrone del Bruno,

ma non gli dava retta nessuno.

Infine *pensò*:

"Il Rosso ce l'ho!"

Detto fatto un ditto si *tagliò*" (I cinque libri, G. Rodari, p. 140)

Ti *ike* udhës së pafundme,

¹³² Sipas modelit të kohës së pakryer, me të njëjtat vlera, hasur në mjaft gramatika italiane por edhe në librin e A. Dhimos: "Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe", A. Dhimo, Libri Universitar, 1996, u hulumtua nëse gjëndeshin raste të njëjta edhe me të kryerën e thjeshtë dhe kërkimet dhanë rezultate pozitive.

Ku zverdhin drurët gjetherënës,

Mbi gjokse pellgjesh tani tundet

I arti medaljon i hënës. (Poezi të zgjedhura, I Kadare, f. 86)

Në kontekste që tregojnë veprime “zakonore”

“ I viveri cominciavano a scarseggiare; *dovettero* fermarsi di notte presso le rade fattorie a dissappellire patate e barbabietole”

“S’u *bè* qameti...”, etj.

6.9 Krahasime ndërmjet përdorimit të kohës së kryer dhe kohës së kryer të thjeshtë, në gjuhën italiane.

Në gjuhën italiane, koha e kryer dhe koha e kryer e thjeshtë, përtej dallimeve aspektore, paraqesin edhe ngjashmëri,¹³³ aq sa mund të zëvendësojnë njëra tjetrën në mjaft kontekste. Edhe dallimet aspektore midis tyre po vijnë gjithnjë e më tepër duke u zbutur, për shkak edhe të një shtrirje gjithmonë e më të madhe të elementëve të gjuhës së folur, në gjuhën e shkruar. Pikërisht për këtë arsye, për shkak se e kryera është koha më e përdorur në gjuhën e folur, mjaft prej gramatikave italiane japin vlerësime, sipas të cilave, koha e kryer do ta shtrijë gjithnjë e më tepër rrezen e saj të veprimit.

Zbutja e dallimeve midis të kryerës dhe të kryerës së thjeshtë, vërehet sidomos në përdorimet e foljeve ndihmëse: “*kam*” dhe “*jam*”.

Në gjuhën italiane, veçanërisht në gjuhën e folur, sot ka njëfarë lirie në zgjedhjen e njëjës, apo tjetrës kohë.

- Come hai fatto a studiare?

- Non c’è nulla di strano, *ebbi* (*ho avuto*) una settimana libera dal lavoro.

¹³³ “*Dizionario di linguistica*”, Zanichelli, 1983, f. 297.

“*Analisi grammaticale dei due tempi passati nell’italiano contemporaneo: passato remoto e passato prossimo*”, B. Esskali, Scholarly Paper, 2002.

“*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.

Gjithsesi, në disa gramatika nënvizohet fakti që kjo ndodh për shkak të kuptimit dinamik që mbart fjalia. Kjo tezë vërtetohet lehtësisht nëse vendosim të njëjtën situatë në një kuptim kontekstual statik.¹³⁴ Për shëmbull:

- Come hai fatto a studiare?
- Non c'è nulla di strano, *ebbi sempre* (???) una settimana libera dal lavoro.
- Non c'è nulla di strano, *ho sempre avuto* una settimana libera dal lavoro.

Në rastin e një situatë statike, vërehet fare qartë që koha e kryer e thjeshtë nuk mund të gjejë përdorim, pasi nga ana aspektore ajo shfaq një veprim të mbyllur dhe pa efekte mbi të tashmen.

Mund të gjejë gjithsesi përdorime të karakterit stilistikor, në nivelin e gjuhës së folur,¹³⁵ për shëmbull në situata të tilla shprehimore:

“Sono rimasto deluso: *ebbi sempre* (*ho sempre avuto*) fiducia in te”

Përdorimi me këtë lloj ngjyrimi në gjuhën e folur, aplikohet për të dhënë idenë të bashkëbiseduesi që: “kjo ka ndodhur në një kohë shumë të largët, nuk ka lidhje fare me të tashmen, madje koha “kur unë pata besim” thuhet i përket një periudhe që nuk mund të inkuadrohet në rrjedhën normale kohore; është e kaluar dhe e harruar”.

E njëjta situatë vihet re edhe me përdorimin e foljes *essere* .

Situatë shprehimore dinamike:

- Come hai fatto a scoprirlo?
- Fu (*è stato*) per puro caso.

Situatë shprehimore statike:

- Perchè non sei venuto a trovarmi la settimana scorsa?
- Il fatto è che *fui* (???) in casa a studiare tutta la settimana.
- Il fatto è che *sono stato* in casa a studiare tutta la settimana.

¹³⁴ “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“*Lingua, Grammatica, Stile*”, G. Tedeschi, Petrini, 1971.

“*Analisi grammaticale dei due tempi passati nell'italiano contemporaneo: passato remoto e passato prossimo*”, B. Esskali, Scholarly Paper, 2002.

¹³⁵ “*Lingua, Grammatica, Stile*”, G. Tedeschi, Petrini, 1971.

Edhe një herë tjetër, me përjashtim të përdorimit stilistikor në gjuhën e folur, duket që në situatat statike nuk përdoret as e kryera e thjeshtë e foljes “essere”

Në kuadër të nuancave shprehimore, aspektore, apo stilistikore që shprehin, midis këtyre dy kohëve ekzistojnë edhe ndryshime kuptimore. Nëse do të bënim një ballafaqim të nuancave dhe ngjyimeve kuptimore që shpreh secila prej këtyre dy kohëve, atëherë do të vërenim për sa më poshtë vijon:

Koha e kryer shpreh :

- Vlerë aspektore të përmbushjes së veprimit, por me rëndësi edhe për aktualitetin, veçanërisht për sa i përket efekteve psikologjike në të tashmen;

- referime kohore jo deiktike, të shfaqura në formën e një veprimi të kryer përpara çastit të cilit i referohet ngjarja, vazhdimisht në të shkuarën, ose në përdorime të konsideruara “jashtëkohore”, ose “gjithëkohore”;

- përfundime të papërcaktuara të procesit.

Në dallim me kohën e kryer, koha e kryer e thjeshtë shpreh:

- Përfundim të veprimit përpara çastit të ligjërimit;


- nuanca deiktike të përcaktimit kohor , përkundrejt të shkuarës.

-referime kohore specifike, të cilat nuk pranojnë interpretime të rastësishme, zakonore etj.

Sigurisht nuk janë të përjashtuara përdorimet stilistikore, për shkak të të cilave mund të hasim përdorim të kohës së kryer të thjeshtë, në kontekste ku me një përdorim normal të rregullave të gramatikës, ato situata shprehimore do të shmangeshin nga përdorimi.

“...Il giovane romano, che alcuni gorni fa *si arpinò* alla gola, è *morto* ieri.

Në shëmbullin e mësipërm hasim një sekuencë të përbërë qoftë nga e kryera e thjeshtë, ashtu edhe nga koha e kryer. Arsyeja e pranisë së të dy kohëve është fakti që veprimet vijojnë me kronologji kohore, njëri pas tjetrit. Pra megjithëse koha e kryer është futur mjaftueshëm në territorin e kohës së kryer të thjeshtë dhe anasjelltas, në disa raste, siç është rrëfimi i mëparshëm, ligjëruesi nuk mund të mos marrë parasysh renditjen e ngjarjeve.



Pra ndërftutja e njërës kohë për të zëvëndësuar kohën tjetër e ka një kufi. Kur këta kufij tejkalohen, normalisht kemi të bëjmë me efekte të pastra stilistikore, ose të paktën me “qëllime stilistikore” të ligjëruesit, të cilit shpesh nuk i mjafton nuanca apo ngjyrimi aspektor që mund të përftojë koha e foljes në një kontekst të caktuar, por përpiqet të krijojë efekte shprehimore origjinale dhe të papërdorura më parë.

“...E invece le assicuro che non *ho* mai *cercato* di approfittare di quella certa palpitazione che era evidente in lei...Eppure non *cercai* mai, con Isabella, in nessuna occasione...” (*La bugiarda*, D. Fabbri, p. 34)

Përdorimi i dy kohëve në një kontekst të tillë mund të justifikohet vetëm stilistikisht, si një reflektim i autorit, i cili në përsëritjen e faktit përdor të kryerën e thjeshtë, si për të kumtuar idenë që ajo kohë është mbyllur një herë e përgjithmonë dhe nuk kthehet më. Me të kryerën e thjeshtë autori e ndan prerazi të shkuarën me çastin e ligjërimit.

“...Facendo diversi viaggi *riuscimmo* a portare nella tana cento litri di olio. *Abbiamo dato* un po’ di olio al tenente Cenci per il suo caposaldo, poi al tenente Sarpi, poi anche il capitano ne *volle*...” (*Il sergente nella neve*, M. Rigoni Stern)

Kalimi nga një kohë në tjetrën është përdorur nga autori si teknikë stilistikore për të përmbyllur prerazi dhe pa asnjë interpretim disa veprime të përshkuara në tekst dhe për të nënvizuar me një kohë pak më të shtrirë (e kryer – *abbiamo dato*) veprimin, të cilin autori me sa duket kërkon ta vendosë më në dukje. Në një rast standart të përdorimit të gjuhës, natyrisht kjo mënyrë e përdorimit të kohëve të foljes nuk do të ishte e këshillueshme.

“Si direbbe che Marco *ha fatto* il proprio dovere”.

“Si direbbe che Marco *fece* il proprio dovere”.

Në shëmbullin e mësipërm, e kryera e thjeshtë është e pranueshme vetëm nëse bëhet fjalë për një veprim të largët në kohë prej çastit të ligjërimit, ndërsa koha e kryer aludon për një kohë më të afërt me çastin e ligjërimit.

Gjithsesi në thelb të këtyre çështjeve mbetet ajo çka kemi pohuar edhe herë të tjera: ndryshimi i vërtetë në përdorimin e dy kohëve mbetet nuanca e një të “shkuare të mirëpërcaktuar” dhe ajo e një të “shkuare të pacaktuar”, siç është rasti i situatave shprehimore:

“Ho visitato Roma” (e kryera nuk të lejon të krijosh një ide të saktë në cilën periudhë kohore ka ndodhur ky fakt)

“Visitai Roma” (ligjëruesi i referohet një momenti të caktuar).

Ndonjëherë, përdorimi ose jo i njëjës apo tjetrës kohë foljore, varet edhe nga përdorimi i ndajfoljeve dhe shprehjeve ndajfoljore të kohës. Kështu, ndajfoljet, të cilat i referohen çastit të ligjërimit si “*adesso*” (tani), “*ora*” (tani), “*attualmente*” (aktualisht), “*in questo momento*” (në këtë çast), “*finora*” (deri tani), etj., në gjuhën italiane nuk e bëjnë të mundur përdorimin e kohës së kryer të thjeshtë.¹³⁶

“Adesso, finalmente, *ho appagato* ogni mio desiderio” (Tani më së fundi kam shpaguear çdo dëshirë timen).

Adesso finalmente *appagai* (X) ogni mio desiderio (Tani, më së fundi shpagueva çdo dëshirë timen).

“Finora *si è vista* una partecipazione massiccia”

“Finora *si vide* (X) una partecipazione massiccia”

Attualmente *ho constatato* (*constatai* - X) che le cose vanno abbastanza bene.

E njëjta gjë vlen edhe për rastet kur çasti i ligjërimit përfshin me barazi kohore çastin e realizimit të veprimit. Në raste të tilla ndajfoljet apo shprehjet ndajfoljore më të përdorura, janë: “*quest’oggi*” (po sot), “*questo mese*” (këtë muaj), “*quest’anno*” (këtë vit) etj.¹³⁷

“Questa settimana *siamo andati* a trovare Marco”

“Questa settimana *andammo* (???) a trovare Marco”

Në gjuhën italiane rekomandohet përdorimi i kohës së kryer, për shkak të afërsisë në kohë të veprimit dhe të pothuaj njëkohësisë me çastin e ligjërimit. Ndërsa në gjuhën

¹³⁶ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986, f. 441.

¹³⁷ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986, f. 442.

shqipe, përdorimi standart i këtij rasti, në fakt, kërkon të kryerën e thjeshtë. Kështu në gjuhën shqipe , për një arsye ose një tjetër, thuhet:

“Këtë javë shkova të takoja Markon” dhe nuk përdoret forma “ Këtë javë kam shkuar të takoj Markon”, përveçse në situata të veçanta, kur ligjëruesi kërkon t’i bëjë një surprizë bashkëbiseduesit të tij.

Ekzistojnë në gjuhën italiane edhe një sërë ndajfoljesh të tjera, të cilat për nuanca të ndryshme shprehimore apo kuptimore, kërkojnë herë njëjërën formë foljore dhe herë tjetrën.

“Infine Marco è *venuto*” (në kuptimin – ka ardhur, më së fundi)

“Infine Marco *venne*” (në kuptimin – pasi e kishim pritur gjatë).

“Ci *ho pensato* spesso, senza riuscire a decidermi (në kuptimin – akoma nuk kam vendosur)

“Ci *pensai* spesso, senza riuscire a decidermi (në kuptimin që ndoshta në të ardhmen do të vendos)

“*E* sempre *venuto* a trovarci” (rregullisht, deri tani)

“*Venne* sempre a trovarci (rregullisht në periudhën për të cilën po flasim)

Ndajfolje të tjera të cilat, në varësi të kuptimit ose nuancës kontekstuale marrin njëjërën ose tjetrën kohë janë:

Ormai (tashmë), *finalmente* (më së fundi), *intanto* (ndërkaq), *frattanto* (ndërkaq), *nel frattempo*,(ndërkohë).

Rast unik për nga ngjyrimi përbën ndajfolja *appena* – sapo:

“*L’ho appena visto*” (kuptimi : e kam parë pikërisht në këtë çast)


“*Appena lo vidi*” (kuptimi: sapo e pashë....i thashë, e takova etj.)

“*Lo vidi appena*” (kuptimi: e pashë fare pak)

Në secilën prej fjalive, me ndryshimin e pozicionit të foljes në fjali, ndryshon edhe kuptimi i fjalisë.

KREU 7 KOHA MË SE E KRYER DHE KOHA E KRYER E TEJSHKUAR.

7.1 Mëse e kryera.



Më se e kryera, njësoj si kohët e tjera të përbëra, e mbështet logjikën kontekstuale të funksionimit të saj në praninë e një çasti të ekzekutimit të veprimit, i vendosur ky në të shkuarën, përkundrejt referimeve të tjera kohore.¹³⁸ Çasti i ekzekutimit të një veprimi, është çasti kur ndodh ngjarja (veprimi) dhe konsiderohet intervali kohor gjatë të cilit ka ndodhur veprimi, ndërsa rezultati mbetet aktual.

“ Siccome *avevo dimanticato* a casa il cellulare, non ho potuto telefonarti”.

“Teri sera ho letto i libri che mi *avevi consigliato* il mese scorso”

“Ho incontrato Carla, subito dopo che tu mi *avevi parlato* di lei

“*Kishte mbetur* në provimet e qershorit, mbeti edhe në ato të vjeshtës”

“*Kishte kënduar* dikur në rininë e tij, por tani e zinte shpesh e më shpesh kolla!

Kujtojmë këtu që ndajfoljet e përdorura nuk tregojnë me patjetër çastin e kryerjes së veprimit; jo rrallë ato tregojnë një çast kohor, të cilës ne i referohemi.

“Alle 7.00, Carla *aveva già fatto* il bagno.”

¹³⁸ “*Grande grammatica italiana di consultazione*”, A. Salvi, G. Cardinaletti, Il Mulino, 1995.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“*Grammatica italiana*”, A. Panzini, Sellerio Editore, 1982.

“*Grammatica per italiani maggiori*”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

“*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.

“Carla aveva già fatto il bagno alle 7.00”

Në shëmbullin e parë, kuptimi kontekstual i mesazhit nuk është që Karla kishte bërë banjë në orën shtatë, por që në orën shtatë ajo e kishte mbaruar prej kohësh banjën, pa e përcaktuar saktësisht.

Në shëmbullin e dytë, ora shtatë shënon pikërisht kohën e kryerjes së veprimit, pra Karla e kishte bërë banjën saktësisht në atë orë dhe jo në një orë tjetër.

E njëjta situatë vërehet edhe në fjalitë në të cilat është përdorur “kur”:

“Quando arrivò la polizia, i ladri si erano allontanati” (Kur mbërriti policia, hajdutët ishin larguar)

“I ladri si erano allontanati quando arrivò la polizia.”(hajdutët ishin larguar kur mbërriti policia)

Në fjalinë e parë, nuk kuptohet mirë sa kohë para mbërritjes së policisë ishin larguar hajdutët.

Përkundarzi, në fjalinë e dytë kuptohet qartë që hajdutët u larguan në çastin e mbërritjes së policisë”

Gjithsesi, prej shëmbujve që sollëm më sipër vërehet qartë që shprehin një veprim më të hershëm përkundrejt të kryerës së thjeshtë dhe të pakryerës, por edhe ndaj një të kryere, dhe të një tashmeje “historike”

“ Non ti capisco proprio: dopo che lo avevi tolto dai pasticci, gli hai fatto questo brutto scherzo.”

“Finalmente il maggiore Bracchi che si era allontanato in cerca di ordini, ritorna. Ci muoviamo finalmente ma torniamo indietro...” (*Il sergente della neve*, M. Rigoni Stern)

“...Gilda mi raccontò con le lacrime agli occhi la sua penosa storia: dopo che ella gli aveva fatto l'estremo dono di sé, il duca era fuggito con una donna dalla condotta non irreprensibile...”

Nga pikpamja strukture më se e kryera mund të përdoret si në fjali të varura kohore apo të një lloji tjetër, ashtu edhe në fjali të thjeshta dhe të pavarura, pa e humbur nuancën e saj të një veprimi që është kryer përpara veprimeve të tjera.¹³⁹

Në tekstet letrare, më se e kryera përdoret për të dhënë përshkrime të gjata personazhesh, vëndesh, apo ngjarjesh që kanë ndodhur në të shkuarën.¹⁴⁰

“...Infine *era venuto* santo Francesco, e *aveva diffuso* un amore di povertà che non contraddiceva ai precetti della chiesa, e per opera sua la chiesa *aveva accolto* il richiamo alla severità dei costumi di quegli antichi movimenti e li *aveva purificati* dagli elementi di disordine che si annidavano in essi. ...E che questo *era* già *avvenuto* ai tempi in cui Francesco era in vita e che le sue parole e i suoi propositi *erano stati traditi*. ...Infatti lui *aveva previsto* l'avvento di un'era nuova, in cui lo spirito di Cristo, da tempo corrotto a opera dei suoi falsi apostoli, si sarebbe di nuovo realizzato sulla terra. E di questo molti francescani si *erano* assai *rallegrati*...”(Il nome della rosa, U. Eco, p. 356)

“...Tre giorni dopo la presa dei due vascelli, la *Folgore* faceva l'incontro con il vascello di linea che *aveva abbordato* presso Maracaybao e che durante la tempesta *aveva cercato* rifugio all'isola. *Era privo* dell'albero maestro, però il suo equipaggio *aveva rinforzati* gli alberi di mezzana e di trinchetto, *aveva spiegato* tutte le vele di ricambio e s'affrettava di guadagnare la Tortue, per tema di venire sorpreso da qualche nave spagnola...” (Il giuramento del corsaro nero, E. Salgari, p. 11)

“...Në orët që kaluan ai *kishte harruar* veten, gjë që nuk ndodhte kurrë. *Kishte harruar* planet e kryengritjes dhe fatin e luftës. “Si në kohën e Burrit, si në kohën e Iskënderit” *kishte thënë* gjatë varrosjes së ushtarëve. Mbase për atë *kishtë dalë* në krye të vdiste edhe vetë si ushtar, duke qënë plak e i braktisur nga bijtë e nipat. Po *kishte dalë* edhe për t'u treguar ushtarëve se, edhe dhjetë kundër njërit, ata mund të thyenin me pallë në dorë armikun burracak. Dhe kjo fitore, sado e kufizuar, do të jehonte larg. ..

Kampi turk *kishte rënë* në zi, jo aq për humbjet, po sepse *ishin thyer* keqas nga një grusht njerëzish në sulmin e parë të vërtetë, *kishin parë* me sytë e tyre Kara Aliun dhe, në vend që ta zinin të gjallë, qene bërë rrëmujë...” (Ali Pashë Tepelena, S. Godo, f. 294)

Për shkak të karakteristikës të më se të kryerës për të shprehur një ngjarje apo veprim që ka ndodhur përpara një tjetër ngjarjeje apo veprimi¹⁴¹, bën që kjo kohë të përdoret jashtë mase në rrëfime:

¹³⁹ “La lingua italiana per stranieri”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

¹⁴⁰ Fenomeni u vërejt pasi u kërkuan shëmbuj të përdorimit të kohës më se të kryer, në tekstet letrarë.

“...Quella infermità terribie per cui *avevo provato* tanto orrore mi *aveva colto* in quell'istante; la malattia di Fosca si *era trasfusa* in me; io avevo conseguito in quel momento la triste eredità del mio fallo e del mio amore...”

Perveç kësaj, duke qënë që përmban edhe vlerat aspektore të përmbushjes se një veprimi, përdoret jo rrallë për të shkurtuar tekstet dhe mënyrat e rrefimit. Bëhet fjalë për situata shprehimore të cilat i referohen një fjale apo një gjesti të kryer më parë dhe për ta rrefyer atë pa patur nevojë për përshkrime të gjata, të cilat duke u marrë me imtësira do të bëheshin edhe të mërzitshme dhe të lodhshme.

“L'uomo *era diventato* paonazo dalla paura”

Shpesh, situatat në të cilat përdoret më se e kryera, për të treguar ngjarje të mëparshme në kohë, nuk janë reale, si për shëmbull përshkrimi i ngjarjeve të ëndrrave. Në situata të tilla shprehimore, çasti i kryerjes së veprimit edhe mund t'i shpëojë rrjedhës logjike kohore:

“Ben presto Marco si immedesimò nel protagonista del racconto. Era lui che *aveva tratto* in salvo la casta duchessa; lui che *aveva affrontato* la masnada degli sbirri, lui e solo lui che *aveva strappato* la maschera dal volto del falso arcivescovo.”

Në fakt, këto situata merren në konsideratë kur duhet vendosur një raport kohor midis më se të kryerës dhe një kohe tjetër foljore, për të studiuar nuancat në kohë dhe hapsirë të shprehur prej foljeve.

Ky raport mund të mos jetë pa tjetër midis dy ngjarjeve, ku njëra është më e hershme se ngjarja tjetër, por ka raste kur largësia kohore midis këtyre dy ngjarjeve është pothuajse e papërfillshme, ose në disa të tjera mund të ndodhin njëkohësisht, për shkaqe të përbashkëta ose jo.

“Nel leggere la sua risposta, avevo capito il perchè di tante cose” (Gjatë leximit të përgjigjes, kisha kuptuar “përse-në” e mjaft gjërave.)

“Mentre leggevo la sua risposta, avevo capito il perché di tante cose.” (Ndërsa lexoja përgjigjen, kisha kuptuar “përse-në” e mjaft gjërave.)

Në shëmbujt e mësipërm nuk ka distancë kohore midis dy veprimeve të shprehura prej foljeve. Përdorimi i më se të kryerës vetëm sa e zhvendos krejt ngjarjen e kumtuar në

¹⁴¹ Të gjitha gramatikat italiane bien dakort në këtë pikë. Edhe në gjuhën shqipe shërben për të treguar një veprim, që ndodh përpara një çasti të caktuar të së shkuarës.

të shkuarën, ndërsa veprimet brënda ngjarjes ndodhin njëkohësisht, me një nuancë të vogël ndryshimi: në rastin e parë fokusohet vetëm momenti kur ligjëruesi kuptoi shumë gjëra (gjatë leximit), ndërsa në shëmbullin e dytë veprimet paraqiten paralel me njëri tjetrin.

Identike paraqitet situata edhe në shëmbujt e mëposhtëm:

“Andando a scuola Carla *aveva notato* qualcosa di strano” (Duke shkuar në shkollë Karla *kishte vërejtur* diçka të çuditshme)

“Mentre andava a scuola, Carla *aveva notato* qualcosa di strano.” (Ndërsa shkonte në shkollë, Karla *kishte vërejtur* diçka të çuditshme.)

Raporti kohor që vendoset midis më se të kryerës dhe kohëve të tjera të pranishme në ligjërim, jo gjithmonë është i drejtë për drejtë, siç mund të ndodhë, për shëmbull, në fjalitë e varura kohore. Mjaft shpesh paraqitet nevoja e një analize kontekstuale të foljeve në mesazh, për të kuptuar edhe llojin e varësisë që vendosin njëra me tjetrën kohët foljore, si në fjalinë e mëposhtme:

“Resta ben poco ormai di ciò che *avevamo fatto* insieme” (Tashmë mbetet fare pak nga ajo që *kishim bërë* së bashku.)

Veprimi i nisur në të shkuarën (*avevamo fatto*) i shtrin disa prej efekteve të tij edhe në të tashmen, jo vetëm si argument për bashkëbisedim, por edhe në kuptimin e drejtë për drejtë të efekteve.¹⁴² Megjithatë të dy konceptet e shprehura nga foljet, e para në kohën e tashme dhe e dyta në kohën e më se të kryer, nuk kanë domosdoshmërisht lidhje, pasi nuk kanë lidhje me çastin e ligjërimin, por vetëm me çastin e kryerjes së veprimit të ndodhur në të shkuarën dhe të shprehur vetëm prej njëres nga foljet.

Nëse do të donim të kumtonim një mesazh me raporte kohore të drejtë për drejta midis kohës së tashme dhe të shkuarës, atëhere do të duhej të përdornim një kohë perfekteve, si për shëmbull:

“Resta poco ormai di ciò che *facevamo* insieme”

“Resta poco ormai di ciò che *abbiamo fatto* insieme”

¹ “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“*Grammatica per italiani maggiori*”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

“*Grammatica italiana; lingua comune e lingua letteraria*”, L. Serianni, UTET, 1989.

“*Guida alla pratica della creatività*”, A. Rossetto, Fabbri Editori, 1980.

Kohët perfekteve janë në gjëndje të mbulojnë të gjitha mundësitë e përcaktuara kohore¹⁴³, ndërsa më se e kryera mbetet më e kufizuar në këtë drejtim. Dhe kjo nuk ka të bëjë me distancën kohore që ndan çastin e ligjërit me çastin e kryerjes së veprimit, se po të ishte fjala thjeshtë për këtë, në ligjërimin e përditshëm ne kemi shëmbuj që tregojnë se kjo distancë mund të reduktohet në maksimum:

“Peccato che sia arrivato proprio ora il tenente; avevo appena *ottenuto* il permesso di uscire”

“Ti *avevo cercato* dappertutto in quest’ultima ora: dove ti eri cacciato?”

Në fakt, ajo që ne duhet të kuptojmë për përdorimin e më se të kryerës në gjuhën italiane, është mungesa e ngjyritit të aktualitetit,¹⁴⁴ madje edhe në dy shëmbujt e mësipërm, nuk bëhet fjalë për veprime që janë rrjedhojë e njëri tjetrit, por të shkëputur dhe me kronologji kohore të ndryshme. Çasti i kryerjes së veprimit, nuk përputhet me çastin e ligjërit, duke vendosur me këtë të fundit një kufi ndarës, të mjaftueshëm për ta distancuar psikologjikisht ngjarjen nga vetë çasti i referimit të saj.¹⁴⁵

Një fenomen i tillë mund të vërehet edhe në stilin e korrespondencës:

“Egregio signor Rossi:

Nel corso del nostro ultimo colloquio, Lei mi *aveva accenato* alla sua intenzione di acquistare una partita della nostra merce. Non so se è ancora dello stesso parere...”

Në këtë shëmbull, koha më se e kryer mund të zëvendësohet me një tjetër kohë perfekteve, por duke qënë se shpreh idenë e një çasti referimi që shërben si barrierë kohore midis dy periudhave të trajtuara në kontekst, atëherë kontribuon për të dhënë një shkëputje më të madhe psikologjike, midis çastit të ligjërit dhe atij, të cilit i referohet letërshkruesi.

Në fakt ky është një fenomen i përgjithshëm. Edhe aty ku më se e kryera nuk shfaq qartazi një raport vjetërsie përkundrejt veprimeve të tjera, është e mundur të krijohet me imagjinatë një çast çfarëdo referimi. Shëmbulli i mëposhtëm e tregon më së miri diçka të tillë:

¹⁴³ “*Guida alla pratica della creatività*”, A. Rossetto, Fabbri Editori, 1980.


“*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.

¹⁴⁴ Ngjarjet vendosen tepër në të shkuarën

¹⁴⁵ “*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.


“Io *ero nato* con virtù eccezionali” (Unë *kisha lindur* me virtyte të jashtëzakonshme)

Në pamje të parë, meqenëse bëhet fjalë për një rrëfim në vetë të parë, mund të krijohet përshtypja e një ngjashmërie me kohët perfekte. Por nuk mund të thuhet me siguri, pasi konteksti nuk na jep asnjë shpjegim në këtë drejtim, pra që këto virtyte të jashtëzakonshme vazhdojnë të frymëzojnë kumtuesin e mesazhit. Në skemën e mëposhtme shihet qartë shpëputja e ngjarjes nga çasti i ligjërimit si dhe nga ligjëruesi (në konceptin e kohës dhe hapësirës)



E njëjta situatë përsëritet në shëmbullin e mëposhtëm:

“Del morto non si *era parlato* più” (Për të vdekurin, nuk *ishte folur* më)



Çasti kur u fol për herë të fundit (çasti të cilit i referohemi) mund të vendoset kudo në të shkuarën, pa u përcaktuar me saktësi siç do të ishte në rast se do të shpreheshim: “*non se ne parlò più*” (nuk u fol më). Pra fakti të cilit i referohemi është krejtësisht i zhvendosur në të shkuarën e papërcaktuar, pa asnjë lidhje me të tashmen (pasi “*nuk ishte folur më*, - pra veprimi nuk u përsërit më pas dhe për pasojë as në të tashmen),

ndërsa figura e ligjëruesit është e fshehur, rrëfimi na vjen si teknikë stilistikore nëpërmjet “zërrit rrëfimtar”.

Pak më ndryshe paraqiten nuacat në shëmbullin e mëposhtëm:

- Hai visto quei bambini ieri sera che litigavano?

- Hanno litigato? Non me n'ero accorto.

Në situatën shprehimore të sjellë më sipër, konteksti e lejon të lokalizohet çasti i kryerjes së veprimit: *në mbrëmjen e një dite më parë*.

Megjithatë, rastet më të zakonshme të përdorimit të më se të kryerës janë ato kur vetëm një vijë e hollë ndarëse e ndan prej kohëve përfektive:

“...In verità, dopo il mio incontro peccaminoso con la fanciulla, gli altri terribili avvenimenti mi *avevano fatto* quasi dimenticare quella vicenda, e d'altra parte, subito dopo essermi confessato a frate Guglielmo, il mio animo si *era sgravato* del rimorso che *avevo avvertito* al risveglio dopo il mio colpevole cedimento, tanto che mi *era parso* di aver consegnato al frate, con le parole, lo stesso fardello di cui esse erano la voce significativa. ...Ma non del tutto mi *ero liberato*...” (*Il nome della rosa*, U. Eko)

“...po im atë që komandonte trimat e vëndit, *kish përgatitur* një plan të mënçur. I la saraçenët të afroheshin me felluket e tyre të shpejta gjer të hyrja e Shpellës. Lart mbi shkëmb, *kish vendosur* dhe fshehur qindra luftëtarë. Pasi *kish dhënë* urdhërin, ata që lart nisën të lëshonin serë të ndëzur...Saraçenët nuk e prisnin këtë lloj arme...” (*Shpella e piratëve*, P. Marko)

Në të gjitha rastet, kur folja në kohën më se të kryer, shoqërohet me ndajfolje apo shprehje ndajfoljore, që lokalizojnë në mënyrë të përgjithshme një hark kohor, mund të zëvendësohet edhe më kohët përfektive.¹⁴⁶

“In quel stesso attimo { ragionai
ho ragionato
avevo ragionato } che la storia si sarebbe finita diversamente”.

¹⁴⁶ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“*Guida alla pratica della creatività*”, A. Rossetto, Fabbri Editori, 1980.

$$\left. \begin{array}{l} \text{Andai} \\ \text{Sono andato} \\ \text{Ero andato} \end{array} \right\} \text{a trovarlo due giorni dopo la morte di suo padre.}$$

Në të gjithë këta shëmbuj ajo që ndryshon janë nuancat dhe raportet e distancës kohore, kuptimi i përgjithshëm i mesazhit mbetet i njëjtë.

7.2 Vlera perfektive të më se të kryerës.

Në gjuhën italiane, sot për sot, më se e kryera nuk studiohet në kuadër të kohëve perfektive. Ajo që mund të diskutohet është qartësia e shkallës së përmbushjes së veprimit dhe që jepet nëpërmjet kohës më se të kryer.¹⁴⁷

Gjithsesi ka një afërsi më të madhe midis më se të kryerës dhe kohës të kryer, sesa midis më se të kryerës dhe kohës të kryer të thjeshtë. Treguesit në këtë drejtim nuk mungojnë.

Në rradhë të parë, më se e kryera mund të shprehë një nuancë kohore që rrjedh nga “eksperiencia”, njëllonj si dhe koha e kryer:¹⁴⁸

“Marco non *aveva* mai *detto* nulla di simile, fino al suo arrivo” (Marko nuk *kishte thënë* asgjë të ngjashme deri në atë çast)

“Marco non *ha* mai *detto* nulla di simile, fino al suo arrivo” (Marko nuk *ka thënë* asgjë të ngjashme deri në atë çast)

Të dyja variantet shprehin diçka që buron prej eksperiencës. Në rastin e dytë duket sikur ligjëruesi është vendosur më pranë Markos dhe kohës kur është verifikuar fakti, gjithsesi vërehet qartë afërsia kuptimore e të dy shëmbujve, madje në varësi nga nuanca stilistikore që dëshiron të mbajë ligjëruesi, mund të përdorë në të njëjtin kontekst, si njëren kohë ashtu edhe tjetren.

¹⁴⁷ “Grammatica italiana con nozioni di linguistica”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995.

¹⁴⁸ “Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986, f. 458

Më se e kryera mund të shprehë nuancë aktualiteti, në raport me çastin e ligjëritimit.

“*Aveva ottenuto il permesso di uscire dalla caserma, e non perdeva tempo*” (*Kishte marrë leje të dilte nga kazerma dhe nuk po himbiste kohë*)

“*Ha ottenuto il permesso di uscire dalla caserma, e non perdeva tempo*” (*Ka marrë leje të dilte nga kazerma dhe nuk humbiste kohë – në gjuhën shqipe është i domosdoshëm përdorimi i më se të kryerës*)

Në shëmbujt e msipërm është koha e kryer që tregon një periudhë kohore të largët përkundrejt çastit të ligjëritimit. Ndryshimet nuancore kanë të bëjnë vetëm me pozicionimin në kohë të çastit “*në të cilin ka marrë lejen*”; sa për pjesën tjetër, me përjashtim të faktit që koha e kryer paraqitet me një vlerë më të ngarkuar dhe të shumëfishtë shprehimore në krahasim me më se të kryerën, të dyja kohët shprehin diçka që bëhet realitet, pra një veprim që realizohet.

Më se e kryera mund të shprehë vlera shprehimore të “perspektivës”.¹⁴⁹ Shëmbujt e mëposhtëm janë shkëputur nga gjuha e folur, pasi në gjuhën e shkruar është më e vështirë të gjejnë përdorim këto forma, natyrisht nëse lëmë mënjanë tekstet letrare, sidomos ato të shkruara me një stil antitradicionalist.

“*Mi ha detto che viene quando ha finito*” (Në gjuhën shqipe është e pamundur që kjo formë të përkthehet nëpërmjet kohës së kryer, por përdoret mënyra lidhore)

“*Mi disse che veniva quando aveva finito*” (Më tha që do të vinte kur të kishte mbaruar)

Në shëmbullin e parë, megjithëse është një rast i përdorur në gjuhën e folur, vihet re mungesa e një kronologjie në rrjedhën e veprimeve. Përdorimi i dy formave të së kryerës nuk e shpreh siç duhet këtë kronologji dhe ndoshta është kjo arsyeja që standarti i gjuhës italiane nuk e pranon këtë formë, megjithëse qëllimi i ligjëruesit për t’i vendosur të dyja veprimet në periudhën kohore kur do të ndodhin, është dukshëm i qartë. Gjithsesi, ai nuk ka mbajtur parasysh faktin që kronologjia e veprimeve mbetet: “*në fillim përfundon punën dhe pastaj vjen*”.

Koha më se e kryer mund të shprehë nuancë jashtëkohore ose gjithëkohore

“*Nei tempi che viviamo, solo a cose fatte che ci si accorge se l’idea aveva avuto successo*” (Në kohët që po jetojmë, vetëm pasi gjërat përfundojnë, vihet re nëse ideja

¹⁴⁹ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

kishte patur sukses – duket që gjuha shqipe kërkon më tepër përdorimin e kohës së tashme gjithëkohore: “*ka*”).

“Nei tempi che viviamo, solo a cose fatte ci si accorge se l’idea *ha avuto successo*” (Në kohët që po jetojmë, vetëm pasi gjërat përfundojnë, vihet re nëse ideja *ka patur sukses*)

Edhe në variantin italisht, është e qartë që vlerat kohore të më se të kryerës kanë ngjashmëri me ato të kohës së tashme gjithëkohore. Forma foljore e përdorur “*aveva successo*”, vendoset kronologjikisht pas “*përfindimit të gjërave*”, por jo në një çast kohor të përcaktuar të së shkuarës, të tashmes, apo të ardhmes. Në një kontekst ku vlerat shprehimore i përkasin të trija këtyre kohëve, edhe më se e kryera shfaq të njëjtat vlera shprehimore dhe stilistikore me ato të kontekstit të krejt mesazhit.

Më se e kryera shpreh përmbushjen thuajse të menjëhershme të një veprimi, përkundrajt një tjetër veprimi të shprehur në kontekst.¹⁵⁰ Në disa raste, nuanca shprehimore e përmbushjes së menjëhershme, shfaqet sikur ndodh përpara edhe vetë kryerjes së veprimit.

“I soldati si gettarono all’attacco; in un batter d’occhio *avevano capovolto* il destino della battaglia.”(Ushtarët u hodhën në sulm; sa hap e mbyll sytë e kishin ndryshuar fatin e betejës)

Nëse e analizojmë me kujdes kontekstin e fjalisë më sipër, do të vërejmë që duket sikur ushtarët e ndërruan fatin e betejës sapo nisën sulmin, ndërsa beteja vazhdonte ende. Edhe më e qartë del kjo nuancë në shëmbullin që vijon:

“...Se la sorpresa, se il terrore non mi avessero reso impossibile il pensarci tosto, sarei stato ancora in tempo a discendere con lei dalla vettura; ma non m’era balenata alla mente questa idea, che il convoglio *era già partito...*” (Fosca, I. U. Tarchetti)

Më se e kryera paraqet harmoni të plotë me të pakryerën, kur kjo e fundit shpreh një veprim, ose gjëndje në progresion.

“...Io m’*ero mosso*, e seguia volentieri,

del mio maestro i passi, e amendue,

¹⁵⁰ “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“*Grammatica italiana; lingua commune e lingua letteraria*”, L. Serianni, UTET, 1989

“*Grammatica italiana con nozioni di linguistica*”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995.

già *mostravam* con'eravam leggeri..."

Por ndërsa koha e pakryer shpreh veprim në progresion, më se e kryera tregon rezultatin e një ngjarjeje të mëparshme, të përjetuar si aktuale prej ligjëruesit.

Koha më se e kryer përputhet mjaft mirë edhe me shprehje që tregojnë kohëzgjatje të përcaktuar.

“La gente *era rimasta* per tre giorni di fila” (Njerëzia *kishin qëndruar* tre ditë rresht)

“La figlia *era tornata* a trovarli altre due volte quell'estate” (E bija ishte kthyer për t'i takuar edhe dy herë të tjera atë verë)

“*Kishite patur* një javë kohë për të studiuar.”

“*Ishin nisur* prej dy orësh dhe akoma nuk kishin bërë gjysmën e rrugës.”

7.3 Veçanësi aspektore dhe modale¹⁵¹ të më se të kryerës.


Koha më se e kryer, herë pas here shfaq nuancën imperfektive të “përfshirjes”. Si e tillë, ajo e lë të pacaktuar çastin e kryerjes të veprimit dhe vetëm një analizë e kujdesshme kontekstuale mund ta qartësojë deri diku vendosjen e një pike referimi për çastin kur është kryer veprimi.

“Marco, il quale *aveva atteso* da molto tempo quel momento di trionfo, ci rimase molto male” (Marko, i cili e kishte pritur prej kohësh atë çast triumfi, u ndje shumë keq)

Veprimi foljor është vendosur në të shkuarën; periudha për të cilën bëhet fjalë paraqitet mjaft e shtrirë në kohë (da molto tempo); mos realizimi i asaj që priste e bën ligjëruesin të ndjehet keq; çasti i mos realizimit është gjithashtu i vendosur në të shkuarën

¹⁵¹ M. Dardano dhe P. Trifone, në librin e tyre : “*Grammatica italiana con nozioni di linguistica*”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995, f. 354, shprehen: “*Më se e kryera mund të marrë vlera modale të ndryshme nga ato të dëftores në përgjithësi...*”, duke trajtuar rastin, kur më se e kryera përdoret në vënd të kushtores në një periudhë hipotetike – *Se non mi fossi ammalato, a quest'ora avevo già terminato gli esami.*

e çastit të ligjërimit. Çasti i ligjërimit, gjithsesi është shumë i shkurtër në krahasim me kohën gjatë të cilës Marko “*kishte pritur*”.



“Quando incontrai Marco, egli *era* già *dedicato* allo studio dell’energia pulita”
(Kur takova Markon, ai i ishte dedikuar prej kohësh energjisë së pastër)

Përcaktimi kohor mbetet i papërcaktuar në të shkuarën, vetëm se lihet të kuptohet që kishte shumë kohë që Marko merrej me studimin e energjisë së pastër, kur u takua me ligjëruesin. Përkundrazi, çasti i takimit është i papërcaktuar, për shkak të foljes të vendosur në të kryerën e thjeshtë. Për ta paraqitur me skemë do të përdornim të njëjtin model skeme që kemi përdorur edhe lart.

Qëllon jo rrallë që konteksti të shoqërohet edhe me situata jo të qarta kuptimore. Në raste të tilla, kur u bashkëngjitet edhe papërcaktueshmëria e veprimit në të shkuarën, e shprehur me kohën “më se të kryer”, interpretimi i kuptimit ndërlikohet me të vërtetë shumë.¹⁵²

“La lettera *era rimasta* lì per un mese” (Letra *kishte mbetur* aty për një muaj)

Fjalìa mund të interpretohet në dy mënyra:

E para që *mbishkrimi vazhdonte të ishte atje*,

E dyta që *tashmë mbishkrimi nuk ishte më*.

¹⁵² P. M. Bertinnetto e trajton një rast të tillë dhe është i mendimit që çasti i kryerjes së veprimit bashkohet me çastin e referimit të këtij veprimi : “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinnetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986, f. 460. Gjithsesi, në mungesë të një konteksti më të plotë, që do ta përcaktonte qartazi, mendojmë që mund të ketë më shumë se një mënyrë interpretimi.

Gjithsesi, vetëm në rastin e interpretimit të parë vazhdojmë të kemi nuancë “përfshirëse”. Në rastin e dytë, harku kohor i fillim-mbarimit të veprimit do të ishte mjaft i përcaktuar.

Në përdorimin e saj imperfektiv, koha më se e kryer mund të zëvendësohet herë pas here prej kohës së pakryer, pa ndryshime të dukshme. E pakryera në këto raste, siç edhe e shqyrtoam më sipër, paraqitet me nuancën e nje veprimi në progresion:

“Marco, il quale *attendeva* da molto tempo quel momento di trionfo, ci rimase male” (Marko, i cili e *priste* prej kohësh atë çast triumfi, mbeti shumë keq)

“Marco, il quale *stava attendendo* da molto tempo quel momento di trionfo, ci rimase male” (Marko, i cili e kishte pritur prej kohësh atë çast triumfi, mbeti shumë keq)

Edhe më se e kryera, njësoj si e pakryera apo ndonjë kohë tjetër, mund të shprehë një situatë shprehimore statike, e cila shërben si sfond i një apo më shumë ngjarjeve.¹⁵³

“La gente *rideva* in continuazione mentre il comico recitava” (Njerëzia *qeshte* vazhdimisht, ndërkohë që humoristi recitonte)

“La gente *aveva riso* in continuazione, mentre il comico recitava” (Njerëzia *kishte qeshur* vazhdimisht, ndërkohë që humoristi recitonte)

Edhe pse zëvendësimi mund të kryhet me sukses vërejmë që ndryshimet kontekstuale në nuanca nuk janë të pakta.

E para: ajo që përmendëm pak më sipër. E pakryera paraqet një veprim në progresion, ndërsa më se e kryera një veprim statik.

E dyta: Distanca kohore prej çastit të ligjëritit rritet me përdorimin e më se të kryerës.

E treta: Veprimi i shprehur prej më se të kryerës, tingëllon si pasojë e veprimit tjetër, recitimit të humoristit. E njëjta situatë paraqitet edhe në shëmbullin tjetër:

“La folla *invadeva* le strade” (Turma *po pushtonte* rrugët – nuancë progresioni)

“La folla *aveva invaso* le strade” (Turma *kishte pushtuar* rrugët – nuancë statike)

¹⁵³ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“*Grande grammatica italiana di consultazione*”, A. Salvi, G. Cardinaletti, Il Mulino, 1995.

Ndërsa në shëmbullin e mëposhtëm, më se e kryera nuk shpreh veprim statik, por veprim shndëruës:

“L’ombra *oscurava* il fondo della vallata” (Hija po errësonte fundin e luginës – nuancë progresioni)

“L’ombra *aveva oscurato* il fondo della vallata” (Hija *kishte errësuar* fundin e luginës – veprim shndërrues)

Ndërsa në shëmbullin e mëposhtëm, vlera aspektore e përmbushjes së një veprimi, mbizotëron mbi atë të kryerjes së një veprimi para një tjetri, madje vërehet edhe që koha më se e kryer përfton nuancën e një veprimi të kthyer në zakon:

“...Al mattino andava all’ufficio; a mezzogiorno bussava regolarmente alla porta della clinica; alla sera andava a visitare i pazienti; e così, ogni giorno *aveva guadagnato* un sacco di soldi”

E njëjta situatë mund të vërehet edhe në gjuhën shqipe:

“*Kishte shkuar* të lutej çdo ditë të perëndisë, por dukej që perëndia e kishte harruar fare.”

Më se e kryera është mjaft e pasur edhe me vlera modale. Një ndër karakteristikat e kohës më se të kryer, është që të luajë një funksion hipotetik, duke paraqitur një realitet, i cili në fakt nuk është aspak real.¹⁵⁴ Për shëmbull:

“Senza quel dannato incidente, a quest’ora *eravamo già arrivati*” (saremmo arrivati)

Folja e vendosur në kohën më se të kryer, shpreh një veprim, që në fakt nuk ka ndodhur. Situata kuptohet lehtësisht edhe nga konteksti mjaft i qartë në këtë rast.

“Un istante in più ed *avevamo raggiunto* la vetta; peccato che non abbiamo avuto la possibilità” (avremmo raggiunto)

I njëjti fenomen përsëritet edhe në shëmbullin e dytë, i cili shpreh një veprim, që në fakt nuk ka mundur të realizohet. Varianti i përdorimit të kohës më se të kryer në këto kontekste, është karakteristikë posaçërisht e gjuhës së folur.

¹⁵⁴ “*Grammatica italiana con nozioni di linguistica*”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“*Impariamo l’italiano*”, C. Marchi, Biblioteca Universale Rizzoli, 1990.

Dhe së fundi, duke mbetur te vlerat modale të kohës më se të kryer, nuk duhet harruar përdorimi i kësaj kohe edhe në përshkrime të fantazisë letrare:

“Una pulce, *aveva abbandonato* la coda di un cane da caccia, ed *era andata* a finire nell’orecchio di un anziano signore . *Era entrata* nel foro auricolare, *aveva guadagnato* strada lungo il condotto acustico, *era saltata* sulla membrana timpanica, precipitandosi tra l’incudine e il martello.....Quel signore per poco non *era impazzito...*” (Guida alla pratica della creatività, A. Rossetto, p. 39).

7.4 Koha e kryer e tejskUAR.

Koha e kryer e tejskUAR tregon një veprim që ka ndodhur përpara një veprimi tjetër, të shprehur me te kryerën e thjeshtë.¹⁵⁵

Në fakt, koha e kryer e thjeshtë nuk ka një përdorim të gjërë në gjuhën e sotme italiane. Koha e kryer e tejskUAR përdoret kur:

- Fjalja kryesore është në të kryerën e thjeshtë;¹⁵⁶

-Kur e kryera e tejskUAR është e paraprirë nga një ndajfolje kohe e llojit: “*pasi që*”, “*sapo*”, “*kur*”, etj.

“Andai via solo dopo che lui mi ebbe salutato” (Ika vetëm pasi që ai më pati përshëndetur”

“Quando Carla se ne fu andata, Paolo telefonò alla madre” (Kur Karla qe larguar, Paolo i telefonoi të jëmës)

“Quando *avemmo vuotato* le nostre tazzine, l’Arciprete cominciò a parlarmi del paese...” (Cristo si è fermato a Eboli, C. Levi, p. 35)

¹⁵⁵ “La lingua italiana per stranieri”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“Grammatica italiana”, A. Panzini, Sellerio Editore, 1982.

“Grammatica per italiani maggiori”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

“Grammatica italiana con nozioni di linguistica”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995.

“I verbi italiani”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.

¹⁵⁶ “La lingua italiana per stranieri”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

Me ç'gaz e me ç'magji

Më *pate ndritur*

Në t'errtat fellësi

Kur *pate zbritur*.

Me petk për kremtërim

Më *pate veshur*

Me zulmë a me shkëlqim


Të buzëqeshur.

Përndritë në lavdi


Shpirtin e nxirë

Që breng e dhëmbshuri

Pat psherëtirë. (Vepra letrare, L. Poradeci, f.342)



Koha e kryer e tejshkuar



Koha e kryer e thjeshtë

Koha e kryer e tejshkuar është karakteristikë e gjuhës së shkruar dhe për këtë arsye është shumë e vështirë ta hulumtosh. Konsiderohet si një element gramatikor dhe gjuhësor, i përdorur veçanërisht për të shprehur një standart të lartë kulturor në përdorimin e gjuhës.¹⁵⁷Për shkak të vështirësisë së përdorimit, koha e kryer e tejshkuar evokon ambiente socio-kulturore, me individë që kanë kryesisht arsimim të lartë.

Disa përdorime letrare, paraqesin një të kryer të tejshkuar paksa të veçantë. Për t'i dhënë ngarkesë stilistikore, si dhe për ta theksuar edhe më tepër veprimin që shpreh, autorë

¹⁵⁷ “Grammatica per italiani maggioreni”, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.

të ndryshëm, sidomos në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, kanë përdorur formën: *Pjesore + foljen ndihmëse*, pra me rend të përmbysur.¹⁵⁸

“*Usciti che furono, non tornarono più*” (Në gjuhën shqipe, forma më e përshtatshme për ta përcjellë këtë sekuencë me sa më pak ndryshime është: *Dalë prej andej, nuk u kthyen më*; ose duke përdorur një tjetër formë, këtë herë më afër standartit, fjalia do të bëhej: *Pasi dolën, nuk u kthyen më*).

Në gjuhën italiane, koha e kryer e tejshkuar po gjen gjithnjë e më pak përdorim në dhjetë vjeçarët e fundit. Kjo kohë kërkon të kombinohet kryesisht me të kryerën e thjeshtë për të shprehur nocionin e një veprimi që ndodh përpara një veprimi tjetër dhe është mjaft e vështirë të gjejë përdorim duke u kombinuar me kohë të tjera.

Ngushtohet akoma më shumë rrezja e përdorimit të kohës së kryer të tejshkuar, edhe për faktin që nuk gjen përdorim në fjalitë e thjeshta, me përjashtim të ndonjë rasti poetik, në të cilin kjo kohë mund të përdoret edhe në fjali të tilla, por duke iu referuar stileve arkaike të italishtes.


Në fjalitë e varura kohore, koha e kryer e tejshkuar po has gjithashtu një përdorim gjithnjë e më të rrallë, megjithë gamën e nuancave që është në gjëndje të shprehë:¹⁵⁹

“*Da quando ebbe terminato i lavori di casa, Marco non trascorse mai un giorno libero*” (Që kur *pati përfunduar* punimet e shtëpisë, Marko nuk *pati* asnjëherë një ditë të lirë.)

Kuptimi kontekstual i mesazhit të mësipërm i referohet faktit që: *Marko kurrë nuk pati një ditë të lirë pasi përfundoi punimet e shtëpisë*. Përdorimi i kohës së kryer të tejshkuar, i lejon ligjëruesit ta shtrijë sa më tepër në kohë këtë fakt. Në fjalinë kryesore, përdorimi i ndajfoljes “*mai*” (kurrë), e përjashton faktin që Marko mund të ketë pasur një ditë të lirë, ndërsa prania e elementit kohor “*da quando*” në fjalinë e varur, përcakton periudhën (në të shkuarën) kur nisi kjo situatë. Madje konteksti krijon përshtypjen që kjo situatë nuk do të ndryshojë edhe në të ardhmen, duke e projektuar në të ardhmen edhe situatën e Markos.

¹⁵⁸ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.


¹⁵⁹ Shëmbujt janë vërejtur (dhe më pas janë përzgjedhur për t’u bërë pjesë e këtij punimi) në ushtrimet e shumta të dhëna nga gramatikat italiane, si p.sh. : “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010; “*Impariamo l’italiano*”, C. Marchi, Biblioteca Universale Rizzoli, 1990; “*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004, etj.



Por ndryshon kuptimi i mesazhit, nëse ndryshojmë kohën e foljes në fjalinë kryesore:

“Da quando *ebbe terminato* i lavori di casa, Marco non *aveva trascorso* mai un giorno libero” (Që kur *pati përfunduar* punimet e shtëpisë, Marko nuk *kishte patur* kurrë, një ditë të lirë.)

Koha e kryer e thjeshtë e foljes, në fjalinë kryesore, është zëvendësuar me kohën më se të shkuar. E gjithë situata shprehimore e mesazhit zhvendoset në të shkuarën, duke u distancuar nga çasti i ligjërimit. Kuptimi kontekstual i mesazhit ndryshon: informacioni i dhënë në fjalinë kryesore, lë të kuptohet se ndoshta, më së fundi, Marko e ka një ditë të lirë. Pra ajo që ndryshon është projektimi i faktit në të ardhmen: “*nuk kishte patur kurrë një ditë të lirë*” mbetet pjesë e të shkuarës dhe pa efekte për të ardhmen



Të njëjtat situata shprehimore mund të riprodhohen edhe në gjuhën shqipe:

“Që kur e *patën plagosur* në vitin e trazuar ’97, nuk *pati* kurrë dëshirë të përzihej me politikë” (Pasojat e vitit ’97 duket sikur nuk do të zhduken kurrë më dhe folja në fjalinë kryesore shpreh një situatë që nuk do të ndryshoje edhe në të ardhmen.)

“Që kur e *patën plagosur* në vitin e trazuar '97, nuk *kishte patur* kurrë dëshirë të përzihej me politikë” (Mbetet e hapur mundësia që të merret me politikë pas çastit të ligjërimit, ose ka filluar të merret pak përpara këtij çasti.)

Këto ndryshime nuancore të kontekstit humbasin, nëse në mesazh janë të shprehur qartë kufijtë kohorë të secilit prej veprimeve.

“Quando *ebbe* ormai *spedito* la lettera da ben due ore, Marco *si accorse* di aver dimenticato l'indirizzo” (Dy orë pasi pati dërguar letrën, Marko vuri re që kishte harruar adresën)

“Quando *ebbe* ormai *spedito* la lettera da ben due ore, Marco *si era accorso* di aver dimenticato l'indirizzo” (Dy orë pasi pati dërguar letrën, Marko kishte vënë re që kishte harruar adresën)

Në të dy shëmbujt e dhënë më sipër, kufiri kohor i vendosur prej ligjëruesit (*pas dy orësh*), bën që krejt situata shprehimore të kufizohet në këtë periudhë, ndërsa çasti i ligjërimit ndodhet dukshëm më pas.

Gjithsesi, problemi i paraqitur më sipër ka dy pamje: nga njëra anë kemi të bëjmë me marrëdhëniet kohore që vendosen midis kohës së kryer të tejkshuar dhe kohës së shprehur nga folja në fjalinë kryesore; dhe nga ana tjetër me marrëdhëniet aspektore, që vendosen midis pozicionimit në kohë të situatës se dhënë nëpërmjet foljeve dhe çastit të ligjërimit. Kontrastet që mund të krijohen midis këtyre dy aspekteve, i hapin rrugë vlerave të veçanta shprehimore dhe stilistikore.

Përgjithësisht koha e kryer e tejkshuar paraqet një veprim që ka ndodhur përpara një veprimi tjetër, por në marrëdhëniet kohore që mund të vendosen në periudhë, këto raporte kohore ndonjëherë edhe ndryshojnë¹⁶⁰:

“Marco *ebbe varcato* la soglia, *nonappena* le luci *si accesero*” (Marko pati kapërcyer pragun, sapo u ndezën dritat)

“Marco *ebbe varcato* la soglia *nel momento in cui* le luci *si accesero*” (Marko pati kapërcyer pragun, në çastin kur u ndezën dritat)

Në këta shëmbuj, koha e kryer e tejkshuar nuk shpreh një veprim që ka ndodhur përpara atij të dhënë nga folja e fjalisë kryesore, por që të dy veprimet ndodhin paralelisht

¹⁶⁰ “*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004 .

dhe në të njëjtën kohë. Në të dyja rastet, Marko e kalon pragun e portës, në çastin kur ndizen dritat dhe i gjithë kumtimi i mesazhit ka për qëllim të fiksojë pikërisht këtë çast.

Ebbe varcato

Veprimi 1 →

nonappena, nel momento in cui

Veprimi 2 →

le luci si accesero

Në raste të tjera, raporti midis të kryerës së tejshtuar dhe kohës së shprehur nga fjalia kryesore, ndjek një tjetër rrjedhë logjike:

“Marco *continuò* a lavorare, fino a che non *ebbe ricevuto* l’ordine di smettere”
(Marko *vazhdoi* të punonte, deri sa nuk *pati marrë* urdhërin që ta linte)

Veprimi i shprehur nga koha e kryer e tejshtuar, ndërpret veprimin e shprehur nga folja në fjalinë kryesore. Vetë qëllimi i kumtimit, duket se është përsëri fiksimi i këtij çasti, i momentit që Marko e lë punën, si dhe i dhënies së shkakut, “përse?” veprimi në këtë mënyrë. E kryera e tejshtuar pra, jo gjithmonë shpreh një veprim që ndodh përpara atij të shprehur nga folja e fjalisë kryesore. Realiteti që na rrethon është aq i shumëfishtë dhe i larmishëm, saqë kjo gjë nuk ka si të mos reflektohet edhe në aspektet kontekstuale të ligjëratave.

Në gjuhën italiane, përdorimi ose jo i të kryerës së tejshtuar, varet në një farë mase edhe nga kuptimi semantik i foljes, që duhet të zgjedhohet. Ka disa lloje foljesh, të cilat çuditërisht, edhe për shkak të aspektit që paraqesin, nuk ia dalin të shprehin kuptim të mirëfilltë me të kryerën e tejshtuar. Të tilla janë, për shëmbull, disa folje që shprehin një veprim i cili ndodh në një fragment të vetëm kohe;¹⁶¹

“Appena *fu nato* (???), i presenti lanciarono grida di gioia”

“Nonappena *si fu sorpreso* (???), trovò la forza di reagire”

¹⁶¹ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

Në fakt, në gjuhën shqipe këto situata shprehimore gjejnë zgjidhje me përdorimin e të kryerës së tejskuar.

“Sapo *pati lindur*, të pranishmit lëshuan klithma gëzimi”

“Menjëherë sapo e *patën zënë* në befasi, gjeti forca që të reagonte”

E njëjta situatë paraqitet edhe me folje që tregojnë një veprim në proces, pra një veprim që vazhdon për një kohë të pacaktuar, si për shëmbull me folje të llojit: *ridere* (qesh); *correre* (vrapoj); *passeggiare* (shëtis) etj.¹⁶²

“*Ebbe riso* (???) di cuore quando gli raccontarono tutto”

“Appena *ebbero passeggiato* (???), ripresero il lavoro”

Edhe njëherë tjetër gjuha shqipe nuk paraqet probleme të kësaj natyre:

“*Pati qeshur* me gjithë zemër, kur i treguan gjithshka”

“Menjëherë pasi *patën shëtitur*, rinisën punën”

Gjithsesi koha e kryer e tejskuar gjen përdorim sa herë që paraqitet nevoja për nuancat e dhëna prej saj dhe që nuk mundet t’i shprehë asnjë kohë tjetër. E kryera e tejskuar e teksteve letrarë, vazhdon të na mahnisë me bukurinë, elegancën dhe të veçantën që paraqet:

“D’un tratto alcune finestre *furono spezzate* come premute da una forza interna, le scintille uscirono all’aperto punteggiando di luci vaganti il buio della notte. Il vento, da forte, *fu diventato* più leggero, e fu sventura, perché forte avrebbe forse spento le scintille, leggero le trasportava, eccitandole...” (Il nome della rosa, U. Eco, p. 245)

“Dhe ne po shtrydhnim lot

Dëshpërimtarë

Ndaj vamë e s’ardhmë dot

Dh’u *patmë ndarë!*” (Vepra letrare, L.Poradeci, f. 338)

¹⁶² Fenomeni u vërejt në fillim me foljen “*correre*”, që tregon një veprim në proces dhe të papërfunduar. Më pas u shtri edhe në folje të tjera, në shumë prej të cilave me të njëjtin rezultat.

KREU 8: E ARDHMJA DHE E ARDHMJA E PËRPARME.

Përpara se të trajtojmë çështje të së ardhmes dhe të ardhmes së përparme në gjuhën italiane, nevojitet të bëjmë disa saktësime mbi klasifikimin që u bëhen këtyre dy kohëve në gjuhën shqipe dhe në atë italiane.

Në gjuhën italiane, e ardhmja klasifikohet në dy lloje: “*Futuro Semplice*” (E ardhmja e thjeshtë) dhe “*Futuro Anteriore*” (E ardhmja e përparme) . (“*Nuova grammatica italiana*”, M. Dardano, P. Trifone; “*Grammatica pratica della lingua italiana*”, S. Nocchi; “*Grammatica italiana*”, G. Pittano; “*Dizionario di Linguistica*”, Zanichelli).¹⁶³

Në “*Gramatika e gjuhës shqipe I*”, botim i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, si dhe i Akademisë së Shkencave, 2002, f. 290 – 291 , koha e ardhme klasifikohet në katër lloje: e ardhme; e ardhme e përparme; e ardhme e të shkuarës; e ardhme e përparme e të shkuarës.

Duket qartazi që Instituti i gjuhësisë e ka klasifikuar të ardhmen edhe sipas nuancave aspektore që ajo shpreh, ndërkohë që në gjuhën italiane, “Il dizionario di linguistica”, Zanichelli, 1983, p. 131) jep këtë përshkrim:

“...E ardhmja është një kohë që e vendos faktin një çast pas të tashmes...{...}...Quajmë të ardhme të përparme, një tërësi formash foljore, të përbëra nga foljet ndihmëse “kam” dhe “jam” plus të shkuarën e pjesores. ... E ardhmja e përparme shfaq kategorinë e aspektit (veprim të kryer) dhe kategorinë e kohës (veprim, kryerja e të cilit ndodh pas çastit të ligjërit) ...¹⁶⁴.

Siç shihet, gramatikat e gjuhës italiane i përmbledhin format aspektore me të ardhmen e përparme, ndërkohë që kemi një ndarje më të imtësishme sipas gramatikës së gjuhës shqipe.

Futuro semplice: “La dea Kali *ucciderà* tutti i suoi nemici” (La corona di Nana Sahib, L. Motta, p. 67)

¹⁶³ “*La nuova grammatica della lingua italiana*”, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1997, f.345

“*Grammatica pratica della lingua italiana*”, S. Nocchi, R. Tartaglione, Alma Edizioni, 2006.

“*Dizionario di linguistica*”, Zanichelli, 1983.

¹⁶⁴ “*Dizionario di linguistica*”, Zanichelli, 1983, f. 131.

“...Che emozione

Sarà perché ti amo...” (*Sarà perché ti amo*, Ricchi e Poveri, canzone)

Futuro anteriore: “...Ma, quando io *avrò finita* l’eroica fatica di trascriver questa storia da questo dilavato e graffiato autografo, e *l’avrò data*, come si suol dire, alla luce, si troverà poi chi duri la fatica di leggerla?...” (*Grammatica per italiani maggiorenni*, M. Luisa, A. Biagi, p. 134)

E ardhme: “...-Dëgjoni o tridhjetë zotërit e vëndit! Dua t’ju pyes për një fjalë. A *do të më përgjigjeni?*”

- Folë Muj, se po të dëgjojmë. Sa për përgjigjen, po të jemi të zotët, *do të ta japim*, po të mos jemi, nuk *do çelim gojë..*” (*Tregime të moçme shqiptare*, M. Kuteli, f. 171)

“Te udhë e ngushtë, te fiqtë,

do të vdesim të dy një ditë,

të gëzohen inatçinjtë,

pak të tutë e shumë të mijtë.

-Inatçinjt të mos gëzojnë,

Se unë e ti *do të rrojmë!* (*Këngë popullore të Labërisë*, Mbledhës, f. 304)

E ardhme e përparme: “Deri nesër në mesditë *do t’i kem larë* hesapet”

“Sa të sqarohen gjërat, fjala *do të ketë marrë* dhenë”

E ardhmja e të shkuarës: “*Do të doja* të mos vija me ju, por me sa duket fatit nuk i shpëtoj dot.”

E ardhmja e përparme e të shkuarës: “*Do të kisha dashur* që gjërat të shkonin ndryshe, por në këtë pikë, nuk ka më kthim prapa”

Siç vërejtëm edhe më sipër, koha e ardhme tregon përgjithësisht një ngjarje që pritet të ndodhë pas çastit të ligjërimit. Meqënëse askush nuk është në gjëndje të njohë të ardhmen, thuajse të gjitha pohimet e bëra për ngjarje që do të ndodhin në të ardhmen janë pak a shumë të pasigurta. Gjithsesi, përdorimi i kohës së ardhme është i njëjtë si për ngjarje, përfundimi i të cilave është i sigurtë që do të realizohet, ashtu edhe për ngjarje

realizimi i të cilave ka mundësi të ndodhë, apo edhe për disa ngjarje të tjera, të cilat nuk kanë gjasa të realizohen.

“Venerdì prossimo *sarà* il mio compleanno”; (ngjarja që pritet të ndodhë është e sigurtë).

“Tra una settimana *partiremo* per le vacanze”; (vendimi për të cilin bëhet fjalë ka mundësi të realizohet)

“Chissà se sabato *farò* 6 al superenalotto”; (ngjarja për të cilën e ka fjalën ligjëruesi, nuk ka pothuajse fare mundësi të ndodhë)

Në pjesën më të madhe të rasteve, e ardhmja ka vlerë perfekteve¹⁶⁵, pra veprimi i shprehur me kohën e ardhme supozohet që do të kryhet plotësisht në të ardhmen.¹⁶⁶

8.1 Vlera kohore të së ardhmes së thjeshtë.

Ndër të tjera, e ardhmja e thjeshtë ka vlera shprehimore jo modale. Kjo është edhe mënyra më karakteristike e paraqitjes të kohës së ardhme të thjeshtë, pra kur ajo shpreh një veprim që do të kryhet pas çastit të ligjërimit. Gjithsesi kjo përmbushje në të ardhmen e çastit të ligjërimit përmban një natyrë disi rastësore, për shkak se kur bëhet fjalë për të ardhmen, është e pamundur të flitet për diçka që do të ndodhë me siguri absolute. Ndoshta ligjëruesi mund të shprehë me anë të intonacionit, apo të mjeteve të tjera gjuhësore dhe ekstragjuhësore sigurinë e tij që gjithshka do të realizohet, por kjo nuk mund ta ndryshojë kontekstin e të ardhmes në mesazh dhe as pasigurinë që përmban ajo.

Shpesh, kjo pasiguri për përmbushjen e gjithshkaje në të ardhmen nuk i shpëton ligjëruesve, të cilët vënë në veprim edhe mjete gjuhësore për ta shprehur këtë pasiguri:

“Se lo dici, vuol dire che così *sarà*” (Nëse e thua ti, do të thotë që kështu *do të bëhet*)

¹⁶⁵ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

¹⁶⁶ Siç do ta vërejmë edhe më tej këtij punimi jo gjithmonë ndodh kështu. Mjafton të citojmë rishitazi “*Gramatika e gjuhës shqipe I*”, Akademia e Shkencave, 2002.

Ligjëruesi përdor ironinë për t'u distancuar nga ideja se e ardhmja do të realizojë me çdo kusht atë për të cilën bëhet fjalë. Përsa i përket gjuhës dhe kohës së ardhme të thjeshtë, mund të shprehen si të sigurta deri edhe ngjarje që s'kanë të bëjnë fare me diçka që jo vetëm nuk mund të merret si e sigurtë, por ndonjëherë nuk mund të merret as seriozisht, siç është rasti i shëmbullit që vijon:

“Sabato prossimo *vincerò* il superenalotto!” (Të shtunën e ardhshme do të fitoj llotarinë)

Gjithsesi, siç edhe e pamë në shëmbujt e mësipër, ka disa lloje informacionesh, të cilat i përkasin të ardhmes për t'u realizuar dhe për të cilat nuk ekziston as dyshimi më i vogël:

“Venerdì prossimo *sarà* il compleanno di mio zio!” (Të premten e ardhshme do të jetë ditëlindja e xhaxhait tim)

“Domani *sarà* il 25 giugno 2011” (Nesër do të jetë 25 qershor 2011)

Krejt e ardhmja, në fakt, hap mundësi për disa lloje realizimesh, si p.sh. në një periudhë të caktuar, në një periudhë të pacaktuar, si mundësi për t'u realizuar, si hipotezë, si dëshirë,¹⁶⁷ e kështu me rradhë:

“Marco *verrà* a trovarci tra un po'di tempo”(Marko *do të vijë* të na takojë së shpejti)

“Marco *verrà* a trovarci l'anno prossimo”(Marko *do të vijë* të na takojë vitin tjetër)

“Marco *verrà* a trovarci tra una settimana”(Marko *do të vijë* të na takojë pas një jave)

“Speriamo che Marco *verrà* a trovarci” (Të shpresojmë se Marko *do të vijë* të na takojë)

Koha e ardhme e thjeshtë mund të shprehë edhe vlera modale. Ndër më të përdorurat janë shprehja e dyshimit dhe lejorja:¹⁶⁸

“*Farà* bel tempo domani?” (*Do të bëjë* kohë e mirë nesër?)

¹⁶⁷ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.

¹⁶⁸ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

“Tu riuscirei anche a batterlo, non lo nego; ma lui gioca decisamente meglio.” (Ti do t’ia dalësh ta mundësh, nuk e mohoj; por ai luan pa dyshim më mirë)

Koha e ardhme e thjeshtë mund të përdoret për të shprehur edhe një urdhër:

“Domani *andrai* con i tuoi compagni, e non voglio più discuterlo”(Nesër *do të shkosh* me shokët e tu dhe nuk dua ta diskutoj më). Përdorimi i kohës së ardhme për të dhënë një urdhër e shkaput ligjëruesin (atë që jep urdhër) nga konteksti i të tashmes dhe krijon një distancë midis tij dhe personit që urdhërohet. Nga ana psikologjike, kjo distancë shërben për të mos e diskutuar më urdhërin, por edhe si një periudhë kohore sigurie për të ndryshuar qëndrimin, në rast të një refuzimi.

Një rast të veçantë përbën konteksti i urdhërit të lëshuar nga persona të veshur me pushtet, autoriteti i të cilëve jo vetëm nuk diskutohet, por në publik u njihet e drejta për të lëshuar urdhëra:

“D’ora in poi chi trasgredisce le regole accettate da tutti, *pagherà* la multa”(Tani e tutje, kushdo që thyen rregullat e pranura nga të gjithë *do të paguajë* gjobë).

Ndryshimi midis këtij rasti dhe atij të mëparshmit, është që në shëmbullin e parë (*Nesër do të shkosh me shokët ...*) zbatimi i urdhërit të dhënë është i dyshimtë dhe ka gjasa të mos zbatohet, ndërsa në shëmbullin e dytë, për shkak se autoriteti është i njohur dhe nuk mund të vihet në diskutim urdhëri i tij, bashkëbiseduesit nuk kanë dyshime që do të ndodhë ashtu siç edhe ligjëruesi e paraqet situatën.

Ndër vlerat modale të kohës së ardhme të thjeshtë, një vënd të rëndësishëm zë dhe e “ardhmja që shërben për të zbutur një situatë të caktuar”¹⁶⁹. Ky është një prej rasteve të veçanta të përdorimit të së ardhmes dhe pa dyshim që mbart edhe vlera shprehimore dhe stilistikore, për shkak se nuk shpreh një veprim që pritët të ndodhë në të ardhmen. “E ardhmja që shërben për të zbutur një situatë të caktuar shprehimore”, përdoret kryesisht për ta bërë sa më pak të ashpër një situatë apo një kumtim, drejtuar një bashkëbiseduesi:

“*Ammetterai* che non ti sei comportato da amico con lui.” (*Do ta pranosh* [Duhet ta pranosh] që nuk je sjellë si mik me atë)

“Le *dirò* che queste sue critiche, non mi hanno precisamente gettato nella disperazione” (*Do të të them* që këto kritikë e tua, nuk më kanë dëshpëruar aspak).

¹⁶⁹ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

Asnjë prej dy shëmbujve të mësipërm nuk bën fjalë për veprime të së ardhmes. Përdorimi i kësaj forme është i natyrës psikologjike: ligjëruesi kërkon të shprehë mendimin e tij, që ka të bëjë pikërisht me qëndrimin e ligjëruesit nga ai çast e tutje, në të ardhmen.¹⁷⁰

Koha e ardhme e thjeshtë mund të shprehë jo vetëm një urdhër, por edhe një dëshirë:

“Domani *verrà*” (Nesër *do të vij*). Pavarësisht faktit nëse të nesërmen ligjëruesi do të shkojë ose jo aty ku thotë, përdorimi i kohës së ardhme e ngarkon fjalinë me kuptimin e dëshirës për ta përmbushur atë veprim. Ndajfolja e kohës tregon që veprimi pritet të verifikohet në të ardhmen e afërt dhe për këtë shkak përmban edhe një dozë të dukshme sigurie.¹⁷¹

Një tjetër përdorim mjaft i përhapur i të ardhmes, është ai që gjen zbatim në kontekste të natyrës hipotetike. Shëmbulli më tipik për këtë rast është:¹⁷²

“Se verrai, ci farai un piacere” (Nëse do të vish, do të na e bësh qejfin).

Në disa shkrime të karakterit dokumentar dhe historik, e ardhmja e thjeshtë përdoret për të bërë një retrospektivë të ngjarjeve¹⁷³, ndërkohë që lexuesi mund t'i shijojë ngjarjet duke i ndjekur me një ngjyrim të ardhmeje, pavarësisht se çasti i ligjërimit është dukshëm pas momentit në të cilin verifikohen ngjarjet që përshkruhen.

“Negli anni '30 del XX secolo, l'Europa era nel pieno di una crisi economica. Su questa constatazione si arresta la nostra ricostruzione. In seguito, e precisamente nel 1939, *inizierà* la Seconda Guerra Mondiale, che *vedrà* come protagonisti le grande potenze: la Germania, l'Italia, il Giappone, l'Inghilterra, la Francia, l'America e l'Unione Sovietica...”

Përdorimi i të ardhmes në kontekstin e mësipërm, bëhet në raport me pjesën e parë të informacionit: (krizën e viteve '30 në Europë). Pikërisht si pasojë e përdorimit më pas të së ardhmes, krijohet një kuptim kontekstual, sipas të cilit kjo krizë, që sjell si pasojë gjithshka shprehet me kohën e ardhme, është edhe shkak i ngjarjeve të mëvonshme.

E ardhmja e thjeshtë mund të përdoret edhe me funksion gnomik, ose të shprehë një nuancë jashtëkohore, në fjalë të urta, llogaritje matematikore, përfundime filozofike etj.

¹⁷⁰ Karakteristikë e këtyre strukturave është që përdoren shpesh në gjuhën e folur, standarte.

¹⁷¹ Duke qënë kohë foljore që shpreh të ardhmen, mjaft shpesh e ardhmja e thjeshtë i shërben ligjëruesit që të shprehë shpresën e tij për realizimin e një dëshire, apo dëshirën që veprimi të realizohet, etj. Edhe ky shëmbull u has dhe u vërejt gjatë përdorimit të gjuhës së folur standarte.

¹⁷² “*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

¹⁷³ “*Lingua, Grammatica, Stile*”, G. Tedeschi, Petrini, 1971.

“Le buone azioni non *saranno* mai dimenticate”

“Dëshmorët e atdheut nuk *do të harrohen* kurrë”etj.

8.2 Vlera aspektore të kohës së ardhme të thjeshtë.

Siç e kemi pohuar edhe më sipër, koha e kryer e thjeshtë është një kohë perfektive. Veprimi i shprehur me anë të së ardhmes së thjeshtë, përgjithësisht e shpreh çastin e përfundimit duke e vendosur brënda kufijve të një kohe të përcaktuar që më parë. Por pikërisht në këtë aspekt duhet bërë edhe një saktësim: meqënëse veprimi vendoset në të ardhmen, përfundimi i tij, ose përcaktimi i kufijve kohorë të këtij veprimi nuk është i dhënë më siguri të plotë; ky veprim nuk i përket, për shëmbull, një kohe të shkuar, në të cilën ne të dallojmë kur ka nisur dhe kur ka përfunduar veprimi, por shtrihet drejt të ardhmes, duke na dhënë një vizion për të ardhmen. Pra përcaktimi kohor i kryerjes së veprimit është më tepër një perspektivë e këtij veprimi, se një veprim i mirëfilltë i kryer dhe i përfunduar.

Duke mbetur në këtë çështje, mund të thuhet që karakteri perfektiv i kohës së ardhme të thjeshtë, ka më tepër një natyrë aspektore, se një qasje semantike të asaj që shpreh realisht, përkundrajt konteksteve në të cilat përdoret. Nga ana tjetër, nëse analizojmë përfundimin e veprimeve të shprehura me të ardhmen e thjeshtë, do të vërejmë që kemi të bëjmë me një projektim të këtij çasti dhe jo me një mbyllje reale të veprimit, i cili nuk mund të konsiderohet i tillë, për sa kohë çasti i ligjërit është vendosur përpara tij në rrjedhën kronologjike të ngjarjeve.

Gjithsesi, koha e ardhme e thjeshtë shfaq edhe nuanca të tjera aspektore, një prej të cilave është nuanca e një veprimi në progresion. Për shëmbull kur themi:

“*Camminerà per la sua strada e non volterà la testa per guardare il passato*” (*Do të ecë në rrugën e tij dhe nuk do ta kthejë kokën për të parë të shkuarën*)

“*Volerà sempre in alto, libero*” (*Do të fluturojë gjithnjë e më lart, i lirë*)

“*Maratonomaku do të vrapojë në shekuj, duke përcjellë mesazhe lirie*”

Koha e ardhme e thjeshtë mund të përdoret për të shprehur edhe supozime aspak të sigurta për të qënë reale, ose vlerësime të përafërta. Në italisht, kjo e ardhme është quajtur edhe “*il futuro suppositivo*”¹⁷⁴ (e ardhmja e supozimit) dhe përdoret gjerësisht në gjuhën e folur, bashkëbisedim, dialogje letrare, etj.

- Bentornato! *Avrai fame dopo questa camminata.* (Kemi të bëjmë me një hamëndësim nga ana e ligjëruesit, që jo domosdoshmërisht është real)

- *Saranno le cinque – cinque e mezza!* (Harku kohor që shprehet në kontekst është një vlerësim i përafërt, pasi shpreh një shtrirje të gjerë kohore)

- *Questa bistecca è enorme; peserà un chilo* (Kemi të bëjmë përsëri me një vlerësim të përafërt, pasi ligjëruesi nuk mund të jetë i sigurtë sa peshon me të vërtetë bifteku)

- *Do të jetë më shumë se pesë metra i thellë.*

Supozime apo vlerësime të përafërta mund të bëhen edhe me fenomene atmosferikë që priten të ndodhin, për shëmbull:

- *Fuori comincerà a piovere* (Megjithatë, deri në çastin kur do të fillojë vërtetë të bjerë shi, gjithshka mbetet një supozim.)

- *Sot do të bjerë dëborë!*

E ardhmja që shpreh supozim e mbështet natyrën e saj në pasigurinë që shoqëron të ardhmen në përgjithësi. Nëse vlerësimi i bërë prej ligjëruesit, shpreh saktësi, në raste të tilla kemi të bëjmë me një nuancë, që është në kontrast me pasigurinë e të ardhmes si kohë:

- *Saranno 20 e 25 minuti !*

-*Avrai 153 km da percorrere!*

¹⁷⁴ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

8.3 Vlera aspektore të kohës së ardhme të përparme.

Sipas gramatikave italiane, e ardhmja e përparme përdoret për të treguar një veprim, që do të kryhet në të ardhmen, përpara një tjetër veprimi, i cili gjithashtu do të kryhet në të ardhmen.¹⁷⁵ Sipas këtyre vlerësimeve, koha e ardhme e përparme shpreh një të “shkuar në të ardhmen”.

Siç e përmendëm edhe në fillim të këtij kreu, gramatika e gjuhës shqipe, botim i Akademisë së Shkencave, e trajton aspektin e të shkuarës, të kohës së ardhme, si kategori më vete, madje të ndarë në të “ardhme të së shkuarës” dhe “të ardhme të përparme të së shkuarës”

Gjithsesi, e ardhmja e përparme e gjuhës italiane, tregon një veprim që ndodh pas çastit të ligjërit, por përpara çastit të cilit ai i referohet dhe që normalisht është i shprehur me një tjetër veprim, gjëndje a fakt.

“Quando ti *sarai accorto* che avevo ragione, ti mangerai le mani, ma sarò troppo tardi” (Kur *do ta kesh vënë* re që kisha të drejtë, do t’i biesh ballit me dorë, por do të jetë tepër vonë. - Në gjuhën shqipe, po t’i qëndrojmë klasifikimit të bërë nga akademia e shkencave, e njëjta nuancë mund të shprehet duke përdorur “të ardhmen e përparme të së shkuarës”)

Në gjuhën italiane, e ardhmja e përparme gjen përdorim kryesisht në gjuhën standart, të shkruar. Ndërsa në gjuhën e folur, fjalia e mësipërme do të shndërrohej:

“Quando ti *accorgerai* che avevo ragione, ti mangerai le mani, ma sarò troppo tardi” (Kur *do të vësh* re që kisha të drejtë, do t’i biesh ballit me dorë, por do të jetë tepër vonë)

Gjithsesi, jo gjithmonë koha e ardhme e përparme e vendos veprimin përpara një çasti të cilit i referohemi. Kështu ndodh për shëmbull kur themi:

“Alle 7.00 *avrò terminato* di fare i compiti” (Në 7.00 *do të kem përfunduar* së bëri detyrat).

¹⁷⁵ “*La nuova grammatica della lingua italiana*”, M. Dardano, P.Trifone, Zanichelli, 1997, f.345

“*Grammatica pratica della lingua italiana*”, S. Nocchi, R. Tartaglione, Alma Edizioni, 2006.

“*La lingua italiana per stranieri*”, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.

“*Lingua, Grammatica, Stile*”, G. Tedeschi, Petrini, 1971.

“*I verbi italiani*”, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.

“Në orën 8.00 të pasdites do të kem mbërritur në shtëpi.”

Për ta konsideruar si të vërtetë secilin prej kumtimeve të msipërme, nuk ka rëndësi nëse veprimi do të përfundojë përpara orës 7.00, apo përpara orës 8.00; e rëndësishme është që të mos përfundojë më vonë se këta kufij kohore, të vendosur nga vetë ligjëruesi. Me kohën e ardhme të thjeshtë, në pamje të parë, gjërat duket se janë më të qarta, ndoshta edhe për shkak të ndryshimeve që ekzistojnë midis dy kohëve të së ardhmes. Por ajo që ndryshon janë vendosjet në kohë dhe hapësirë të veprimeve, ligjëruesve, ndryshimet e largësive kohore dhe gjithshka që ka të bëjë me nuanca aspektore, shprehimore, stilistikore.

Ndonjëherë koha e ardhme e përparme shpreh edhe një veprim zakonor.¹⁷⁶


“Ogni qual volta *avrai constatato* qualcosa di strano, ce lo dirai immediatamente” (Sa herë që *do të konstatosh* diçka të çuditëshme, do të na e thuash menjëherë).

“Ogni giorno *avrai visto* gli alberi nel cortile e *avrai udito* gli uccelli cantare, ma ora le cose sono cambiate” (në gjuhën shqipe kjo situatë përçohet me atë që quhet “e ardhmja e përparme e të shkuarës”, një nuancë kjo sa e veçantë aq edhe stilistikore: “Çdo ditë do të kesh parë pemën në oborr dhe *do të kesh dëgjuar* zogjtë të këndojnë, por tani gjërat kanë ndryshuar)¹⁷⁷.

Analiza e këtij rasti paraqitet shumë komplekse. Së pari kemi të bëjmë me një hamëndësim nga ana e ligjëruesit, i cili i referohet në këtë mënyrë sjelljes, në dukje zokonore, të bashkëbiseduesit, por pa qënë i sigurtë që gjërat kanë rrjedhur pikërisht kështu. Në rradhë të dytë, është shumë e vështirë, ta sistemojmë mbi boshtin e kronologjisë kohore, kohën e ardhme të përdorur në mesazh. Në gjuhën italiane, forma foljore e përdorur përfiton, në fakt, nuancat e asaj që në gjuhën shqipe konsiderohet si “e ardhme e përparme e të shkuarës”, por ndërsa shqipja e ka qartësisht të dallueshme edhe në formë, italishtja e nxjerr si vlerë aspektore vetëm pasi i bëhet një analizë e kujdeshme. Në se realizojmë skemën e kronologjisë së veprimeve, forma e ardhme e realizuar në kontekst vendoset në të shkuarën e çastit të ligjëritimit.

¹⁷⁶ “*Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano*”, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca, 1986.

¹⁷⁷ “*Gramatika e gjuhës shqipe I*”, Akademia e Shkencave, 2002.



E njëjta situatë haset në gjuhën italiane kur themi:

“Marco *sarà disceso* da una famiglia nobile” (Marko *do të ketë* rrjedhur nga një familje fisnikësh – i shprehur stilistikisht, veprimi ka ndodhur në të shkuarën, pasi Marko ka qënë i tillë që nga lindja. Gjuha shqipe, gjithsesi e zgjidh situatën me përdorimin e të ardhmes së përparme, vetëm nëse ... “*Marko nuk është më në jetë*”. Atëhere ndryshon krejt këndvështrimi ynë mbi ngjarjen dhe gjuha shqipe, për të ruajtur kuptimin kontekstual të formës së ardhme të përdorur në variantin italisht, do të përdorte edhe njëherë të ardhmen e përparme të së shkuarës. Mungesa në mesazh e një pike referimi kohore në raport me Markon, lë të hapur mundësinë e shumë interpretimeve, që gjithsesi e zhvendosin veprimin e shprehur nga forma e ardhme e zbatuar mbi foljen, drejt të shkuarës dhe jo drejt të ardhmes së çastit të ligjërimit.

Të njëjtin përdorim mund ta hasim edhe në gjuhën shqipe, kur konteksti shpreh një hamëndësim (supozim), pra asgjë të sigurtë:

“...Kushedi se ç’duar *do ta kenë përdorur!* Kushedi sa beteja *do të ketë bërë!* Kushedi sa piratë *do të ketë shpuar!*...” (Shpella e piratëve, P. Marko, f. 120)

Duket sikur forma e të ardhmes, ka zëvendësuar kohën e kryer:

“...Kushedi se ç’duar e *kanë përdorur!* Kushedi sa beteja *ka bërë!* Kushedi sa piratë *ka shpuar!*...”

E njëjta formë haset edhe në gjuhën italiane, po në kontekste që shprehin hamëndësim:

“Dove *sarà andato* a cacciarsi?” (E ardhmja e përparme mund të zëvendësohet me kohën e kryer – “Dov’è *andato* a cacciarsi?”)

Ndërsa në fjalinë: “*Saranno state* sì e no le tre.” (Koha e ardhme e përparme zëvendëson kohën e pakryer –“*Erano* sì e no le tre”)

Ndonjëherë, në gjuhën shqipe, e shkuara e shprehur me të ardhme të përparme është aq afër të tashmes së ligjërit, saqë pothuajse shkrihen në një të vetme:

“...Tani prindërit *do të jenë zgjuar*, mendonim, dhe *do të kenë thënë*: - Po ç’u bënë djemtë tanë? – *Do të kenë shkuar* në Stavridh për të parë vashat si kërcejnë!. Ashtu *do të kenë thënë*. Dhe pastaj *do të jenë nisur* për punë...” (Shpella e piratëve, P.Marko, f. 62)

Në disa raste, e kryera e përparme përfton edhe nuancat e një veprimi që kryhet shpejt e shpejt, veçanërisht kur ndihmohet në këtë proces nga shprehje ndajfoljore. P.sh:

“Sono certo che mi *avrete* ben presto *dimenticato*.”

“*Avrai dormito* in due minuti”

Në përshkrime me karakter historik, e ardhmja e përparme përdoret për të bërë retrospektivë të ngjarjeve¹⁷⁸, duke e vendosur ligjëruetin në një pozicion jashtëkohor, për shkak të përdorimit të një forme kohore të ardhme, për ngjarje që tashmë i përkasin historisë:

“...Questa era dunque la situazione della nostra gente sul finire del secolo scorso. Ma in breve tempo, anche gli ultimi rappresentanti di quella generazione *saranno dispersi*: gente felice, che tuttavia, prima di morire *avrà* ancora *assistito* con sgomento al diffondersi dell’industrializzazione, senza mai riuscire ad abituarcisi...”

Ndërsa në shëmbujt e mëposhtëm, forma e të ardhmes që është përdorur, shpreh plotësisht një të ardhme:

“...Ti amo Lucia: e tu sarai la sola donna, cui avrò detto queste parole senza mentire”

“...Kur *do të jemi futur* në atë det shpellë të mrekullueshëm, unë do të vras një gaforre të madhe sa një derr...ose një breshkë gomar...dhe kur ta sjell në fshat do të mblidhen të gjithë për të na parë.

Dëshmojnë origjinalitet dhe pasuri semantike dhe forme, dy variantet e të ardhmes në gjuhën shqipe: “*e ardhmja e të shkuarës*” dhe “*e ardhmja e përparme e të shkuarës*”

E ardhme e të shkuarës: “...Po shyqyr që nuk i thashë gjë, se atëhere *do të shkelja* betimin...” (*Shpella e piratëve*, P. Marko, f. 52)

¹⁷⁸ “*Lingua, Grammatica, Stile*”, G. Tedeschi, Petrini, 1971.

E ardhme e përparme e të shkuarës: “...Mua më dogji! Patjetër që mësuesit *do t'i kishte rënë era...*Sidoqoftë, unë isha betuar të mos i kallëzoja njeriu...” (*Shpella e piratëve*, P. Marko, f. 52)

Prania e këtyre dy formave foljore është gjithashtu dëshmi e një gjuhe të përpunuar artistikisht.

PËRFUNDIME

Studimi “Vlerat stilistikore të kohëve të dëftores në gjuhën italiane, në përjasje me shqipen”, në përfundim të tij, solli edhe një tjetër përjasje: atë midis dallimeve të “kohës fizike” dhe kohëve gjuhësore, dallime këto që u japin jetë nuancave semantike dhe aspektore, me forcë shprehimore në ligjërim.

Pothuajse njësoj si me “kohën” dhe “hapësirën” e Ajnshtajnit, në të cilat raportet midis çastit të referimit dhe asaj që ndodh, vulosin këndvështrimin dhe përfundimet e “Vëzhguesit të pavarur”, edhe në kodet gjuhësore janë raportet e vendosura midis *çastit të ndodhisë* dhe *çastit të ligjërimin, të referimit, apo të leximit*, ato që vulosin perceptimin kohor të atij që ligjëron, dëgjon, apo lexon.

Një libër i Balzakut, Dikensit, apo Hygosë, na vjen natyrshëm në të tashmen e leximit, duke u bërë po aq i pranueshëm për lexuesin e apasionuar, sa një libër i Dino Buxatit, apo i Umberto Ekos. Fantazia e një rrëfimi historik vjen vrulltazi në imagjinatën e gjithsecilit prej nesh, duke lënë gjurmë dhe duke shenjuar njëherë e përgjithmonë këndvështrimin tonë për ngjarjet historike, ndërsa është po “Gjuha”, që na mundëson të përjetojmë realizimin e dëshirave në të ardhmen, ende pa mbërritur kjo e ardhme.

Fakti, lajmi, apo ndodhia, të cilat në pamje të parë ngjajnë si një tërësi kuptimore e pandryshueshme, qartësisht e pozicionuar në kohë dhe hapësirë, kthehen në objekt ndryshimesh nuancore, ndonjëherë edhe kuptimore, fortësisht të ndikuara prej përdorimit gjuhësor, duke kushtëzuar në këtë mënyrë edhe qëndrimin e publikut, ose lexuesit.

Përzgjedhja për të përdorur të kryerën e thjeshtë në vënd të së pakryerës, apo të ardhmen e përparme në vënd të së ardhmes së thjeshtë, bashkë më përzgjedhjen e krejt pjesës tjetër të materialit gjuhësor, nuk është thjesht një përdorim “teknik” gjuhësor, apo një çështje shije; mbi të gjitha, kjo përzgjedhje shpreh qëndrimin e ligjëruesit përkundrejt asaj që ai thotë dhe në mënyrë të vullnetshme, ose të pavullnetshme, një prirje për të ndikuar dhe për të komunikuar tek të tjerët, pikërisht këtë këndvështrim të tij.

Mbi këto shina është vendosur dhe orientuar edhe punimi i doktoraturës me titull “Vlerat stilistikore të kohëve të dëftores në gjuhën italiane, në përjasje me shqipen”

Për shkak edhe të natyrës së studimit, në pjesën e parë është marrë në shqyrtim “Gjuha” si koncept filozofik, duke u përpjekur të vendosen që në fillim disa pika referimi, që shërbejnë për të sqaruar mjaft çështje në pjesët dhe kapitujt pasardhës. Në këtë pjesë, është trajtuar natyra subjektive e gjuhës dhe funksioni i saj shprehës, në kuadër të një organizimi të “dytë gjuhësor”, i cili mbështet dhe plotëson organizimin “e parë gjuhësor” (fonetika, gramatika, leksikologjia, etj.).

Mbi bazën e këtyre dallimeve, është vënë theksi në “relativitetin” kuptimor të gjuhës, qoftë për shkak të kushteve të ndryshme në të cilat ndodhen përdoruesit e gjuhës gjatë procesit të komunikimit, qoftë për shkak të ndryshueshmërisë së vlerave në lidhje me kohën dhe vëndin, të cilit i përket produkti gjuhësor (vihet re më së shumti në gjuhën e shkruar).

Po në këtë kapitull, është studiuar një rindarje e pjesëve të Fjalës (sipas teorisë strukturaliste), duke futur konceptin e “*imazhit*” dhe duke i dhënë Fjalës “tre-dimensionalitet”. *Imazhi* është shqyrtuar dhe konsideruar i ndryshëm prej të “*shenjuarit*”, si një lloj “*Limbi*” dhe “*Logosi*” njëkohësisht, i përbashkët, në të cilin ngjizen mendimi, koncepti, madje edhe vetë Fjala, si elementi me ndikimin më të rëndësishëm në ngjyrimet dhe nuancat shprehimore, që i vishen fjalës prej ligjëruesve.

Një çështje tjetër, e trajtuar në pjesën e parë të punimit, gjithashtu e rëndësishme për identifikimin dhe trajtimin e vlerave stilistikore, është krahasimi dhe dallimet që janë bërë midis koncepteve të “*gjuhës në kohë*” dhe “*kohës gjuhësore*” (më hollësisht: “veprimi i foljes dhe koha e veprimit”, Kreu I, f.16), si dhe midis koncepteve të “*kohës fizike*” (ose objektive) dhe “*kohës gjuhësore*” (ose subjektive).

Më pas, ky punim paraqet një pamje të përgjithshme të mënyrës dëftore dhe mundësive shprehëse që shfaq ajo, duke e vështruar fenomenin si një udhëtim në kohë, nëpërmjet gjuhës.

Kreu i katërt i kushtohet kohës së tashme të mënyrës dëftore. Fenomeni i “të tashmes” në këtë pjesë të punimit trajtohet jo vetëm sipas standartit “*e tashme në të shkuarën, në të tashmen dhe në të ardhmen*”, por përcjell modele tërësisht të ndryshme dhe të dallueshme në vlera stilistikore dhe shprehimore, të cilave nëse u jepet rëndësia e duhur gjatë të shkruarit, apo të folurit, mund të kthehen në teknika elegante shprehëse. Dy janë kolonat mbi të cilat është ndërtuar analiza: bindja që situatat shprehimore nuk janë asnjëherë të ngjashme me njëra tjetrën, si dhe dallueshmëria dhe natyra e ndryshme e imazheve të konceptuara dhe të perceptuara, si produkt përfundimtar të ligjëruesit.

Prej analizës së kryer, në këtë kapitull janë vënë re edhe disa risi, si për shëmbull nuanca e “fiksimit të një të tashmeje në të shkuarën”, “zhvendosja e korpusit mendor të lexuesit në të shkuarën”, “zhvendosja e ngjarjeve në të tashmen e lexuesit”, e tashmja zakonore, e tashmja e foljeve që shprehin dëshirë, e tashmja e foljes “jam”, e tashmja e stilit burokratik, e tashmja e komentatorëve sportivë, etj.

Në këtë pjesë, ashtu si edhe në kapitujt në të cilët trajtohen kohët e tjera, këmbëngulet në faktin që kohët e dëftores, më shumë se për përcaktimin e kohës, shërbejnë për të orientuar në kohë dhe hapësirë veprimin, ligjëruesin, lexuesin, apo dëgjuesin.

I njëjti qëllim vërehet edhe në kapitullin, në të cilin trajtohet koha e pakryer. Shqyrtimi i rasteve me vlera të veçanta shprehimore nis me shprehjen e përdorur rëndom në rrëfime, sidomos në ato për fëmijë, “*C’era una volta*”, duke e kthyer kohën e pakryer të përdorur në këto shprehje, në një shëmbull të përdorimit të saj me vlera kohore universale, apo si një kohë që qëndron jashtë rrjedhës kohore fizike.

Janë marrë në shqyrtim nuanca të së pakryerës, që përftohen nga ballafiqimi midis kohës dhe lëvizjes të shprehur nga folja. Është fjala për lëvizjen në kohë dhe kohës së lëvizjes: këndvështrimi i parë i shqyrtuar nga një pozicion i afërt me lëvizjen, ose edhe nga brënda saj; rasti i dytë nga një këndvështrim i distancuar prej lëvizjes, që e shikon këtë të fundit si një të tërën.

Janë trajtuar gjithashtu mjaft aspekte të së pakryerës: zakonor, progresiv, i vazhdimësisë, i njëkohëshmërisë në të shkuarën, i të ardhmes në të shkuarën, etj., aspekte këto të shqyrtuara edhe me shumëllojshmëri rastesh të paraqitura, si dhe në përqasje me të njëjtat situata shprehimore në gjuhën shqipe.

Koha e pakryer e mënyrës dëftore është marrë në analizë edhe në struktura periudhash të posaçme, në përqasje me gjuhën shqipe, siç është rasti i fjalive hipotetike. Duke qënë se vetë struktura e fjalisë hipotetike lë të hapura mjaft interpretime me karakter kuptimor dhe aspektor, “sjellja” e kohës së pakryer brënda këtyre strukturave shfaq raste me mjaft interes studimor.

Në pjesën në të cilën trajtohet e pakryera rrëfimtare, rëndësi të veçantë i është kushtuar “*të pakryerës stilistikore*”, pra bashkimit të aspektit të formës gramatikore (të pakryerës) me aspektin që mbartin disa folje si *nis, filloj, mbaroj, vdes, vazhdoj*, etj. Një pjesë mjaft e madhe e shëmbujve të së pakryerës rrëfimtare janë marrë nga tekste letrare, qoftë ajo italiane, apo edhe shqiptare, duke u përpjekur që situatat shprehimore të përzgjedhura të kenë ngjashmëri.

Në një kapitull të veçantë janë trajtuar koha e kryer dhe koha e kryer e thjeshtë e mënyrës dëftore, qoftë me një ballafaqim kuptimor dhe përdorimor midis tyre, qoftë të marra në analizë si kategori gramatikore të veçanta. Është synuar që të dalin në pah edhe ndryshimet në vlera shprehimore, ose stilistikore, për të gjitha ato raste kur situata ligjërimore e lejon zëvendësimin e njërës kohë me tjetrën; ndryshime këto që të lejojnë të shikosh nga më afër fenomenin e zëvendësimit, si një fenomen që lidhet ngushtësisht me këndvështrimin dhe qëndrimin e ligjëruesit përkundrejt asaj që shpreh.

Një pjesë e veçantë, në këtë kapitull, i kushtohet dallimeve shprehimore në përdorimet e kohëve të kryera dhe kohës së pakryer, si dhe impakteve që sjellin këto përdorime në raportin ligjërues – mesazh. Skemat e shumta që janë përdorur në këtë pjesë të punimit, kanë patur për qëllim që t'i vijnë në ndihmë analizës për një qartësi më të madhe.

Koha e kryer e mënyrës dëftore është analizuar, në tërësinë e saj, në raport kohor me çastin e ligjërimit, qoftë në shëmbujt e përzgjedhur nga gjuha italiane, qoftë në shëmbujt e përzgjedhur nga gjuha shqipe. Janë shqyrtuar më me hollësi përdorime deiktike të kohës së kryer me vlera konotative, ku një prej elementëve më kryesorë të përzgjedhur si pikë referimi, është për shëmbull “*qëndrueshmëria në kohë e rezultateve të një veprimi*”. Në këtë kuadër, janë evidentuar disa nuanca stilistikore të kohës së kryer, në disa situata të veçanta shprehimore dhe ligjërimore, si për shëmbull kur kjo kohë përdoret në lajmet televizive, apo në titujt e gazetave; kur përdoret për të përcjellë tek të tjerët eksperiencia personale, apo edhe disa raste të tjera, kur në kontekste të caktuara e kryera paraqitet me vlerat e një kohe imperfektive, etj.

Janë analizuar gjithashtu edhe përdorime jo deiktike të kohës së kryer, kryesisht në rrethana të natyrës pragmatike dhe e koordinuar edhe me kohë të tjera foljore. Edhe në këtë pjesë është përdorur metoda e krahasimit, si dhe përdorimi i skemave, për ta qartësuar analizën e shëmbujve të sjellë sa më tepër që të jetë e mundur.

Ndër përdorimet e tjera të kohës së kryer që janë marrë në shqyrtim, në përjasje me shqipen, mund të përmëndim rastet e të kryerës me nuanca aktualiteti, rastet e të kryerës “jashtëkohore” (me shumëllojshmëri nënrastesh), etj.

Që në fillim, koha e kryer e thjeshtë është marrë në analizë si kohë rrëfimtare, me aspekte të ndryshme të saj dhe “vështruar” në situata pak a shumë të ngjashme, qoftë në gjuhën italiane, ashtu edhe në gjuhën shqipe.

Me interes paraqitet përdorimi gnomik i kohës së kryer të thjeshtë, për shkak edhe të këndvështrimeve të ndryshme që mund të hidhen mbi mesazhin e përcjellë prej ligjëruetit.

Në një kapitull të veçantë trajtohen koha më se e kryer dhe koha e kryer e tejshkuar.

Më se e kryera është shqyrtuar duke u nisur nga një logjikë kontekstuale e funksionimit të saj, me praninë e një çasti të ekzekutimit të veprimit, i vendosur ky në të shkuarën, përkundrejt referimeve të tjera kohore. Çasti i ekzekutimit të një veprimi, është marrë në konsideratë si çasti kur ka ndodhur veprimi dhe më pas është shqyrtuar intervali kohor, gjatë të cilit ka ndodhur ky veprim, në raport me rezultatin.

Janë bërë përpjekje që vlerat shprehimore dhe stilistikore të më se të kryerës, të dalin nga analiza e bërë mbi shëmbuj të shumtë dhe të shkëputur kryesisht nga tekste letrare, por që nuk ka përjashtuar edhe përdorime tipike të gjuhës së folur.

Për të nxjerrë në pah më mirë natyrën e më se të kryerës, kjo kohë është shqyrtuar edhe në raport me kohët perfektive, duke dalë në përfundimin që më se e kryera mbetet pak më e kufizuar në këtë drejtim. Si raste të veçanta të më se të kryerës, që janë marrë në analizë, mund të përmëndim: vlerat imperfektive të më se të kryerës, disa veçanësi modale të saj, etj.

Koha e kryer e tejshkuar është analizuar në raporte kohore të vendosura midis dy veprimeve apo ndodhive, duke u përpjekur të identifikojmë veçanësi shprehimore dhe stilistikore, që shfaqen nga ndryshimet e shprehura në këto raporte.

Në këtë punim, koha e kryer e tejshkuar, në gjuhën italiane, është konsideruar si një element gramatikor dhe gjuhësor i përdorur gjithmonë e më rrallë, për të shprehur sidomos një standart të lartë kulturor në gjuhë. Është vërejtur, edhe nëpërmjet shëmbujve të sjellë, fenomeni i zëvendësimit të kësaj kohe me më se të shkuarën, duke i dhënë jetë edhe disa ndryshimeve në nuanca shprehimore. Nëpërmjet shëmbujve, të përzgjedhur në gjuhën italiane dhe në gjuhë shqipe, qëllimi ka qënë për të sjellë disa situata të veçanta ligjërimore, veçanërisht të pranishme në gjuhën e folur.

Kohët e ardhme janë shqyrtuar tërësisht në përjasje me gjuhën shqipe, duke mbajtur parasysh edhe karakteristikat e veçanta të të dyja gjuhëve.

Është vënë në dukje ndarja e të ardhmes në dy kohë, në gjuhën italiane, si dhe tendenca për të dalluar katër kohë të së ardhmes në gjuhën shqipe, tendencë që mbështetet mbi disa nuanca aspektore, të pranishme edhe në gjuhën italiane.

Qëllimi ka qënë jo aq shumë për të nxjerrë në pah klasifikimet, se sa për të pasuruar kuptimet aspektore të kohëve të së ardhmes me shëmbuj të rinj. Janë qartësuar vlera modale dhe jo modale të së ardhmes, janë marrë në vlerësim nuanca aspektore që shprehin progresion, një të ardhme të supozuar, veprime zakonore, një të ardhme në të shkuarën, etj.

Është vlerësuar gjithashtu fakti, që në përshkrimet me karakter historik, e ardhmja e përparme përdoret për të bërë retrospektivë të ngjarjeve, duke e vendosur ligjëruesin në një “pozicion jashtëkohor” dhe duke i dhënë krejt ligjëritimit vlera stilistikore.

Kohët e të ardhmes janë shqyrtuar gjithashtu edhe në këndvështrimin e raporteve që ato krijojnë me kohën fizike, objektive.

Në përfundim të këtij punimi, mendojmë që analiza e kryer, rastet e trajtuara gjuhësore me vlera stilistikore, si dhe interpretimet e bëra mbi këto raste, kontribuojnë në evidentimin e vlerave shprehimore të gjuhës italiane, shqipe, por edhe të Gjuhës në përgjithësi, duke dhënë një ndihmesë tepër modeste në tërësinë e studimeve të kryera, por edhe tepër të vogël, përballë një realiteti gjuhësor tejet të pamatshëm dhe në zhvillim e ndryshim të vazhdueshëm.

Jetojmë të “zhytur në një realitet gjuhësor”, i cili na paraqitet si i vetmi realitet që ekziston. Gjuha kthehet në shkencë, histori, informacion, filozofi, politikë, letërsi dhe në një pafundësi aktivitete të Njeriut, duke u kthyer madje edhe në të vetmin mjet që merr në shqyrtim vetveten.

Në këtë realitet, të analizosh qoftë edhe vlerat stilistikore të kohëve të dëftores, nuk ka si të mos e ndjesh veten në rolin e peshkatarit të perlave, i cili pavarësisht koleksionit të pasur që mund të krijojë me kalimin e viteve, mbetet brënda vetes së tij i bindur, që ajo çfarë ndodhet ende në oqean, është pafundësisht më e mrekullueshme se koleksioni i tij.

BIBLIOGRAFIA

Fjalorët

1. “*Fjalor Shqip –Italisht*”, A. Preza, E. Preza, Elena Gjika, 2000.
2. “*Atlas i Ilustruar i Filozofisë*”, U. Nicola, I.S.P., 2004.
3. “*Dizionario della Lingua Italiana*”, Casa Editrice Bietti, 1965.
4. “*Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*”, G. L. Beccaria, Einaudi, 1994.
5. “*Dizionario di linguistica*”, Zanichelli, 1983.
6. “*Dizionario di Retorica e Stilistica*”, UTET, 2008.
7. “*Dizionario Enciclopedico Sansoni*”, 1986.
8. “*Enciclopedia Treccani*”, Editore Ist. Enciclopedie Italiane, 2009.
9. “*Enciclopedia Universale*”, Garzanti Libri, 2010.
10. “*Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*” Ist. i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 1980.
11. “*Fjalor i Gjuhës Shqipe*”, J. Thomai, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 2006.
12. “*Grande dizionario enciclopedico*”, Editore UTET, 2005
13. “*Italisht – shqip*”, F. Leka, Z. Simoni, “8 Nëntori”, 1986.
14. “*Piccola Enciclopedia Vallardi*”, Editore Vallardi.A., 2008.

Literatura Shkencore

15. “*Analisi grammaticale dei due tempi passati nell’italiano contemporaneo: passato remoto e passato prossimo*”, B. Esskali, Scholarly Paper, 2002.
16. “*Analisi stilistica*” A. B. Terracini, Feltrinelli, 1966.
17. “*Apogeo ed eclissi della stilistica*”, C. Segre, Einaudi, 1993.
18. “*Aspekti dhe mënyrat e veprimit foljor në gjuhën shqipe*”, A. Dhrimo, Libri Universitar, 1996.
19. “*Corso di linguistica generale*”, F. Saussure, Laterza, 1987 .
20. “*Critica stilistica e semantica storica*”, L. Spitzer, Laterza, 1966.
21. “*Dire, fare, capire*”, G. Bottiroli, D. Corno, T. De Mauro, Paravia, 1990.
22. “*Discorsi e progetti 2*”, M. Della Casa, M. Mambrini, LaScuola, 1980.
23. “*Fjalët e Ajnshtajnit*”, D. Gouthier, E. Ioli, Dituria, 2008.
24. “*Fra grammatica e vocabolario: studio sull’aspetto del verbo italiano*”, V. Lucchesi, Accademia Crusca: Studi di grammatica italiana 1, Sansoni, 1971.
25. “*Gramatika e gjuhës shqipe 1*”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002.
26. “*Gramatika e gjuhës shqipe 2*”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002.
27. “*Grammatica avanzata della lingua italiana*”, S. Nocchi, R. Tartaglione, Alma Edizioni, 2006.
28. “*Grammatica essenziale della lingua italiana*” M. Mezzadri, Guerra Edizioni, 2000.

29. *“Grammatica italiana con nozioni di linguistica”*, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1995.
30. *“Grammatica italiana: italiano comune e lingua letteraria”*, L. Serianni, UTET, 1988.
31. *“Grammatica italiana”*, A. Panzini, Sallerio Editore, 1982.
32. *“Grammatica italiana”*, G. Pittano, Bruno Mondadori, 1986.
33. *“Grammatica per italiani maggioreni”*, M. Luisa, A. Biagi, Mursia, 1989.
34. *“Grande grammatica italiana di consultazione”*, A. Salvi, G. Cardinaletti, Il Mulino, 1995.
35. *“Guida alla pratica della creatività”*, A. Rossetto, Fabbri Editori, 1980.
36. *“Guida allo studio della letteratura”*, R. Cesarani, Laterza, 1999.
37. *“I verbi italiani”*, S. Bailini, S. Consonno, Alma Edizioni, 2004.
38. *“Il divenire delle arti”*, G. Dorfles, Bompiani, 1998.
39. *“Il linguaggio”*, C. Schick, Einaudi, 1960.
40. *“Il segno del soggetto”*, E. Macola, L. Marcheselli, Editre Edizioni, 1983.
41. *“Impariamo l’italiano”*, C. Marchi, Biblioteca Universale Rizzoli, 1990.
42. *“Italiano antico e nuovo”*, G. L. Beccaria, Garzanti, 1988.
43. *“Komunikimi”*, X. Mignot, Ch. Baylon., përkthyes Xh. Lloshi, Tekste Universitare, 2005.
44. *“L’estetica come scienza dell’espressione e linguistica generale”*, B. Croce, Laterza, 1902.
45. *“La lingua come strumento di libertà”*, L. Nadin, Padova, 1990.
46. *“La lingua italiana per stranieri: corso superiore”*, K. Katerinov, Guerra, 1976.

47. *“La lingua italiana per stranieri”*, K. Katerinov, Guerra Edizioni, 2010.
48. *“La linguistica sincronica”*, M. Durante, Boringhieri, 1975.
49. *“La nuova grammatica della lingua italiana”*, M. Dardano, P. Trifone, Zanichelli, 1997.
50. *“Le diversità delle lingue”*, V.v. Humbolt, Laterza, 2004.
51. *“Le oscillazioni del gusto”*, G. Dorfles, Einaudi, 1990.
52. *“Lezioni di grammatica storica italiana”*, L. Seriani, Bulzoni, 2000.
53. *“Lingua e linguaggi”*, F. Sabatini, Loescher Editore, 1990.
54. *“Lingua, grammatica, stile”*, G. Tedeschi, Petrini, 1971.
55. *“Lingua, Grammatica, Stile”*, G. Tedeschi, Petrini, 1971.
56. *“Lo stile indiretto libero in italiano”*, G. Herczeg, G. C. Sansoni, 1963.
57. *“Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe”*, Sh. Demiraj, Prishtinë, 1971.
58. *“Relativiteti, teoria speciale dhe e përgjithshme”*, A. Ajnshtajni, Bargjini, Tiranë 2001.
59. *“Segno”*, U. Eco, Istituto Editoriale Internazionale, 1973.
60. *“Semiotica e filosofia del linguaggio”*, U. Eco, Einaudi, 1996.
61. *“Studi di stilistica”*, G. Devoto, LeMonier, 1950.
62. *“Tempo, aspetto e azione nel verbo italiano”*, P. M. Bertinetto, Edizioni Accademia Crusca.
63. *“Tense and aspect in the languages”*. Ö. Dahl, Mouton de Gruyter, 1989.
64. *“Time in language”* Wolfgang Klein, Routledge, London, 1994.

Literaturë mbështetëse.

65. *Apologeticum*, “ *Est modus*”, A. Piva, G. Sega, La Nuova Italia, 2002.
66. *Faust*, J. V. Goethe, përkthyer G. Scalvini, 1960.
67. *Historia e Skënderbeut*, Marin Barleti, Naim Frashëri, 1967.
68. “*Emblema e dikurshme*”, I Kadare, Naim Frashëri, 1977.
69. “*Il nome della rosa*”, U. Eco, Bompiani, 1989.
70. *Historia e Skënderbeut*, N. Frashëri, Naim Frashëri, 1962.
71. “*Le canzoni di re Enzo*”, G. Pascoli, Arnoldo Mondadori Editore , 1974.
72. “*Promessi sposi*”, A. Manzoni. Garzanti, 2008
73. “*Della canzone di Legnano*”, G. Carducci, Zanichelli, 1980.
74. “*La Divina Commedia*”, D. Alighieri, Mediabook, 2005.
75. “*Il pendolo di Foucault*”, U. Eco, Bompiani, 2004.
76. “*Ali Pashë Tepelena*”, S. Godo, Artemida, 1993.
77. “*Vepra letrare*”, L. Poradeci, Naim Frashëri, 1990.
78. “*Shpella e piratëve*”, P. Marko, Botimet Almeria, 2007.
79. “*Sonete*”, E. Çabej, Botime Çabej, 2008.
80. “*Fausti*”, J. V. Gëte, shqipërues S. Luarasi, Infbotues, 2004.
81. “*Costituzione della Repubblica Italiana*”, Istituto Poligrafico e Zecca dello Stato, 2008.
82. “*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*”, Miratuar nga Kuvëndi Popullor, 1998.
83. “*Poezi të zgjedhura*”, I. Kadare, Naim Frashëri, 1982.

84. “*Il trionfo della morte*”, G. D’Annunzio, Edizione elettronica WWW.liberliber.it, 2010.
85. “*Il garofano rosso*”, E. Vittorini, Bompiani, 1946.
86. “*Il gattopardo*”, G. Tomasi di Lampedusa, Feltrinelli, 1988.
87. “*Il nome della rosa*”, U. Eco, Bompiani, 1985.
88. “*Gli indifferenti*”, A. Moravia, Bompiani, 2000.
89. “*I pirati della malesia*”, E. Salgari, Garzanti editore, 1986.
90. “*Fiabe italiane*”, I. Calvino, Mondadori, 1993.ù
91. “*I cinque libri*”, G. Rodari, Einaudi, Libreria Universitaria, 2005.
92. “*Piccolo mondo antico*”, A. Fogazzaro, Garzanti Libri, 2009.
93. “*La corona di Nana Sahib*”, L. Motta, Ditta G.B.Paravia, 1922.
94. “*Tregime të moçme shqiptare*”, M. Kuteli, Edlor, 2004.
95. “*Albumi*”, F. Noli, Naim Frashëri, 1966.
96. “*La casa di via Valadier*”, C. Cassola, Einaudi, 1956.
97. “*Le lande di fuoco*”, R. A. Salvatore, Gruppo editoriale Armenia, 1982.
98. “*Il sergente nella neve*”, M. Rigoni Stern, Atuttascuola, 1953.
99. “*Il giuramento del corsaro nero*”, E. Salgari, Garzanti Editore, 1986.
100. “*Cristo si è fermato a Eboli*”, C. Levi, Einaudi editore, 2010.
101. “*Këngë popullore të Labërisë*” 8, Mbledhës, I. K. P. Akademia e Shkencave, 1991.